

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Pregatitën materialin:

Irma Baraku Komisionere

Ardiana Hala Drejtore në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe
Marrëdhënieve me Jashtë

Blerina Pirani
Amarda Çoku
Mirela Rrumbullaku

Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Artan Xhindi Inspektor në Drejtorinë e Hetim-Inspektimit

Shtypur nga : Classic Print

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Informacion mbi institucionin mund të gjeni në internet(www.kmd.al)

Printuar në Tiranë, 2015

HYRJE

Në shkurt të vitit 2010 është miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Ky ligj synon të garantojë ndihmë për viktimat e diskriminimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon disa mundësi për tu mbrojtur nga sjelljet diskriminuese, duke shfrytëzuar instrumente e struktura të ndryshme ligjore dhe institucionale. Ai parashikon mbrojtjen nga sjelljet diskriminuese pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe trajtimin e çështjeve të diskriminimit në gjykatë si rrugët më efikase për tu ndjekur. Pavarësisht mjeteve ligjore që viktima e sjelljes diskriminuese përdor, është e rëndësishme që institucionet që e trajtojnë çështjen të njohin mirë legjislacionin në fuqi, të dinë të evidentojnë elementet që ka një sjellje diskriminuese në çështjen që shqyrtojnë, në mënyrë që të japin një vendim apo zgjidhje ligjore me një nivel të lartë profesionalizmi. Duke qenë se në Shqipëri kemi të bëjmë me zbatimin e një ligji të ri dhe në mungesë të një praktike ligjore administrative dhe gjyqësore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka mbajtur parasysh aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj dhe në mënyrë të veçantë jurisprudencën e mekanizmave ndërkombëtare që sigurojnë zbatimin e këtyre akteve.

Duke qenë se trajtimi i çështjeve të diskriminimit përfshin aktorë të ndryshëm si: stafin e KMD-së, përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore, përfaqësues të OJF-ve, prokurorë e gjyqtarë, e çmuam të rëndësishëm realizimin e botimit të një përmbledhjeje të dytë të vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Disa nga vendimet e KMD, sipas fushave dhe shkaqeve të ndryshme për të cilat garantohej mbrojtje në ligj, janë përzgjedhur për këtë botim si vendimet më kyçe tek të cilat është bazuar edhe për raste të tjera analoge vendimmarrja e Komisionerit, duke krijuar në këtë mënyrë një praktikë administrative të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Irma Baraku
Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Dhjetor 2015

ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJINISË

Ankesa e znj. A.K, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, ku pretendohet diskriminimi për shkak të “*bindjeve politike*” dhe të “*gjinisë*”.

V E N D I M Nr. 51 / 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. A.K shpjegon se: “*Ka filluar punë pranë Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (ALSSH-së) Has, më datë 16.01.2013, në detyrën “Inspektore Bujkut Privat për Komunitet Fajza e Gjinaj”. Ajo është larguar nga puna nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSH-së) Kukës, më datë 18.02.2014, me motivacionin e shkurtimit të vendit të punës. Ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, pasi bashkëshorti i saj, U.Sh. është anëtar i PD-së, dhe vjehrrri i saj është kryetar i PD-së për seksionin Vranisht. Gjithashtu, ankuesja pretendon se është diskriminuar edhe për shkak të gjinisë, pasi është zëvendësuar me një punonjëse të gjinisë tjetër dhe anëtar të PS-së. Ajo pretendon se pozicioni i saj i mëparshëm i punës kishte si kriter arsimin e lartë, Fakultetin Ekonomik, të cilin ajo e përmbysh.*”

1.2. A.L., me pozicion Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Kukës, u vu në dijeni në rrugë shkresore për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës, ku iu kërkua informacion mbi pretendimin e ngritur nga A.K. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, me gjithë afatet e përcaktuara në ligj për t’iu përgjigjur kërkesës së Komisionerit, nuk e përmbyshi detyrimin ligjor.

1.3. Me datë 15.01.2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Kukës. Grupi i inspektimit u takua me A.L (Drejtori), i cili hodhi poshtë pretendimet e ankueses dhe me Sh.D.(Shef i Degës së Administrimit të Përgjithshëm), të cilit iu kërkua të njiheshin me dokumentacionin e dosjeve personale të A.K. dhe A.Xh., i cili ishte emëruar në pozicionin e punës që mbante ankuesja para largimit të saj.

1.4. Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore mes palëve ku ishte e pranishme pala kundër së cilës bëhej ankesa dhe në mungesë të subjektit ankues.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. A.K ka filluar marrëdhëniet e punës me DRSSH-në Kukës, me Urdhërin nr. 5, datë 10.01.2013, në pozicionin e punës Inspektore Bujku për komunitet Fajza-Gjinaj. Personi që e ka zëvendësuar, është emëruar me shkresën me nr. 932 Prot., datë 08.04.2014.

2.2. Me datë 25.02.2014 është njoftuar se marrëdhëniet e saj të punës me këtë institucion do të shpëputeshin me datë 28.05.2014 (me mbarimin e afatit të njoftimit), pasi *për shkak të rristrukturimit të institucionit, pozicioni i punës si inspektor bujku nuk ekziston. Në fakt, nga inspektimi rezulton se vendi i punës vazhdon të jetë edhe pas largimit të znj. A.K.*

2.3. Kriter për këtë pozicion pune është që *punonjësi duhet të ketë arsimin e Lartë Ekonomik. A.K mbante këtë pozicion pune në përputhje me kriteret e përcaktuara. Ndërkohë, A.XH. ka depozituar në dosje një Vertetim, me anë të të cilit provohet se ka mbaruar shkollën e mesme,*

në degën Ekonomik, pa shpëputje nga puna, në vitin 1988-1989. Në dosjet personale të këtyre punonjësve nuk kishte kontrata pune dhe emërimet janë bërë me Urdhërat përkatës.

3. BAZA LIGJORE

- 3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*
- 3.2. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese në fushën e punësimit. Konkretisht, në nenin 12, pika 1, germa b) parashikon: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. **Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:** c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*__
- 3.3. Neni 3, pika 2, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *...“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

4. OPINION

- 4.1. A.K është trajtuar ndryshe, në mënyrë të pafavorshme, duke u larguar nga pozicioni i punës (Inspektore Bujku, në Komunën Fajza, Gjinaj), *me motivimin e shkurtimit të pozicionit të punës, ndërkohë që ky pozicion ekziston edhe pas ndryshimit të strukturës dhe duke u zëvendësuar (pavarësisht se plotëson kriteret e arsimit që kërkon ky pozicion pune) nga një nëpunës që nuk i plotëson kriteret e kërkuara për këtë pozicion pune.*
- 4.2. Subjekti ankues pretendon se një nga shkaqet e diskriminimit të saj nga ana DRSSH, Kukës, janë bindjet e saj politike, pasi bashkëshorti i saj, U.Sh është anëtar i PD-së dhe vjehrrin e saj është kryetar i PD-së për seksionin Vranisht (pretendime të vërtetuara përmes kartave përkatëse të antarësisë, të cilat mbajnë datën 14.05.2014). Siç shihet, faktet për të cilat ankuesja pretendon se ka ndodhur diskriminimi, kanë ndodhur para anëtarësimit të të afërmeve të saj në këtë parti politike.
- 4.3. Parë në një këndvështrim krahasues, vihet re se:
- Në strukturën e vjetër të DRSSH-së Kukës, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) Inspektorë Bujku gjithsej, (të emëruar në komuna të ndryshme), 4 (katër) prej tyre janë femra.

- Në strukturën e re të DRSSH-së Kukës, nga 11 (njëmbëdhjetë) Inspektorë Bujku gjithsej, (të emëruar në komuna të ndryshme), nuk ka asnjë femër në pozicionin e punës Inspektore Bujku. Për më tepër, janë larguar punonjëset femra me arsim të lartë, të cilat janë zëvendësuar me punonjës meshkuj pa arsimin e kërkuar sipas pozicionit përkatës në Strukturë (arsimi i lartë ka qenë kriter si në strukturën e re ashtu edhe të vjetrën). ***Në kuadër të zbatimit të këtij ligji, Komisioneri, konstaton se subjekti ankues është diskriminuar për shkak të gjinisë, lidhur me largimin e saj nga puna.***

- 4.4. DRSSH Kukës pretendon se motivi i largimit nga puna është ristrukturimi. Nga verifikimi i dokumentacionit vërejmë se në Strukturën e re organizative të DRSSH-së Kukës, ka shkurtime në numrin e punonjësve, pasi nga 16 Inspektorë Bujku që ishin në strukturën e vjetër, aktualisht janë 11 Inspektorë Bujku. Por, pozicioni i punës Inspektor Bujku për komunën Fajza, Gjinaj nuk është shkurtuar, por thjesht është zëvendësuar nga një punonjës tjetër, i cili nuk ka arsimimin e kërkuar, në përputhje me kriteret për pozicionin e punës si Inspektor Bujku. ***Pra, gjendemi në kushtet e trajtimit më pak të favorshëm të A.K në kushte të njëjta pa një motivimin objektiv dhe të arsyeshëm.***
- 4.5. DRSSH nuk ka parashtruar asnjë arsye mbi largimin e punonjësve femra dhe zëvendësimin në këtë strukturë në një nivel 100% me punonjës meshkuj.

5. VENDIMI

- 5.1. Konstatimi i mosdiskriminimit për shkak të bindjeve politike, të A.K., nga ana e DRSSH-së Kukës.
- 5.2. Konstatimi i diskriminimit të drejtëpërdrejtë, për shkak të gjinisë të A.K, nga ana e DRSSH-së Kukës.
- 5.3. Në referim të pikës 2, të këtij vendimi, DRSSH Kukës, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj A.K., të bëjë rikthimin e saj në vendin e punës, si Inspektore Bujku.
- 5.4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, DRSSH Kukës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJINISË, SHTATËZANISË DHE GJENDJES SHËNDETËSORE

Ankesë e znj. E. H, kundër Shoqërisë “Protec Shoes” shpk, ku pretendohet për diskriminim të saj, për shkak të “gjinisë, shtatëzanisë dhe gjendjes shëndetësore”.

VENDIM NR.146/2014

1.PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Znj. E. H shpjegon se: “Ka qenë punonjëse, financiere, pranë “Protec Shoes” shpk, që prej datës 18.04.2012. Ndërmjet saj në pozicionin e punëmarrëses dhe Shoqërisë “Protect Shoes” sh.p.k. në pozicionin e punëdhënësit ka qenë lidhur një kontratë pune me afat të caktuar, deri në datën 02.07.2013. Ankuesja pretendon se përfaqësuesi shqiptar i firmës së sipërpërmendur fillimisht i ka komunikuar se kontrata e saj e punës përfundonte në datën 02.07.2013 dhe se ajo nuk do të ripërtërihej më dhe kjo ndodhi vetëm 2 ditë pasi ajo kishte lindur fëmijën e saj dhe ishte ende në maternitet, fakt që e ka rënduar së tepërmi gjendjen shëndetësore të lehonës. Më pas, nëpërmjet shkresës së datës 02.05.2013, së Shoqërisë “Protect Shoes” shpk, ankueses i komunikohet zyrtarisht fakti, se kontrata e saj nuk do të rinovohej më, pas përfundimit të këtij afati. Ndërkohë, ajo ishte me raport barrë-lindjeje¹, pas një procesi lindjeje² tepër të vështirë dhe të shoqëruar nga gjendje shëndetësore jo e mirë e lehonës dhe e fëmijës së sapolindur. Ankuesja pretendon për diskriminim të saj për shkak të gjinisë, shtatëzanisë dhe gjendjes shëndetësore, nga ana e Shoqërisë “Protec Shoes” shpk”.

1.2. Mbështetur në nenin 33³, pika 7, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua z. A. D, Administrator i Shoqërisë “Protec Shoes” shpk, me shkresën nr. 496/1, datë 27.05.2014, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e ankueses E. H.

1.3. Në vijim të procedurave hetimore, në datën 08.07.2014, u realizua takimi me ankuesen E. H, e cila u paraqit pranë ambienteve të Komisionerit për të dhënë informacion shtesë mbi ankesën e saj.

1.4. Në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim kryerjen e verifikimeve të nevojshme mbi ankesën e znj. E. H, në datën 26.06.2014, kreu inspektim pranë Shoqërisë “Protec Shoes” shpk.

1.5. Komisioneri vendosi që në datën 31.07.2014, të realizojë një seancë dëgjimore, ku palët u ftuan të merrnin pjesë, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre. Në seancë u paraqit vetëm pala ankuese, ndërkohë që përfaqësuesit e Shoqërisë “Protec Shoes” shpk nuk u paraqitën.

1 Nga dokumentacioni i dorëzuar prej ankueses, pranë Komisionerit, rezulton se ajo është paguar me raport lindjeje nga data 21.01.2013, deri në datën 16.12.2013.

2 Ankuesja ka qenë e shtruar pranë Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” në Repartin e Reanimacion-Obstetrik, nga data 20.01.2013, deri në datën 25.02.2013. Gravidanca ka qenë 30-31 javëshe, preklampsia e rëndë. Fëmija ka qenë podalik lindur në datën 21.01.2013.

3 Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Znj. E.H. ka punuar në pozicionin e financieres pranë Shoqërisë “Protec Shoes” shpk, që prej datës 18.04.2012. Ndërmjet saj dhe Shoqërisë “Protec Shoes” shpk, në pozicionin e punëdhënësit, ka qenë lidhur një kontratë pune me afat të caktuar, deri në datën 02.07.2013. Në datën 21.01.2013, ankuesja E.H. i ka dhënë jetë vajzës së saj, në muajin e shtatë të shtatëzannisë me operacion cezarian. Fëmija i lindur prematur peshonte vetëm 900 gram dhe 2 muajt e parë të jetës i ka kaluar në inkubator. Gjendja shëndetësore e nënës dhe fëmijës ka qenë kritike. Një fakt i tillë provohet edhe me vërtetimin e datës 05.05.2014⁴ si dhe nga Epikriza Përcjellëse, lëshuar nga Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë.

2.2. Nëpërmjet shkresës së datës 02.05.2013, ankueses i komunikohet zyrtarisht fakti, se kontrata e saj nuk do të rinovohej më pas përfundimit të afatit të caktuar në të, domethënë pas datës 02.07.2013, ndërkohë që znj. E. H ishte me raport barrë-lindjeje, fakt që vërtetohet nëpërmjet vërtetimit nr. 15/4, datë 15.04.2014⁵ të lëshuar nga Agjensia e Sigurimeve Shoqërore Krujë.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Neni 107/1 i Kodit të Punës, parashikon shprehimisht: “Eshtë e pavlefshme zgjidhja e kontratës së punës e njoftuar nga punëdhënësi në periudhën gjatë së cilës gruaja pretendon për të përfituar të ardhura nga Sigurimet Shoqërore në rast lindjeje ose birësimi”.

3.2. Neni 147, pika 1 dhe 2 e Kodit të Punës, parashikon: “1. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi kryen shërbimin ushtarak, përfiton pagesë paaftësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të dhëna nga punëdhënësi. 2. Kur zgjidhja e kontratës bëhet para se punëmarrësi të thirret në shërbimin ushtarak, të jetë me paaftësi të përkohshme në punë ose të jetë me pushime të dhëna nga punëdhënësi dhe afati i njoftimit nuk ka përfunduar, ky afat pezullohet për periudhën e kryerjes së shërbimit ushtarak, të paaftësisë së përkohshme në punë ose të pushimeve të dhëna nga punëdhënësi dhe rifillon pas përfundimit të kësaj periudhe”.

3.3. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

4. OPINION

4.1 Znj. E.H. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e Shoqërisë “Protec shoes” shpk, në krahasim me punonjës të tjerë të saj. Ky trajtim, ka lidhje të drejtpërdrejtë me gjininë e saj si femër. Ajo është bërë nënë dhe si e tillë ka qenë e detyruar t’i përkushtohet fëmijës së saj, duke marrë lejen e lindjes

4 Në vërtetim citohet shprehimisht se : “Znj. E.H. është shtruar në maternitetin tonë nga data 20.01.2013, deri më datën 25.02.2013 në Repartin e Reanimacion-Obstetrik, me nr. Karte 423, me diagnozë “gravidancë 30-31 javëpreklampsia e rëndë, diskako placente, lindje me sexio cezarea”.

5 Në vërtetim citohet shprehimisht se znj. E.H. është paguar me raport barrë lindjeje për periudhën 21.01.2013 – 16.12.2013.

për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë, leje e cila është e mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore. Një fakt i tillë nuk është marrë në konsideratë nga Shoqëria “Protec shoes” shpk.

4.2. Ankuesja është diskriminuar, duke e njoftuar në një kohë të papërshtatshme për zgjidhjen e kontratës së punës në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës, si dhe duke e zëvendësuar atë me një punonjës të seksit mashkull, me të cilin ka lidhur kontratë pune në një kohë që kontrata e punës me znj. E. H nuk kishte përfunduar ende, sikurse provohet edhe nga vertetimi nr. 15/4, datë 15.04.2014 të lëshuar nga Agjensia e Sigurimeve Shoqërore Krujë.

4.3. Ankuesja është njoftuar për zgjidhjen e kontratës së punës në një kohë kur po kalonte peripeci shëndetësore dhe si punëmarrëse e kishte njoftuar punëdhënësin e saj “Protec shoes” se kishte sjellë në jetë fëmijën e saj dhe ishte me leje barrë-lindjeje. Gjatë kësaj kohe, ajo do të përfitonte pagesë nga Sigurimet Shoqërore dhe jo nga Shoqëria “Protec shoes” shpk.

4.4. Zgjidhja e kontratës së punës nga Shoqëria “Protec shoes” shpk është e pavlefshme, përsa kohë punëmarrësi, znj. E. H, përfiton të ardhura nga Sigurimet Shoqërore, për shkak të lejes së barrë-lindjes⁶. Shoqërisë i lind e drejta e rilogaritjes së afatit të njoftimit pas përfundimit të afatit një vjeçar të parashikuar nga Kodi i Punës⁷.

4.5. Nga korrespondenca elektronike e ankueses me drejtues të shoqërisë “Protec shoes” shpk rezulton se ankuesja i ka kërkuar palës së paditur të kthehet në punë pas 45 ditësh pas lindjes, meqënëse kontrata e saj përfundonte në datën 02.07.2013, ndërkohë që përfaqësuesit e Shoqërisë i janë përgjigjur se ajo ishte zëvendësuar me dikë tjetër.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjinisë dhe paaftësisë së përkohshme në punë, të znj. E.H. nga ana e Shoqërisë “Protec Shoes” shpk.

5.2. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme nga ana e administratorit të Shoqërisë “Protec shoes” shpk, për njohjen e të gjithë punonjësve të kësaj shoqërie, me ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe një kopje e këtij ligjit të afishohet në ambientet e brendshme të Shoqërisë.

5.3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Shoqëria “Protec shoes” shpk, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

5.4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

6 Nenin 107/1 i Kodit të Punës, parashikon shprehimisht se: “Është e pavlefshme zgjidhja e kontratës së punës e njoftuar nga punëdhënësi në periudhën gjatë së cilës gruaja pretendon për të përfutur të ardhura nga Sigurimet Shoqërore në rast lindjeje ose birësimi”.

7 Neni 147, pika 1 dhe 2 e Kodit të Punës: “1. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi kryen shërbimin ushtarak, përfiton pagesë paaftësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të dhëna nga punëdhënësi. 2. Kur zgjidhja e kontratës bëhet para se punëmarrësi të thirret në shërbimin ushtarak, të jetë me paaftësi të përkohshme në punë ose të jetë me pushime të dhëna nga punëdhënësi dhe afati i njoftimit nuk ka përfunduar, ky afat pezullohet për periudhën e kryerjes së shërbimit ushtarak, të paaftësisë së përkohshme në punë ose të pushimeve të dhëna nga punëdhënësi dhe rifillon pas përfundimit të kësaj periudhe”.

ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË “BINDJEVE POLITIKE”

Ankesa e paraqitur nga A.T, me objekt pretendimin për diskriminim “ për shkak të bindjeve politike” nga ana e z. A.H, Administrator i Përgjithshëm i Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.

V E N D I M Nr. 133/2014

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. A.T shpjegon se: “Ka punuar si specialist në Sektorin Mekanik të Departamentit të

Mirëmbajtjes pranë KESH sh.a. që me datë 16.11.2009 me kontratë pa afat të caktuar. Me shkresën e datës 01.11.2013, është njoftuar mbi fillimin e bisedimeve për zgjidhjen e Kontratës së Punës, për shkak të ristrukturimit të Departamentit të Mirëmbajtjes. Me anë të shkresës me datë 07.11.2013, nr. Prot. 6177/1, është njoftuar se përfundimi i kontratës të punës, do të bëhej me datë 06.01.2014, sipas afatit ligjor të njoftimit sipas Kodit të Punës. Ankuesi pretendon se, pas datës 18.11.2013, nuk është lejuar të paraqitej në punë për të kryer detyrën e tij, duke i hequr numrin e telefonit, kartën e aksesit dhe e-mailin e punës, si dhe është shkarkuar në mënyrë verbale nga të gjitha detyrat që ka patur, megjithëse është paguar deri më 06.01.2014. Po kështu, ai pretendon se nuk ka marrë shpërblimin e vitit 2013, ndërkohë që kolegët e tjerë e kanë marrë. A.T pretendon se në vend të tij është emëruar një punonjës tjetër, pa arsim të lartë, gjë që sipas ankuesit tregon që jo vetëm nuk ka patur ristrukturim me zvogëlim të numrit të punonjësve, por ka ndodhur e kundërta”. Për sa më sipër, A.T, me datë 6 Nëntor 2013, ka bërë një kërkesë për rishqyrtim të shkepëtjes së marrëdhënieve të punës, drejtuar Administratorit të Përgjithshëm të KESH sh.a, pasi duke qenë se është edhe kredimarrës, ndodhet në një situatë të vështirë ekonomike. Po kështu, me datë 12 Nëntor 2013, ka bërë kërkesë për aktivizimin e e-mailit dhe të numrit të telefonit të punës. Subjekti ankues pretendon se i është bërë presion për të dorëzuar tavolinën e punës nga ana e Shefit të Personelit, i cili i ka thënë se s’ duhet të kishte dalë në punë. Ai ka qenë edhe anëtar i Këshillit Mbikqyrës të TEC-it të Vlorës dhe është hequr nga ky pozicion pa shkresë zyrtare nga ana e Administratorit të Përgjithshëm.

1.2. Me shkresën Nr. 297/1 prot, datë 18.03.2014 u njoftua dhe ju kërkua informacion A.H, Administrator i Përgjithshëm i Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.

1.3. Me datë 18.04.2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim në ambjentet e Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., në lidhje me shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së A.T, si dhe për të kryer verifikimet e nevojshme. Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore, pranë KESH sh.a, Tiranë, kërkoi që t’i lihej një afat kohor prej një jave, për të dërguar pranë Zyrës së Komisionerit gjithë dokumentacionin shkresor të specifikuar në urdhërin e inspektimit.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Administratori i Përgjithshëm i KESH sh.a, Tiranë, përmes shkresës me nr. 1967/1 Prot., datë 30.04.2014, sqaroi se: Numri i punonjësve të KESH sh.a në fillim të vitit 2013 ishte 1004 punonjës,

miratuar me Vendim të Këshillit Mbikqyrës me nr. 3, datë 12.02.2013, numër i cili në muajin Qershor 2013 shkoi në 1053 punonjës, miratuar me Vendim të Këshillit Mbikqyrës me nr. 17, datë 07.06.2013. Me vendimin nr. 4, datë 23.10.2013 Këshilli Mbikqyrës i KESH sh.a, miratoi strukturën e re të Koorporatës, duke përcaktuar dhe numrin e punonjësve, i cili zbriti në 996, pra 57 më pak. Në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikqyrës u programua edhe puna për ristrukturimin e shoqërisë, duke u bazuar në elementët teknikë e profesionalë të çdo punonjësi. Pas vlerësimit të këtyre elementëve, rezultoi se A.T nuk plotësonte kriterin bazë, atë të përputhshmërisë së arsimit me vendin e punës. Kjo, pasi A.T ka mbaruar Shkollën e Lartë të Arsimit Pedagogjik e Teknologjik, Athinë, ndërkohë që vendi i punës kërkon specialist të diplomuar në Universitet, në profilin Inxhinier Mekanik me cikël të plotë. Përfaqësuesja e KESH sh.a, pretendon se ankuesi nuk ka arsimin përkatës, pasi ai është diplomuar për mësuesi të inxhinierisë mekanike. Kërkesës për një dokument që të bënte përshkrimin e punës përmes të cilit të verifikoheshin kriteret e përcaktuara për pozicionin përkatës, A.B u përgjigj se nuk i disponon, por do t'i nisë në rrugë zyrtare me shkresë.

2.2. Me shkresën me nr. 1967/3 Prot., datë 18.06.2014 A.H, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: Arsimi i A.T është për pedagogji dhe pozicioni i punës në Sektorin e Sistemit mekanik të Departamentit të mirëmbajtjes pranë KESH sh.a, nuk ka të bëjë me pedagogjinë. A.H bën me dije se është detyruar të punësojë rishtaz në këtë institucion vetëm në rastet kur persona me profesione të caktuara i mungonin kësaj strukture.

2.3. Rroga e 13-të i është dhënë të gjithë punonjësve në marrëdhënie pune me KESH sh.a, dhe jo punonjësve për të cilët kishin filluar bisedimet për zgjidhjen e kontratës së punës, njëri prej të cilëve ishte edhe A.T. Në dosjen e A.T nuk është janë gjendur as vlerësime pune dhe as vërejtje apo masa disiplinore. Pranë KESH sh.a, nuk është ngritur asnjë komision për marrjen në dorëzim e materialeve të zyrës së A.T.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese në fushën e punësimit. Konkretisht, në nenin 12, pika 1, germa b) parashikon: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës.”

4. OPINION

4.1. Komisioneri konstaton se qëndrimi i KESH është jo korrekt, pasi për fillimin e bisedimeve për zgjidhjen e Kontratës së Punës, me nr. 6177 Prot., datë 01.11.2013 apo të njoftimit të zgjidhjes përfundimtare të Kontratës së Punës me nr. 6177/1 Prot., datë 07.11.2013, shkaku zyrtar i largimit nga

puna të ankuesit është ristrukturimi (shkurtimi i vendit të punës) dhe jo mospërputhshmëria e arsimit të ankuesit me vendin e punës.

4.2. KESH sh.a ka dërguar edhe një kopje të dokumentit “Diplomë” të z.A.T., i cili merr titullin “Inxhinier Mekanik i Arsimit Teknologjik”. Të gjitha pretendimet e parashtruara nga Koorporata janë verbale. Mbetemi të mendimit se pretendimi i KESH sh.a nuk qëndron, pasi, duke marrë në konsideratë faktin që shkurtimet që do të realizonte KESH sh.a do të cënonin së pari personat që nuk plotësonin kriteret profesionale që kërkonte vendi i tyre i punës, nuk është dërguar asnjë dokument shkresor me përshkrimet e pozicionit të punës, ku të përcaktoheshin edhe kriteret e kërkuara për pozicionin e specialistit në të cilin ishte emëruar A.T. (ku të ishte i specifikuar edhe arsimimi i kërkuar).

4.3. Nga shqyrtimi i Strukturës organike të KESH sh.a miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 3, datë 12.01.2013 në Divizionin e Gjenerimit, në Departamentin e Mirëmbajtjes, rezultojnë të jenë 10 (dhjetë) punonjës. Ndërkaq në Strukturën organike të KESH sh.a miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 4, datë 23.10.2013 në Divizionin e Gjenerimit, në Departamentin e Mirëmbajtjes, rezultojnë të jenë 15 (pesëmbëdhjetë) persona, pra 5 (pesë) më shumë se në strukturën e mëparëshme, çka dmth se nuk kemi reduktim të numrit të punonjësve, përkundrazi. Është e vërtetë që në Strukturën e re ka 57 punonjës më pak sesa në Strukturën e mëparëshme, por kjo vlen për Shoqërinë e KESH sh.a në rang kombëtar, ndërsa verifikohet se për rastin specifik të Departamentit të Mirëmbajtjes ku ishte i punësuar z. A.T, kemi rritje në numër të punonjësve. **Pra reduktimi i numrit të punonjësve nuk është shkak i drejtëpërdrejtë për largimin nga puna të z. A.T.**

4.4. *Lidhur me pretendimin e A.T se është diskriminuar duke mos mos iu paguar rroga e 13-të,* Komisioneri konstaton se ai është trajtuar ndryshe në krahasim me punonjësit e tjerë që e kanë përfituar atë dhe kanë qenë në kushte të njëjta, në marrëdhënie pune me KESH sh.a pasi përfundimi i Kontratës së Punës mes ankuesit dhe kësaj Shoqërie është bërë me datë 06.01.2014. Lista e personave të cilët kanë përfituar rrogën e 13-të apo kopja e Urdhërit për miratimin e listës së personave që e kanë përfituar atë, nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit nga ana e KESH sh.a, siç ishte kërkuar në shkresën nr.540 Prot., datë 30.05.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. **Shpërblimi ishte për punën që çdo punonjës i Koorporatës ka kryer gjatë vitit 2013 dhe është e paarsyeshme që ankuesi të përjashtohet nga përfitimi i këtij shpërblimi.**

4.5. Komisioneri e gjen të pabazuar në ligj shpjegimin që jepet nga KESH sh.a., se A.T “e kanë trajtuar sipas Kodit të Punës, në mënyrë të drejtë dhe rigorozë”. Komisioneri ka kërkuar një kopje të Listë-prezencës së punonjësve të Departamentit të Mirëmbajtjes për periudhën Nëntor-Dhjetor 2013, gjë që është refruzuar nga KESH sh.a. Ndërsa, lidhur me pretendimin për marrjen në dorëzim të materialeve të zyrës së ankuesit pa praninë e tij, nuk u bë i mundur verifikimi i këtij fakti, pasi nuk na është paraqitur një dokument ku të vertetohej ngritja e një Komisioni të tillë, as nga vetë subjekti ankues dhe as nga ana e KESH sh.a. KESH sh.a, në shkresën me nr. 1967 prot., datë 18.06.2014 mohon faktin që të jetë ngritur një Komision i tillë.

4.6. Arsyeja e largimit të tij nga puna, kanë qenë bindjet politike, pasi ai është anëtar i Partisë Demokratike⁸. Punëdhënësi nuk ka sjellë asnjë fakt që të hedhë poshtë pretendimet e ankuesit dhe të vertetojë se trajtimi ndryshe i tij ka ardhur për shkaqe të arsyeshme.

8 Kopje e Kartës së Anëtarësimit të z. A.T., lëshuar me datë 21.11.2012.

5. VENDIM

5.1. Në bazë të nenit 32, gërma “c”, si dhe nenit 33, pikat 10, 11 dhe 12, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

5.2. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të bindjeve politike, ndaj A.T, nga ana e Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., Tiranë.

5.3. Në referim të pikës 1, Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, ndaj A.T, të bëjë rikthimin e tij në vendin e punës.

5.4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, KESH sh.a të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE

Ankesa e F.R., kundër Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*Bindjes Politike*”.

V E N D I M Nr. 10 /2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. F.R shpjegon se: “*Ka qenë e punësuar pranë DSHP Mat që nga periudha 01.02.2013, me detyrë llogaritare, arkëtare. Me shkresën nr. 168, datë 20.05.2014 është urdhëruar nga Drejtori B.D për largimin e menjëhershëm politikisht nga puna F.R shpjegon se gjatë punës pranë institucionit është karakterizuar nga rezultatet në punë dhe ndaj saj nuk është marrë ndonjë vërejtje apo masë disiplinore dhe është larguar nga puna pa asnjë referencë ligjore, por për motive politike*”.

1.2. Me shkresën nr. 1011/1 prot, është bërë njoftimi për Drejtorinë e Shëndetit Publik Mat dhe kërkesa për informacion në lidhje me: Procedurën e plotë të largimit nga puna të punonjës F.R. Më datën 27.11.2014, me shkresën nr. 1011/2 Prot, është kërkuar informacion shtesë nga subjekti ankues në lidhje me ankesën e bërë.

1.3. Me shkresën datë 01.12.2014 subjekti ankues në mbështetje të ankesës së bërë ka dorëzuar pranë zyrës së Komisionerit, autorizimin si vëzhguese e subjektit politik Partia Demokratike, lëshuar nga KZAZ Qarku Dibër, për znj. F.R në cilësinë e vëzhgueses për subjektin zgjedhor, Partia Demokratike pranë KQV nr. 0936, datë 23.06.2013.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Znj. F.R. me datë 01.02.2013 ka filluar punë pranë subjektit, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, me detyrë Llogaritare/Arkëtare e vërtetuar me Librezën e Punës. Me shkresën nr. 168, datë 20.05.2014, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat urdhëron: “***Largimin e menjëhershëm të znj. F. R. politikisht nga Drejtoria e Shëndetit Publik Mat. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë***”.

2.2. Duke mos rënë dakord me vendimin e marrë për largimin e saj nga puna, F.R i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e cila me Vendimin Nr.6467.Vendimi, datë 12.11.2014 ka pranuar pjesërisht kërkesë padinë dhe ka vendosur detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Shëndetit Publik Mat t’i paguajë F.R dëmshpërblim për pushim të padrejtë nga puna.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon në nenin 18/2 se: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a

filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3.2. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

3.3. Bindja politike, është shkak për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me bindjen politike.

3.4. Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

3.5. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ndalon diskriminimin e personave në lidhje me të drejtën e tyre për punësim. Kështu në nenin 12, pika 1, përcaktohet se ndalohej diskriminimi për shkak të bindjes politike dhe që ka lidhje me: c) *“trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

4. OPINION

4.1. Komisioneri vlerëson se Urdhri nr. 168, datë 20.05.2014 për largimin nga puna të znj. F.R. në mënyrë të shprehur për shkak të bindjes politike, është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

4.2. Komisioneri vlerëson se tendenca për lirimin e menjëhershëm nga puna të F.R. pa respektuar procedurat ligjore për lirimin e punonjësve nga puna bie ndesh dhe me Urdhrin nr. 506, datë 18.09.2013 të Ministrit të Shëndetësisë, i cili në pikën 1, Urdhëron: 1. *“Pezullimin, deri në një urdhër të dytë, të procedurave të marrjes dhe largimit nga puna, të punonjësve në institucionet shëndetësore”*.

4.3. Njohja me veprimtarinë politike të subjektit ankues vërtetohet me anë të dokumentit të paraqitura nga F.R. që është: Autorizimi në cilësinë e vëzhgueses për subjektin Partia Demokratike gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet për kuvend të datës 23.06.2013.

4.4. Punëdhënësi, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat nuk ka sjellë asnjë fakt që të hedhë poshtë pretendimet e subjektit ankuesit dhe të vërtetojë se trajtimi ndryshe i saj ka ardhur për shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkak të bindjes politike të F.R.

5. VENDOSI

5.1. Konstatimin e diskriminimit të F.R, nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, për shkak të bindjes politike.

5.2. Në referim të pikës 1, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e F.R në vendin e mëparshëm të punës.

5.3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Drejtori i Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

5.4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

5.5. Kujtojmë se bazuar në nenin 35 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” çdo person mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e tij por kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e institucionit.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE

Ankesë e z. K.S, kundër Këshillit të Qarkut Vlorë, ku pretendohet për diskriminim të tij për shkak të bindjeve politike.

VENDIM NR. 176/2014

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Ankuesi K.S⁹ shpjegon se: “Ka filluar punë, në vitin 2005, në pozicionin “Specialist për Transportin, Investimet dhe Rrugëve Rurale” pranë Drejtorisë së Shërbimeve, të Këshillit të Qarkut Vlorë. Me Vendimin nr. 2, datë 27.01.2012 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë është vendosur lirimi i tij nga detyra në kuadër të ristrukturimit¹⁰ të institucionit. Me urdhërin nr. 10, datë 01.02.2012, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë është shpallur lista e pritjes për 8 (tetë) punonjës, njëri ndër të cilët është edhe ankuesi. Pas ankimit të tij pranë Komisionit të Shërbimit Civil, ky i fundit e ka shfuqizuar aktin administrativ nr. 2, datë 27.01.2012 për lirin nga shërbimi civil dhe të aktit nr. 10, datë 01.02.2012 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, në atë pjesë që urdhëron kalimin në listë pritjeje të ankuesit. KSHC ka vendosur gjithashtu kthimin e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës si specialist për transportin dhe investimet në Drejtorinë e Urbanistikës. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit nr. 31, datë 19.03.2012 të Komisionit të Shërbimit Civil. Ankuesi K.S thekson se vendimi i sipërpërmendur nuk ekzekutohet nga Këshilli i Qarkut Vlorë dhe ai po diskriminohet për shkak të bindjeve të tij politike”.

1.2. Me shkresën nr. 778/1, datë 30.12.2013, Komisioneri iu drejtua Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, z. A.Dh, ku kërkohej informacion lidhur me çështjen e ankuesit K.S. Kryetari i Qarkut Vlorë, i është përgjigjur Komisionerit lidhur me ankesën e sipërpërmendur, përmes shkresës nr. 2733/1, datë 22.01.2013¹¹.

1.3. Më datë 17.02.2014, në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri, përmes ekipit të inspektorëve, kreu inspektim pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. K.S. ka qenë punonjës i administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë duke filluar nga viti 2005, deri në miratimin e Vendimit të Lirimit nga Shërbimi Civil, nr.2, datë 27.01.2012. Me miratimin e strukturës së administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë nr. 6, datë 29.12.2011, në këtë institucion janë kryer ristrukturime duke suprimuar edhe pozicionin e punës së z. K.S, si specialist në Drejtorinë e Shërbimeve. Aktualisht, pozicioni i tij i punës është suprimuar dhe nuk është pjesë në asnjë drejtori ekzistuese të Këshillit të Qarkut Vlorë. Në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” dhe VKM-ve në zbatim të tij, z. S ka qenë pjesë e listës

9 K. S. është me profesion inxhinier ndërtimi.

10 Ankuesi thekson se pozicioni i tij i punës nuk është suprimuar, por me strukturën e re të institucionit është bërë pjesë e Drejtorisë së Urbanistikës, ndërkohë që me strukturën e vjetër ka qenë pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve.

-11 Shkresa në fjalë është protokolluar pranë KMD-së me nr. 79, datë 27.01.2014.

së pritjes së këtij institucioni, që prej datës 01.02.2012, për një vit rresht. Çështja e z. S, ka qenë objekt gjykimi pranë Komisionit të Shërbimit Civil, Gjykatës së Apelit Tiranë dhe së fundmi pranë Gjykatës së Lartë. Në shkresë theksohet fakti se z. K.S ka punuar disa vite pranë Këshillit të Qarkut Vlorë, me titullarë të forcave të ndryshme politike, ndaj për këtë arsye nuk mund të ketë arsye për diskriminim për shkak të bindjeve politike.

2.2. Nga analizimi i vlerësimeve të punës së z. K. S për vitet¹², kur ai ka punuar si specialist në Drejtorinë e Shërbimeve, vihet re se:

- Vlerësimi i eprorit për ankuesin për vitet: 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, ka qenë “shumë mirë” (niveli i vlerësimit 1).
- Vlerësimi i eprorit për ankuesin për vitin 2011 ka qenë “mirë” (niveli i vlerësimit 2).

2.3. Referuar Ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit Civil”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 14.07.2000 “Për lirimimin nga shërbimi civil”, si dhe në bazë të Vendimit nr. 2, datë 16.02.2011 të Këshillit të Qarkut Vlorë “Për miratimin e strukturës së administratës së Qarkut Vlorë, për vitin 2011”, në kuadër të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Vlorë, 8 punonjës janë kaluar në listë pritjeje.

2.4. Sipas informacionit të administruar rezulton se Komisioni i Shërbimit Civil ka pranuar ankesat e K.S. dhe M.B.¹³. Me vendimin nr. 31, datë 19.03.2012, të Komisionit të Shërbimit Civil është vendosur:

- Pranimi i ankesës së K.S.
- Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 2, datë 27.01.2012, “Për lirimimin nga shërbimi civil” dhe të aktit nr.10, datë 01.02.2012 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, në atë pjesë që urdhëron kalimin në listë pritjeje të ankuesit, si të pabazuar.
- Kthimin e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës si specialist për Transportin dhe Investimet në Drejtorinë e Urbanistikës etj.

Me Vendimin nr. 35, datë 19.03.2012, të Komisionit të Shërbimit Civil është vendosur:

- Pranimi i ankesës së M. B.
- Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 1, datë 24.01.2012, “Për lirimimin nga shërbimi civil” dhe të aktit nr.10, datë 01.02.2012 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, në atë pjesë që urdhëron kalimin në listë pritjeje të ankuesit, si të pabazuar.
- Kthimin¹⁴ e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës, duke ndërprerë marrëdhëniet e punës për punonjësin që realisht i është shkurtuar vendi i punës etj.

2.5. Vendimi nr. 71, datë 03.07.2012 i Gjykatës së Apelit Tiranë ka lënë në fuqi Vendimin nr. 31, datë 19.03.2012 të Komisionit të Shërbimit Civil, për K.S. Ndërkohë që Vendimi nr. 68, datë 03.07.2012, i Gjykatës së Apelit Tiranë ka lënë në fuqi Vendimin nr. 35, datë 19.03.2012, të Komisionit të Shërbimit Civil, për M.B.

2.6. Në datën 20.08.2012 Këshilli i Qarkut Vlorë ka paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë për të dy ish punonjësit e tij të larguar nga puna nëpërmjet ristrukturimit.

12 Vlerësimi i punës për vitin 2010 për z. K. S, nuk është dërguar pranë KMD-së, nga ana e Këshillit të Qarkut Vlorë.

13 M.B është femër.

14 Referoju Vendimit nr. 35, datë 19.03.2012, të Komisionit të Shërbimit Civil dhe Vendimit nr. 68, datë 03.07.2012, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

2.7. Komisioneri bëhet me dije nëpërmjet shkresës nr. 360/1, datë 07.03.2014, të Këshillit të Qarkut Vlorë, se nëpërmjet Vendimit nr. 3, datë 04.02.2014 “Për miratimin e strukturës së administratës së Qarkut Vlorë për vitin 2014” nga lista e pritjes janë kthyer në punë punonjëset M. B (në Vlorë) dhe M. K (në Sarandë).

3. BAZA LIGJORE

3.1. Ligji 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3/1 parashikon: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

3.2. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

3.3. Neni 12/1, i ligjit 10 221/2010 parashikon: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

a) shpalljen e vendeve të lira të punës;

b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;

c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;

ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi”.

3.4. Neni 15 i ligjit 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon:

1. “Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në Gjykatë, nëse beson se ka pasur diskriminim....
2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve shprehimisht të kontratës.
3. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit.
4. Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t’u mbrojtur nga diskriminimi. Punëmarrësi kthen pagën e marrë, sipas këtij neni, në rast se diskriminimi i pretenduar nuk rezulton i vërtetuar me vendim të formës së prerë”.

4. OPINION

4.1. Sipas Z. K.S., diskriminimi për shkak të bindjeve politike, e ka fillimin që në vitin 2010, ku nëpërmjet vendimit nr. 20, datë 02.11.2010, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, ankuesi është komanduar si specialist i bonitetit, kullimit, ujitjes për Sarandën e Delvinën. Ky pozicion konsiderohet nga ankuesi si një pozicion i papërshtatshëm ndaj profesionit të tij. Në vend të tij, si specialist pranë KQ Vlorë ishte emëruar një person tjetër, profesioni i të cilit ishte ekonomist dhe i papërshtatshëm me specialitetin “inxhinier” që kërkohej për atë pozicion pune.

4.2. Komisioneri konstatoi se znj. M. B dhe z. K. S, ndodheshin në të njëjtat kushte:

- Të dy ish-punonjësit e Këshillit të Qarkut Vlorë, janë larguar nga puna, nëpërmjet procesit të ristrukturimit të institucionit, me anë të Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë nr. 6, datë 29.12.2011.
- Të dy ish-punonjësit e sipërpërmendur kanë paraqitur ankesë pranë Komisionit të Shërbimit Civil, nëpërmjet vendimit të të cilit, kanë fituar të drejtën për t'u rikthyer në vendet e mëparshme të punës.
- Për të dy ish-punonjësit, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimet respektive të KSHC-së.
- Këshilli i Qarkut Vlorë ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë, për të dy këta ish-punonjës.

4.3. Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë ka rikthyer në punë znj. M. B, ndërkohë që nuk është vepruar njësoj me z. K.S. Pavarësisht se të dy këta ish-punonjës kanë qenë në kushte të njëjta, ata janë trajtuar në mënyrë të ndryshme nga Këshilli i Qarkut Vlorë. Nga lista e pritjes është kthyer në punë edhe znj. M.K, ankesa e së cilës nuk është pranuar nga KSHC.

5. VENDIMI

5.1 Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike të z. K.S., në fushën e punësimit, nga Këshilli i Qarkut Vlorë.

5.2 Referuar pikës i të këtij Vendimi, rekomandohet marrja e masave nga Këshilli i Qarkut Vlorë, për sistemimin në punë të ankuesit, pranë këtij institucioni.

5.3 Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Këshilli i Qarkut Vlorë të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

5.4 Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

ÇËSHITJE DISKRIMINIMI NË FUSHËN E ARSIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE FETARE

Ankesa e J.R. ku pretendohet diskriminim për shkak të bindjeve fetare nga Drejtoria e Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”.

VENDIM Nr. 14 / 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Subjekti ankues, nxënësja J.R., ka paraqitur përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ankesën me Nr. 92 Regj, datë 29.09.2014, me objekt pretendim diskriminimin “për shkak të bindjeve fetare”, nga Drejtoria e Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”.

1.2. Bazuar në nenin 32, pika 1, germa (c) të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, me shkresën Nr. 816/1 Prot., datë 02.10.2014, është njoftuar dhe kërkuar informacion nga Drejtoria e Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”, lidhur me pretendimet e nxënëses J.R. Në përgjigje të shkresës së Komisionerit, Drejtoria e Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku” nuk vuri në dispozicion asnjë informacion.

1.3. Më datë 03.11.2014 u zhvillua një seancë dëgjimore ku morën pjesë përfaqësues ligjor të ankueses dhe DAR Korçë, Drejtoria e Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku” dhe Kryetari i Forumit Mysliman të Shqipërisë. Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nuk u paraqit asnjë përfaqësues në seancë dëgjimore. Përfaqësuesi i ankueses sqaroi se “*nxënësja nuk është pranuar nga stafi për shkak të mbulesës si “simbol fetar”. Me email prej Drejtorisë së Shërbimeve Juridike të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, thuhej se veshja duhet të jetë laike. Sipas përfaqësuesit të ankueses, në nenin 7 të ligjit nr. 69/2012, ku është bazuar emaili i dërguar i është bërë një interpretim i gabuar për shkak se legjislatori ka pasur për synim se laiciteti duhet të respektohet tek: Kurrikula arsimore, tek fasadat e godinave arsimore dhe tek programi arsimor. Përsa i përket mbulesës ajo nuk është simbol fetar sepse simbol fetar do të quajmë një gjysmë hënë, një kryq, një flamur, pra këto janë simbole fetare*”.

1.4. Me shkresën dt.10.11.2014, DAR Korçë sqaroi: “Rregulli i shkollës që normon një veshje nuk bie ndesh me normat Kushtetuese që sanksionojnë lirinë e besimit, i cili nuk kushtëzohet te veshja por një sërë praktikash që personi konkret aplikon, për këtë nuk abrogohet si antikushtetues apo shkelës i të drejtave të njeriut. Përkundrazi, ky rregull normon barazinë mes studentëve çka shkolla synon dhe promovon. Ndalesa e veshjes sipas normave fetare në asnjë rast nuk pengon lirinë e besimit, por nëse me një analizë a contrario do të lejohej veshja sipas normave fetare të një komuniteti pa u marrë mendimi i komuniteteve të tjera, pikësëpari do të ndodheshim para shkeljes së barazisë mes feve të sanksionuar në Kushtetutë, pikësëdyti do të ndodheshim përpara një trajtimi preferencial të një numri nxënësish që do të lejoheshin të aplikonin parimet fetare (këtu nuk flitet vetëm për veshjen por edhe parime të tjera të fesë) duke prishur ose mosfrekuentuar lëndë të caktuara. Dhe trajtimi preferencial bie në kundërshti të hapur me parimin e barazisë mes nxënësve. Nga ana e Drejtorisë Arsimore çmohet i ligjshëm moslejimi i frekuentimit të orëve mësimore deri në pushim të cënimit të këtyre parimeve dhe normave ligjore.

1.5. Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresë zyrtare parashtroi: “Udhëzimi i MASH nr. 30, datë 02.08.2013 “Për rregulloren tip të institucioneve arsimore”, përcakton se institucioni arsimor, duhet të përcaktojë veshjen dhe uniformën e nxënësve në institucion. Shkolla “Muharrem Çollaku”, Pogradec ka miratuar në Rregulloren e Brendshme 2014-2015, se: “Veshja e tij të jetë korrekte, pa teprime, e papërshtatshme për moshën që ka dhe të respektojë ambientin laik të shkollës”. Ndërkohë që termi “veshja duhet të jetë laike” konsiderojmë që nuk vjen në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, por është në zbatim të tij, pasi të gjithë elementët që përbëjnë arsimin parauniversitar publik, duhet të jenë brenda kufijve të laicitetit të kërkuar nga ligji. Veshjet dhe objektet fetare bien ndesh me parimin e laicizmit, mesazhit të tolerancës dhe barazisë në Shqipëri”.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, nxënësja J.R., ka mbaruar klasën e 10-të, në Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”, gjatë vitit shkollor 2013-2014. Në muajin qershor të vitit 2014, nxënësja J.R., e cila i përket besimit fetar musliman, ka vendosur mbulesë.

2.2. Më datë 16 shtator 2014, vajza ka njoftuar mësuesen kujdestare dhe i ka sqaruar se për shkak të besimit ajo është mbuluar. Nga ana e mësueses ka marrë informacion se për shkak të laicitetit, nuk mund të ndjekë arsimin publik. Pasi është realizuar takim me prindërit e vajzës, me drejtorinë arsimore dhe zyrën arsimore, Shkolla e Mesme “Muharrem Çollaku” ka vendosur të mos lejohet që vajza të ndjekë mësimin në këtë shkollë. Ndër arsyet e mospranimit në shkollë, ishte mënyra si do të paraqitet vajza në orën e edukimit fizik, kur në këtë orë nevojitet uniforma për të zhvilluar lëndën e edukimit fizik dhe si mund të ndiqte vajza një orë të biologjisë, a ja lejon feja këtë gjë?”. Shkolla nuk ka një uniformë, por në një plan afat mesëm mendojnë të vendosin uniformë.

2.3. Forumi Musliman i Shqipërisë, pas kontaktit që ka pasur me Drejtoreshën e Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”, Pogradec, është vënë në dijeni të një e-maili të dërguar nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet të cilit, ndër të tjera sqarohet se: “Bazuar në nenin 7, të ligjit Nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar”, i cili përcakton se arsimi është laik, rregullorja e brendshme e shkollës duhet të përcaktojë normat e veshjes. Në rast se nuk ka rregullore të miratuar, zbatoni drejtpërdrejtë dispozitat normative të cilat përcaktojnë se veshja duhet të jetë në përputhje me normat e bashkëjetesës **ku në një ambient laik, veshja duhet të jetë laike**”.

2.4. Drejtoresha e Shkollës “Muharrem Çollaku” theksoi se nuk është menduar ndonjëherë për zgjidhje alternative për nxënësen dhe se ishte në pritje të një interpretimi ligjor nga MAS dhe DAR Korçë.

3. BAZA LIGJORE

3.1. “Bindjet fetare” është shkak për të cilin ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/c të tij Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me bindjet fetare.

3.2. Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe ndalon diskriminimin e kujtdo ndër të tjera edhe për bindjet fetare. Gjithashtu, në nenin 57, pika 1 të Kushtetutës, parashikohet se: “Kushdo ka të drejtën për arsimim”, si dhe pika 3: “Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë”. Liria për të zgjedhur dhe shprehur individualisht apo kolektivisht, në publik ose në jetën private besimin fetar garantohet nga Kushtetuta e Republikës së

Shqipërisë në nenet 10 dhe 24 të saj. Kështu në nenin 10 të Kushtetutës parashikohet se: “Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe **garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike**”, ndërsa në nenin 24, pika 1, përcaktohet se: “Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar”, ndërkohë që “Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t’i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve.”

3.3. Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 10, pika 10 të tij parashikon: “1. Ndalohet diskriminimi lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, veçanërisht kur ka të bëjë me shprehjen e tyre individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve.

3.3. Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 17, pika 1, gërma “ç”, sanksionon se: “Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre” dhe pika 2 e këtij ligji, ku citohet: “**Ndalohet t’i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji**”.

3.4. Garantimi i së drejtës për arsim në Republikën e Shqipërisë, gjen mbrojtje edhe në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, e më saktësisht në nenin 5 pika 1, në të cilin parashikohet se: “Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.” Në nenin 6, ligji 69/2012, parashikon se: “1. Në veprimtarinë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, **interesi i nxënësit është parësor**; 3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund të shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral; 4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve; 5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.”

3.5. Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

3.6. Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

3.7. Në nenin 3, pika 2 e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet se kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo nga shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, kemi të bëjmë me diskriminim të shfaqur në formën e “Diskriminimit të drejtpërdrejtë”.

3.8. Në nenin 9 pika 2 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut është parashikuar se: “Liria e shprehjes së fesë ose e bindjeve të tij **nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre të parashikuara nga ligji** dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit, të shëndetit ose të moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”.

3.9. Në nenin 17 të Kushtetutës, përcaktohet se: “Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë”. Pra, Kushtetuta jo vetëm që mban të njëjtin qëndrim me Konventën, por nga ana tjetër Kushtetuta sanksionon se: “Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.

3.10. Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon se “Përjashtimi nga kjo dispozitë mund të lejohet vetëm kur ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. Megjithatë, në çdo rast, lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj. Përjashtimi për këtë shkak duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar nevojën për diskriminimin. Në çdo rast lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.

4. OPINIONI

4.1. Ndalimi i diskriminimit për shkak të bindjeve fetare gjen rregullim në një sërë aktesh ligjore. Në këtë kuadër, edhe ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” mban të njëjtin qëndrim, lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë. Ky ligj ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese në mënyrë të posaçme në fushën e arsimit. **Por, si çdo e drejtë tjetër ajo nuk është absolute dhe mund të kufizohet.**

4.2. Në proceset e aderimit në institucionet ndërkombëtare, Shqipëria ka nënshkruar një sërë aktesh ndërkombëtare, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Të njëjtin qëndrim me Konventën mban dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në lidhje me kufizimet që çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave të njeriut. Gjithashtu edhe ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon se lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj.

4.3. Trajtimi i çështjeve të lirisë së besimit në Gjykatën e Strasburgut (theksojmë që edhe institucionet arsimore i janë referuar këtyre çështjeve) ka vënë theksin në disa parime të rëndësishme.

Kufizimi duhet të bëhet vetëm me ligj. Sipas mendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, janë dy kërkesa që rrjedhin nga shprehja “e parashikuar me ligj”. **Së pari**, ligji duhet të jetë si duhet i kuptueshëm, në mënyrë që qytetarët të jenë sa më të qartë dhe të vetëdijshëm. **Së dyti, një normë nuk mund të konsiderohet si një “ligj”,** nëse nuk është formuluar me saktësi në mënyrë që ti mundësojë qytetarit që të rregullojë sjelljen e tij dhe të jetë në gjendje të parashikojë, pasojat që mund të shkaktojë një veprim”.

4.3.1. Këtë qëndrim ka mbajtur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen **Leyla v. Turqi (2005)**¹⁵. Gjykata u shpreh se:

15 Leyla vjen nga një familje që tradicionalisht ka praktikuar fenë muslimane. Leyla konsideron si detyrë të saj fetare mbajtjen e shamisë. Ajo u ankua në lidhje me një rregull të shpallur në 1998, kur ajo ishte një studente e mjekësisë në Universitetin e Stambollit, i cili ndalonte studentët të mbanin shami të tilla në klasë ose gjatë provimeve, të cilat përfundimisht detyruan atë të lërë vendin dhe të ndjekë studimet e saj në Austri. Pas vendimeve të dhëna kundër saj prej gjykatave të Turqisë, Leyla iu drejtua me një ankesë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me objekt: “Ndalimi i mbajtjes së shamisë islamike përbente shkelje të së drejtës për lirinë e mendimit, besimit dhe fesë, të garantuara nga Neni 9 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për shkelje të së drejtës për edukim, sipas kuptimit të Nenit 2 të

- Nuk ka pasur shkelje të Nenit 9 të Konventës, duke arsyetuar se ka pasur një bazë ligjore në ligjin turk, i cili ndalonte mbajtjen e shamisë në universitete. Gjithashtu, vijoi se ndërhyrja ishte e “parashikuar në ligj”.
- Gjykata Kushtetuese Turke bënte të qartë se lejimi i studentëve për të “mbuluar qafën dhe flokët me një shami ose shall për shkak të bindjeve fetare” në universitete ishte në kundërshtim me Kushtetutën.
- Nga ana tjetër, është jashtë çdo dyshimi që ndalimi i mbajtjes së shamisë ishte parashikuar nga universiteti shumë më parë se të rregjistrohej ankuesja. Në këto kushte mund ta kishte parashikuar që nga momenti i rregjistrimit në universitet, që mbajtja e shamisë ishte e ndaluar sipas normave universitare, sidomos në bazë të urdhëresës së vitit 1998, dhe për këtë arsye ajo rrezikonte të mos lejohej të merrte pjesë në mësim nëse insistonte për ta mbajtur shaminë.
- Duke pasur parasysh lirinë e vlerësimit të Shteteve në këtë pikëpamje, Gjykata u shpreh se ndërhyrja, për të kufizuar mbajtjen e shamisë, mund të konsiderohet si “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për qëllime të nenit 9 § 2 të Konventës. Në veçanti, Gjykata vlerësoi se kur merret në analizë çështja e shamisë islamike në kontekstin turk, nuk mund të mos mbahet parasysh impakti që mund të ketë mbajtja e këtij simboli, i pretenduar ose i perceptuar si detyrim fetar, ndaj atyre që nuk e mbajnë.

4.3.2. Të njëjtin qëndrim mban GJEDNJ edhe në çështjen **Dahlab v. Zvicër (2001)**¹⁶:

Protokollit 1, për shkelje të Nenit 14 të interpretuar së bashku me Nenin 9 për shkak se sipas saj në lidhje me uniformat universitare kishte diskriminim midis besimtarëve dhe jobesimtarëve. Ajo ankohej gjithashtu për shkelje të neneve 8 dhe 10 të Konventës.”

- 16 Dahlab ishte emëruar mësuese në një shkollë fillore publike në kantonin e Gjenevës. Pak kohë pasi ajo kishte nisur punën në sistemin arsimor, braktisi besimin e krishterë dhe u konvertua në praktikante e fesë muslimane. Në respekt të zakoneve fetare që përfaqësonte tashmë, ajo nisi të mbulohej me shami. Autoritetet përgjegjëse për sistemin arsimor, pas konstatimit të këtij fakti i kërkuan znj. Dahlab, të mosmbajë shaminë gjatë kryerjes së detyrave të saj profesionale, pasi kjo sjellje është në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit për Arsimin Publik dhe përbënte “një mjet të dukshëm të identifikimit i cili imponohej nga një mësuese tek nxënësit e saj të moshës 4-8 vjeç, sidomos në një sistem publik, laik”. Ankuesja parashtroi përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, se masa që ndalon atë të mbajë shaminë gjatë kryerjes së detyrave të saj të mësimdhënies, shkel Lirinë për të manifestuar fenë e saj, siç garantohet në nenin 9 të Konventës Evropiane të të Drejtave të publik. Ajo vërejti se fakti që ajo kishte veshur një shami islamike kishin shkuar pa u vënë re për katër vjet dhe nuk duket të ketë shkaktuar ndonjë shqetësim të dukshëm brenda shkollës. Në lidhje me Nenin 9 të Konventës, ankuesja parashtroi se ndalimi imponuar nga autoritetet zvicerane arriti në diskriminimin për shkak të gjinisë, në kuptim të nenit 14 të Konventës.

Gjatë shqyrtimit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, qeveria e Zvicrës parashtroi se mësuesja është kualifikuar për të mësuar fëmijët e moshës nga katër deri në tetë vjeç, dhe se ajo në përputhje me rrethanat, kishte mundësi të punësohej në shkollë private, në kantonin e Gjenevës, ku ka shkollë të cilat nuk e kanë detyrim ndalimin e shfaqjes së besimit fetar.

Përsa i përket të drejtës së ankueses për lirinë e fesë, qeveria e Zvicrës, parashtroi se ndërhyrja ishte e justifikuar në bazë të paragrafit 2 të nenit 9 të Konventës. Gjithashtu, qeveria Zvicerane sqaroi se ky ndalim ishte në përputhje me Nenin 27 § 3 i Kushtetutës Federale, Nenin 6 të Ligjit për Arsimin Publik, dhe seksioni 120 (2) të Aktit, i cili detyron që nëpunësit civilë duhej të jenë persona laik.

Për më tepër, madje edhe para se ankuesja të kishte vendosur të konvertohet në Islam në mars 1991, Gjykata Federale kishte vendosur në objektin e nenit 27 § 3 të Kushtetutës laicizmin. Në veçanti, në një gjykim të publikuar të datës 26 shtator 1990, kishte ndaluar praninë e një kryqi në klasat e shkollave fillore. Qeveria argumentoi se synimet e ndjekura në rastin në fjalë ishin të pamohueshme të ligjshme dhe ishin pjesë e të drejtave të listuara në paragrafin e dytë të nenit 9 të Konventës.

Masa për ndalimin e aplikantit për të veshur shaminë islamike është bazuar në parimin e neutralitetit të besimit në shkollë dhe në atë të harmonisë fetare.

Së fundi qeveria parashtroi se, nuk duhet të harrohet fakti se mësuesit ishin modele të rëndësishëm për nxënësit e tyre, veçanërisht, për rastin e aplikantit, ku nxënësit ishin fëmijë shumë të vegjël të cilët ndjekin arsimin e detyrueshëm fillor. Përvoja ka treguar se fëmijët e tillë kanë qenë më të prirur për tu identifikuar me mësuesin e tyre, veçanërisht për shkak të kontaktit të tyre të përditshëm dhe natyrën hierarkike të marrëdhënieve të tyre.

Shumë ligje dhe akte nënligjore, në një masë janë të paqarta, për këtë arsye interpretimi dhe zbatimi i akteve të tilla varet nga praktika. Duke shqyrtuar arsyetimin e Gjykatës Federale në këtë pikë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vëren se:

- seksionet 6 dhe 120 (2) të Aktit kantonal të datës 6 nëntor 1940, ishin krejtësisht të saktë për t'i mundësuar qytetarëve rregullimin e sjelljes së tyre
- masat e marra në çështjen në fjalë parashikoheshin me ligj, në kuptim të nenit 9 § 2 të Konventës.

Në përputhje me rrethanat, Gjykata peshon të drejtën e një mësuesi për të shfaqur fenë kundër nevojës për të mbrojtur nxënësit dhe ruajtur harmoninë fetare. Duke pasur parasysh moshën e vogël të nxënësve dhe përgjegjësinë e mësueses si përfaqësuese e shtetit, autoritetet e Gjenevës, nuk kishin tejkaluar lirinë e tyre të vlerësimit dhe morën masat e duhura për rastin në fjalë.

4.4. Referuar çështjes që po shqyrtojmë vërejmë se:

- Në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” nuk gjejmë asnjë dispozitë të qartë që të ndalojë në mënyrë të shprehur ushtrimin e së drejtës për arsim për shkak të bindjeve fetare. **Pra, ndërhyrja nuk ishte e “parashikuar në ligj”.**
- Në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 7 “Laiciteti”, parashikohet se “Arsimi parauniversitar është laik” dhe se “ *Përrjashtim bëjnë ato institucione arsimore që themelohen nga bashkësi fetare të njohura me ligj, sipas përcaktimeve të nenit 42 pika 4 të këtij ligji*”. Por, ndryshe nga legjislacioni turk (për të cilin ka edhe një interpretim të Gjykatës Kushtetuese që përcakton qartë se lejimi i studentëve për të “*mbuluar qafën dhe flokët me një shami ose shall për shkak të bindjeve fetare*” në universitete ishte në kundërshtim me Kushtetutën), nuk është aspak e qartë se çfarë do të kuptojmë me karakter laik. Edhe në Rregulloren e Brendshme të vitit 2014-2015, të Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”, përcaktohet se: “**Veshja e tij të jetë korrekte, pa teprime, e përshtatshme për moshën që ka dhe të respektojë ambientin laik të shkollës**”. Komisioneri çmon se ky është parashikim i paqartë, që lë vend për interpretim dhe e lë zbatimin e saj në kuptimin dhe vullnetin e një drejtuesi të institucionit arsimor”.
- Ndryshe nga çështja Leyla v. Turqi (2005), në çështjen që po shqyrtojmë vihet re se nuk ka asnjë dispozitë ligjore dhe nënligjore që ta pengonte arsimimin e saj në shkollën publike, përkundrazi edhe gjatë shqyrtimit të ankimit pranë Komisionerit Shkollë e Mesme e Përgjithshme “Muharrem Çollaku” nuk ka pasë një rregullore. **Duke mos pasë një rregullore drejtuesja e institucionit arsimor i është drejtuar eprorëve të saj duke kërkuar qëndrimin e tyre institucional. Përgjigjja ka qenë e paqartë e vonuar, dhe nuk linte mundësinë që të kuptohej saktë nëse nxënësja J.R. duhej të vazhdonte arsimimin pranë kësaj shkolle publike apo jo.**
- Ndryshe nga çështja Dahlab v. Zvicër (2001), (në të cilën GJEDNJ ka analizuar faktin nëse ankueses i janë krijuar mundësitë alternative për punësimin e saj), në çështjen që po shqyrtojmë vihet re (nga informacioni i dhënë nga ana e Drejtorisë së Shkollës në gjatë seancës dëgjimore të datës 03.11.2014) se nxënësja J.R. i është mohuar e drejta për tu arsimuar nga ana e institucioneve arsimore përkatëse, pa parë më parë mundësitë alternative si zgjidhje, edhe pse këto institucione nuk ishin të bindur plotësisht në kuptimin e legjislacionit përkatës¹⁷.

17 Shkresa e depozituar gjatë seancës dëgjimore, datë 03.11.2014, nga ana e Juristit të DAR Korçë, z. M.K., në të cilën citohet se: “...Duke parë karakterin e cunguar të këtij neni duhet qartësuar ratio legis për një interpretim literal i fjalisë “Arsimi parauniversitar është laik”...”.

Shkresa nr. 8046/2 prot., datë 12.12.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në të cilën ndër të tjera citohet se: “Në konkluzion, duke mos e konsideruar Ministrinë e Arsimit dhe Sportit palë në këtë proces, pasi nuk mund të legjitimohet si e tillë për arsye të përcaktimeve të pikës 1 të nenit 54 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në

- Nxënësës i është mohuar e drejta për tu arsimuar përmes komunikimit verbal, pa e formalizuar asnjëherë qëndrimin institucional të institucionit arsimor.

4.5. Rezultoi e provuar se ka një diferencë në trajtimin e nxënësës J.R., të cilës ndryshe nga nxënës të tjerë, që kanë ose jo besime të ndryshme apo të njëjta fetare, i është mohuar e drejta e ndjekjes së mësimin në mënyrë të barabartë me të tjerët, për shkak të mbulesës, dhe ky kufizim është i pa bazuar në ligj, mbështetur në akte nënligjore të paqarta dhe të diskutueshme.

4.6. Duke iu referuar çështjes Dahlab v. Zvicër (2001) vërejmë se GJEDNJ parashtroi se: “Rregullat në sferën e besimit fetar rrjedhimisht do të ndryshojnë nga një vend në tjetrin në varësi të traditave kombëtare dhe të kushteve që vihen nga nevoja për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe për të ruajtur rendin publik. Përkatësisht, zgjedhja dhe forma që duhet të marrin rregulloret të tilla duhet patjetër të lihet deri në një pikë në dorën e Shtetit të përfshirë, pasi do të varet në kontekstin vendas në fjalë”. Përsa më lart, dhe referuar në përfundimet e GJEDNJ-së, Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të marrë hapat e duhur për të bërë amendimet e nevojshme në legjislacionin për arsimin parauniversitar, duke parashikuar aktet ligjore dhe nënligjore, të formuluar me saktësi, të kuptueshme dhe sa më të qarta, në mënyrë që qytetarët të jenë të vetëdijshëm për sjelljet që duhet të mbajnë.

4.7. Edukimi i publikut për respektimin e barazisë dhe mosdiskriminimit mbetet një ndër sfidat kryesore për të cilën duhet të angazhohen të gjithë aktorët që mbartin detyrime ligjore përkatëse sipas Ligjit. Kjo çështje që po shqyrtojmë është tregues që duhet të jemi të vëmendshëm dhe të kujdesshëm në trajtimin e fëmijëve lidhur me të drejtën e arsimimit, mbi bazën e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të bindjeve fetare. Bashkëjetesa fetare është një vlerë për shoqërinë shqiptare, e cila duhet ruajtur dhe ushqyer si një model i mirë për të ndërtuar raportet mes komuniteteve të ndryshme përmes tolerancës dhe respektimit të të drejtave të çdo individi, pavarësisht cilësive individuale apo përkatësisë në një grup të veçantë që na dallon nga pjesa tjetër e shoqërisë.

5. VENDIMI

5.1. Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë në fushën e arsimit, për shkak të bindjeve fetare të nxënësës J.R., nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë dhe Drejtorisë së Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”, Pogradec.

5.2. Detyrimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë dhe Drejtorisë së Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”, Pogradec, për të ndaluar në mënyrë të menjëhershme sjelljet dhe veprimet diskriminuese si dhe shfrytëzimin e të gjitha mundësive që japin dispozitat ligjore në fushën e arsimit për të siguruar ecurinë mësimore të nxënësës J.R. me të njëjtin nivel me nxënësit e tjerë.

5.3. Në zbatim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, detyrohet Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë dhe Drejtoria e Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”, Pogradec, që brenda 30 ditëve të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me masat e marra.

5.4. Rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të amendojë **ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, duke parashikuar aktet ligjore dhe nënligjore, të formuluar me saktësi, të kuptueshme dhe sa më të qartë, në mënyrë që qytetarët të jenë të vetëdijshëm për të drejtat, liritë dhe kufizimet e tyre.**

Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 19 të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, shpresojmë që ky rast të analizohet në mënyrë objektive nga ana juaj, analizë e cila do të ndihmonte dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme”.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE

Ankesë e shtetasit T.K kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “etnisë” dhe “gjendjes ekonomike”.

Vendim Nr. 212 / 2014

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga shtetësi T.K kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “etnisë”¹⁸ dhe “gjendjes ekonomike”. T.K në ankesën e sjellë pranë KMD-së, vë në dukje se: *“Ai është pjesëtar i komunitetit egjiptian, dhe se familjet e këtij komuniteti përballen me vështirësi të mprehta ekonomike dhe sociale, të cilat bëjnë të pamundur vijimin e arsimimit të detyrueshëm 9-vjeçar të fëmijëve të tyre. Kjo sjell uljen në mënyrë të ndjeshme të numrit të të rinjve egjiptianë që frekuentojnë shkollën. Për të zbutur këto rrethana të pafavorshme për arsimimin e mëtejshëm të komunitetit egjiptian, subjekti ankues kërkon që fëmijët egjiptian të përfshihen në skemën e përfitimit të teksteve falas, gjë e cila do të ishte në mbështetje të të rinjve të këtij komuniteti, të cilët synojnë të shkollohen”*.

1.2. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkoi informacion nga ministria e Arsimit dhe Sportit, e cila informoi Komisionerin mbi bazën ligjore që mundëson pajisjen me libra falas të grupeve të ndryshme vulnerabel.

1.3. Me datë 04.12.2014, inspektorët e Komisionerit realizuan një takim me R.K, bashkëshortja e T.K, në ambjentet e “Lëvizjes rinore egjiptiane dhe rome”, Elbasan, në lidhje me marrjen e një informacioni më të detajuar, lidhur me ankesën në fjalë. Në formularin e ankesës së sjellë pranë KMD-së, ka patur mangësi dhe aty janë shprehur në mënyrë të përgjithshme problematikat e komunitetit pa dhënë detaje për rastin specifik.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Familja me kryefamiljar T.K, me numër anëtarësh katër: bashkëshorten dhe dy fëmijët e tyre të mitur, trajtohet me ndihmë ekonomike, pranë Bashkisë së Elbasanit. Procedura për përfitimin e pajisjes së fëmijëve të tyre me tekste shkollore falas, si fëmijë që vijnë nga një familje që trajtohet me ndihmë ekonomike, përshkruhet e detajuar në Udhëzimin e përbashkët me nr. 51, datë 20.09.2013, ku citohet: *“4. Kategoritë që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin e çmimit të teksteve shkollore, janë si më poshtë vijon:...4.1, germa b) për nxënësit në sistemin parauniversitar që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga Zyrat e Punësimit”, çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në masën 100% të tij.*

¹⁸ Ankuesi T.K. shprehet se i përket komunitetit egjiptian.

2.2. Pra, T.K, bazuar në statusin e përfituesit të ndihmës ekonomike, përfiton që fëmijët e tij të pajisen me tekste shkollore falas dhe çmimi i blerjes së teksteve shkollore rimbursohet në masën 100% të tij. Kjo bëhet në respektim të procedurës së përcaktuar, ku fillimisht ai duhet të paraqesë pranë drejtorisë së shkollës një dokument që vërteton gjendjen e tij ekonomike dhe që ai trajtohet me ndihmë ekonomike nga ana e Këshillit Bashkiak, Elbasan dhe kuponin tatimor me të cilin është bërë blerja e teksteve shkollore, sipas të cilit bëhet edhe kompensimi i vlerës së tyre. Nga biseda me R.K, rezultoi se ata nuk kanë paraqitur pranë drejtorisë së shkollës 9-vjeçare “Ptoleme Xhuvani”, Elbasan, kuponin tatimor, i cili duhej depozituar aty, për efekt të kompensimit të çmimit të blerjes së teksteve shkollore, të dy fëmijëve të tyre.

2.3. Pika 6, e po këtij Udhëzimi, përcakton se: “Nxënësit, prindërit, institucioni arsimor (shkolla), pas blerjes së teksteve shkollore, dorëzojnë në Drejtorinë e institucionit arsimor (shkollës) përkatës, faturat tatimore të blerjes”. Është detyrë e drejtorisë së shkollës që, për nxënësit që përfshihen në pikën 4.1 deri në 4.7, mbështetur në dokumentacionin që vërteton statusin/ gjendjen sipas vendimeve të njësive vendore (Këshillit të Bashkisë apo të Komunës), për gjendjen ekonomike/ familjare, të hartojë listat për çdo klasë dhe për të gjithë shkollën, dhe brenda datës 30 Shtator t’i dorëzojë ato në DAR/ ZA, në formë zyrtare dhe elektronike. DAR/ ZA brenda datës 10 Tetor dërgon në MAS kërkesën për fonde buxhetore të detajuar sipas niveleve arsimore/buxhetore, për arsimin bazë.

2.4. Po ashtu, Udhëzimi nr. 23, datë 08.08.2014, për vitin shkollor 2014-2015, në sistemin shkollor parauniversitar, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, në kreun V-të të tij, ***Regjistrimi i nxënësve dhe pajisja me tekste shkollore***, në pikat 4 dhe 5 parashikon se: “4. DAR/ZA- të drejtuesit e shkollave dhe mësuesit të ndjekin me përgjegjësi procesin e shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore, në mënyrë që me 15 Shtator të mos mbetet asnjë nxënës pa u pajisur me të gjitha tekstet shkollore që do t’i duhen t’i përdorë gjatë vitit shkollor 2014-2015. 5. DAR/ZA-të, të njoftojnë zyrtarisht MAS-in për ecurinë e procesit të pajisjes me tekstet shkollore.”

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, **racën**, ngjyrën, **etninë**, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3 të tij, përcakton: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

3.3. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3, pika 3, parashikon se: “Diskriminimi i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.

3.4. Neni 18, i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “Detyrat e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrit të Arsimit dhe Sportit”, në pikën 2, germa c) parashikon se: “2. *Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit*

dhe Sportit, ndër të tjera, marrin secili masa për: (c) arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuar, **si dhe të personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji.**”

3.5. Në bazë të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Nxënësit që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, kanë qenë dhe janë në fokus të vëmendjes së Komisionerit.

4. OPINION

4.1. ECRI, në Rekomandimin Nr. 7 të tij, përkufizon se: “Diskriminimi racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë që bazohet në shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”. Referuar këtij përkufizimi, në vijim të trajtimit të ankesës, Komisioneri, do t’i referohet diskriminimit për shkak të etnisë, si diskriminim për shkak të racës, duke qenë se përfshihet tek kjo e fundit.

4.2. Institucioni i Komisionerit në përmbushje të qëllimit të ligjit sipërcituar, dhe të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, ka bërë dhe Rekomandime të posaçme, në fushën e arsimit. Në Rekomandimin “Për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim, në fillimin të vitit shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor parauniversitar”, drejtuar Ministrit të Arsimit dhe Sportit, në pikën e 5, për subvencionimin e teksteve shkollore, shpreh se: “Vitin e kaluar, për shkak të vonësës në subvencionimin e testeve shkollore, u shkaktua një situatë problematike për kategoritë e nxënësve si, romë, egjiptianë, fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit dhe statusin e të verbërit, fëmijët e emigrantëve dhe pakicave kombëtare, fëmijët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, apo kategori të tjera, të cilët përfitojnë subvencionim nga shteti për tekstet shkollore. Duke marrë shkas nga eksperiencia e vitit të kaluar, por edhe nga zhvillimet e deritanishme lidhur me këtë proces, **rekomandojmë ndjekjen dhe monitorimin me prioritet të gjithë procesit për subvencionimin e teksteve shkollore, për të gjithë kategoritë e fëmijëve që përfitojnë subvencionimin e teksteve shkollore, për të garantuar pajisjen e të gjithë nxënësve me tekstet shkollore dhe për të parandaluar në këtë mënyrë krijimin e situatave diskriminuese për këto kategori nxënësish, të cilët do të gjendeshin në pamundësi për t’u pajisur me tekstet shkollore.**”

4.3. Nisma e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit duke porositur shtëpitë botuese që të përgatisin libra shkollorë, sipas klasave, falas, për të gjithë fëmijët romë, pa qenë e nevojshme të paguajnë për t’u rimbursuar më pas nga shteti, ka mundësuar lehtësimin e pajisjes me tekste të fëmijëve.

4.4. Në këtë kuadër, Komisioneri, nisur nga konstatimi i bërë gjatë shqyrtimit të ankesave të ardhura pranë Institucionit të tij, ka vërejtur se në një situatë të ngjashme janë edhe pjesëtarët e kategorisë që përfitojnë rimbursim në masën 100% të çmimit të blerjes së teksteve shkollore, si rezultat i përkatësisë në kategoritë që përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin e çmimit të teksteve shkollore, pasi rezultojnë se burim të vetëm të të ardhurave të tyre monetare kanë ndihmën ekonomike. Në rastin specifik, të familjes K., ata rezultojnë të përfitojnë gjithsej të ardhura mujore në masën 4000 (katër mijë) lekë të rinj, në trajtën e ndihmës ekonomike, shumë e cila nuk është e mjaftueshme as për nevojat e domosdoshme jetike. Ata janë 4 (katër) persona në familje, të dy bashkëshortët të papunë, me dy fëmijë në moshë shkollore, dhe e gjithë shuma e vlerës mujore që ata përfitojnë nuk mjafton vetëm për blerjen e teksteve shkollore. Nga deklarimi i R.K, rezulton se asaj i është dashur të kërkojë para borxh për t’u blerë tekstet shkollore të dy fëmijëve.

4.5. Komisioneri, konstaton se, fëmijët që ndjekin arsimin 9-vjeçar, dhe janë pjesëtarë të kategorisë që familjet e tyre përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga Zyrat e Punësimit, duhet të pajisen me tekste shkollore falas, sipas klasave përkatëse, pa qenë e nevojshme të paguajnë për t'u rimbursuar më pas nga shteti.

4.6. Në këtë kuadër, Komisioneri, konstaton se kjo kategori përfituesish të teksteve shkollore falas, të cilët fillimisht i paguajnë tekstet shkollore, e më pas rimbursohen nga shteti, diskriminohet në mënyrë të tërthortë, nga Udhëzimi i përbashkët nr. 51, datë 20.09.2013, i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për "Procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parashkollor", lidhur me procedurën se si do të rimbursohen. **Kjo vjen për faktin se, duke qenë një kategori pa të ardhura të mjaftueshme, ata, nuk kanë mundësi reale që të bëjnë blerjen fillestare të teksteve shkollore, e më pas të presin rimbursimin.**

5. VENDIMI

5.1. Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi konstatimin e mosdiskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të racës dhe të gjendjes ekonomike, ndaj T.K, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

5.2. **Konstatimin e diskriminimit të tërthortë**, të kategorisë që përfitojnë ndihmë ekonomike, (të cilët rimbursohen në masën 100%), sipas klasave përkatëse, nga Udhëzimi i përbashkët nr. 51, datë 20.09.2013, i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për "Procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parashkollor", lidhur me procedurën se si rimbursohen.

5.3. Rekomandimin e subjektit ankues që të ndjekë procedurën e përcaktuar në Udhëzimet e cituara në Vendim¹⁹, për kompensimin në masën 100% të çmimit të blerjes së teksteve shkollore, duke ruajtur dhe kuponin tatimor të blerjes së librave, me anë të të cilit bëhet ky kompensim.

5.4. Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe Ministria e Financave, për vitin e ardhshëm shkollor 2015-2016, të parashikojë që, kategoria e nxënësve, që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga Zyrat e Punësimit, të pajisen me tekste shkollore falas, sipas klasave përkatëse, pa patur nevojë që fillimisht t'i blejnë tekstet e më pas të presin rimbursimin nga shteti.

5.5. Në referim të nenit 33, pika 11²⁰, të Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe Ministria e Financave, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.

5.6. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

19 Udhëzimi nr. 23, datë 08.08.2014, për vitin shkollor 2014-2015, në sistemin shkollor parauniversitar, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Udhëzimi i përbashkët nr. 51, datë 20.09.2013, i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për "Procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parashkollor".

3. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

ÇËSHITJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL DHE IDENTITETIT GJINOR

Ankesa e Shoqatës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT” dhe Shoqatës “Të bashkuar pro kauzës LGBT”, të përfaqësuar nga Xh. K. dhe E. T.

Vendim Nr. 125 / 2014

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 41, datë 02.05.2014, e Shoqatës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT” dhe Shoqatës “Të bashkuar pro kauzës LGBT”, të përfaqësuar nga Xh.K. dhe E. T., ku pretendohet për diskriminim të komunitetit LGBT, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, nëpërmjet postimeve të bëra në faqen zyrtare të Aleancës Kuq e Zi, në rrjetin social Facebook. Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë dhe fakteve të paraqitura pranë Komisionerit, pretendohet se, “nëpërmjet përmbajtjes së postimeve të bëra në datat 29-30 prill 2014, në faqen e FB të Aleancës Kuq e Zi, synohet kërcënimi dhe përhapja e gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBT. Një gjë e tillë vihet re qartë edhe në komentet përkatëse, në vijim të posterave të publikuara”. Ankuesit kërkojnë ndërhyrjen e Komisionerit, lidhur me heqjen e komenteve me përmbajtje diskriminuese dhe kërkim faljeje në një post në faqen zyrtare të rrjetit social Facebook, ashtu si edhe në një konferencë për shtyp nga ana e përfaqësuesve të Aleancës Kuq e Zi.

1.2. Pasi u konstatua se nga pikëpamja formale, ankesa plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mbështetur në nenin 33, pika 7, të këtij ligji, Komisioneri iu drejtua me shkresë zyrtare Z. Kreshnik Spahiu, kryetar i Aleancës Kuq e Zi, ku kërkohej informacion lidhur me çështjen në fjalë. Aleanca Kuq e Zi nuk ka dërguar asnjë përgjigje zyrtare në adresë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të dhënë sqarime, lidhur me ankesën e Shoqatave “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT” dhe “Të bashkuar pro kauzës LGBT”.

1.3. Aleanca Kuq e Zi refuzoi të bashkëpunonte me Komisionerin dhe nuk dha informacionin²¹ e nevojshëm për hetimin e kësaj çështjeje, duke rënë ndesh me dispozitat e ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Përmbajtja e disa prej publikimeve në faqen e rrjetit social FB të Aleancës Kuq e Zi, jepet si më poshtë vijon :

“Data 26 prill 2013

Thuaj STOP në 17 maj “Rilindjes Gay” në Tiranë! Të gjithë në protestë kundër iniciativës socialiste për martesat burrë me burrë. Pro familjes, pro moralit, pro jetës!

²¹ Informacioni u kërkuar nëpërmjet shkresës nr. 451/1, datë 05.05.2014, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Data 27 prill 2014

Shqiptar reago TANI. Çdo 17 maj, fëmijët tuaj do të gjenden përballë këtyre situatave rrugëve të Tiranës. Mbroni familjet tuaja, mbroni moralin familjar, mbroni të ardhmen. Shqipëria nuk është Greqi, thuajti "STOP GAY PARADE NË SHQIPËRI". Çdo sugjerim për parandalimin e këtij fenomeni është i mirëpritur.

Data 29 prill 2014

Njoftoni miqtë tuaj (jo ata gay) se më 17 maj, shqiptarët do të protestojnë :Pro familjes" dhe të gjithë së bashku t'i themi "STOP GAY PARADE NË SHQIPËRI". Minimumi i kontributit tuaj të shpërndajmë këtë njoftim që çdo shqiptar të jetë i informuar.

(Më poshtë jepet një video, titulli i së cilës është "Të largojmë LGBT më 17 maj")

Data 29 prill 2014

SKANDAL : Përcaktohen ngjyrat e veshjes dhe flamurëve për "Paradën e Homoseksualëve" në 17 Maj, në Tiranë/Sipas komunikatës ata do të përdorin sërish ngjyra lejla si vazhdimësi e fushatës elektorale dhe shpresës "Rilindja Gay".

Data 30 prill 2014

"Mbroni familjen! Të gjithë së bashku më 17 maj kundër "Rilindjes Gay" dhe kundër martesave homoseksuale në Shqipëri. Aleanca Kuq e Zi ju fton të distancoheni nga parada e homoseksualëve nga Shqipëria, Serbia, Greqia dhe Maqedonia. Bashkohuni me ne në shesh "Pro familjes dhe pro moralit".

2.2. Përveç postimeve të mësipërme, për t'u nënvizuar kanë qenë edhe shumë komente në vijim të tyre të bëra nga persona të ndryshëm, të cilat kanë patur përmbajtje tejet ofenduese dhe diskriminuese, ku evidentohet qartë gjuha e urrejtjes së shprehur ndaj personave që i përkasin komunitetit LGBT. Disa prej komenteve parashtrihen si më poshtë :

SH.I.: "Vetëm tritoli mbaron punë";

J.V. : "Digjini të gjallë këto poshtërsira";

L.L.: "Duhet me i vra krejt homoseksualët në botë";

D.D.C.: "Stop gay, jo në Shqipëri";

C.T.B. : ".....Në shumë shtete të botës këta të sëmurë (gay-t), dënohen me vdekje, vec në ato shtete që nuk njohin moral, që i ka pushtuar Sida, Hiv...etj. Ne jemi shqiptarë dhe kemi moral shqiptar, në rast se europa nuk na do me moral, as ne nuk e duam.....";

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" parashikohet objekti i këtij ligji, duke sanksionuar se : "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, **identitetin gjinor, orientimin seksual**, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."

3.2. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

3.3. Neni 32, pika 2, i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikon: *“Të gjitha institucionet publike dhe **subjektet private** janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

3.4. Neni 33, pika 13, i ligjit nr. 10221/2010 parashikon se: *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë:*

a) personi fizik, nga 10 000 deri në 60 000 lekë;

b) personi juridik nga 60 000 deri në 600 000 lekë;

c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30 000 deri në 80 000 lekë;

ç) personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkelje në bazë të këtij ligji, nga 30 000 deri në 80 000 lekë”.

4 . OPINIONI

4.1. “ rientimi seksual” dhe “identiteti gjinor”, janë shkaqe, për të cilat ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese dhe bazuar në nenin 32/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë, në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Mbështetur në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

4.2. Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në themelet e shtetit shqiptar. Kjo sanksionohet në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, **dinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij**, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”.* **Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cënojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.**

4.3. Në ligjin nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ligjvënësi ka ofruar të gjitha garancitë e mundshme që individit të mos cënohet, për shkaqet e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji, qoftë edhe nëpërmjet publikimit²² të reklamave dhe njoftimeve të ndryshme nëse ato paraqesin, haptazi apo në mënyrë të nënkuptuar, qëllim për të diskriminuar.

²² Në nenin 8, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Ndalohet publikimi i reklamave dhe njoftimeve të ndryshme, nëse ato paraqesin, haptazi apo në mënyrë të nënkuptuar, qëllim për të diskriminuar, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.*

4.4. Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuara në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

4.5. Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”, miratuar në datë 31 mars 2010, është mbajtur parasysh nga Komisioneri në rastin konkret, sepse ky rekomandim është nxjerrë ndër të tjera duke mbajtur në konsideratë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Komiteti i Ministrave rekomandon shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të të drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre. Në kuadër të garantimit të kësaj të drejte, rekomandohet që: “Shtetet anëtare duhet të marrin masat e duhura për të luftuar të gjitha format e shprehjes, duke përfshirë, në media dhe **në internet**, të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme, se ka gjasa për të prodhuar efektin e nxitjes, përhapjen ose nxitjen e urrejtjes apo të tjera forma të diskriminimit kundër personave gay, lesbike, biseksual dhe transeksual. Një **“gjuhë urrejtje” e tillë, duhet të ndalohej dhe publikisht të kundërshtohet kurdo që ndodh**. Gjithë masat duhet të respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes, në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe jurisprudencën e Gjykatës.”²³

4.6. Pra, vihet re se “gjuha e urrejtjes” kundër personave gay, lesbike, biseksualë dhe transeksualë (komuniteti LGBT), ka të bëjë me të gjitha format e shprehjes, të përhapura si nëpërmjet medias, ashtu edhe **nëpërmjet internetit**, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj personave LGBT. Vlerësimi, nëse shprehje apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “gjuhë e urrejtjes”, duhet të bëhet në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.²⁴

4.7. Shprehjet e përdorura në rrjetin social FB, nga ana e Aleancës Kuq e Zi ndaj komunitetit LGBT, të tilla si : Thuaj STOP në 17 maj “Rilindjes Gay” në Tiranë! Të gjithë në protestë kundër iniciativës socialiste për martesat burrë me burrë. Pro familjes, pro moralit, pro jetës!” apo “Mbroni familjen! Të gjithë së bashku më 17 maj kundër “Rilindjes Gay” dhe kundër martesave homoseksuale në Shqipëri. Aleanca Kuq e Zi ju fton të distancoheni nga parada e homoseksualëve nga Shqipëria, Serbia, Greqia dhe Maqedonia. **Bashkohuni me ne në shesh “Pro familjes dhe pro moralit”, krijojnë në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar, në lidhje me çështjet e orientimit seksual apo identitetit gjinor, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj komunitetit LGBT.**

4.8. Në çështjen Féret kundër Belgjikës²⁵, çështje në të cilën Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka bërë interpretime të rëndësishme, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: “...**një ligjëratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijojë mes publikut - e veçanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të**

23 Përkthim i Komisionerit

24 KEDNJ në nenin 10 parashikon se: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes”. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor

25 Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009

mirë informuar - ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje ndaj të huajve”²⁶, si dhe: “...nxitja e urrejtjes nuk nënkupton domosdoshmërisht thirrje për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera nëpërmjet fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme...”²⁷

Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke referuar në konkluzionet e mësipërme të çështjes “Féret kundër Belgjikës”, thekson në çështjen “Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë”²⁸, se: “diskriminimi në bazë të orientimit seksual është po aq serioz sa diskriminimi për shkak të “racës, origjinës, ose ngjyrës”.²⁹

4.9. Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se në çështjen në fjalë, postimet dhe publikimet në rrjetin social FB nga ana e Aleancës Kuq e Zi, në datat 26-30 prill 2014, si dhe komentet vijuese të personave të ndryshëm janë flagrante dhe përcjellin një gjuhë të urrejtjes të pajustificuar. Ato kanë haptazi përmbajtje diskriminuese ndaj komunitetit LGBT. Këto postime janë kryer përgjithësisht për të nxitur dhe irrituar opinionin publik, kundër Paradës që do të realizohej në datën 17 maj 2014, nga shoqatat që përfaqësojnë LGBT në Shqipëri. Mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

4.10. Gjykata Evropiane e Drejtësisë e ka theksuar këtë fakt në çështjen Feryn³⁰ ku është shprehur se: “mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Direktivës për barazi bazuar në shkaqe raciale”³¹.

4.11. Veprimet e ndërmarra nga Aleanca Kuq e Zi me publikimet e postimet e saj në FB kanë paraqitur haptazi qëllimin për ekspozimin e komunitetit LGBT ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, me komunitete të tjera jo LGBT. Qëllimi i saj gjykohet si diskriminues ndaj këtij komuniteti.

4.12. Megjithatë, vlen për t’u theksuar fakti, se në muajt në vijim, posterat dhe publikimet kundër komunitetit LGBT dhe paradës së 17 Majit, janë zhvendosur nga faqja e rrjetit social FB të Aleancës Kuq e Zi, por kjo nuk e zhduk efektin negativ dhe diskriminues të tyre në mbarë opinionin publik, për aq kohë sa ato kanë qenë pjesë e kësaj faqeje.

5. VENDIM

5.1. Mbështetur në nenet 1, 2, 3 pika 1, nenin 7, pika 1, nenin 8, nenin 21, pika 1, nenin 22, nenin 32, pika 1, germa b), c) dhe ç) e pika 2, si dhe nenin 33, pika 13 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi **konstatimin e diskriminimit** të Komunitetit LGBT, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, nga Aleanca Kuq e Zi, nëpërmjet postimeve dhe publikimeve të kryera në rrjetin social Facebook, në muajin prill 2014.

26 Përkthim i Komisionerit

27 Përkthim i Komisionerit

28 Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë, nr. 1813/07, datë 09 shkurt 2012.

29 Përkthim i Komisionerit

30 Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër Firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008

31 Përkthim i Komisionerit

5.2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, rekomandohet që përfaqësues të Aleancës Kuq e Zi të kërkojnë publikisht ndjesë brenda 15 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, si dhe në të ardhmen të evitohet përdorimi i gjuhës, që prodhon efektin e përhapjes, nxitjes së urrejtjes apo forma të tjera të diskriminimit, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre.

5.3. Aleanca Kuq e Zi të gjobitet me gjobë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për mosdhënie të informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

5.4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Aleanca Kuq e Zi të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

5.5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË RACËS DHE ETNISË

Ankesa e paraqitur nga Shoqata “Qëndistarët”, Korçë dhe nga Qendra Evropiane për të Drejtat Rome në Shqipëri, në të cilën pretendohet për diskriminim të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, për shkak të racës dhe etnisë, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë.

VENDIM Nr. 145 /2015

1. PROCUDURA E NDJEKUR

1.1. Shoqata “Qëndistarët”, Korçë dhe Qendra Evropiane për të Drejtat Rome në Shqipëri, pretendojnë se: “Në Shkollën 9-vjeçare “Naim Frashëri” Korçë, prej disa vitesh rregjistrohen vetëm fëmijë të cilët i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare kanë ofruar për fëmijët e shkollës, në mënyrë të veçantë për fëmijët me probleme të forta ekonomike dhe sociale, ushqim, veshje dhe bazë materiale. Si rezultat i ofrimit të këtyre kushteve, numri i fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian ka ardhur në rritje deri në momentin që në këtë shkollë mësojnë vetëm fëmijë të këtyre dy komuniteteve. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave nëpërmjet vendimeve Nr. 700, datë 10.10.2012, Nr. 665, datë 07.08.2013 dhe Nr. 678, datë 15.10.2014 “Për miratimin e projektit pilot për masat për nxitjen e të nxënësve, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve rom dhe egjiptian të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë”, ka parashikuar bursa dhe kuota ushqimore vetëm për fëmijët rom dhe egjiptian të kësaj shkolle. Ofrimi i një vakti ditor, për nxënësit, ka rritur në dukje frekuentimin e shkollës, por në të njëjtën kohë ka bërë që vetëm nxënësit e këtij komuniteti të rregjistrohen në këtë shkollë. Në këtë mënyrë, veçimi i fëmijëve të këtij komuniteti, mund të sjellë një numër më të madh të fëmijëve, të cilët nuk vijnë më tej studimet, rezultate të ulta etj. Sipas ankuesve, ndonëse në dukje, ofrimi i ushqimit në shkollë për nxënësit rom dhe egjiptian ka synimin e rritjes së frekuentimit, mjetet e përdorura nuk janë të përshtatshme dhe në përpjestim të drejtë me gjendjen që ka shkaktuar këtë veçim. Në analizë të rezultateve të nxënësve të kësaj shkolle, nga të dhënat që janë administruar nga DAR Korçë dhe MAS, konstatohet se një numër i vogël i nxënësve kanë vijueshmëri të rregullt në shkollë dhe kanë vazhduar më tej studimet për në shkollë të mesme”.

1.2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 629 prot., datë 24.06.2015, L.N Ministre e Arsimit dhe Sportit dhe K.G, Drejtor i DAR Korçë, ku i kërkohej informacion mbi çështjen e parashtruar nga ankuesit.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. DAR Korçë me shkresën nr. 763 prot, datë 01.07.2015, informon Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi se: “Në lidhje me shqetësimet e ngritura mbi frekuentimin e nxënësve romë dhe egjiptianë në një shkollë, ju bëjmë me dije se ka qënë politika shtetërore qëndrore për rritjen e frekuentimit të shkollës nga ana e këtij komuniteti, duke nxitur frekuentimin nëpërmjet ndihmave monetare dhe jo vetëm. Kjo politikë është ndjekur edhe prej lobimeve të shumta të Shoqatave Rome dhe Egjiptiane. Qëllimi primar i marrëveshjeve të këtyre shoqatave me Ministrinë e Arsimit dhe me Këshillin e Ministrave ishte rritja e

numrit të nxënësve që frekuentojnë shkollën duke i subvencionuar.” Subvencionimi në formë ushqimesh dhe ndihmash të komunitetit rom ka sjellë si pasojë largimin e nxënësve të komuniteteve të tjera për shkak të pabarazisë në trajtim. Duke qënë se janë larguar gradualisht fëmijët e komuniteteve të tjera, shkolla “Naim Frashëri” ka një numër të konsiderueshëm nxënësish rom dhe egjiptian dhe më pak të komuniteteve të tjera. Si rezultat i zbatimit të këtij projekti pilot, i cili ka në fokus rritjen e aksesit dhe cilësinë e arsimit të fëmijëve me prejardhje nga komuniteti rom dhe egjiptian, ka pasur një efekt të paparashikueshëm por jo të dëshiruar, siç është ai i segregacionit, pasi prindërit e fëmijëve që nuk përfitonin ndihma për shkak të përkatësisë shoqërore kanë larguar hap pas hapi fëmijët duke u ndjerë të mënjnauar në mënyrë të heshtur.

2.2. Gjithashtu, për të rritur mundësitë e nxënësve të këtij komuniteti, Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë, ka udhëzuar shkollat e arsimit të mesëm, gjimnazet, që në pranimet e tyre në klasën X të kenë një kuotë jo më pak se 5 % të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, pavarësisht nëse ata i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga këto shkolla sipas Dispozitave në fuqi.”

3. BAZA LIGJORE

3.1. Shteti shqiptar është angazhuar për të respektuar të drejtat e minoritetit rom dhe egjiptian, duke formalizuar vullnetin e vet përmes nënshkrimit të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës romë”, e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 633 datë 18.09.2003. Në përmirësimin e kushteve të jetesës, në kapitullin I të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës romë”, parashikohen politika mbështetëse në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të komunitetit rom.

3.2. Në mbrojtje të parimit të barazisë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 18 të saj “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”. Në nenin 20 të Kushtetutës parshikohet shprehimisht se “1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre.”.

3.3. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut në nenin 2, Protokolli nr. 1, parashikon se: “Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.”.

3.4. Në pikën 1/d, të nenit 29 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, parashikohet që Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim: “Ta përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymë të mirëkuptimit, paqes, tolerimit, barazisë midis seksëve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone;”

3.5. Duke analizuar bazën ligjore për arsimin parauniversitar, e më saktësisht nenit 28/3 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, vërejmë se: “Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për rregjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë”.

3.6. Sipas legjislacionit shqiptar, rregjistrimi i nxënësve në shkollat 9-vjeçare bëhet bazuar në Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Në analizë të Kreut III, nenit 12, pika 1, në të cilën citohet se: “Rregjistrimi i fëmijëve në kopësht dhe i nxënësve në shkollën 9-vjeçare

apo në shkollën e mesme të përgjithshme, si rregull, bëhet në kopshtin dhe në shkollën e përcaktuar nga ndarja territoriale e vendbanimit e vendosur nga pushteti vendor me propozim të Drejtorisë Arsimore”, pika 2 “Nxënësi, me miratimin e drejtorit të shkollës, mund të rregjistrohet në shkollat 9-vjeçare jashtë ndarjes territoriale të vendbanimit të tij, kur këtë gjë e lejojnë kushtet e kapacitetet e lokaleve”, rregjistrimi i nxënësve dhe shpërndarja e tyre në shkollat 9-vjeçare, bëhet në shkollën që i përket njësisë administrative në të cilën jetojnë nxënësit.

3.7. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 64 të Dispozitave Normative “Për arsimin parauniversitar”, përcaktohen qartë detyrat e Drejtorive Arsimore, në të cilat citohet se: “Drejtoria Arsimore është organi më i lartë administrativ publik i arsimit në nivel vendor” dhe “Drejtoria Arsimore drejton, organizon dhe përgjigjet për funksionimin e tërë punës së institucioneve arsimore dhe cilësinë e arsimit në juridiksionin e saj”.

3.8. Në nenin 3, pika 3, ligji përcakton se: **“Diskriminim i tërthortë”** është ajo **formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.**

3.9. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashtrohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

3.10. Mbrojtja nga diskriminimi në arsim trajtohet në një kapitull të veçantë të ligjit dhe pikërisht në kapitullin e tretë. Në nenin 18, pika 1, parashikohen detyrat e Këshillit të Ministrave dhe Ministrit të Arsimit, dhe citohet se: **“Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës janë secili përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim”.**

3.11. Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si **“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.**

4. OPINION

4.1. Komisioneri gjatë shqyrtimit të çështjes i është referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, në shqyrtimin e çështjes Lavida dhe të tjerët v Greqisë, ku Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut doli në përfundimin se: **“vendosja e nxënësve rom në një shkollë të veçantë, i mënjanon ata nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe nuk i lejon fëmijët e këtij komuniteti të integrohen në jetën sociale”.**

4.2. Mbështetur në informacionin e dhënë nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë dhe referuar rastit të shkollës “Naim Frashëri”, mund të themi se zbatimi i Vendimeve të përvitshme të Këshillit të Ministrave që nga viti 2012, ka sjellë një tjetër fakt që **ka një tendencë në rritje e numrit të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, krahasuar me komunitet e tjera.** Gjithashtu, duke krahasuar me shkollat e së njëjtës njësi administrative, në shkollën Naim Frashëri, numri i fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian është më i madh.

4.3. Ndonëse synimi i hartimit të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, nuk ka qënë kthimi i shkollës Naim Frashëri në një institucion arsimor ku ndjekin mësimin vetëm fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, këto dispozita ligjore të paanshme në dukje, kanë sjellë si pasojë që në shkollën Naim Frashëri të ndjekin mësimin vetëm fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian.

4.4 Përsa më sipër, konstatohet se Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë, pavarësisht faktit se ka qënë në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe ka qënë e ndërgjegjshme³² që zbatimi i këtij projekti pilot, ka patur efekt segregimin e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në shkollën “Naim Frashëri”, nuk ka njoftuar Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për efektet që ka sjellë zbatimi i këtij projekti. Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë me veprimet dhe mosveprimet e saj ka bërë që fëmijët e këtyre dy komuniteteve të vihen përballë një situatë segregimi apo veçimi. Ndërkohë që, edhe fëmijët që nuk janë pjesë e këtij komuniteti dhe vijnë nga familje në nevojë, janë ndjerë të diferencuar në trajtim dhe si rezultat gradualisht janë larguar nga kjo shkollë.

4.5. Këshilli i Ministrave, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë duhet të kishin marrë masa që situata e krijuar, pra veçimi i fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në një shkollë të vetme, të ishte shmangur. DAR Korçë dhe strukturat në varësi të saj, kanë patur detyrimin që me përgjegjësinë e ngarkuar me ligj, të shmangnin situatën e krijuar në Shkollën “Naim Frashëri”

4.6. *Në përfundim, Komisioneri, konstaton se pas analizës së bërë në lidhje me numrin e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në Shkollën “Naim Frashëri”, shihet se nuk ka një tendencë të veçimit apo përqëndrimit të fëmijëve rom në një shkollë të vetme, por Vendimet³³ e Këshillit të Ministrave të miratuara çdo vit, të paanshme në dukje, kanë sjellë si pasojë veçimin e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në një shkollë dhe diskriminimin e tyre për shkak të racës dhe etnisë.*

5. VENDIMI

5.1 Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian të Shkollës “Naim Frashëri”, Korçë, për shkak të racës dhe etnisë, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë.

5.2 Detyrimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë të marrë masa të menjëhershme, me qëllim përmirësimin e situatës dhe ndryshimin e raportit të nxënësve që i përkasin komunitetit rom/egjiptian dhe komuniteteve të tjera, në Shkollën “Naim Frashëri”, Korçë.

5.3 Detyrimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë, të marrin masa të menjëhershme për sensibilizimin e stafit të institucioneve arsimore në varësi, në mënyrë që të shmanget veçimi apo segregimi i fëmijëve rom/egjiptian në shkolla apo klasa të caktuara.

5.4 Detyrimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë, të informojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve Komisionerin lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 33, pika 11 e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

32 Referuar shkresës së DAR Korçë, “Kthim përgjigje”, drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me nr. 763 prot., datë 01.07.2015

33 VKM Nr. 700, datë 10.10.2012, VKM Nr. 665, datë 07.08.2013 dhe VKM Nr. 678, datë 15.10.2014 “Për miratimin e projektit pilot për masat për nxitjen e të nxënësve, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve rom dhe egjiptian të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë”

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË PUNË PËR SHKAK TË RACËS

Ankesë e z. E.B, kundër Filialit të Postës Elbasan, ku pretendohet diskriminim në punë për shkak të “racës”.

VENDIM NR. 44/2014

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. E.B sqaron se: *“Ka punuar shpërndarës pranë Filialit të Postës Elbasan. Me urdhër nr. 25, datë 09.01.2014, të Drejtores së Filialit të Postës Elbasan, ai është transferuar nga pozicioni “shpërndarës”, në pozicionin “agjent” pranë Zyrës Postare Stravaj Librazhd. Ankuesi nuk ka qenë dakord me këtë transferim dhe është i bindur, se ky është një veprim diskriminues i ndërmarrë ndaj tij, për shkak se ai i përket komunitetit rom”.*

1.2. Me shkresën nr. 33/1, datë 20.01.2014, Komisioneri kërkoi informacion Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan, lidhur me çështjen e ankuesit E.B. Me shkresën nr. 142, datë 29.01.2013 të Filialit të Postës Elbasan, Drejtoresha e këtij Filiali, informon Komisionerin, lidhur me ankesën e E.B.

1.3. Komisioneri kreu inspektim pranë Filialit të Postës Elbasan, me qëllim kryerjen e verifikimeve mbi ankesën e E.B. Ekipi i inspektorëve të Komisionerit morën takim me Drejtoreshën e Filialit të Postës Elbasan znj. K.K³⁴, e cila dha sqarimet përkatëse mbi çështjen objekt ankese. Sipas saj, arsyeja kryesore e transferimit të z. B nga detyra si “shpërndarës” pranë këtij filiali, në detyrën “agjent” pranë Degës Stravaj, Librazhd, u krye si pasojë e ristrukturimit të institucionit. Ajo thekson faktin se pas transferimit, ai nuk është paraqitur asnjëherë në detyrën e re. Mosparaqitja në detyrën e re dhe mungesat e tij ishin shkaku kryesor, i cili ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në largimin e tij nga puna³⁵. Një arsye tjetër që znj. K e rendit si shkak për transferimin e ankuesit, është edhe niveli i tij arsimor. E.B ka përfunduar arsimin 8-vjeçar, ndërkohë që në bazë të aktit “Struktura organizative e degëve të kategorisë së parë të Posta Shqiptare sh.a, me pagat përkatëse sipas vendeve të punës dhe kategorive 2012”, rezulton se për pozicionin “shpërndarës”, arsimi i mesëm është kriter për punësim.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. E.B ka punuar shpërndarës pranë Filialit të Postës Elbasan. Me urdhër nr. 25, datë 09.01.2014, të Drejtores së Filialit të Postës Elbasan, ai është transferuar nga pozicioni “shpërndarës”, në pozicionin “agjent” pranë Zyrës Postare Stravaj Librazhd.

2.2. Me Urdhër nr. 25, datë 09.01.2014 të Drejtorisë së Filialit sh.a. Elbasan dhe me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm, për arsye të riorganizimit të punës, punonjësi E.B, me detyrë “shpërndarës” pranë Zyrës Qendër Elbasan, ka kaluar “agjent” pranë Zyrës Postare Stravaj të Degës Librazhd.

³⁴ Znj. K..K. është emëruar në pozicionin e drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan në muajin tetor të vitit 2013.

³⁵ Ankesa nr. 10, datë 05.02.2014, e z. E.B.

2.3. Më datën 28.01.2014, me Urdhër nr. 121, datë 28.01.2014 të Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan, E.B është larguar nga puna si shpërndarës pranë këtij filiali, me motivacionin: *“Bazuar në evidencat e Zyrave Postare, në të cilat nuk arrihet efektiviteti i duhur për mbarëvajtjen e ecurisë së Filialit, si dhe për arsye të mos realizimit të detyrave për vitin 2013, të paraqitura në auditimet e kryera gjatë vitit 2013 mbi problemet dhe mangësitë e konstatuara me shkresën nr. 23, datë 23.01.2014, të Drejtorisë së Auditimit”.*

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në mbrojtje të parimit të barazisë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 18 të saj: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnina, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objective”. Në nenin 20 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se: “1 Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre”.

3.2. Ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “... rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.3. Ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenin 15, pika 2 parashikon shprehimisht: “Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës”.

4. OPINION

4.1. Pas analizimit të dokumentacionit dhe listë-prezencës së muajit janar 2014 të Filialit të Postës Elbasan rezulton se E.B. është paraqitur në punë pranë Filialit të Postës Elbasan, jo pranë Zyrës Postare Stravaj Librazhd, deri në datën 28.01.2014 dhe nuk ka kryer asnjë mungesë të paarsyeshme. Ky fakt bie në kundërshtim me dëshminë e znj. K.K, e cila theksoi se një ndër arsyet kryesore të largimit të tij nga puna ishte numri i mungesave pa arsye, që ai kishte bërë pranë Zyrës Postare Stravaj Librazhd, ndërkohë që E.B nuk kishte asnjë arsye për t’u paraqitur në detyrën e re, sepse Urdhëri nr. 25, datë 09.01.2014, për transferimin e tij, ishte anuluar dhe nëpërmjet Urdhërit nr. 28/1, datë 10.01.2014, pra, ai ishte rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës.

4.2. Sipas shkresave të administruara, rezulton se vetëm 18 ditë më vonë, përkatësisht në datën 28.01.2014, E.B është larguar nga puna (nga detyra e shpërndarësit pranë FP Elbasan), nëpërmjet Urdhërit nr. 121, datë 28.01.2014, të Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan. Motivacioni i përshkruar në Urdhërin nr. 121, datë 28.01.2014 është : *“Bazuar në evidencat e Zyrave Postare, në të cilat nuk arrihet efektiviteti i duhur për mbarëvajtjen e ecurisë së Filialit, si dhe për arsye të mos realizimit të detyrave për vitin 2013, të paraqitura në auditimet e kryera gjatë vitit 2013 mbi problemet dhe mangësitë e konstatuara me shkresën nr. 23, datë 23.01.2014, të Drejtorisë së Auditimit”.*

4.3. Për sa më sipër, për të qartësuar motivacionin e largimit nga puna të E.B, inspektorët e Komisionerit kërkuan të administronin një kopje të shkresës nr. 23, datë 23.01.2014 të Drejtorisë së Auditimit. Nga

shqyrtimi i kopjes së shkresës ku është shkruar motivacioni i largimit nga puna të ankuesit, u konstatua se emri i shpërndarësit E.B nuk rezultonte në asnjë pjesë të këtij raporti, si punonjës, i cili kishte patur mangësi, probleme apo shkelje gjatë punës së tij. Njëkohësisht, referuar motivacionit të këtij urdhëri, nuk ekzistonte ndonjë akt tjetër i përmendur në të, ku të evidentohej ndonjë shkelje e ankuesit E.B.

4.4 Motivacioni i mosplotësimit të kriterit të arsimit të mesëm nuk është vënë as në Urdhërin nr. 28/1, datë 10.01.2014 të transferimit të z. E.B (i cili është anuluar nëpërmjet Urdhërit nr. 25, datë 09.01.2014, të Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan) dhe as në Urdhërin nr. 121, datë 28.01.2014 për largimin e tij nga puna. Në këtë mënyrë, rezulton se *Urdhëri nr. 121, datë 28.01.2014, i Drejtoreshës së Filialit të Postës Elbasan, është mbështetur në motivacion të pabazuar në ligj apo në raporte auditimi.*

4.5. Në nenin 15, pika 2, e ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet: *“Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës”.* Drejtoresha e Filialit të Postës Elbasan ka qënë në dijeni të faktit, që ankesa e E.B po shqyrtohej dhe hetohej nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, (nëpërmjet korrespondencës zyrtare me KMD-në) dhe pavarësisht kësaj ankuesi është larguar nga puna, gjë që sjell si pasojë shkeljen e parashikimit të këtij ligji.

5. VENDIMI

5.1. *Konstatimin e mosdiskriminimit* për shkak të racës, në fushën e punësimit, të z. E.B nga Filiali i Postës Elbasan, *për arsye të transferimit* të tij nga detyra e shpërndarësit pranë Filialit të Postës Elbasan, në detyrën e agentit pranë Zyrës Postare Stravaj Librazhd.

5.2. *Konstatimin e diskriminimit për shkak të racës, në fushën e punësimit, të z. E. B nga Filiali i Postës Elbasan, për arsye të largimit të tij nga puna.*

5.3. Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, rekomandohet marrja e masave të menjëhershme nga Filiali i Postës Elbasan, për sistemimin në punë të ankuesit.

5.4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Filiali i Postës Elbasan të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

5.5 Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE BINDJEVE POLITIKE

Ankesa e z. S.U., kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Kukës (DRSSH), me objekt pretendimi për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar³⁶ dhe bindjeve politike³⁷.

V E N D I M Nr. 15/2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. S.U shpjegon se: “Ka punuar në DRSSH-në Kukës, prej vitit 2007 e në vazhdim, në pozicione të ndryshme pune. Me datë 01.04.2014, ka marrë njoftim me shkrim për takimin, që do të zhvillohet mes tij dhe Përgjegjësit të Agjensisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (ALSSH), ku do t’i parashtrohen arsyet për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Më datë 08.04.2014, verbalisht, i është komunikuar nga Përgjegjësi i ALSSH-së Has, largimi i tij nga puna, ndërsa më datë 09.04.2014, ka marrë njoftim për kalimin nga pozicioni i punës së specialistit të kontrollit të pagave, në atë të specialistit të kontributeve. Largimi i tij përfundimtar nga puna është bërë më datë 20.05.2014, për shkak të ristrukturimit të DRSSH-së Kukës, ndërsa në librezën e tij të punës është shënuar mosparaqitje në punë. S.U në ankesën e tij pretendon se, për shkak të aftësisë së tij të kufizuar dhe duke qënë një nga themeluesit e Partisë Demokratike të Hasit, është pushuar nga puna në DRSSH-në Kukës”.

1.2. Më datën 11.07.2014, me shkresën Nr. 634/1 Prot, është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektivit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, në lidhje me ankesën për pretendim për diskriminim të paraqitur nga S.U. Nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, nuk u dërgua përgjigje mbi çështjen e S.U.

1.3. Duke qënë se nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, nuk ishte dhënë asnjë informacion, më datë 02.10.2014 në mjediset e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u zhvillua një seancë dëgjimore. Gjatë seancës dëgjimore S.U paraqiti pretendimet e tij sikurse janë të përshkruara edhe në ankesën e depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Duke qënë se nga ana e DRSSH-së Kukës nuk u vu në dispozicion asnjë nga dokumentet e kërkuara gjatë seancës dëgjimore, inspektori i çështjes kontaktoi nëpërmjet emailit³⁸ me Kryetarin e Degës dhe Përgjegjësin e Sektorit të Personelit dhe Marrëdhënieve me Publikun në DRSSH-në Kukës, Sh.D dhe kërkoi prej tij informacion lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga Zyra e KMD-së. Në përgjigje të emailit SH.D vuri në dispozicion të Komisionerit një kopje të Strukturës Organike të DRSSH-së përpara datës 01.02.2014, ndërsa për pjesën tjetër të dokumentacionit të kërkuar nga Komisioneri, sqaroi se: “Sa

36 Vërtetuar me anë të Dëshmisë së Invalidit të Punës, me nr. 71059/2, të dosjes së invaliditetit, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë.

37 Vërtetuar nëpërmjet vërtetimit datë 13.10.2014, të lëshuar nga Kryetari i Partisë Demokratike Dega Has, z.M. D.

38 Email datë 14.11.2014

për informacionet e tjera si p.sh. kopjen e dosjes personale³⁹, nuk kemi të drejtë të japim info, dhe në lidhje me të larguarit nga puna, kemi të drejtë t'i japim informacion vetëm ISSH-së Tiranë, rregulloren Nr. 12 duhet ta sjellim zyrtarisht nëse keni nevojë”.

2.2. Sipas informacionit të mësipërm rezulton se S.U, ka punuar pranë DRSSH-së Kukës për 11 (njëmbëdhjetë) vite dhe ka një eksperiencë pune prej rreth 6 (gjashtë) vitesh, në pozicionin e Specialistit të Kontrollit të Pagave në ALSSH Has.

2.3. Në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Komisioneri, DRSSH Kukës me anë të shkresës nr. 3567/2 prot., datë 20.11.2014, dërgoi bashkëngjitur një pjesë të dokumentacionit dhe nuk bëri me dijeni Komisionerin, lidhur me kopjen e dosjes personale të S.Xh (i cili ka zëvendësuar S.U., për pozicionin e specialistit të kontrollit të ALSSH Has), kopje të vlerësimit të punës për dy vitet e fundit të S.U, si dhe informacion lidhur me arsyet e lëvizjes së S.U nga pozicioni i Specialistit të Kontrollit të Pagave, në atë të Specialistit të Kontributeve.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe bindjeve politike janë shkaqe të mbrojtura nga ligji 10221/2010, neni 1 dhe neni 3/1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet se *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

3.2. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashtrohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”*

3.3. Ligji nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:*

...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

3.4. Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

3.5. Në nenin 3, pika 2 e ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet se kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo nga shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, kemi të bëjmë me diskriminim të shfaqur në formën e *“Diskriminimit të drejtëpërdrejtë”.*

39 Të S.U

4. OPINION

4.1. Duke iu referuar provave dhe dy strukturave organizative (strukturës së mëparshme dhe asaj të miratuar më datë 07.02.2014) të DRSSH-së Kukës, të vëna në dispozicion të Komisionerit, konstatohet se S.U është larguar nga detyra e Specialistit të Kontrollit të Pagave dhe është zëvendësuar nga S.Xh, i cili deri në momentin e transferimit në këtë pozicion mbante detyrën e inspektorit të bujkut, pranë ALSSH-së Has. Sipas strukturës së re, pozicioni i Specialistit të Kontrollit të Pagave, kërkonte arsimin e lartë Ekonomik, në degët Financë dhe Kontabilitet.

4.2 Pra, rezulton se S.U është trajtuar ndryshe nga nënpunësit e tjerë, pasi është larguar nga pozicioni i punës për të cilin i plotësonte kriteret (sipas të dy strukturave) dhe është zëvendësuar me S.Xh, i cili edhe pse mund të plotësojë kriteret e punës, nuk ka eksperiencën dhe kualifikimet e S.U, e për më tepër deri atëherë mbante një pozicion pune që kërkonte një tjetër⁴⁰ nivel arsimor.

4.3 Përsa i përket aftësisë së kufizuar të ankuesit, mbështetur në provat dhe faktet e sipërcituara, rezulton se drejtuesi i DRSSH-së Kukës ka patur dijeni, pasi së pari një kopje e vendimit të KMCAP-së ishte e arkivuar në dosjen personale të ankuesit, dhe së dyti ishte institucioni që ai drejton, i cili bazuar në nenin 64⁴¹ dhe 65⁴², pika 1 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” bënte shpërndarjen e fondeve për pensionet e invaliditetit. Nga ana e S.U janë paraqitur fakte dhe prova, mbi të cilat mbështeten pretendimet për diskriminim dhe shkakun e pretenduar (bindjet politike, për të cilën zotëron kartën e anëtarësisë), ndërsa nga ana e DRSSH-së Kukës, nuk është paraqitur asnjë provë apo fakt i dokumentuar, që do të mbështeste se largimi nga puna është bërë për shkaqe të arsyeshme dhe të argumentuara.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë të ankuesit S.U, për shkak të bindjeve politike, nga punëdhënësi Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës.

5.2. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë të ankuesit S.U për shkak të aftësisë së kufizuar, nga punëdhënësi Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës.

5.3. Detyrimin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, të kthejë në mënyrë të menjëhershme në pozicionin e mëparshëm të punës z. S.U.

5.4. Referuar nenit 13, pika 2 e Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashtrohet se: *“Punëdhënësi detyrohet të rrisë ndërgjegjësimin për këtë ligj edhe duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tij me mjetet e veta ose me ndihmën e subjekteve të specializuara”*, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, të marrë masat e menjëhershme për zbatimin e kësaj dispozite.

5.5. Detyrimin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, të informojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve Komisionerin lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 33, pika 11 e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

⁴⁰ Referuar Strukturës Organizative të DRSSH-së Kukës, pozicioni i inspektorit të bujkut që mbante z. Xh, kërkonte arsimin e mesëm.

⁴¹ Në nenin 64, parashikohet se: *“Përfitimet që parashikon ky ligj, financohen nga fondi i sigurimeve shoqërore, tek i cili do të kontribuojnë rregullisht punëdhënësit, të punësuarit dhe personat e tjerë vullnetarisht të siguruar”*

⁴² Në nenin 65, pika 1, përcaktohet se: *“Fondi i sigurimeve shoqërore është i ndarë nga buxheti i shtetit. Ai administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me statusin e tij të miratuar nga Këshilli i Ministrave”*

ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

Ankesa nga E.P. kundër subjektit Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar.

VENDIM Nr. 113/ 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. E.P shpjegon se: *“Është prind i një fëmije me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me Vendim KMCAP-je⁴³. Ankuesja ngre pretendimin se fëmija i saj, Xh.P. duhet të ketë një mësues mbështetës, të siguruar nga DAR-i, në bazë të vlerësimit të bërë nga Komisioni i ngritur pranë këtij Institucioni. Ky Komision, nuk ka bërë asnjë vlerësim për këtë nxënë. Prindi ankohet se fëmija i saj nuk di fare as të shkruajë, as të lexojë, megjithëse është në klasën e katërt të shkollës 9-vjeçare “Jani Minga”. Subjekti ankues kërkon që në përfundim të hetimit, Komisioneri, të ndërhyjë pranë DAR Vlorë për t’i siguruar një mësues mbështetës fëmijës së saj me aftësi të kufizuara”.*

1.2. Me shkresën Nr.218/1 prot, datë 10.03.2015 u njoftua dhe ju kërkua informacion subjektit Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, mbi pretendimin e ngritur nga E.P.

1.3. Me shkresën me nr.584 Prot., datë 24.03.2015, DAR Vlorë, bën me dije Komisionerin se: *“Bazuar në Dispozitat Normative për arsimin parauniversitar dhe në Udhëzimin nr.38, datë 07.10.2014 “Për kriteret e mësuesit ndihmës dhe nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar” në DAR Vlorë është ngritur dhe kryen funksionet konform ligjit Komisioni Multidisiplinar.*

1.4. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 27.04.2015, në zbatim të Urdhërit nr.45, datë 15.04.2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim në ambientet e Drejtorisë së DAR Vlorë.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Nga ana e inspektorëve të KMD-së, u kërkua një kopje e dokumentacionit ku të vërtetohej se nxënësi kishte ndërprerë procesin mësimor dhe shkolla kishte dijeni që nxënësi nuk do të frekuentonte në vijim procesin mësimor, si dhe një kopje e dokumentacionit ku të provohej se nga ana e DAR Vlorë të ishte caktuar një mësues mbështetës për nxënësin Xh.P.

2.2. Meqenëse, nga ana e DAR Vlorë, nuk ishte e mundur të na sigurohej brenda ditës dokumentacioni i kërkuar, u dakortësua që dokumentacioni mbështetës të dërgohej në rrugë zyrtare. Ndërkaq, inspektorët e Komisionerit u njohën me dokumentacionin e depozituar pranë DAR Vlorë, për fëmijën Xh.P.

⁴³ Vendim nr.249, datë 27.03.2014, i KMCAP-së Vlorë.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. “Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr. 108/2012, datë 15 Nëntor 2012, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuara, duke ndryshuar para së gjithash trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

3.3. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e kësaj Konvente, ku ofrohet një mbrojtje e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara, për të siguruar që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë. Në interpretim të Konventës, personat me aftësi të kufizuara përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

3.4. Referuar ligjit 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6, thuhet shprehimisht se: “...3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi, që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral. 4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i

gjithëpërfshirjes së nxënësve. 5. Çdo nxënës i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim. 6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë, u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj...”

4. OPINION

4.1. Nisur nga dinamika e ngjarjeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjykon se: ka ekzistuar një situatë diskriminuese ndaj nxënësit XH. P, për shkak se, atij nuk i është krijuar mundësia e ofrimit të mësuesit ndihmës, deri në momentin kur Drejtorisë Arsimore Rajonale, Vlorë, i është bërë me dije se Komisioneri po shqyrton ankesën e tij. Menjëherë pas këtij momenti, DAR Vlorë, ka reaguar duke i caktuar një mësues ndihmës.

4.2. Për sa më sipër, dhe nga sa rezultoi nga komunikimi verbal e shkresor me DAR Vlorë, pas ndërmjetësimit të KMD-së, nga ana e kësaj Drejtorie janë ndjekur të gjitha procedurat për rregullimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor për nxënësin Xh.P, në përputhje me parashikimet e ligjit “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

4.3. Përmes ndërmjetësimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë, u arrit qëllimi që nxënësit t’i caktohej mësues ndihmës. Nga ana tjetër, referuar shkresave cituar në vendim, rezultoi se prindi ka tërhequr fëmijën nga shkolla, duke bërë të pamundur vijimin e punës së mësuesit ndihmës, të caktuar nga DAR Vlorë, për të asistuar në mbarëvajtjen e procesit mësimor të nxënësit Xh. P.

5. VENDIMI

- 5.1 Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të nxënësit Xh.P, nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Vlorë.
- 5.2 Situata është zgjidhur në favor të nxënësit Xh.P dhe konsiderohet se ***është arritur qëllimi***.
- 5.3 Rekomandimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë, për të patur në vëmendje zbatimin me korrektësi të gjithë kuadrit ligjor të sipërcituar në vendim, në mënyrë që nxënësve me aftësi të kufizura, t'u ofrohet mundësia e vënies në dispozicion të mësuesit ndihmës, si një e drejtë e garantuar me ligj.
- 5.4 Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, të marrë të gjitha masat paraprake, për mbulimin me mësues ndihmës që në fillim të vitit shkollor 2015-2016, për të gjithë nxënësit e identifikuar me aftësi të kufizuar, që ndjekin procesin mësimor në institucionet e arsimit parauniversitar.

ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË VENDBANIMIT

Bazuar në informacionin e marrë nga shtetasi D.D, banues në Mbretërinë e Bashkuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes lidhur me masën e tarifës së pajisjes me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë që banojnë në shtete të ndryshme të Evropës dhe mënyrës së pagesës së kësaj tarife.

VEND I M Nr. 129 / 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1 D.D shpjegon se: *“Shtetasit shqiptarë që banojnë në Mbretërinë e Bashkuar janë të detyruar të paguajnë tarifë më të lartë për tu pajisur me pasaportë biometrike, gjë që vendos këto shtetas në pozita të pabarabarta në raport me shtetasit Shqiptarë që banojnë në shtete të tjera. D.D informon se shtetasit shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar në diferencë me shtetasit Shqiptarë me banim në Itali dhe Greqi janë të detyruar që pagesat për pajisjen me pasaportë ti kryejnë vetëm nëpërmjet pagesës me (Postal order) dhe jo në forma të tjera⁴⁴, gjë që ngarkon me pagesë ekstra këto shtetas për tu pajisur me pasaportë biometrike”.*

1.2 Me shkresën Nr. 377/1, datë 09.02.2015 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Punëve të Brendshme informon se vendosja e tarifave për shërbimin e pajisjes me dokumente identifikimi është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 9972, datë 28.07.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve elektronike dhe pasaportave biometrike”, ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit Sagem Securite dhe Fondit Shqiptaro Amerikan të Ndërmarrjeve, i ndryshuar me ligjin Nr. 129/2013, datë 15.03.2013, shtojca 11 “Çështjet financiare”, Seksioni 1 “Dokumentet e Identifikimit”, si dhe Marrëveshjet “Për hapjen dhe funksionimin e zyrës/ave të reja të aplikimit” pranë ambasadave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e nënshkruar më 18.09.2012 dhe pranë ambasadave në Evropë, e nënshkruar më 17.05.2013.

1.3. Në kushtet kur informacioni i kërkuar nuk ishte shoqëruar me parashtrime dhe dokumentacion, Komisioneri me shkresën Nr. 170, datë 16.02.2015 ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, kopje të pjesëve të kontratës dhe marrëveshjeve në të cilat detajohet/justifikohet vendosja e tarifave të ndryshme për shtetasit Shqiptarë që banojnë në shtete të ndryshme ku ofrohet shërbimi i pajisjes me letërnjoftim elektronik dhe pasaportave biometrike. Me shkresën Nr. 1193/1, datë 25.02.2015 Ministria e Punëve të Brendshme ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacionin e mëposhtme: - Shtojca 11 “Çështjet financiare”, Seksioni 1 “Dokumentet e identifikimit” (16 fletë), - Marrëveshjen “Për hapjen dhe funksionimin e zyrës/ave të reja të aplikimit” pranë ambasadës SHBA, e nënshkruar më 18.09.2012, (5 fletë) - Marrëveshjen “Për hapjen dhe funksionimin e zyrës/ave të reja të aplikimit” pranë ambasadave në Evropë, e nënshkruar më 17.05.2013 (4 fletë).

1.4. Me shkresën Nr. 1869/1, datë 19.03.2015 Ministria e Punëve të Brendshme ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacionin e mëposhtëm: - Programi 11 “Çështjet financiare” (4 fletë), - Programi 21 “Çështje të reja financiare” Seksioni 3 “Zyrat e aplikimit në ambasada” dhe Seksioni 4 “Dokumenti me

44 Në Itali dhe Greqi pagesat lejohen të kryhen nëpërmjet sistemit bankar.

procedurë të shpejtë” (3 fletë). Në këtë dokumentacion të dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme nuk shpjegoheshin asnjë nga kërkesat e kërkuara nga Komisioneri.

1.5. Me shkresën Nr. 4982/1, datë 03.07.2015 Ministria e Punëve të Brendshme ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacionin e mëposhtëm: - Kontratë “Për ndryshimin e kontratës së koncesionit “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike, lidhur më 21.07.2008” nënshkruar më datë 13.07.2010, (10 fletë) – Relacionin shpjegues “Për ratifikimin e kontratës “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9972, datë 28.07.2008”” (16 fletë). Dhe në këtë dokumentacion të dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme nuk shpjegoheshin kriteret për përcaktimin e çmimeve të ndryshme dhe informacioni i dërguar nuk ishte i mjaftueshëm për të argumentuar diferencën në çmim në shtete të ndryshme.

1.6. Me shkresën Nr. 3274/1, datë 16.03.2015, Ministria e Punëve të Jashtme sqaron se arsyet që Ambasada Londër ka vendosur të ofrojë shërbimin me “Postal order” janë: 1. Jep mundësi për verifikimet e nevojshme, 2. Përdoret edhe nga shtetasit shqiptarë që kanë hyrë në UK në mënyrë ilegale dhe nuk kanë llogari bankare, dhe 3. Redukton shpenzimet e bankës për mirëmbajtjen e llogarisë.

1.7. Me shkresën Nr. 297, datë 27.03.2015 i është kërkuar përsëri informacion Ministrisë së Punëve të Jashtme në lidhje me: -Format e pagesave që përdoren për përfitimin e shërbimeve konsullore në ambasadat e Republikës së Shqipërisë në shtetet: Itali, Greqi, Belgjikë dhe Zvicër; - Çfarë kuptohet me termin “Verifikimet e nevojshme” dhe si bëhen verifikimet e nevojshme në shtetet e tjera të sipërpërmendura, në të cilat lejohen dhe forma të tjera të pagesave; - Përse shërbimi i pagesës me “Postal order” konsiderohet si lehtësi për tu përdorur nga shtetasit shqiptarë që kanë hyrë në mënyrë ilegale dhe nuk kanë llogari bankare vetëm në Mbretërinë e Bashkuar dhe jo në shtetet e tjera të sipërpërmendura në të cilët lejohen dhe forma të tjera të pagesave; - Përse vetëm në ambasadën Shqiptare të Mbretërisë së Bashkuar duhet të merren parasysh shpenzimet e bankës për mirëmbajtjen e llogarisë, gjë që ngarkon me pagesë shtesë shtetasit shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar dhe nuk merren parasysh shpenzimet e bankës në shtetet e tjera të sipërpërmendura në të cilat lejohen forma të ndryshme pagese pa marrë parasysh reduktimin e shpenzimeve të bankës për mirëmbajtjen e llogarisë.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Lidhur me pretendimin se për shkak të vendbanimit, shtetasit Shqiptarë që banojnë në Mbretërinë e Bashkuar janë të detyruar të paguajnë tarifë më të lartë për tu pajisur me dokumentet e identifikimit:

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti, kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe informacion të detajuar mbi përbërësit e kostos së pasaportave biometrike për shtetasit shqiptarë që banojnë në shtete të ndryshme të Evropës, në mënyrë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kishte një bazë krahasimore dhe të shqyrtonte këtë ankesë në mënyrë sa më objektive dhe të paanshme. Komisioneri konstaton se Ministria e Punëve të Brendshme me dijeninë e plotë nuk ka dhënë asnjëherë informacionin dhe shpjegimet e kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

2.2. Lidhur me pretendimin se shtetasit shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar në diferencë me shtetasit shqiptarë me banim në Itali dhe Greqi janë të detyruar që pagesat për pajisjen me dokumente identifikimi ti kryejnë vetëm nëpërmjet pagesës me (Postal order) dhe jo në forma të tjera: Procedurat dhe rregullat për pajisjen e shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit me dokumentet e identifikimit janë të publikuara në faqet zyrtare të internetit të ambasadave të Republikës së Shqipërisë në shtetet

përkatëse. Referuar faqes së internetit të Ambasadës Shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar⁴⁵ vërehet se pagesa për pajisjen me dokumente identifikimi bëhet vetëm me “Postal order”, i cili blihet në Post Office. Referuar tarifave për blerjen e një Postal Order-i në vlerën që kërkohet për tu pajisur me pasaportë biometrike (144 GBP) verifikohet se çmimi që duhet të paguhet është 12.50 GBP. Referuar faqes së internetit të Ambasadës Shqiptare në Greqi⁴⁶ vërehet se pagesa për pajisjen me dokumente identifikimi bëhet nëpërmjet paraqitjes së faturës së pagesës që kryhet pranë “Pireos Bank” për vlerën 130 euro. Referuar faqes së internetit të Ambasadës Shqiptare në Itali⁴⁷ vërehet se pagesa për pajisjen me dokumente identifikimi bëhet nëpërmjet pagesës që kryhet në bankë për vlerën 130 euro.

2.3. Në njoftimet e publikuara nga Ministria e Jashtme, Ministria e Brendshme dhe selitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtete të ndryshme janë të publikuara tarifa të ndryshme për pajisjen e shtetasve Shqiptarë me pasaportë biometrike.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Diskriminimi për shkak të vendbanimit është shkak i cili gëzon mbrojtje nga ligji dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

3.3. Në nenin 4, pika 2 të ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “Shtetasit Shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare”, pra shtetasit shqiptarë me banim jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen që ofron ligji për mbrojtjen nga diskriminimi.

3.4. Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

3.5. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3, pika 3, parashikon se: “Diskriminimi i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.

45 www.ambasadat.gov.al/united-kingdom/pajisja-me-pasaporte-biometrike

46 www.ambasadat.gov.al/greece/sq/sh

47 www.ambasadat.gov.al/italy/sq/informacion-shpjegues

4. OPINION

4.1. Për sa më sipër, rezulton e provuar se Ministria e Punëve të Brendshme, ka shkelur nenin neni 32, pika 2 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili thotë se: Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 32, pika 2 *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*, si dhe neni 33, pika 13, *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”: b) personi juridik nga 60000 deri në 600000 lekë;*

4.2. Ministria e Punëve të Jashtme në komunikimin me zyrën e Komisionerit nuk ka arritur të parashtrojë shpjegime të arsyeshme pyetjeve të ngritura në lidhje me trajtimin e pabarabartë të shtetasve shqiptare me banim në Mbretërinë e Bashkuar, duke mos iu përgjigjur pyetjeve të ngritura nga Komisioneri në shkresën Nr. 297, datë 27.03.2015 në të cilën kërkohej shpjegime.

4.3. Referuar mënyrës së pagesës të publikuara në ambasadat Shqiptare në shtetet Itali, Greqi dhe Mbretëria e Bashkuar, vërehet se praktika e ndjekur nga ambasadat shqiptare në këto shtete në dukje nuk i diferencojnë/pengojnë shtetasit shqiptarë nga pajisja me dokumente identifikimi për shkak të vendbanimit, por shtetasit shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar për shkak⁴⁸ të çmimit të blerjes së “Postal Order-it” vendosen në pozita më pak të favorshme krahasuar me shtetasit shqiptarë me banim në Itali dhe Greqi. ***Kufizimi i pagesës vetëm me “Postal Order” është në fakt një praktikë diskriminuese për shkak të vendbanimit.*** Shtetasit shqiptarë me banim në Itali dhe Greqi, duke qenë se kanë mundësi të kryejnë pagesat nëpërmjet bankës, si rrjedhim dhe çmim më të ulët janë më të favorizuar se shtetasit shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar që duhet të paguajnë një çmim më të lartë për tu pajisur me dokumente identifikimi.

4.4. Për sa më sipër, në mungesë dhe të një justifikimi të arsyeshëm nga ana e Ministrisë së Jashtme, Komisioneri vlerëson se shtetasit Shqiptare me banim në Mbretërinë e Bashkuar diskriminohen në mënyrë të tërthortë nga praktika e pagesës, vetëm me “Postal Order” së tarifës së pajisjes me dokumente identifikimi në raport me shtetasit shqiptarë që jetojnë në Itali dhe Greqi.

5. VENDIMI

5.1. ***Ministria e Punëve të Brendshme të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për mosdhënie të informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.***

5.2. Gjoka të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda një muaji nga marrja dijeni, mbi masën administrative.

5.3. ***Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të shtetasve shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë.***

5.4. Në referim të pikës 3, Ministria e Punëve të Jashtme, rekomandohet që shtetasve Shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar ti ofrojë mundësi pagese nëpërmjet sistemit bankar apo formave të tjera.

5.5. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Ministria e Punëve të Jashtme, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

5.6. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

48 Gjendja ekonomike

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË MËMËSISË DHE GJINISË

Ankesa e D.Ç, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, ku pretendohet për diskriminim të saj, për shkak të bindjeve politike, shtatëzanisë dhe për çdo shkak tjetër.

V E N D I M Nr 25/2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. D.Ç shpjegon se: “Është punësuar në vitin 2006, në pozicionin e juristit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës dhe prej rreth 8 vitesh ka punuar në këtë pozicion pune. Në datën 02.12.2013, ankuesja ka marrë lejen e barrë lindjes dhe në pozicionin e saj të punës është komanduar një punonjës tjetër. Në bazë të strukturës së re të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, të miratuar me Urdhërin e Drejtorit të ISSH-së nr. 398, datë 12.02.2014, një nga dy pozicionet e juristëve, që bënin pjesë në strukturën paraardhëse, është suprimuar. Si pasojë e suprimimit të këtij pozicioni pune, nëpërmjet Urdhërit nr. 58, datë 26.05.2014 të Drejtorit të DRSSH Kukës, E.Xh është liruar nga detyra, duke i zgjidhur kontratën e punës. Ndërkohë që, me Urdhërin nr. 105, datë 10.12.2014, të Drejtorit të DRSSH Kukës, D.Ç largohet nga detyra, sërisht për efekt të hyrjes në fuqi të strukturës së re të institucionit, disa ditë⁴⁹ pasi është kthyer nga leja e barrë lindjes dhe në vend të saj është emëruar një person tjetër. Ankuesja kërkon konstatimin e diskriminimit të bërë ndaj saj, për largimin nga detyra në kundërshtim me ligjin. Rekomandimin e Komisionerit drejtuar palës punëdhënëse (DRSSH-Kukës) për ndreqjen e shkeljeve ligjore për të më rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës”. Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 99, datë 23.01.2015, ajo i ka shtuar kërkesat ndaj Komisionerit, lidhur me çështjen në fjalë, duke kërkuar edhe: “konstatimin e diskriminimit, lidhur me faktin e mos-garantimit të njohjes me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive themelore, si dhe të trajtimit me pagë, si një e drejtë themelore e çdo punonjësi”.

1.2. Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, me shkresën nr. 1082/1, datë 24.12.2014, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e ankueses D.Ç.

1.3. Me datë 19.01.2015, inspektorët e KMD-së, kryen inspektim pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, me qëllim kryerjen e verifikimeve mbi ankesën e D.Ç.

1.4. Komisioneri kontaktoi me ankuesen dhe i kërkoj informacion me shkrim lidhur me bindjet politike të saj, duke kërkuar që ajo të dorëzonte pranë KMD-së kopje të kartës së anëtarësisë në një prej subjekteve politike, vërtetime lidhur me pjesëmarrje në fushata elektorale apo komisione zgjedhore etj.

⁴⁹ Referuar njoftimit të datës 19.11.2014, të ankueses drejtuar DRSSH Kukës dhe vërtetimit nr. 3648, datë 26.11.2014 të lëshuar nga DRSSH Kukës, rezulton se ankuesja është kthyer në punë pas lejes së barrë lindjes në datën 26.11.2014.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Në bazë të Urdhërit nr. 105, datë 10.12.2014, të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, D.Ç, është larguar nga puna, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës. Referuar njoftimit nr. 3733, datë 03.12.2014, të DRSSH Kukës, ankuesja është njoftuar se shkak për zgjidhjen e kontratës së punës është struktura organizative e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës për vitin 2014. Në procesverbalin e mbajtur gjatë takimit që A.L, Drejtor i DRSSH Kukës ka realizuar me D.Ç rezultoi se: *“Dokumentacioni që provon shkakun e justifikuar të zgjidhjes së kontratës së punës është ristrukturimi i institucionit, bazuar në strukturën e re të miratuar me Urdhërin e ISSH-së nr. 398, datë 12.02.2014, ku pozicioni i punës “juriste” nuk ekziston më”*.

2.2. Inspektorët u informuan mbi të gjitha çështjet që përbënin objektin e inspektimit. Ristrukturimi i institucionit dhe saktësisht shkurtimi i pozicionit “jurist”, ishte arsyeja e lirimit nga detyra të D.Ç. Në kuadër të ristrukturimit të DRSSH Kukës, ishin larguar nga puna 12 punonjës. Duhet theksuar se nga verifikimet e bëra rezultoi se nuk është shkurtuar pozicioni i juristit.

2.3. Nga verifikimet e kryera në dosjen personale të D.Ç, rezultoi se ajo nuk kishte marrë asnjëherë masa disiplinore gjatë periudhës që kishte punuar pranë DRSSH Kukës. D.Ç i bëri me dije inspektorët se është ankuar administrativisht pranë DRSSH Kukës. I pyetur mbi pagesën e D.Ç për ditët që kishte punuar pas kthimit nga leja e barrë-lindjes e deri në largimin e saj nga puna, Drejtori sqaroi se pagesat ishin kryer në rregull, duke e demonstruar këtë me listë prezencat e muajve nëntor dhe dhjetor 2014.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Referuar nenit 8, të ligjit nr. Nr.8829, datë 05.11.2001 “Për ratifikimin e “Konventës nr.183 “Mbrotjtja e Amësisë, 2000”” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”, parashikohet se : *“1.Është e paligjshme për punëdhënësin të pushoje nga puna gruan gjatë kohës së shtatzënisë ose mungesës në punë për shkak të lejes së parashikuar në nenet 4 ose 5, ose gjatë një periudhe të caktuar pas kthimit të saj në punë, që duhet përcaktuar nga ligjet ose rregullat e vendit, përveç shkaqeve që nuk lidhen me shtatzëninë ose lindjen e fëmijës dhe pasojat e saj ose ushqimin e fëmijës. Baza e provës se arsyet e pushimit nga puna nuk lidhen me shtatzëninë ose lindjen e fëmijës dhe pasojat e saj ose ushqimin e fëmijës bie mbi punëdhënësin. Pas përfundimit të lejes së barrelindjes, gruaja duhet të sigurohet që, me rimarrjen e punës, do të gjeje të njëjtin vend pune ose një vend pune ekuivalent me paqe të njëjtë”*.

3.2. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

3.3. Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenet 12, 13 e 15, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe **nenit 8, të ligjit nr. Nr.8829, datë 05.11.2001 “Për ratifikimin e “Konventës nr.183 “Mbrotjtja e Amësisë, 2000”” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës**”, Komisioneri dha opinionin e mëposhtëm.

4. OPINIONI

4.1. Sikurse rezulton nga dokumentacioni i administruar gjatë procesit të hetimit, D.Ç është kthyer nga leja e barrë lindjes dhe është paraqitur në punë në datën 26 nëntor 2014. Ajo pretendon, se nuk është paguar për ato ditë që është paraqitur në punë, deri në momentin e hyrjes në fuqi të Urdhërit nr. 105, datë 10.12.2014, të Drejtorit të DRSSH Kukës për largimin e saj nga detyra. Referuar listëprezencave të muajve nëntor dhe dhjetor 2014 u konstatua se ankuesja nuk rezulton të jetë prezente në listëprezencën e muajit nëntor, ndërkohë që në listëprezencën e muajit dhjetor 2014, ajo rezulton të ketë qenë prezente në datat 01-15 dhjetor 2014, ndërkohë që sipas Urdhërit nr. 105, datë 10.12.2014, të Drejtorit të DRSSH-së, marrëdhëniet financiare të ankuses me këtë institucion ndërpritën në datën 10.12.2014. Në këto kushte gjykojmë se D.Ç, pas kthimit nga leja e barrë-lindjes nuk është paguar nga data 26.11.2014, deri në datën 10.12.2014, datë në të cilën janë ndërprerë marrëdhëniet financiare të saj me DRSSH Kukës.

4.2. Gjykojmë se D.Ç është larguar nga puna, nga ana e drejtuesit të DRSSH Kukës, menjëherë pas përfundimit të lejes së barrë lindjes, në kundërshtim me parashikimin e nenit 8, pika 1, të ligjit të sipërpërmendur, nëpërmjet një urdhëri me motivacion të pambështetur ligjërisht. ***Në pozicionin e saj të punës është mbajtur punonjësi i komanduar, i cili duhet të ishte liruar nga detyra, menjëherë pas kthimit të saj në detyrë në datën 26.11.2014.*** Pra, motivacioni i largimit të D.Ç është i pambështetur në fakte konkrete, por njëkohësisht edhe i pambështetur në ligj, kjo pasi ajo është larguar nga vendi i punës, pak ditë pasi është kthyer nga leja e barrë lindjes, kushte në të cilat gruaja gjen mbrojtje edhe nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nga RSH-ja.

4.4. Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se D.Ç, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e DRSSH Kukës, në krahasim me punonjës të tjerë të këtij institucioni. Ky trajtim ka lidhje të drejtpërdrejtë, së pari me gjininë e saj si femër dhe së dyti me faktin e të qënurit nënë e re, e cila si e tillë ka qenë e detyruar t'i përkushtohet foshnjës së saj, duke marrë lejen e lindjes për shkak të paaftësisë së përkohëshme në punë, leje e cila është e mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore. Një fakt i tillë nuk është marrë në konsideratë nga DRSSH Kukës, por ankuesja është diskriminuar duke e larguar nga puna, menjëherë pas përfundimit të lejes së barrë lindjes, si dhe duke e zëvendësuar atë me një punonjës të seksit mashkull, i cili u komandua për ta zëvendësuar ankuesen gjatë lejes së barrë lindjes.

4.5. Gjykojmë se nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta apo të tërthorta, që largimi nga puna i ankuses, të jetë kryer për shkak të bindjeve të saj politike, pasi kjo e fundit është shprehur se nuk është anëtare e asnjë subjekti politik dhe nuk ka qenë e angazhuar në asnjë aktivitet politik. Në këtë mënyrë, Komisioneri e ka të pamundur të vërtetojë që bindjet politike të ankuses kanë qenë shkak për diskriminim të saj, nga ana e DRSSH Kukës. Njëkohësisht, aktet administrative të DRSSH Kukës, për largimin e ankuses nga puna, janë nxjerrë pas përfundimit të periudhës së shtatëzanisë së D.Ç, ndaj vlerësojmë, se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkak të shtatëzanisë.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të bindjeve politike dhe për shkak të shtatëzanisë, të D.Ç, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës.

5.2. ***Konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjinisë dhe për shkak të mëmësisë, të D.Ç, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës.***

5.3. Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, për sistemimin e D.Ç në pozicionin e mëparshëm të punës, pranë këtij institucioni.

ÇËSHITJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE DHE PËRKATËSISË NË NJË GRUPIM SINDIKAL

Ankesa e M.G. kundër ALBPETROL sh.a Patos, me pretendim diskriminimi për shkak të gjendjes shëndetësore dhe përkatësisë në një Grupim Sindikal

VENDIM Nr. 202 / 2014

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. M.G. ka paraqitur ankesë kundër Albpetrol sh.a Patos, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “përkatësisë në një Grupim Sindikal” dhe “gjendjes shëndetësore”. Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri, të bëjë të mundur ndreqjen e shkeljeve ligjore në dëm të tij, si dhe të bëjë të mundur rikthimin e tij në punë.

1.2. Me shkresën Nr. 557/2 prot, datë 11.06.2014 u njoftua dhe ju kërkua informacion E.P, Administrator i Albpetrol sh.a. Patos, duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe duke i kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga M.G. Me datë 05.09.2014, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore mes palëve. Seanca u zhvillua vetëm me praninë e ankuesit, pasi pala ndaj së cilës është bërë ankesa, nuk u paraqit, dhe as nuk kishte bërë ndonjë njoftim paraprak për mospjesëmarrjen e saj. Me datë 01.10.2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim në ambientet e Albpetrol sh.a, Patos.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. M.G. ka qenë punonjës pranë QAR Patos, qendër në varësi të Albpetrol sh.a Patos, me vjetërsi në punë prej 43 vitesh (që nga viti 1970 e në vijim). Në muajin Janar të këtij viti i është ndryshuar pozicioni i punës. Ankuesi i është drejtuar E.P në rrugë zyrtare me shkresën nr. 3096 Prot., datë 08.04.2014, në të cilën kërkon të rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës. Ai pretendon se ka vijuar të diskriminohet për shkak të përkatësisë së tij në Grupimin Sindikal, duke mos u lejuar nga ana e përgjegjësit të sektorit ku punon për të ushtruar aktivitetin e sindikalistit. Pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore ankuesi e bazon në faktin se ndonëse, ai është trajtuar një muaj me raport mjekësor dhe KML i Spitalit Rajonal Fier, ka vendosur që M.G. të punojë pa turne dhe me orare të kufizuara, drejtuesit e Sektorit nuk ia kanë njohur raportin.

2.2. Ankuesi ka paraqitur një shkresë të datës 03.06.2014, në të cilën citohet se M.G. duhet të punojë me tre turne. Gjithashtu, për shkak se ka qenë me një muaj raport mjekësor dhe me raport mjeko-ligjor të zgjatur (KML), me shkresën me nr. 3554 prot., datë 22.04.2014 ka kërkuar të trajtohet me ndihmë ekonomike në zbatim të VKM-së me nr.929, datë 17.11.2010, e ndryshuar me VKM-në nr. 493, datë 06.07.2011, e cila në pikën 7, parashikon se: “Në ndihma të menjëherëshme për raste fatkeqësish dhe në raste të tjera, të cilat përballohen nga fondi faktik i veçantë, përfshihen pagesat për rastet e: sëmundjeve të

rënda të punonjësit, apo një trajtim mjekësor i gjatë. Pagesa jepet nga titullari i Institucionit deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të rinj”, ndihmë e cila nuk i është akorduar nga Albpetrol sh.a Patos.

2.3. Me shkresën me nr. 4428 prot., datë 27.05.2014, M.G i është drejtuar sërish administratorit të Albpetrol sh.a Patos, në të cilën kërkon të merren masa për rregullimin e shkeljeve ligjore të kryera ndaj tij.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, **gjendjen shëndetësore**, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, **përkatësinë në një grup të veçantë**, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: (c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

3.3. Kodi i Punës në nenin 181, pikat 3, dhe 5, të tij parashikojnë se: “ 3. Ndalohet diskriminimi ndaj përfaqësuesve të sindikatës. 5. ...punëdhënësi nuk mund të ndryshojë vendin e punës së përfaqësuesve të organizatës së punëmarrësve, edhe nëse ky ndryshim është parashikuar nga kontrata e punës, pa pëlqimin e punëmarrësit dhe të kësaj organizate...”. Në një linjë me nenin 181, pika c) , të Kodit të Punës, i cili i konsideron si veprime ndërhyrjeje të punëdhënësit, masat që: “... dëmtojnë punëmarrësin për shkak të përkatësisë ose veprimtarisë së tij sindikale, duke e diskriminuar atë”.

3.4. Neni 140, pika 2 i Kodit të Punës parashikon se: “Si rregull, kontrata e punës lidhet për një periudhë të pacaktuar. Lidhja e kontratës së punës për një periudhë të caktuar duhet të justifikohet me arsye objektive, që lidhen me natyrën e përkohshme të detyrës, në të cilën punëmarrësi do të punësohet”.

3.5. Neni 110, pika 1 i Kodit të Punës, përcakton se: “ Punëdhënësi i paguan punëmarrësit pagën sipas dispozitave të kontratës kolektive ose kontratës individuale...”.

3.6. Kodi i Punës, neni 21, pika 1, e tij parashikon se: “...Çdo ndryshim i kontratës së shkruar, në dëm të punëmarrësit, duhet të përfundohet me shkrim”.

3.7. Neni 15, në pikat 1, 2, 3, dhe 4 të LMD, parashikon se: “ 1. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit. 2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.

3.8. Neni 13, pikat 1, 2, 3 e po këtij ligji, lidhur me detyrimet e punëdhënësit, parashikon se: “Punëdhënësi është i detyruar: a) të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloji diskriminimi; b) të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e

punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dijenisë; c) t'u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre”.

3.9. Neni 15, në pikat 3 dhe 4, të këtij ligji parashikon se punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit. Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për atë kohë sa është e nevojshme për t'u mbrojtur nga diskriminimi.

3.10. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, në nenin 5, pika 1, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

4. OPINION

4.1. KMD e sheh të paarsyeshme që një shoqëri me vazhdimësi në aktivitetin e saj prej kaq shumë vitesh, dhe me një natyrë pune jo të përkohshme, siç është Albpetrol sh.a., Patos, duhet të nënshkruajë kontrata me afat të përcaktuar me punonjës që kanë vjetërsi pune të konsiderueshme pranë saj. Njëherësh me ndryshim e pozicionit të punës, është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe një element thelbësor i kontratës, siç është paga. Kontrata që i referohemi ka qenë brenda afatit të përcaktuar në të, dhe ndryshimi i elementit pagë është bërë brenda këtij parashikimi kohor. Marrëdhëniet e punës mes punëdhënësit e punëmarrësit rregullohen sipas parashikimeve të bëra në Kodin e Punës.

4.2. Transferimi i fundit, i bërë për M.G, rezulton të jetë bërë me shkresën me nr. 292 Prot., 07.07.2014⁵⁰, ditën e parë të paraqitjes së tij në punë, pas mbarimit të Raportit Mjekësor. Nga ana e Albpetrol sh. a., Patos nuk janë zbatuar rekomandimet e këtij Raporti, as sa i takon orarit të punës dhe as natyrës së punës, me justifikimin se në këtë shoqëri nuk ka punë më të lehtë se shërbimi i rojës.

4.3. Nisur nga shqyrtimi i fakteve, Komisioneri gjykon se, paligjshmëria e veprimeve apo mosveprimeve nga ana e Albpetrol sh.a., Patos në dëm të ankuesit, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, duke filluar që nga transferimi i tij nga një pozicion pune në një tjetër më pak të favorshëm për të, e deri në largimin e tij nga puna në mënyrë përfundimtare, si pasojë e zgjidhjes së Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit.

4.4. Po kështu, duke iu referuar faktit që M.G. ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit më datë 05.06.2014, dhe masat shtrënguese ndaj tij nga ana e Albpetrol sh.a., Patos, janë marrë kryesisht pas kësaj date dhe kanë ardhur si rezultat i këtij ankimimi, sjellim në vëmendje se ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka parashikuar në nenin 3, pika 8 të tij: **“trajtimi i disfavorshëm apo pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë është “Viktimizim”.**

4.5. Komisioneri, konstaton se M.G. për sa më sipër cituar, është diskriminuar për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, duke mos iu ofruar asnjë lehtësi e përfituar për shkak të kufizimeve të shprehura nga komisioni mjeko-ligjor, (sa i takon orarit të punës vetë Rr.B, shprehet se ai ka punuar me orare të njëjta me punonjësit e tjerë⁵¹), duke u detyruar të punojë në një pozicion pune, i cili është një ambjent i hapur dhe pa asnjë kusht minimal.

50 Referuar Urdhërit sipërcituar, efektet e tij fillojnë me datë 08.07.2014.

51 Referuar deklarimeve të Rr.B. në proces-verbalin e mbajtur më datë 01.10.2014, mbajtur në ambjentet e Albpetrol sh.a., Patos.

4.6. Lidhur me pretendimin e M.G. për dhënie të padrejtë të masave disiplinore dhe mospagim të Raporteve Mjekësore nga ana e Albpetrol sh.a., Patos, mendojmë se ato mund të bëhen objekt shqyrtimi gjyqësor, por Komisioneri ka bindjen se vetë kontrollet e bëra në vend-rojen ku punonte M.G, si dhe shënimet në Librin e marrjes në dorëzim të detyrës, kanë qenë të qëllimshme dhe tendencioze. Kjo, bazuar në proces verbalin e datës 09.10.2014, si më poshtëcituat: - Me datë 08.07.2014 M.G. ka marrë detyrën si roje, në vëndrojen nr. 9, Bubullimë-Kol-7, në orën 06:45 të mëngjesit dhe në orën 14:55 të drekës, ka vajtur për ta kontrolluar Përgjegjësi i Turnit, i cili e ka gjetur në krye të detyrës, në vendin e punës, fakt ky, i evidentuar në proces verbalin e po kësaj date. - **Me datë 09.10.2014, në orën 06:45 të mëngjesit, shefi i sektorit ka vajtur për kontroll në vendin e punës të M.G. dhe në Librin e marrjes në dorëzim të punës, ka shënuar: “në orën 6:45 të mëngjesit nuk u gjet në vendin e punës roja M.G.”, megjithëse puna merret në dorëzim në orën 07:00.** Lidhur me këtë fakt të evidentuar në Librin e marrjes në dorëzim të detyrës, në mënyrë jo të saktë dhe të qëllimshme, **M.G. ka paraqitur si provë mbështetëse në favor të tij, një Deklaratë Noteriale të K.P. i cili po ashtu është me pozicion roje, në të njëjtën vëndroje me ankuesin, me të cilin ndërrohen sipas turneve.** Ai pohon se: “Në orën 6:45 M.G. ka ardhur në shtëpinë time për të marrë Librin e marrjes në dorëzim të detyrës dhe më pas iku tek vënd-roja. Librin e mbajmë të banesa ime pasi banoj 100 m afër vëndit të punës dhe për shkak se vëndi ynë i punës është ambjent i hapur dhe s’ kemi ku ta mbajmë. Pas tij shkova edhe unë. Në këtë çast në vëndin e punës erdhi z. T, me pozicion Shef Sektori dhe megjithëse ora ende s’ kishte vajtur 07:00, ai mori Librin e marrjes në dorëzim të detyrës M.G nga dora dhe bëri shënimin sikur roja, M.G, nuk u gjet në vëndin e punës në orën 06:45. M.G e kundërshtoi këtë shënim që ai i bëri në libër, duke i thënë që është i pavërtetë. Në këto momente, M.G i telefonoi në praninë time Drejtorit të Q.A.R-së Patos, z. K. duke e informuar rreth ngjarjes. Unë kam ngelur i habitur, sepse M.G. ishte prezent në vëndin e punës, ndërsa shënimet iu bënë sikur nuk ishte prezent në vëndin e punës”. Më datë 25.07.2014, në proces-verbalin e firmosur nga Përgjegjësi i Turnit, z. H, ankuesi rezulton të ketë marrë në dorëzim detyrën në orën 06:45 të mëngjesit dhe ka bërë dorëzimin në orën 15:00. I pyetur rreth këtij fakti, edhe Rr.B, pohon se është e vërtetë që me datë 25.07.2014, M.G ka qenë prezent në punë⁵².

4.7. Komisioneri gjen të pabazuar ligjërisht shkresën me nr. 6035 Prot., datë 25.07.2014, Vendim nr. 477, datë 25.07.2014 të Administratorit E.P., me anë të së cilës bëhet zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës për M.G. dhe për faktin se po me këtë datë është urdhëruar edhe përfundimi i marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, ndërkohë që në proces-verbalin e po kësaj date, ankuesi rezulton të ketë qenë në punë.

4.8. Lidhur me faktin e diskriminimit nga ana e Albpetrol sh.a., Patos të M.G për shkak të përfaqësimit të një grupimi sindikal: Me anë të shkresës me nr. 1655 Prot., datë 30.05.2011, është nënshkruar një Kontratë Kolektive Pune, midis shoqërisë Albpetrol sh.a., Patos, në cilësinë e punëdhënësit, dhe Sindikatave në cilësinë e punëmarrësit, përfaqësuar nga 5 (pesë) Sindikata, ndër të cilat edhe Sindikata Autonome e Ndërmarrjeve të Nxjerrjes së Naftës Patos, me kryetar M.G.⁵³ Kjo kontratë është me afat të përcaktuar për periudhën kohore nga data 30.05.2011 – 30.05.2012, pra me afat 1 (një) vjeçar. Komisioneri gjykon se përfundimi i Kontratës Kolektive nuk sjell për pasojë edhe heqjen dorë të M.G. nga posti i kryetarit të Sindikatës Autonome të Ndërmarrjeve të Nxjerrjes së Naftës Patos, formuar me urdhër nr. 6/1, datë 30.01.1993 të Ministrit të Drejtësisë, e regjistruar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. Akti 6486, dhe nr. 7234 vendimi, datë 14.12.2006. Përderisa në momentin e nënshkrimit të Kontratës kolektive të nënshkruar për periudhën kohore 30.05.2011 – 30.05.2012, Albpetrol sh.a, Patos e ka njohur M.G. në tagrin e përfaqësuesit të Sindikatës Autonome të Ndërmarrjeve të Nxjerrjes së Naftës Patos, sepse ai ka firmosur kontratën së bashku me 5-përfaqësues të sindikatave të tjera, pse nuk duhet ta njohë tani?!

52 I referohemi deklarimeve të Rr.B. në proces verbalin e datës 01.10.2014, mbajtur në ambjentet e Albpetrol sh.a., Patos.

53 Kjo Sindikatë është formuar me urdhër nr. 6/1, datë 30.01.1993 të Ministrit të Drejtësisë, e regjistruar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. Akti 6486, dhe nr. 7234 vendimi, datë 14.12.2006.

4.9. Në lidhje me interpretimin e vlefshmërisë kohore të fuqisë ligjore të kësaj kontrate, i referohemi përcaktimeve që bën Kodi i Punës, i cili në nenin 149, pikat 1 dhe 2, të tij, parashikon se: “1. Kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake. 2. Kur, mbas përfundimit të afatit të caktuar, kontrata zgjatet në heshtje tej këtij afati, ajo konsiderohet si kontratë me afat të pacaktuar”. Mirëpo, në kuptim të nenit 142, të po këtij Kodi, “*Kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra palë dhe ka përfunduar afati i njoftimit*”. Pra, në këto kushte nuk jemi para detyrimeve reciproke që rregullon Kontrata Kolektive e Punës, mes punëdhënësit e punëmarrësit. Procedura e zgjidhjes së Kontratës së Punës nga punëdhënësi, përfshirë dhe afatet e njoftimit për fillimin e bisedimeve me punëmarrësin, rregullohen sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Punës.

4.10. Po kështu, në Dosjen Personale të M.G., janë të depozituara në cilësinë e provës edhe 2 (dy) kopje të Kontratave Individuale të Punës: 1. Kontratë Individuale Pune, lidhur mes punëdhënësit, Albpetrol sh.a., dhe punëmarrësit, M.G. me detyrë Pergjegjës Turni. Kjo kontratë është lidhur me afat të përcaktuar 1 (një) vjeçar, nga data 01.06.2012 – 01.06.2013.⁵⁴; - 2. Kontratë Individuale Pune, lidhur mes punëdhënësit, Albpetrol sh.a., dhe punëmarrësit, M.G. me detyrë Pergjegjës Turni. Kjo kontratë është lidhur me afat të përcaktuar 2 (dy) vjeçar, nga data 01.08.2013 -31.06.2015 dhe është e nënshkruar vetëm nga ana e punëdhënësit, pasi M.G. ka refuzuar ta firmosë⁵⁵, me argumentimin se ishte në disfavor të tij.

4.11. Komisioneri konstaton se subjekti ankues është diskriminuar nga ana Albpetrol sh.a., Patos, për shkak të pozicionit të tij si kryetar i Sindikatës Autonome të Ndërmarrjeve të Nxjerrjes së Naftës Patos.

4.12. Gjatë vitit 2014, z.M.G. është ankuar tek punëdhënësi për trajtim të pabarabartë dhe diskriminues,⁵⁶ i cili nuk i është përgjigjur ankesave, duke neglizhuar me dashje një të drejtë ligjore të tij.

4.13. Sa i takon pretendimeve të tjera të ankuesit, që kanë lidhje me dëmshpërblimet e tij sipas parashikimeve të Kodit të punës për rregullimin e marrëdhënieve mes punëdhënësit e punëmarrësit, dhe për pasojë edhe të gjithë detyrimeve që burojnë si rezultat i kësaj marrëdhënieje, Komisioneri, konstaton se këto janë pretendime që duhen ndjekur gjyqësisht.

5. VENDIMI

5.1. Në bazë të nenit 12, pika 1, gerrat c) dhe ç), nenit 13, pika 1, germa a), nenit 32, germa c), si dhe nenit 33, pikat 10, 11 dhe 12, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi ***konstatimim e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe për shkak të përkatësisë në një grupim sindikal të M.G. nga ana e Albpetrol sh.a., Patos.***

5.2. Konstatimi i diskriminimit në formën e viktimizimit, për shkak të ankimimit të paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndaj Albpetrol sh.a, Patos.

54 Kopje e kësaj Kontrate është sjellë nga ankuesi.

55 Referuar përmbajtjes së e-mailit së dërguar nga ana e M.G. më datë 27.10.2014, ora 12:04, në adresën zyrtare të KMD-së.

56 Me shkresën me nr. 4428, datë 27.05.2014, subjekti ankues i drejtohet E.P., ku i kërkon që të ndërpritet diskriminimi ndaj tij nga ana e drejtuesve të Q.A.R-së Patos, lidhur me marrëdhëniet e punës mes tij dhe kësaj shoqërie. - Me anë të shkresës me nr. 25626 Prot., datë 10.07.2014, M.G. vë në dijeni E.P se, nga ana e Rr.B., me detyrë Përgjegjës i Zyrës Administrative dhe Personelit të Q.A.R-së Patos dhe nga z. T, me detyrë Shef Sektori, pranë Albpetrol sh.a Patos, po ushtrohet diskriminim i hapur dhe presion psikologjik për ta pushuar nga puna. Ai kërkon që për rregullimin e kësaj situatë të ndërmerren masa konkrete nga ana e E.P., si Administrator i Albpetrol sh.a., Patos. Lidhur me këto shkresa, ku citohet në mënyrë të qartë se po diskriminohet nga ana e Albpetrol sh.a., Patos, M.G. nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare, verifikuar kjo dhe nga këqyrja e Librit të Protokollit nga ana e inspektorëve të Komisionerit, po ashtu referuar deklarimeve të znj. I, në proces verbal.

5.3. Në referim të pikave 1 dhe 2, Albpetrol sh.a. Patos, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, ndaj M.G, të bëjë rikthimin e tij në vendin e punës, si përgjegjës turni.

5.4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Albpetrol sh.a Patos, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.

ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE

Ankesa nga K.T., kundër A.K, me pozicion Drejtor në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “të bindjeve politike”.

VENDIM Nr. 11/ 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. K.T. shpjegon se: “Ka filluar punë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, në Sektorin e Kontrollit në Terren, në vitin 2010. Sipas ankueses, gjatë kësaj periudhe ajo ka patur performancë të lartë në punë dhe ndaj saj nuk janë marrë asnjëherë masa administrative. Në fillim të muajit Janar është emëruar drejtori i ri i DRTT-së. Brenda 10 ditëve të para të emërimit të tij, K.T ka marrë një masë disiplinore për largim nga puna me argumentimin “për shkelje të detyrës”. Pas marrjes së kësaj mase, ankuesja për një muaj është paraqitur fizikisht në punë në orarin zyrtar 08⁰⁰-16⁰⁰, por duke iu hequr mundësia të kryejë detyrën e saj(nuk i është ngarkuar asnjë punë ditore, sipas programit të tyre të punës). Po kështu, pretendon se nuk është pajisur qëllimisht me Kartën ligjore (Badge) për vitin 2014, e cila është e detyrueshme për t’u prezantuar tek subjektet gjatë kontrollit në terren, për arsye se ajo ka bindjen se ishte planifikuar për t’u larguar nga detyra që me ardhjen e K.T në detyrën e drejtorit të kësaj Drejtorie. Ankuesja thekson faktin se është operuar dhe trajtuar përpara kësaj periudhe, pasi ishte diagnostikuar me kancer. Kjo faktohet me anë të dokumentit “Epikrizë dalje”, i cili mban nr. e kartelës klinike 112171, të pacientes K.T, ku rezulton se me datë 29.02.2011 është kryer një intervent mjekësor (operacion) si pasojë e diagnostikimit të saj me kancer”. Ndërkohë që ishte me Raport- mjekësor, ka dalë Vendimi nr. 1068, datë 23.06.2014 i Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, në të cilin është vendosur marrja e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”. Me shkresën me nr. 43769/1 prot., datë 03.07.2014, i është komunikuar lirimi nga detyra.

1.2. U njoftua A.K, me pozicion Drejtor në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe iu kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga K.T.

1.3. Komisioneri realizojë një seancë dëgjimore mes palëve.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Më datë 27.05.2014, subjekti ankues ka paraqitur një raport mjeko-ligjor për paaftësi të përkohëshme në punë,⁵⁷ dhe nga data 27.05.2014 dhe deri më datë 10.07.2014, nuk është paraqitur më në punë për arsye shëndetësore, pasi zonja ka qenë e shtruar në spital për kurim. Pala ndaj së cilës ajo ankohet, ka qenë në dijeni për situatën e saj të rënduar shëndetësore, pasi ajo ka depozituar Raportin mjeko-ligjor pranë DRT Tiranë.

⁵⁷ Raportet mjekësore të znj. K.T. i përkojnë respektivisht datave si më poshtë:

1. Nga datë 27.05.2014 – 30.05.2014.
2. Nga datë 29.05.2014 – 12.06.2014.
3. Nga datë 12.06.2014 – 26.06.2014
4. Nga datë 26.06.2014 – 10.07.2014.

2.2. Po ashtu, ankueses i është bërë vetëm një lajmërim për t'u paraqitur në KD, më datë 27.05.2014, datë kur ka qenë me raport mjekësor dhe nuk ka patur më tej asnjë lajmërim të dytë zyrtar, për t'u paraqitur në KD.

2.3. Ankuesja nuk është paraqitur në Komisionin e Disiplinës, pasi nuk është ndjerë mirë nga ana shëndetësore dhe ka paraqitur një Raport-mjekësor. Ndërkohë që ishte me Raport- mjekësor, ka dalë Vendimi nr. 1068, datë 23.06.2014 i Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, në të cilin është vendosur marrja e masës disiplinore "Largim nga shërbimi civil". Me shkresën me nr. 43769/1 prot., datë 03.07.2014 i është komunikuar lirimi nga detyra.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese në fushën e punësimit. Konkretisht, në nenin 12, pika 1, germa b) parashikon: "Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës".

3.2. Neni 41, pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", parashikon se: "Nëpunësi civil ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedimi administrativ dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e tij të shërbimit civil".

3.4. Po ashtu, neni 59, pika 7 e po këtij ligji, shpreh se: "...procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të asistohet gjatë procedimit disiplinor nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, një avokat apo një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate".

3.5. Neni 34, pika 1, e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", përcakton se: "Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimi përpara organeve kompetente për ndjekje penale".

3.6. Në nenin 37, pika 1 e këtij ligji, parashikohet se: "Vendimi i Gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit".

3.7. Po kështu, neni 38 i po këtij ligji parashikon se: "Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e dëmtuar për dëmet pasurore dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme".

3.8. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen

familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

4. OPINION

4.1. Komisioni Disiplinor ka marrë vendimin pa bërë njoftimet përkatëse sipas ligjit, edhe pse ka qenë në dijeni për Raportet-mjekësore të K.T. Vendimi është marrë në mungesë, pa ju dhënë mundësia që ajo të ngrejë pretendimet në KD për shkeljet e pretenduara nga DRT Tiranë. Për sa kohë ankuesja ka provuar me Raporte mjekësore se ishte e paaftë të merrte pjesë në mbledhjet e Komisionit, pasi kishte shkak të arsyeshëm për mospjesëmarrje, KD nuk mund të vazhdonte procedurën e vendimmarrjes në mungesë të saj. (Referuar nenit 41, pika 1, dhe nenit 59, pika 7, e Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.)

4.2. Në shkresën me nr. 12486 prot., datë 22.05.2014 K.T është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj saj për shkelje të rëndë të detyrës funksionale. Në këtë shkresë i bëhet me dije se nuk ka përmbushur kërkesat e Urdhërit të punës nr. 21540, datë 10.04.2014, ndërkohë që në cilësinë e provës është paraqitur Urdhëri i punës nr. 12540, datë 10.03.2014, i cili ka shërbyer dhe si bazë për fillimin, zhvillimin e ecurisë disiplinore dhe ndëshkimin e ankueses me masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil”. Nga ana tjetër, jemi në rrethanat kur shkresa së cilës i referohet marrja e vendimit për largim nga shërbimi civil,⁵⁸ të KD, është e gabuar në datë dhe në përmbajtje, çka verteton vendimin arbitrar të marrë në shkelje të ligjit, dhe tendencën për largim nga puna për një motivacion tjetër dhe jo atë të cituar në këtë vendim.

4.3. Kundër Vendimit nr. 1068, datë 23.06.2014, të Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për punonjësin civil znj. Kozeta Tili, me detyrë Inspektor i dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren në DRTT”, ankuesja ka paraqitur një kërkesë-padi drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. **Kjo Gjykatë me Vendimin e saj nr. 7795, datë 26.12.2014, ka shfuqizuar Vendimin nr. 1068, datë 23.06.2014 të Komisionit Disiplinor të DPT Tiranë, si të pabazuar në prova dhe ligj. Në vendimin e saj, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur:**

- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 1068, datë 23.06.2014 të Komisionit Disiplinor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- **Detyrimin e palës së paditur, DPT, të rikthejë paditësen Kozeta Til në detyrën Inspektore e Dytë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë.**
- Detyrimin e palëve të paditura t’i paguajnë pagën e plotë që nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare e në vijim.

4.4. Lidhur me pretendimin e diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore. Gjatë shqyrtimit të ankesës, vertetohet që gjendja shëndetësore e ankueses është rënduar gjatë periudhës së marrjes së masave disiplinore ndaj saj, pasi raportet mjekësore të paraqitura e vertetojnë atë. Ato datojnë në periudhën nga 27.05.2014 – 10.07.2014. Që para kësaj periudhe, zonja rezulton të jetë operuar e trajtuar për një periudhë të gjatë kohore për diagnozën “Rektorogji post rezeksion rektosignoiden”, megjithatë marrja e masave disiplinore ndaj saj ka vijuar .

4.5. Komisioneri, konstaton se subjekti ankues është diskriminuar për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, gjatë procesit disiplinor të ndërmarrë ndaj saj, si dhe lidhur me largimin e saj nga puna. Komisioneri sheh si tendencioze dhe të qëllimshme marrjen e njëpasnjëshme të masave disiplinore ndaj znj.K.T. (akoma pa u shprehur Komisioni Disiplinor për masën e parë, i propozohet masa e dytë

58 Kjo shkresë nuk u vu në dispozicion të Komisionerit, mgjs u kërkuar të sillë në rrugë zyrtare.

disiplinore). Fakti që kjo shkresë ⁵⁹ nuk ka të bëjë fare me motivacionin për të cilin ankuesja është larguar nga shërbimi civil dhe është tërësisht e pabazuar, bën që Komisioneri të ketë bindjen se në këtë rast ka një tendencë të fshehur për largimin e K.T.

4.6. E gjithë dinamika e ngjarjeve, duke filluar që nga marrja e masave disiplinore dhe mungesa e transparencës në gjithë këtë procedim administrativ, bën që ankueses t'i mohohet e drejta e aksesit si palë, për t'u informuar dhe për t'u dëgjuar. Pala ndaj së cilës, K.T ankohet, ka patur dijeni për gjendjen e saj shëndetësore, përmes Raporteve mjekësore, dhe megjithatë ka vazhduar procedimin administrativ pa i bërë njoftimin e dytë, që ajo të mund të përfaqësohej me përfaqësues ligjor. Në këtë mënyrë është shkelur haptazi parimi i garantimit të barazisë së armëve në komision. Pra, Komisioni Disiplinor ka marrë vendim, duke patur dijeni për gjendjen shëndetësore të ankueses dhe pa i dhënë mundësinë asaj (ose përfaqësuesit të saj ligjor) të parashtojë dhe argumentojë pretendimet e saj.

4.7. Lidhur me shkakun për të cilin pretendohet diskriminimi për shkak të bindjeve politike, subjekti ankues pretendon se një nga shkaqet e diskriminimit të saj, nga ana e DRTT, janë edhe bindjet e saj politike, pasi ajo mendon se Drejtori, A.K ka krijuar përshtypjen se ajo ka bindje të ndryshme politike nga vetë ai. Shkak mund të jetë edhe shoqërimi i saj me persona të cilët i kanë shprehur haptas bindjet e tyre të djathta politike. Mirëpo ankuesja:

- a) nuk ka paraqitur ndonjë dokument që të tregojë angazhimin e saj politik, (si psh. Kartë anëtarësie në një Parti politike).
- b) nuk solli asnjë fakt që të krijonte bindjen se drejtori mund të kishte dijeni për bindjet e saj politike. Për këtë shkak, pretendimi i saj se diskriminohet për shkak të bindjeve politike nuk është i mbështetur në një dokument shkresor dhe nuk është i provuar.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të bindjeve politike, të K.T, nga ana e DRT Tiranë.

5.2. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, për shkak të gjendjes shëndetësore të K.T, nga ana e DRT Tiranë.

5.3. Në referim të pikës 2, të këtij vendimi, i rekomandohet subjektit ankues që mund të kërkojë dëmshpërblim sipas parashikimeve ligjore, gjyqësisht, bazuar në: nenin 36, pika 1, nenin 37, pika 1, dhe në nenin 38 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

59 Shkresa nr. 12486 Prot., datë 22.05.2014.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË MOSHËS

Ankesa e T.G., ku pretendohet për diskriminim të tij, nga ana e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për shkak të bindjeve politike dhe “çdo shkak tjetër”.

VENDIM Nr. 130/2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1 T.G. shpjegon se: “Ka punuar si operator prodhimi pranë Albpetrol sh.a. prej vitit 2005 dhe largimin e tij nga Albpetrol sh.a. e konsideron si diskriminim për shkaqe politike, pasi në zgjedhjet vendore të vitit 2001 dhe 2003, ai ka qenë kryetar i KZQV – Bashkia Patos, si përfaqësues i subjektit “Partia Socialiste”. Në të dy këto zgjedhje vendore, kandidati fitues ka qenë përfaqësues i subjektit politik të sipërpërmendur. Si rrjedhim, ankuesi pretendon se Partia Demokratike, Dega Patos ka shpifur ndaj tij për manipulim të rezultateve të zgjedhjeve në K.Z.Z. nr. 67, ku përfshihej Bashkia Patos. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, në datën 28 dhjetor 2013, në gazetën Shqiptarja.com, Albpetrol sh.a. ka publikuar një njoftim për disa vende të lira pune. T.G ka paraqitur kërkesë me shkrim pranë Albpetrol sh.a. për t’u punësuar në një ndër vendet vakante pranë kësaj Shoqërie Sipas ankuesit, kjo kërkesë, jo vetëm që nuk është marrë parasysh, por ta punësuar atë sërish pranë Albpetrol sh.a., por atij nuk i është kthyer asnjë përgjigje zyrtare nga ana e strukturave përgjegjëse të Shoqërisë. Në formularin e ankesës, për këtë çështje, ankuesi ka përcaktuar si shkak diskriminimi opsionin “çdo shkak tjetër”.

1.2. Për të marrë sqarime të mëtejshme lidhur me këtë çështje, ankuesi u paraqit në datën 12.02.2015 pranë ambienteve të Komisionerit. I pyetur, nëse mund të identifikonte shkakun e diskriminimit, për sa i përket çështjes së dytë të parashtruar nga ana e tij, T.G. u shpreh se mendonte se shkakun e diskriminimit për rastin konkret kishte të bënte me ankesat e shumta që T.G dhe punonjës të tjerë të Albpetrol sh.a., që ishin larguar larguar nga puna në vitin 2010, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 275, datë 26.04.2010, si rrjedhojë e ristrukturimit të Shoqërisë, kishin kryer pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe pranë institucioneve të tjera shtetërore, ku denonconin veprimet e paligjshme të Albpetrol sh.a., për sa i përket trajtimit të ish-punonjësve të tij.

1.3. Ankesa e depozituar nga T.G, pranë Komisionerit, mban datën **11.02.2015**. Referuar formularit të ankesës, ankuesi ka shënuar si kohë, kur ka ndodhur diskriminimi për çështjen në fjalë, datën **09.08.2010**, ndërkohë që në këtë formular, ai ka shënuar si data kur ai ka marrë dijeni për diskriminimin e pretenduar, përkatësisht datat **08.07.2013 dhe 18.12.2012**. Për sa më sipër, konstatohet se ankuesi e ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit, më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit, ose më vonë se një vit nga marrja dijeni për këtë fakt. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se çështja e parë e parashtruar nga ankuesi, nuk mund të pranohet për shqyrtim.

1.4. Çështja e dytë, e parashtruar nga ankuesi, lidhur me kërkesën për punësim pranë Albpetrol sh.a., e cila sipas tij nuk është marrë parasysh nga administratori i kësaj shoqërie, i plotëson kërkesat e nenit 33, të ligjit të sipërpërmendur, ndaj iu nënshtrua shqyrtimit nga ana e Komisionerit. Për këtë arsye, Komisioneri

për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj. Mbështetur në nenin⁶⁰ 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Albpetrol sh.a. Patos, me shkresën nr. 157/1, datë 13.02.2015, ku kërkohej informacion, lidhur me çështje⁶¹ në fjalë. Nga Shoqëria “Albpetrol” sh.a. nuk u kthye përgjigje shkresës së sipërpërmendur.

1.5. Në datën 25.03.2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kreu inspektim pranë kësaj Shoqërie.

1.6. Në vijim të procedurave hetimore⁶², në datën 14.04.2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi realizoi seancën dëgjimore ndërmjet ankuesit T.G dhe përfaqësuesve të Albpetrol sh.a. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. Përfaqësuesit e Komisionerit i kërkuan T.G të paraqiste një listë të ish-punonjësve që bënë pjesë në të njëjtin grup me të. T.G theksoi faktin, se ai kërkonte të konstatohej diskriminim për të personalisht, por jo në cilësinë e përfaqësuesit të punonjësve të larguar nga Albpetrol në vitin 2010⁶³. Nga përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u kërkuua që të dërgonin informacion, si më poshtë vijon:

-Informacion mbi ish-punonjësit e larguar nga puna në vitin 2010 si pasojë e ristrukturimit dhe që aktualisht ishin ri-punësuar pranë Albpetrol sh.a.; -Informacion, nëse ndonjëri nga ish-punonjësit që bënë pjesë në grupin ku merrte pjesë edhe ankuesi, ishte ri-punësuar pranë kësaj Shoqërie.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. T.G., ish punonjës i Albpetrol sh.a. ka depozituar një kërkesë me shkrim ku kërkohet punësim pranë kësaj shoqërie, referuar njoftimit të datës 28 dhjetor 2013, të botuar në gazetën Shqiptarja.com. Kërkesa rezultoi e regjistruar dhe e protokolluar në librat e protokollit të kësaj Shoqërie dhe mban nr. 5444 Prot, datë 30.12.2013.

2.2. Referuar kërkesës së T.G., konstatohet se ai nuk ka aplikuar për një pozicion të caktuar pune, por ka kërkuar të bëhet pjesë e konkurimit, për të fituar një nga vendet e lira të punës që i përgjigjen formimit dhe eksperiencës së tij profesionale. Pas përfundimit të procesit të punësimit të punonjësve të rinj pranë Albpetrol sh.a., rezultoi se T.G, nuk ishte pjesë e stafit të ri të sapo punësuar. Gjithashtu, rezultoi se strukturat përkatëse të Shoqërisë nuk i kanë dërguar asnjë përgjigje zyrtare, lidhur me mospunësimin e tij, apo arsyet e skualifikimit të tij gjatë procesit të përzgjedhjes së këtij stafi.

2.3. T.G. pretendon se është diskriminuar, pasi ka qenë një nga nismëtarët dhe përfaqësuesit e një grupi të ish – naftëtarëve që ishin larguar nga Albpetrol sh.a., si pasojë e ristrukturimit të kësaj Shoqërie në vitin 2010. Grupi i ish-naftëtarëve, të cilët ishin firmëtarë në letrat e hapura drejtuar mediave të shkruara apo institucioneve të administratës publike, referuar shkresës nr. 157/5, datë 22.04.2015 të ankuesit, përbëhet nga 239 ish punonjës të Albpetrol sh.a. Sipas ankuesit, nga grupi i punonjësve firmëtarë rezultoi se janë punësuar sërish pranë Albpetrol sh.a, 7 të tillë, ndërkohë që sipas informacionit të dërguar nga Albpetrol sh.a. KMD ka konstatuar se janë punësuar 7 prej tyre.

60 Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

61 Informacion u kërkuua vetëm për çështjen e dytë, lidhur me ri-punësimin e z. T.G. pranë Albpetrol sh.a.

62 Njoftimi për realizimin e seancës dëgjimore u krye nëpërmjet shkresës nr. 157/4, datë 07.04.2015 të Komisionerit.

63 Referuar njëkohësisht edhe shkresës nr. 501, datë 21.05.2015 të dërguar në vijim të seancës dëgjimore nga z.T.G.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Nenin 7, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4, gërma dh), 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

3.2. Referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

4. OPINION

4.1. Komisioneri gjykon se duke mos i kthyer përgjigje zyrtare T.G, lidhur me kërkesën e tij për punësim, Shoqëria “Albpetrol” sh.a. ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

4.2. Komisioneri mendon se, nuk ekziston një lidhje shkakësore, ndërmjet shkakut të diskriminimit që pretendohet nga ankuesi, me mospunësimin e tij pranë Albpetrol sh.a. Nëse, Albpetrol sh.a. nuk do ta kishte punësuar T.G, për shkak se bënte pjesë në grupin e ish-naftëtarëve firmëtarë, në letrat e hapura drejtuar mediave dhe institucioneve të ndryshme, atëherë natyrshëm lind pyetja, se si është e mundur që 7 ish-punonjës firmëtarë janë punësuar sërish pranë kësaj shoqërie. Në këtë kontekst Komisioneri gjykon se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

4.3. Referua njoftimit të datës 28.12.2013, të publikuar nga Albpetrol sh.a. në gazetën “Dita”, ku shpallen disa vende vakante, konstatohet se nuk janë të përcaktuara kriteret që nevojiten për punësimin e stafit të ri, por vetëm përcaktohet dokumentacioni për punësim, që duhet dorëzuar pranë Shoqërisë. Ndër të tjera, në këtë njoftim është shënuar: *“Përparësi kanë punonjësit që kanë punuar më parë në Albpetrol sh.a. dhe janë prekur nga ristrukturimi”.*

4.4. Në rastin e T.G, i cili është një ish-punonjës i kësaj shoqërie, i prekur nga ristrukturimi në vitin 2010, me arsim të lartë, si dhe me një eksperiencë të pasur në fushën e naftës, vihet re se strukturat përkatëse të Albpetrol sh.a. janë treguar indiferente në trajtimin e kërkesës së tij për punësim, duke mos respektuar as kriteret e vendosura në shpalljen e vendeve vakante.

4.5. Komisioneri gjykon se T.G. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, me personat që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, për shkak të moshës. Në këtë kontekst gjykojmë se, pavarësisht se në aktet nënligjore në bazë të së cilave Albpetrol sh.a. organizohet dhe funksionon, kriteri “moshë” nuk është parashikuar shprehimisht si kriter për punësimin e punonjësve të tij pranë kësaj Shoqërie, thëniet e Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Albpetrol sh.a. se: *“sipas mendimit të tij, ishin marrë në konsideratë kërkesat e punonjësve në moshë relativisht të re, në mënyrë që puna në këtë sektor të kishte rendiment të lartë”,* (thenie të cilat rezultojnë në procesverbalin e inspektimit), janë të mjaftueshme për të dalë në përfundimin se T.G është diskriminuar për shkak të moshës.

5. VENDIMI

5.1. Mospranimin e çështjes së parë të parashtruar në ankesën e T.G, pasi është paraqitur pranë Komisionerit, më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit, ose më vonë se një vit nga marrja dijeni për këtë fakt.

5.2. Konstatimin e mosdiskriminimit të T.G, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Shoqërisë “Albpetrol sh.a. Patos, Fier.

5.3. Konstatimin e diskriminimit të T.G, për shkak të moshës, nga ana e Shoqërisë “Albpetrol sh.a. Patos, Fier.

5.4. Referuar pikës 3 të këtij vendimi, Shoqëria “Albpetrol” sh.a. të marrë sa më shpejt të jetë e mundur, të gjitha masat e nevojshme për punësimin e T.G, në një pozicion pune të përshtatshëm me arsimin, eksperiencën dhe kualifikimet e tij.

ÇËSHITJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE

Ankesa e V.D., ish punonjës pranë Prefekturës së Qarkut Shkodër, ku pretendohet për diskriminim për shkaqe politike dhe për shkak të gjendjes arsimore.

VENDIM Nr. 18 / 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka trajtuar ankesën e V.D, ish punonjës pranë Prefekturës së Qarkut Shkodër, ku pretendohet për diskriminim të tij, për shkaqe politike⁶⁴ dhe për shkak të gjendjes arsimore⁶⁵. Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë “ V.D ka punuar në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve të Brendshme, pranë Prefekturës së Qarkut Shkodër. Me shkresën nr. 1602, datë 11.11.2013, të Prefektit, ai është njoftuar për zgjidhjen e kontratës së punës, për shkak se është vlerësuar se diploma e tij nuk është në përputhje me funksionin e tij si Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme. Ankuesi pretendon se motivacioni i përdorur për zgjidhjen e kontratës së tij të punës nuk është i vërtetë, pasi në datën 11.11.2013, ai është njoftuar dhe ka patur një takim zyrtar me P.R., ku ky i fundit është shprehur se “*vendin e tij të punës e kishte marrë Lëvizja Socialiste për Integritim dhe në vend të tij do të punësohej O. L.*”. V.D thekson faktin, se i ka kërkuar P.R. që të sistemohet në sektorin e arsimit, sektor në të cilin ai kishte punuar në vitet paraardhës, por ai i ka dhënë përgjigje negative. V.D kërkon nga Komisioneri: konstatimin e diskriminimit për shkaqe politike dhe për shkak të gjendjes arsimore; rekomandim për kthim në vendin e punës; dëmshpërblim moral financiar.

1.2. Pas analizimit të ankesës nga pikëpamja formale, Komisioneri filloi procedurat për shqyrtimin e saj, duke iu drejtuar P.R., Prefekt i Qarkut Shkodër, me shkresë nr. 601/1, datë 24.06.2014, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e ankuesit V.D.

1.3. Me shkresën nr. 1192, datë 04.07.2014, të Prefekturës së Qarkut Shkodër, KMD bëhet me dije se, V.D është liruar nga detyra me Urdhërin nr. 33, datë 14.11.2013. Me shkresën nr. 1602, datë 11.11.2013, të Prefektit, ankuesi është njoftuar për zgjidhjen e kontratës së punës, pasi është vlerësuar se diploma e tij, nuk është në përputhje me funksionin e tij si Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme. Çështja në fjalë ka qenë objekt gjykimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Bashkëlidhur shkresës, janë dërguar edhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

1.4. Në vijim të procedurave hetimore, në datën 25.09.2014, pranë Zyrës së Komisionerit u zhvillua seanca dëgjimore, ndërmjet përfaqësuesve të Prefekturës Shkodër dhe ankuesit V.D. Në këtë seance, palët parashtruan dhe argumentuan në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre. V.D bëri një prezantim të eksperiencës së tij në punë dhe kualifikimeve të fituara përgjatë viteve. Ndër të tjera, ai përsëriti faktin se është i diskriminuar, jo vetëm se është larguar padrejtësisht nga vendi i punës, por edhe se ai mund të sistemohej në një pozicion tjetër punë brenda Prefekturës, gjë që i është mohuar. Në

64 V.D. sqaron se ai gëzon statusin e ish të përndjekurit politik.

65 Ankuesi është diplomuar në vitin 1975, për Matematikë-Fizikë, pranë Institutit të Lartë Pedagogjik Shkodër.

këtë kontekst, ai përmendi pozicionin e arkivistit pranë këtij institucioni, duke theksuar se punonjësja aktuale dilte në pension pleqërie dhe vendi do të ishte vakant. Por, një mundësi e tillë i është refuzuar nga Prefekti. Ankuesi theksoi gjithashtu, se në Rregulloren e Brendshme të institucionit nuk është përcaktuar arsimi që duhet të ketë punonjësi, ndaj largimi i tij nga puna për shkak se është vlerësuar se diploma e tij nuk është në përputhje me funksionin e tij si Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme, ishte i paligjshëm. Ndërkohë, përfaqësueset⁶⁶ e Prefekturës së Qarkut Shkodër bënë një përmbledhje të situatës, nëpërmjet leximit të shkresës nr. 1192/3, datë 23.09.2014, shkresë kjo e dërguar posaçërisht nga Prefekti i Qarkut Shkodër, për seancën dëgjimore që zhvillohej në Zyrën e Komisionerit. Sipas kësaj shkrese, theksohet edhe një herë se motivi i largimit nga puna të V.D, ka qenë mospërputhja e diplomës së ankuesit me pozicionin e tij të punës, si Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme pranë kësaj Prefekture. Prefekti ka vlerësuar se diploma e tij, nuk i jep mundësi personit të arrijë që të realizojë detyrën e tij funksionale dhe ka respektuar procedurën e lirimit nga detyra, pasi marrëdhënia mes punëdhënësit⁶⁷ dhe punëmarrësit është një marrëdhënie pune vullneti dhe jo një marrëdhënie administrative, që do të thotë se punëmarrësi mund të ngre padi në gjykatë, vetëm për dëmshpërblimin sipas pasojave që rrjedhin nga kontrata e punës dhe jo për rikthimin në punë, referuar kjo, Vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 01.06.2011. Sipas shkresës në fjalë, V.D është në proces gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe sipas vendimeve gjyqësore, deri tani është dëmshpërblyer në shumën prej 712.800 lekë. Prefekti vlerëson se V.D nuk është diskriminuar as për arsye politike dhe as për arsye arsimore, por i është referuar vetëm detyrave funksionale të ankuesit. Ndër të tjera, Prefekti i Qarkut Shkodër shpreh angazhimin për ta informuar Komisionerin në vijimësi për këtë çështje. Në seancë dëgjimore, përfaqësuesit e Prefekturës së Qarkut Shkodër informuan gjithashtu se në pozicionin e punës së V.D ishte punësuar një punonjëse e re, e cila ishte juriste.

1.5. H.A, përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe E.K., juriste pranë këtij sektori dhe inspektorët e KMD-së ranë dakord që një pjesë e informacionit të përcillej në rrugë zyrtare nga ana e Prefekturës së Qarkut Shkodër. Ky informacion konsistonte në çështjet, si më poshtë vijojnë :

- Informacion mbi të gjithë ish-punonjësit e Prefekturës së Qarkut Shkodër që janë larguar nga puna me motivacionin “mospërputhje e diplomës me funksionin përkatës”, në të njëjtën periudhë me ankuesin.
- Kopje e procesverbalit të takimit të datës 11.11.2013, ndërmjet Prefektit të Qarkut Shkodër dhe ankuesit.
- A ekziston ndonjë akt administrativ, ku të përcaktohen kriteret, mbi bazën e të cilave kryhet emërimi i punonjësve pranë Prefekturës së Qarkut Shkodër.
- Informacion mbi punonjësin, që ka zëvendësuar V.D.
- Mbledhja dhe administrimi i informacioneve të tjera, që kanë lidhje me çështjen e V.D.

1.6. Duke qenë se informacioni i kërkuar, nuk u dërgua zyrtarisht pranë KMD-së, në vijim të procedurave hetimore, inspektorët e KMD-së realizuan inspektim pranë Prefekturës së Qarkut Shkodër në datën 09.10.2014. Në mungesë të Prefektit të Qarkut Shkodër, inspektorët u takuan me N.K, specialiste e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, H.A, Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe E.K, juriste pranë këtij sektori. Këto punonjëse u përgjigjën lidhur me informacionin e kërkuar nga Komisioneri.

1.7. Inspektorët kërkuar të administronin një kopje të procesverbalit të takimit të datës 11.11.2013, ndërmjet Prefektit dhe punonjësve të cilëve iu ishte komunikuar largimi nga puna, ndër të cilët edhe V.D.

⁶⁶ Prefektura e Qarkut Shkodër u përfaqësua në këtë seancë dëgjimore nga H.A., përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe E.K., jurist pranë këtij sektori.

⁶⁷ Cituar shprehimisht sikurse në shkresën nr. 1192/3, datë 23.09.2014, të Prefekturës së Qarkut Shkodër.

Punonjëset siguruan një kopje të këtij procesverbalit, në të cilin figuronte vetëm nënshkrimi i Prefektit dhe jo i pjesëmarrësve të tjerë në takim, ndër të cilët bënin pjesë punonjësit e larguar nga puna, si dhe punonjës të tjerë të Prefekturës. Inspektorët morën në administrim edhe një kopje të Rregullores së Brendshme të Prefekturës së Qarkut Shkodër.

1.8. Gjatë inspektimit, E.K. sqaroi faktin se detyrat funksionale për çdo pozicion pune, përcaktoheshin në këtë rregullore, ndërsa H.A. shtoi se nuk kishte ndonjë akt administrativ, ku të përcaktoheshin kriteret e punësimit të punonjësve pranë këtij institucioni. Sipas saj, punësimi i punonjësve kryhej në bazë të Kodit të Punës, Ligjit nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, i ndryshuar. Në bazë të nenit 9 të këtij ligji, emërimi dhe shkarkimi i punonjësve të Prefekturës së Qarkut Shkodër kryhej nga Prefekti. H.A. u shpreh se donte edhe një herë të përcillte mesazhin e titullarit të institucionit, sipas së cilit V.D nuk ishte diskriminuar as për bindjet politike dhe as për gjendjen arsimore, por thjesht për faktin se Prefekti kishte gjykuar se profesioni i ankuesit si mësues matematike dhe fizike nuk përshtatej me detyrat që ky i fundit kryente, të cilat ishin të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të institucionit.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. V.D është diplomuar në vitin 1975, në degën matematikë-fizikë, pranë Institutit të Lartë Pedagogjik Shkodër dhe ka punuar pranë Prefekturës së Qarkut Shkodër që prej vitit 2005. Në pozicionin e Përgjegjësit të Shërbimeve Mbështetëse ka punuar që prej vitit 2006, deri në vitin 2013, kur me Urdhërin nr. 33, datë 14.11.2013⁶⁸, të Prefektit të Qarkut Shkodër, ankuesi është liruar nga detyra. Ankuesi ka punuar rreth 8 vjet në këtë pozicion, duke krijuar një eksperiencë pune shumëvjeçare në drejtimin e këtij sektori. V.D nuk i është dhënë asnjëherë ndonjë masë disiplinore, për moskryerje të detyrave funksionale, në përputhje me Rregulloren e Brendshme dhe arsimimi i tij nuk e ka penguar asnjëherë që t'i kryejë funksionet e tij, si Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.

2.2. Nga pyetjet që iu bënë përfaqësuesve të Prefekturës së Qarkut Shkodër, inspektorët e KMD-së u informuan mbi faktin se punonjësit e këtij institucioni punësohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Ndërmjet Prefektit, në rolin e punëdhënësit dhe punëmarrësve lidhen kontrata individuale pune. Detyrat funksionale të secilit punonjës janë të përcaktuara në Rregulloren Organizative të Brendshme dhe Sjelljes Etike të Institucionit, ndërkohë që nuk ekzistojnë përsëkrime të mirëfillta puna, ku të përcaktohen kriteret për punësimin e këtyre punonjësve, të tilla si: arsimi, kualifikimet pasuniversitare, eksperiencia në punë, njohuritë mbi kompjuterin dhe gjuhët e huaja etj. Sipas përfaqësuesve të Prefekturës, kriteret vendoseshin nga Prefekti, në bazë të kompetencave që atij i jepte në mënyrë të shprehur ligji nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, i ndryshuar. Nga informacioni i dhënë nga përfaqësueset e Prefekturës së Qarkut Shkodër, kriteret e punësimit të punonjësve nuk janë të përfshira në asnjë akt nënligjor.

2.3. Për sa i përket takimit të datës 11.11.2013, ndërmjet Prefektit të Qarkut Shkodër dhe ankuesit, (ku H.A kishte qenë e pranishme), ajo u shpreh se në këtë takim ishte mbajtur një procesverbal, ku ishte reflektuar gjithçka që kishte ndodhur. Në këtë takim, Prefekti i kishte komunikuar arsyet përkatëse të gjithë punonjësve të liruar nga detyra. H.A u pyet nga inspektorja e KMD-së nëse ajo kishte dëgjuar që Prefekti të shprehej ndaj ankuesit se “*vendin e tij të punës e kishte marrë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe në vend të tij do të punësohej Z. O. L.*”, por ajo u shpreh se për këtë çështje duhej pyetur në mënyrë të drejtpërdrejtë Prefekti dhe se ajo nuk preferonte të përgjigjej.

⁶⁸ Motivacioni përkatës për largimin nga puna nuk figuron të jetë shënuar në këtë urdhër, por në shkresën nr 1602, datë 11.11.2013 “Njoftim mbi fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës mes Prefektit të Qarkut Shkodër dhe disa punëmarrësve të institucionit të Prefektit”.

2.4. Sipas informacionit të administruar rezultoi, se përveç ankuesit V.D, edhe 2 punonjëse të tjera, ishin larguar nga puna me motivacionin “mospërputhje e diplomës me funksionin përkatës”. Këto punonjëse ishin:

- R.Xh., e cila ishte diplomuar pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Dega Gjermanisht, e cila punonte prej vitit 2006, në pozicionin e Specialistes së Territorit dhe Turizmit, në Sektorin e Kompetencave Vendore;
- B.M. e cila ishte diplomuar pranë Fakultetit Ekonomik dhe punonte në pozicionin e Specialistes së Funksioneve të Deleguara (shëndetësia, arsimi, shërbimet e gjendjes civile), pranë Sektorit Juridik.

2.5. Nisur nga parashikimet ligjore, rezulton se kompetencat e Prefektit përfshijnë emërimin dhe lirimin nga detyra të të gjithë punonjësve të administratës së Prefekturës. Prefekti, në rolin e punëdhënësit dhe punonjësi i administratës, në rolin e punëmarrësit, lidhin një kontratë individuale pune, mbështetur në dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2.6. Nga informacioni i marrë, nëpërmjet seancës dëgjimore dhe nëpërmjet inspektimit të kryer pranë Prefekturës së Qarkut Shkodër, rezultoi se nuk ekziston asnjë akt ligjor apo nënligjor, në të cilin të jenë përcaktuar kriteret për punësimin e punonjësve të administratës së këtij institucioni, fakt që na lë të gjykojmë, se këto kriterë lihen në vlerësimin individual të titullarit.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 19, të ligjit nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, i ndryshuar, parashikohet se: “Për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e përgjegjësiave të detyrave, prefekti ka administratën e vet. Struktura dhe detyrat e administratës së prefektit, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, miratohen nga Kryeministri”. Ndërkohë që referuar nenit 9, pika 1 të po këtij ligji parashikohet se: “Prefekti në përputhje me strukturën administrative të miratuar, sipas përcaktimeve të nenit 19 të këtij ligji, emëron dhe largon, sipas procedurave të përcaktuara në ligj, punonjësit e vet të administratës, si dhe të strukturave administrative, të cilët, me akte ligjore e nënligjore të veçanta, i janë caktuar drejtpërdrejt atij”.

3.2. Neni 42 i Rregullores së Brendshme Rregullore Organizative të Brendshme dhe Sjelljes Etike të Institucionit, miratuar me Urdhërin nr. 10, datë 01.03.2012 të Prefektit të Qarkut Shkodër parashikon se: “Sektori i Shërbimit të Brendshëm

- Mban në efçencë rrjetin elektrik, telefonik, internet, transportin për auditet, komisionin e vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, raste emergjencash civile e për çdo rast me urdhër të Prefektit apo Sekretarit të Përgjithshëm. Kujdeset për pastrimin e zyrave, korridoreve, banjove, ambienteve të brendshme si dritare e tavolina etj. Sistemon ambientet për mbledhje sipas rasteve;
- Grumbullon, sistemon dhe përpilon, konform dispozitave ligjore, të dhënat dokumentare për secilin punonjës sipas urdhrave të brendshëm;
- Në zbatim të Urdhrave të Prefektit, koncepton urdhra vendime a propozime për emërimin dhe lëvizjen e personelit të aparatit administrativ;
- Në bashkëpunim me Zyrën e Administrimit Financiar, ku krahas pozicionit për çdo emërim, apo lëvizje të personelit, cakton edhe klasën e pagës dhe vjetërsinë në punë;

- Bën shënimet përkatëse për masat disiplinore që propozohen e vendosen për personelin dhe i administron ato në dosjet e personelit etj.”.

3.3. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10/221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

4. OPINIONI

4.1. Duke analizuar në tërësi nenin 42 të Rregullores së Brendshme, të Prefekturës së Qarkut Shkodër, gjykojmë se Sektori që drejtohej nga V.D, kryen detyra që i përkasin sferës së menaxhimit të burimeve njerëzore, sikurse edhe kryerjes së shërbimeve me karakter teknik pranë institucionit.

4.2. Rregullorja Organizative e Brendshme dhe Sjelljes Etike të Institucionit, miratuar me Urdhërin nr. 10, datë 01.03.2012 të Prefektit të Qarkut Shkodër, neni 42 përcakton në mënyrë të hollësishme detyrat dhe kompetencat e të gjitha strukturave të administratës së kësaj prefekturë.

Në këtë dispozitë, parashikohen vetëm detyrat e këtij sektori, por jo kriteret që duhet të plotësojnë individët që duan të punësohen në të. Kur flasim për kriteret, kemi parasysh: arsimin, kualifikimet pasuniversitare, vjetërsinë në punë, njohuritë mbi gjuhët e huaja dhe kompjuterin etj.

4.3. Nga sa u analizua më sipër, rezulton se motivacioni “diploma juaj nuk është në përputhje me funksionin tuaj”, motivacion nëpërmjet të cilit V.D është larguar nga puna, nuk mbështetet as në përshkrime pune, ku të përcaktohet arsimi apo diploma që duhet të ketë Përgjegjësi i Shërbimeve Mbështetëse dhe as në ndonjë akt nënligjor, i cili t’i përcaktojë shprehimisht këto kriteret, e në rastin konkret arsimin e punonjësit. **Në këtë kontekst, shtojmë faktin, se nuk rezulton të jetë dokumentuar në asnjë akt administrativ, një vlerësim i përgjithshëm i të gjithë punonjësve të Prefekturës së Qarkut Shkodër, ku të jetë konstatuar se diplomat e V.D, R.Xh dhe B.M, nuk kanë qenë në përputhje me funksionin e tyre, ndërkohë që diploma apo arsimi i punonjësve të tjerë të këtij institucioni, ka qenë në përputhje me funksionet përkatëse.**

4.4. Gjithashtu, gjatë kohës së shqyrtimit të kësaj ankese, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ku në Lidhjen 1, “Lista e institucioneve të administratës shtetërore”, pika 4, “Administrata e Prefektit” përcaktohet si një institucion, i cili i nënshtrohet parashikimeve të kësaj VKM-je.

Në bazë të pikës 35, të Lidhjes 3 “Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës”, së VKM-së së sipërpërmendur, përcaktohen, ndër të tjera edhe kërkesat e vendit të punës, për pozicionin “specialist në njësitë organizative përkatëse të ministrave të linjës, institucioneve të pavarura dhe kushtetuese, institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit dhe ministrave të linjës, si dhe në ato rajonale dhe vendore për burimet njerëzore”. Në këto kërkesa përcaktohet: “Arsim i lartë, Diplomë “Master i Shkencave/i Arteve të bukura”; “Master profesional”; “Bachelor” në shkenca të ndryshme sociale, natyrore, inxhinierike, etj.”

4.5. Pavarësisht se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” ka hyrë në fuqi pas paraqitjes së ankesës së V.D pranë KMD-së apo lirimit të tij nga detyra,

sërish Komisioneri i referohet këtij Vendimi, me qëllim që të nxjerrë në pah faktin se specialistët e burimeve njerëzore, apo edhe përgjegjësit e sektorëve përkatës mund të jenë të diplomuar në fusha të ndryshme të tilla si: shkenca të ndryshme sociale, natyrore, inxhinierike, etj. Pra, detyrën e përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve të Brendshme, pranë Prefekturës së Qarkut Shkodër, i cili menaxhon një sektor që ka kompetenca në fushën e burimeve njerëzore dhe shërbimeve, mund ta kryejë si një individ që është diplomuar në degën matematikë-fizikë, ashtu sikurse edhe një individ që është diplomuar për shkenca sociale apo edhe juridik.

4.6. Nga analiza e sipërpërmendur, gjykojmë se ndaj V.D janë ndërmarrë veprime që kanë krijuar baza për mohimin e barazisë ndaj tij, si dhe e kanë ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, për shkak të gjendjes së tij arsimore, në krahasim me punonjësit e tjerë të institucionit. Ndërkohë që, vlerësojmë se nuk disponohen prova dhe fakte konkrete, që të vërtetohet se ky trajtim ka ardhur për shkaqe politike. Në procesverbalin e takimit të Prefektit me punonjësit e larguar, në datën 11.11.2013, nuk figuron shprehja e Prefektit “*vendin e tuaj të punës e ka marrë Lëvizja Socialiste për Integritet dhe në vendin tuaj do të punësohet Z. O. L.*”, por njëkohësisht ky procesverbal nuk rezulton të jetë nënshkruar nga të gjithë të pranishmit në këtë takim, por vetëm nga Prefekti, ndaj nuk mund të vlerësohet si provë konkrete, që të vërtetojë të kundërtën e pretendimit të V.D. **Në mungesë të provave konkrete, Komisioneri nuk mund të shprehet, nëse diskriminimi i pretenduar nga V.D mund të ketë ardhur si pasojë e bindjeve politike të tij.**

4.7. Në bazë të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka tagër për dhënie dëmshpërblimi moral (financiar), ndaj ankuesi duhet t’i drejtohet gjykatës, për të përfituar këtë dëmshpërblim.

5. VENDIMI

5.1. Mbështetur në nenin 3, 12, 13, 15, 21, pika 1, 32, pika 1, germa a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të bindjeve politike, të V.D, nga ana e Prefektit të Prefekturës së Qarkut Shkodër, P.R.

5.2. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjendjes arsimore, të V.D nga ana e Prefektit të Prefekturës së Qarkut Shkodër, P.R.

5.3. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme, nga ana e Prefektit të Qarkut Shkodër, për punësimin e V.D, në strukturat e Prefekturës së Qarkut Shkodër.

5.4. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme nga ana e e Prefektit të Qarkut Shkodër, për njohjen e të gjithë punonjësve të këtij institucioni, me Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe një kopje e këtij ligjit të afishohet në ambientet e brendshme të Prefekturës.

5.5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Prefektura e Qarkut Shkodër, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

5.6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE

Ankesa e E.G., pedagoge e jashtme pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes arsimore.

Vendim Nr. 6 / 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa e E.G., pedagoge e jashtme pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, ku pretendohet për diskriminim të saj, për shkak të gjendjes arsimore. Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, Universiteti Politeknik i Tiranës ka shpallur konkurs për dy pozicione të lira për personel akademik pranë Departamentit të Inxhinierisë Fizike, të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike. E.G. ka dorëzuar kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar në datën 16.09.2014, pranë Degës së Burimeve Njerëzore të Rektoratit. Në datën 17.09.2014, ajo është paraqitur sërish pranë kësaj strukture, për të marrë informacion mbi fazat e mëtejshme të konkurimit dhe bëhet me dije se faza e dytë e vlerësimit është kryer, por ajo nuk është njoftuar pasi është skualifikuar, sepse nuk plotëson të gjitha kriteret. Pikërisht, kriteri, të cilin ajo nuk e plotëson në bazë të njoftimit të kryer nga Rektorati, në datën 08.10.2014, është: “Kandidati për këtë vend pune duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: Të ketë diplomë “Master i shkencave” në sistemin 3+2, Diplomë të nivelit të dytë, Diplomë të integruar të nivelit të dytë (sistemi 5-vjeçar) në Inxhinieri Fizike, FIMIF në UPT dhe Fizikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, UT ose në degë ekuivalente me to, jashtë vendit”. Ankuesja i ka përfunduar studimet e larta në vitet 1994-1998, në degën e Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Kriteri i sipërpërmendur ka qenë përjashtues për të, sepse ky kriter ka përcaktuar si kualifikues vetëm ata kandidatë që kanë diplomë në Inxhinieri Fizike, FIMIF në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Fizikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universitetit të Tiranës. Për sa më sipër, ankuesja pretendon se ky kriter është diskriminues, sepse ajo i plotëson dhe i superon të gjitha kriteret e tjera⁶⁹, përveç faktit që studimet e larta i ka përfunduar në degën e Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

1.2. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁷⁰, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua J.K, Rektor pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, me shkresën nr. 839, datë 20.10.2014, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesja. Njëkohësisht, J.K iu dërgua edhe Urdhëri nr. 155, datë 20.10.2014 “Për kryerjen e inspektimit

69 Ankuesja ka studiuar dhe është diplomuar “Doktor Shkencash” pranë Universitetit të Bolonjës në Itali, si dhe prej muajit maj 2014 gëzon titullin “Profesor i Asociuar”.

70 Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

pranë Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës, me qëllim kryerjen e verifikimeve mbi ankesën e E.G.”. Objekti i Urdhërit të inspektimit konsistonte, si më poshtë vijon:

- Informacion mbi kriteret e vendosura në njoftimin e datës 08.10.2014, nëpërmjet të cilit janë shpallur konkurset për dy pozicione të lira për personel akademik pranë Departamentit të Inxhinierisë Fizike, të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike.
- Informacion mbi arsyet e vendosjes së kriterëve, që përjashtojnë nga konkurimi apo skualifikojnë kandidatët, të cilët i kanë përfunduar studimet e larta apo edhe ato të nivelit Master në universitetet analoge të rretheve të tjera.
- Mbledhja dhe administrimi i informacioneve të tjera, që kanë lidhje me çështjen e E.G.

1.3. Inspektorët e KMD-së u takuan me J.K, Rektor pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe me S.J., Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore pranë Rektoratit të UPT-së. Pasi u njoh me ankesën e E.G., Rektori i Universitetit Politeknik sqaroi se kriteret mbi punësimin e pedagogëve vendosen nga Departamenti përkatës e më pas miratohen nga Dekani dhe Rektori. Kjo parashikohej shprehimisht në nenin 52, pika 3, të Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës. Ndër të tjera, J.K u shpreh se pedagogët e brendshëm të UPT-së përzgjidhen në bazë të kriterëve të vendosura dhe në përgjithësi, kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet e larta në sistemin 5-vjeçar, i cili është i një niveli më të lartë se ai 4-vjeçar. Sipas S.J., në rastin konkret të ankueses E.G., në bazë të sistemit 4-vjeçar, studentët që diplomohen në degën e Fizikës, fitojnë titullin “mësues fizike”, ndërkohë që në bazë të sistemit 5-vjeçar, të diplomuarit fitojnë titullin “fizikant”. S.J. i bëri me dije inspektorët e Komisionerit se informacion më të hollësishëm për rastin konkret mund të merrnin nga Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike. Ndër të tjera gjatë këtij inspektimi, inspektorët e KMD-së kërkuar informacion mbi fituesit e pozicioneve të shpallura vakante me njoftimin e datës 09.10.2014 dhe morën në administrim një kopje të dokumentacionit të tyre.

1.4. Në datën 28.10.2014, u krye inspektim pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizikë, ku inspektorët e Komisionerit u takuan me L.N, Dekan i këtij Fakulteti. Dekani i informoi inspektorët se E.G. kishte depozituar një ankesë pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, që kishte të bënte në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështjen në fjalë dhe se nga ana e tij si Dekan i Fakultetit i ishte dërguar përgjigje zyrtare, ku ajo sqarohej hollësisht. Inspektorët morën në administrim një kopje të ankesës së E.G. dhe përgjigjes së dërguar nga ana e Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike. Ndër të tjera, L.N sqaroi se kandidatët fitues për pozicionet e shpallura vakante për pedagogë të brendshme pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike mbanin titullin “fizikantë”, në ndryshim me ankuesen, e cila nëpërmjet diplomimit të saj ka fituar titullin “mësuese fizike”. Sipas tij, kriteret përzgjedhëse për pedagogët vendosen nga departamentet përkatëse, synimi i të cilave është filtrimi i kandidatëve më të mirë për këto pozicione. Dekani shtoi faktin se pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike diplomohen inxhinierë matematikë dhe fizikë, ndaj edhe niveli i pedagogëve të brendshëm kërkohet në nivel të lartë dhe domosdoshmërisht që të gëzojnë titullin “fizikant”. ***L.N sqaroi se nga eksperiencia e deritanishme kishte rezultuar se prurjet e Fakultetit të shkencave-e të Natyrës dhe Universitetit Politeknik të Tiranës kishin qenë më të mira, sesa ato të Universiteteve në rrethe. Për këtë arsye, në njoftimet e pozicioneve të lira për pedagogë preferohen kandidatët e diplomuar nga këto dy fakultete. Gjithsesi, edhe kandidatët e diplomuar në Universitetet e rretheve janë punësuar në pozicione të ndryshme pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, por si pedagogë të punësuar me kontratë me afat të përcaktuar, për të plotësuar nevojat e procesit mësimor.***

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Nëpërmjet njoftimit të datës 08.09.2014, Universiteti Politeknik i Tiranës ka shpallur konkurs për dy pozicione të lira për personel akademik pranë Departamentit të Inxhinierisë Fizike, të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike. E.G., e cila në bazë të kontratës së saj të punës, ka qenë pjesë e stafit akademik të këtij fakulteti, vitin e kaluar akademik, si pedagog e punësuar me kontratë me afat të përcaktuar, ka aplikuar për të konkurruar për këto vende vakante dhe është skualifikuar për mosplotësim kriteresh. Ankuesja zotëron një diplomë të nivelit të dytë në degën e Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Kriteri i sipërpërmendur ka qenë përjashtues për të, sepse ky kriter përcakton si kualifikues, vetëm ata kandidatë që kanë Diplomë të nivelit të dytë, Diplomë të integruar të nivelit të dytë (sistemi 5-vjeçar) në Inxhinieri Fizike, FIMIF në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Fizikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universitetit të Tiranës.

2.2. Sikurse vihet re nga parashikimi i nenit 52, pika 3, kriteret e konkurimit propozohen nga njëjësia bazë, që konsiderohet Departamenti përkatës, i Fakultetit të UPT-së. Më pas, lista e këtyre kriterëve miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe përfundimisht nga Rektori i UPT-së, i cili konsiderohet si njëjësia kryesore e gjithë këtij procesi.

2.3. Në Njoftimin e UPT-së, në pikën 1, përcaktohet si një ndër kriteret se “*Kandidati duhet të ketë diplomë “Master i shkencave” në sistemin 3+2, Diplomë të nivelit të dytë, Diplomë të integruar të nivelit të dytë (sistemi 5-vjeçar) në Inxhinieri Fizike, FIMIF në UPT dhe Fizikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, UT ose në degë ekuivalente me to, jashtë vendit*”.

2.4. Për sa më sipër, Rektori i UPT-së dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Matematike dhe Fizike theksojnë faktin se kriteri që e ka skualifikuar E.G., ka qenë fakti se ajo nëpërmjet studimeve universitare 4-vjeçare që ka kryer në degën e Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër ka fituar titullin “mësuese fizike”, ndërkohë që kandidatët për pedagogë të brendshëm pranë Fakultetit të Shkencave Matematike dhe Fizike, kërkohen të zotërojnë diplomë të nivelit të dytë apo Diplomë të integruar të nivelit të dytë (sistemi 5-vjeçar), nëpërmjet së cilës ata të gëzonin titullin “fizikant”.

2.5. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të fituesve për dy pozicionet për staf akademik, të shpallura, nëpërmjet njoftimit të datës 08.09.2014 nga ana e Rektoratit, vihet re se të dy fituesit kanë përfunduar arsimin universitar pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore, përkatësisht në vitin 1992 dhe 2007 dhe gëzonin titullin “Fizikan”. Njëri prej tyre kishte fituar titullin “docent” në vitin 2012 dhe fituesi tjetër ishte në prag të mbrojtjes së titullit “doktor shkencash”.

2.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesja pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatohet se:

- Në periudhën 1994-1998 ka kryer studimet e larta në Degën e Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Referuar diplomës së saj, rezulton se titulli i fituar nga ankuesja është “mësuese e fizikës”.
- Në periudhën 2003-2007, ankuesja ka kryer Master në Fizikë, me drejtim Biofizikë, pranë Departamentit të Fizikës, të Fakultetit të Shkencave Natyrore, Tiranë.
- Në periudhën 2005-2009 ka kryer studimet e Doktoraturës në Departamentin e Fizikës, pranë Universitetit të Bolonjës, nga ku ka fituar titullin “Doktor” në Fizikë⁷¹. Nëpërmjet Vendimit nr.

⁷¹ Referuar Diplomës së Doktoraturës së lëshuar nga Universiteti i Bolonjës, E.G. ka fituar titullin “il Dottorato di Ricerca in Fisica”.

154, datë 08.10.2010, të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, grada e fituar në Itali nga E.G., është e barazvlefshme me gradën “Doktor” në Republikën e Shqipërisë.

- Në vitin 2014, mbështetur në Vendimin nr. 63, datë 18.12.2013, të Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, së Universitetit të Tiranës, E.G., referuar Dëshmisë nr. 40, datë 27.05.2014, të lëshuar nga Universiteti i Tiranës, ka fituar titullin “Profesor i Asociuar”.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

3.2. Në nenin 52 të Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës parashikohet hollësisht procedura e punësimit të personelit akademik pranë UPT-së, si më poshtë:

1. *Vendet e punës për personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor dhe personelin administrative në UPT fitohen me konkurim. Përfshihen nga konkurimi vetëm vendet e punës për personelin e shërbimit.*
2. *Kriteri i përgjithshëm i konkurimit për stafin akademik që do të punësohet në UPT është:*
 - a. *Të ketë mbaruar studimet universitare me një grumbullim pikësh mbi 85/100%, si dhe masterin e nivelit të dytë.*
3. *Kritere të tjera të konkurimit, propozohen nga njësitë përkatëse bazë dhe miratohen nga dekani i fakultetit/drejtori i institutit dhe nga rektori i UPT-së.*
4. *Kandidatët konkurrojnë në bazë të konkurseve publike duke zbatuar afatet përkatëse.*
5. *Procedurat për përzgjedhjen e kandidatit fitues janë:*
 - *Njësia bazë/kryesore paraqet kërkesën për plotësim të vendit vakant të punës, duke specifikuar kriteret që duhet të plotësojë kandidati/ja për këtë vend pune.*
 - *Kjo kërkesë i paraqitet Rektoratit të UPT.*
 - *Rektorati i UPT shpall në median e shkruar dhe /apo elektronike konkursin për këtë vend vakant, brenda i muaji.*
 - *Rektorati/njësia kryesore afishon njoftimin përkatës në vende të dukshme.*
 - *.....*
 - *.....*
 - *Vlerësimi i kandidatëve kryhet me kritere të pikëzuara, të propozuara nga njësia bazë dhe të miratuara nga njësia kryesore.*
 - *E gjithë procedura është transparente.*

- Përzgjidhet ai kandidat që plotëson më mirë kërkesat e publikuara dhe i përgjigjet më mirë përshkrimit të vendit të punës.
- Kandidatët jo fitues kanë në dispozicion një afat kohor prej një jave për të paraqitur tek Rektori apelimin e tyre.
- Mënyra e organizimit të konkursit dhe e përzgjedhjes së kandidatit, përcaktohen në procedura të veçanta, të miratuara nga Rektori.

6. Rektori i UPT bën miratimin përfundimtar të kandidatit fitues për personel akademik dhe administrative dhe vendos datën e fillimit të marrëdhënieve financiare dhe pagën mujore në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”.

4. OPINIONI

4.1. Për sa më sipër, gjykojmë se pavarësisht titullit “mësuese fizike”, që ankuesja ka fituar në bazë të diplomës së studimeve të larta, i cili është konsideruar si kriter skualifikues për të për t’u punësuar dhe për të qenë pjesë e pjesë e stafit akademik të Departamentit të Inxhinierisë Fizike, të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në vijim ajo ka kryer studime pasuniversitare të nivelit Master në Fizikë, Doktoraturë në Fizikë dhe ka fituar së fundmi titullin “Profesor i Asociuar”, sikurse një i diplomuar pranë Universitetit Politeknik të Tiranës apo Fakultetit të Shkencave Sociale, në Tiranë, që gëzon titullin “fizikan”. Gradat dhe titujt janë nivele më të larta të kualifikimit se kandidatët fitues.

4.2. Duke iu përmbajtur kriterit përcaktuar në pikën 1, të njoftimit të datës 08.09.2014, rezulton se në bazë të tij, përjashtohen nga konkurimi në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe të gjithë kandidatët që zotërojnë një diplomë të integruar të nivelit të dytë në degën e Fizikës, në Universitetet e rretheve. Pra, duke iu referuar sërish njoftimit të mësipërm, gjykojmë se kriteri përjashtues për E.G., nuk ka qenë vetëm fakti se ajo nuk zotëronte një diplomë të nivelit të dytë (5-vjeçar) apo një diplomë të integruar të nivelit të dytë (5-vjeçar), në bazë të së cilës, ajo do të kishte fituar titullin “fizikante”, por edhe sepse ajo nuk ishte diplomuar as pranë UPT-së dhe as pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Tiranë.

4.3. Nga analiza e sipërpërmendur, gjykojmë se kriteri i përcaktuar në pikën 1 të njoftimit të Rektoratit të UPT-së, për shpalljen vakant të dy pozicioneve për staf akademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Fizike dhe Matematike, është një kriter diskriminues për E.G. dhe për të gjithë ata kandidatë, të cilët kanë përfunduar studimet e larta dhe zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë të integruar (sistemi 5 vjeçar) pranë Universiteteve të rretheve, në Fakultetin e Fizikës.

5. VENDIMI

5.1. Mbështetur në nenet 3, 4, 5, pika 1, 7, pika 1, nenet 12, 13, 15, 21, pika 1, 32, pika 1, germa a), pikat 2, 3, 4, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi **konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë** të E.G., për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Rektorit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

5.2. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të kandidatëve që janë diplomuar pranë Universiteteve të Rretheve, në Fakultetin e Fizikës dhe zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë të integruar, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Rektorit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

5.3. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme, nga Rektorati dhe Dekanati i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, për ndryshimin e kriterit përjashtues në të gjithë njoftimet për punësim për personel akademik, nga data e daljes së këtij vendimi.

5.4. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme nga ana e Rektoratit dhe Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, për njohjen e të gjithë punonjësve të këtij institucioni, me Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe një kopje e këtij ligjit të afishohet në ambientet e brendshme të institucioneve përkatëse.

5.5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Rektori i UPT-së, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

5.6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË LIDHJES FAMILJARE

Ankesa z.E.G., kundër kompanisë Albpetrol sh.a Patos, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të lidhjes familjare⁷².

VENDIM Nr. 164, / 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. E.G. shpjegon se: “Që nga data 23.07.2007 ka filluar punë pranë kompanisë Albpetrol sh.a Patos në pozicionin e juristit dhe deri më sot nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj tij. Ankuesi deklaron se veprimet diskriminuese ndaj tij dhe familjes së tij kanë filluar pas denoncimeve që prindërit e tij, M.G.⁷³ dhe L.G.⁷⁴ kanë bërë në drejtim të punëdhënësit E.P., në cilësinë e Administratorit të kompanisë Albpetrol sh.a. E.G në ankesën e tij informon se babai i tij M.G. me anë të disa shkresave⁷⁵ ka kërkuar nga Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a ndalimin e sjelljeve diskriminuese dhe presionin psikologjik për largimin e tij nga puna. E.G deklaron se me datë 03.09.2014 është thirrur nga Dh.Gj., Drejtor i Qendrës së Prodhimit Naftë Gaz dhe Rërë Patos, i cili i ka komunikuar se me urdhër në formë verbale të Administratorit, E.P. ishte i pushuar nga puna në mënyrë të menjëhershme pa i vënë në dispozicion një urdhër me shkrim. Me kërkesën datë 16.10.2014, avokat E.H. në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të E.G ka kërkuar nga Albpetrol sh.a arsyet e mos pagesës së pagës së tij për periudhën Shtator-Nëntor 2014. E.G deklaron se deri më sot nuk ka marrë përgjigje për kërkesën e bërë. Me shkresën datë 13.01.2015 drejtuar Komisionerit, subjekti ankues deklaron se në vitin 2008 kompania Albpetrol sh.a me anë të marrëveshjes nr. 5070/1, datë 24.09.2008 ka mbuluar shpenzimet financiare për kualifikimin profesional të tij, në një marrëveshje 2-vjeçare deri në përfundimin e studimeve master pa shkëputje nga puna. Gjithashtu ankuesi bën me dije se që nga data 01.08.2013 ka nënshkruar një kontratë pune individuale, 2-vjeçare me punëdhënësin Albpetrol sh.a në të cilën përcaktohen dhe marrëdhëniet e ndërsjellta mes punëdhënësit dhe punëmarrësit”.

1.2. Me shkresën Nr. 11, datë 09.01.2015 është bërë njoftimi i subjektit Albpetrol sh.a në lidhje me ankesën. Me shkresën Nr. 629/1, datë 18.02.2015 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Albpetrol sh.a informon mbi çështjen, shoqëruar me dokumentat përkatëse.

1.3. Më datë 25.03.2015 në mjediset e zyrës së Komisionerit u zhvillua një seancë dëgjimore. Në këtë seancë nga ana e Albpetrol sh.a morën pjesë, E.Ç. me detyrë specialiste pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe D.F. me detyrë jurist pranë Albpetrol sh.a si dhe M.G. përfaqësues me prokurë i E.G. Në këtë seancë, palët parashtruan pretendimet e tyre, lidhur me çështjen objekt shqyrtimi nga Komisioneri.

72 E.G është i biri i M.G. dhe L.G. të cilët kanë paraqitur ankesë për diskriminim pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

73 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr.202, datë 09.12.2014 ka konstatuar diskriminimin e drejtpërdrejtë të z.M.G nga ana e Albpetrol sh.a, për shkak dhe të përkatësisë në grupimin sindikal.

74 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr. 203, datë 09.12.2014 ka konstatuar diskriminimin e të znj.L.G. në formën e viktimizimit nga ana e Albpetrol sh.a.

75 Me shkresën nr. 4428, datë 27.05.2014, subjekti ankues i drejtohet E.P., ku i kërkon që të ndërpritet diskriminimi ndaj tij nga ana e drejtuesve të Q.A.R-së Patos, lidhur me marrëdhëniet e punës mes tij dhe kësaj shoqërie. Me shkresën nr. 5626, datë 10.07.2014, E.G., vë në dijeni E.P. se po ushtrohet diskriminim i hapur dhe presion psikologjik për ta pushuar nga puna.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Referuar regjistrin themeltar të punonjësve të Albpetrol sh.a, rezulton se punonjësi E. G ka filluar punë në detyrën “Jurist” pranë Qendrës së Prodhimit të Gazit Patos, në datë 23.08.2007. Me shkresën nr. 3762/1, datë 14.11.2011, E.G është transferuar pranë Qendrës së Prodhimit të Hidrokarbureve Patos në detyrën si specialist i lartë dhe me shkresën nr. 3762/3, datë 18.04.2012 është sistemuar në detyrën si specialist jurist i lartë, pranë QPH Patos. Që nga data 01.05.2013 ka punuar në detyrën Jurist pranë QPNGR Patos derisa i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me Vendimin nr. 516, datë 21.08.2014 për shkak të shkurtimit të vendit të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me datë 22.11.2014.

2.2. Me shkresën nr. 5070/1, datë 24.09.2008, punëdhënësi Albpetrol sh.a ka lidhur një marrëveshje kualifikimi me punëmarrësin E.G në të cilën Albpetrol sh.a angazhohet të financojë punëmarrësin E.G. me qëllim kualifikimin e tij duke ndjekur studimet Master pasuniversitar pa shkëputje nga puna.

2.3. Në datë 01.08.2013, mes punëdhënësit Albpetrol sh.a dhe punëmarrësit E.G është lidhur një kontratë punë individuale me afat dy vjeçar deri në datë 31.07.2015, në të cilën punëmarrësi ka pasur të përcaktuar pozicionin e punës si Jurist.

2.4. Bazuar në strukturën organizative të QPH Patos, nr. 2260/3, datë 12.10.2011 dhe në strukturën organike të QPNGR Patos, nr. 1523/1, datë 03.05.2013 në administratën e kësaj qendre rezulton që të jetë planifikuar një vend pune si specialist i lartë jurist. Referuar shkresës nr. 1408, datë 29.04.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Albpetrol sh.a, E.D. është emëruar në pozicionin si “Jurist”, e cila referuar Librezës së Punës rezulton se nga data 26.08.2013 ka qenë me leje lindje dhe është kthyer në punë në datë 21.07.2014.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

3.2. Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

4. OPINION

4.1. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁷⁶. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohej mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje

⁷⁶ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1. Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁷⁷.

4.2. Në mungesë të një praktike kombëtare Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

4.3. Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. **Pretendimi i ankuesit se shkak për diskriminimin e tij është lidhja familjare me M.G dhe L.G që janë prindërit e tij dhe që kanë denoncuar veprimet diskriminuese të drejtuesve të shoqërisë Albpetrol sh.a, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.**

4.4. Referuar dokumentit “Çertifikatë Familjare”, datë 08.01.2015 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Patos, rezulton se E.G. është i biri i M.G dhe L.G. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr.202, datë 09.12.2014 ka konstatuar diskriminimin e drejtpërdrejtë të M.G nga ana e Albpetrol sh.a, për shkak dhe të përkatësisë në grupimin sindikal. Po kështu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr. 203, datë 09.12.2014 ka konstatuar diskriminimin e L.G në formën e viktimizimit nga ana e Albpetrol sh.a.

4.5. Duke iu referuar faktit që M.G dhe L.G kanë paraqitur ankesën pranë Komisionerit respektivisht më datë 05.06.2014, dhe datë 09.06.2014 dhe masat shtrënguese ndaj E.G. nga ana e Albpetrol sh.a, Patos, janë marrë pas kësaj date, dhe kanë ardhur si rezultat i këtyre ankimeve, ndodhemi para formës së viktimizimit i konsideruar nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 8 të tij, si: “*trajtimi i disfavorshëm apo pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë*”.

4.6. Referuar Urdhrit nr. 4599, datë 27.11.2013 të administratorit të Albpetrol sha, autoriteti i vetëm për kryerjen e procedurës së punësimit dhe shkëputjes së marrëdhënieve të punës me çdo punonjës të shoqërisë është administratori i Albpetrol sha. Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

⁷⁷ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

4.7. Në analizë të provave të marra në shqyrtim rezulton se administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a, si autoriteti i vetëm që kryen procedurën e punësimit dhe shkëputjes së marrëdhënieve të punës ka qenë tendencioz në vendimin për largimin e E.G. nga vendi i punës, pasi edhe pse ishte në dijeni se shoqëria Albpetrol kishte investuar vlera monetare për kualifikimin akademik si dhe kishte një kontratë pune individuale me afat dy vjeçar deri në datë 31.07.2015 me E.G, përsëri ndërmoi veprimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Duke marrë në konsideratë faktin se pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me E.G, shoqëria Albpetrol sh.a, ka emëruar në punë dhe dy punonjës të tjerë në pozicionin e juristit (respektivisht Y.S. emëruar në pozicionin e punës si Jurist pranë qendrës Q.A.R. Patos me Vendimin nr. 595, datë 21.10.2014 dhe H.Gj. në pozicionin e punës Jurist pranë Q.SH.GJ. Patos me Vendimin nr. 41, datë 27.01.2015), përforcon faktin e pretendimit të subjektit ankues që veprimi i largimit nga puna ka qenë për shkak të lidhjes familjare të E.G.

4.8. Fakti i qëndrimit diskriminues ndaj E.G përforcohet dhe me veprimin e mosinformimit⁷⁸ dhe mos pagesës së pagës për periudhën Shtator-Nëntor 2015 nga ana e punëdhënësit me arsyetimin se punëmarrësi nuk është paraqitur në punë. Referuar Vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë 30.09.2014, vërtetohet se E.G. ka qenë në punë si përfaqësues i shoqërisë Albpetrol sha në çështjen gjyqësore me paditës: K.Ll dhe të paditur Albpetrol sha. Prania në punë e E.G. përforcohet dhe me faktin që në datë 25.09.2014 në mjediset e Albpetrol sh.a është mbajtur proces verbali mbi dorëzimin e dosjes gjyqësore (me palë paditëse K.Ll dhe të paditur Albpetrol sha) të dorëzuar juristit R.M.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit E.G, për shkak të lidhjes familjare në formën e viktimizimit, nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a.

5.2. Në referim të pikës 1, shoqëria Albpetrol sh.a, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e E.G në vendin e mëparshëm të punës.

5.3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, shoqëria Albpetrol sh.a, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

5.4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

5.5. Kujtojmë se bazuar në nenin 35 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” çdo person mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e tij por kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e institucionit.

⁷⁸ Me kërkesën datë 16.10.2014, avokat E.Hamataj në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të z.Goxhaj ka kërkuar nga Albpetrol sh.a arsyet e mos pagesës së pagës së z.Goxhaj.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FORMËN E DISKRIMINIMIT TË DREJTPËRDREJTË

Ankesa e R.P kundër Spitalit Rajonal Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të bindjeve politike në fushën e punësimit

Vendim Nr. 38/2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti ankues R.P, kundër Spitalit Rajonal Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”. R.P. në ankesën e saj deklaroi se: “*Është njoftuar në rrugë shkresore për nisjen e procedurës për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me pretendimin e ndryshimit të strukturës së Spitalit Rajonal Shkodër, ku pozicioni i kuzhinieres kishte rezultuar mbi organikë. Në takim me drejtorin, R.P. ka ngritur pretendimin se përse i ndërpriten marrëdhëniet e punës kur ka kualifikime dhe eksperiencë punë ndërkohë mbahen në punë 8 persona të tjerë me kualifikim dhe eksperiencë pune më pak. R.P. deklaroi se familja e saj në zgjedhjet e Qershorit 2013 ka mbështetur subjektin politik “Aleanca Kuq e Zi”, pasi bashkëshorti i saj ka qenë kandidat për deputet i këtij subjekti*”.

1.2. Pas njoftimit të subjektit, me datë 28.01.2015 u realizua inspektimi pranë Spitalit Rajonal Shkodër. Sipas shpjegimeve të dhëna nga M.Zh., Përgjegjëse e zyrës së Burimeve Njerëzore pranë Spitalit Rajonal Shkodër: “*R.P. ka filluar punë pranë Spitalit Rajonal Shkodër në datë 01.03.2014. Për vitin 2012 dhe 2014 nuk ka të depozituar vlerësimin e performancës së personelit të Sektorit të Hotelerisë. Vlerësimi i performancës së personelit të Sektorit të Hotelerisë është bërë për vitin 2013 në të cilën figuron se i gjithë personeli kuzhinier është vlerësuar në masën “mirë”. Me urdhrin e brendshëm nr. 49, datë 15.04.2014 të drejtorit të spitalit është ngritur Komisioni për përcaktimin e punonjësve për të cilët duhet të fillonin procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për shkak të mos përfshirjes në strukturën e vitit 2014 në Spitalin Rajonal Shkodër. Komisioni i ngritur ka propozuar tek drejtuesit që kriteri kryesor, i cili duhet të kenë punonjësit për të qëndruar në punë duhet të ishte vjetërsia në punë në pozicionin si kuzhinier. Të gjithë punonjësit në pozicionin kuzhinier me miratimin e strukturës së re janë njoftuar për largim nga puna, me përjashtim të punonjësve A.O dhe N.S. për arsye se A.O kryen funksionin si përgjegjës dhe është më i vjetri në punë dhe N.S. është kuzhinierë më vete në Sanatorium dhe kryen funksionin e furnitores dhe drejtueses së kuzhinës*”. Gjatë inspektimit në zyrën e burimeve njerëzore u verifikuan dhe dosjet e personelit kuzhinier.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. R.P. me datë 01.12.1990 ka filluar punë si kuzhinierë pranë subjektit Materniteti Shkodër e vërtetuar me Librezën e punës.

2.2. Me shkresën nr. 633 datë 09.04.2014 Spitali Rajonal Shkodër i është drejtuar Ministrisë së

Shëndetësisë në të cilën ka kërkuar ndryshimin e organikës së spitalit, në të cilën ndërmjet të tjerash ka kërkuar zvogëlimin e numrit të kuzhinierëve nga 16 në 10, për arsye se numri i shtrimeve të pacientëve pranë këtij spitali nuk justifikonte punën e gjithë këtij personeli.

2.3. Me Urdhrin e Brendshëm nr. 49, datë 15.04.2014, “Për verifikimin e shpërndarjes së personelit sipas strukturës në Spitalin Rajonal Shkodër”, Drejtori i spitalit ka urdhëruar ngritjen e një komisioni prej pesë persona për përcaktimin e punonjësve për të cilët duhet të fillonin procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, për shkak të mos përfshirjes në strukturën e spitalit për vitin 2014. Me shkresën Nr. 624 datë 18.06.2014, ky komision i është drejtuar drejtorit të spitalit me një relacion në të cilën mendon se kriteri kryesor për përcaktimin e punonjësve për të cilët duhet të fillonin procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të ishte vjetërsia e punës në sektorët përkatës.

2.4. Pas miratimit të kërkesës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për fillimin e procedurës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për punonjësit kuzhinierë, Spitali Rajonal Shkodër ka filluar procedurat e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për 13 punonjës, përfshirë edhe ankuesen. Për punonjësit A.O, N.S. dhe T.M. nuk ka pasur njoftim për fillimin e procedurës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me arsyetimin se A.O kryen funksionin si përgjegjës dhe është më i vjetri në punë dhe N.S. është kuzhinierë më vete në Sanatorium dhe kryen funksionin e furnitores dhe drejtueses së kuzhinës. Ndërkohë, për punonjësen T.M. nuk ka asnjë justifikim nga ana e drejtuesve të spitalit. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga palët, vlerësohet se për të gjithë punonjësit e njoftuar për fillimin e procedurës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës janë ndjekur procedurat bazuar në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

3.2. Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

3.3. Në nenin 12, pika 1 të ligjit nr. 10221/2010, përcaktohet se ndalohet diskriminimi për shkak të bindjes politike dhe që ka lidhje me: c) *“trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

4. OPINIONI

4.1. Meqë Komisioni i ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 49, datë 15.04.2014, (për përcaktimin e punonjësve për të cilët duhet të fillonin procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës) i kishte propozuar Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër që, kriteri kryesor për përcaktimin e punonjësve për të cilët duhet të fillonin procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të ishte vjetërsia e punës në sektorët përkatës⁷⁹, **Komisioneri analizoi vjetërsinë në punë të punonjësve kuzhinierë. Nga analizimi i të dhënave, vlerësohet se nga ana e drejtuesve të spitalit nuk është marrë parasysh kriteri i vjetërsisë në punë në sektorët përkatës të punonjësve kuzhinierë, pasi sipas të dhënave vlerësohet se për disa punonjëse, përfshirë ankuesen, nuk duhet të ishin ndërprerë marrëdhëniet e punës. Kështu, në një rënditje të punonjësve kuzhinierë sipas vjetërsisë në punë, subjekti ankues renditej e treta me 24 vite punë. Kjo çoi në vlerësimin e Komisionerit se shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen R.P. nuk ishte vjetërsia në punë.**

4.2. Subjekti ankues ka faktuar me prova bindjet e saj politike, të cilat i ka pretenduar dhe përpara Komisionit të zyrës së burimeve njerëzore të dokumentuara këto në Procesverbalin nr. 699 prot datë 31.07.2014 gjatë takimit të zhvilluar pas njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, në të cilin ka deklaruar se: “Dua t’iu vë në dijeni se bashkëshortin tim e ka hequr nga puna PD-ja dhe sot po më heq nga puna PS-ja”. Bazuar në dokumentacionin që disponojmë nga hetimi dhe bindja e krijuar nga komunikimi shkresor me përfaqësues të Spitalit Rajonal Shkodër, **Komisioneri vlerëson se shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me punonjësen R. P. janë bindjet e saja politike.**

4.3. Spitali Rajonal Shkodër nuk ka dhënë prova që të justifikonin largimin nga puna të znj. R.P për shkaqe të ndryshme nga bindja politike. Madje, provat tregojnë të kundërtën e arsyetimit të tyre që ishte kriteri i vjetërsisë në punë.

5. VENDIMI

5.1. Mbështetur në nenin 12 pika 1/c, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) dhe c), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 10 dhe 11 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi **konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë** të shtetases R.P, për shkak të bindjes politike nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër.

5.2. Në referim të pikës 1, Spitali Rajonal Shkodër, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e R.P. në vendin e mëparshëm të punës.

5.3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Spitali Rajonal Shkodër, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

5.4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

5.5. Kujtojmë se bazuar në nenin 35 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” çdo person mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e tij por kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e institucionit.

79 Bazuar në shkresën nr. 624, datë 18.06.2014, “Relacion” të hartuar nga Komisioni për përcaktimin e punonjësve për të cilët duhet të fillonin procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT NË FORMËN E “DISKRIMINIMIT TË DREJTËPËRDREJTË”

Ankesa e paraqitur nga I.S., kundër subjektit Ministria e Arsimit dhe Sportit.

V E N D I M Nr.115/2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. I.S shpjegon se: “Është diplomuar në vitin 2008, në Universitetin Amerikan të Bullgarisë, në Bullgari, me program 4-vjeçar, në Ekonomiks me profile në Shkenca Kompjuterike dhe Sisteme Informacioni. Me shkresën me nr. Regj. 147, datë 25.03.2014, Komisioni i Njohjes së Diplomave në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ka bërë vërtetimin e njohjes dhe njësimit, duke e njësuar si Bachelor në Republikën e Shqipërisë. Me anë të shkresës me datë 20.10.2014, të P.N, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm në Drejtorinë e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, i bëhet me dije I.S. se: “... diploma e saj është një diplomë universitare që i përket ciklit të parë të studimeve, prandaj është njësuar si “Bachelor”. Po kështu vetë emërtimi i diplomës në përmbajtjen e saj është “Bachelor of Arts” dhe nuk i përket ciklit të dytë të studimeve Master. I.S, pretendon se ka një Urdhër të posaçëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas të cilit, diplomat e Universitetit të New Yorkut në Tiranë njihen si Master Profesional. Ankuesja pretendon se diplomat e lëshuara në Shqipëri në vitin 2008, vit në të cilin është diplomuar edhe ajo, njihen si Master Shkencor i nivelit të dytë. I.S. pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me studentët që janë diplomuar brenda Shqipërisë, për faktin se diploma e saj është e huaj dhe është lëshuar nga Institucione amerikane jashtë Republikës së Shqipërisë”.

1.2. Me shkresën Nr.946/1 prot, datë 10.11.2014 subjekti Ministria e Arsimit dhe e Sportit u vu në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe duke i kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga I.S.

1.3. Me datë 16.01.2015 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi realizoi një inspektim në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

1.4. Pranë Komisionerit u realizua një seancë dëgjimore.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 2497 prot., datë 25.03.2015, bën me dije se:...” Komisioni i Njohjes së Diplomave, i cili ka marrë në shqyrtim dosjet e shtetasve të sipërcituar (J.GJ dhe E.M), i trajtonte dhe i vlerësonte diplomat e huaja, rast pas rasti, sipas kriterit të vlerësimit të diplomave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë.

2.2. Personat e sipërcituar janë diplomuar në të njëjtin universitet me ankuesen dhe kanë përfunduar studimet me programin 4-vjeçar të studimeve, të njohura si “bachelor” në universitetin e origjinës, njëlloj si ajo.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen** ekonomike, **arsimore** ose shoqërore, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Neni 3, pika 1 i po këtij ligji, shpreh se: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

3.3. Në nenin 7 të ligjit nr. 10 221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

4. OPINION

4.1. Komisioneri shqyrton ankesën në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, dhe bën verifikimet nëse në kundërshtim me këtë ligj kemi trajtim të ndryshëm në kushte të njëjta të ankuesit krahasuar me persona të tjerë, apo trajtim më pak të favorshëm të tij, për një nga shkaqet e parashikuara në këtë ligj.

4.2. Pretendimi i ankueses se është trajtuar ndryshe nga studentët e Universitetit të New Yorkut në Tiranë, nuk qëndron, pasi, Komisioneri, konstaton se nuk mund të bëhet një krahasim i tillë, për arsye se, Universiteti i New Yorkut në Tiranë, është një institucion privat i arsimit të lartë dhe ushtron aktivitetin si i tillë në Republikën e Shqipërisë. Diplomat e lëshuara nga ky institucion i arsimit të lartë nuk i nënshtrohen procesit të njohjes siç ndodh me diplomate huaja.

4.3. Komisioneri konstaton se në dokumentin për vërtetimin e njohjes dhe njësimit të diplomave të të pesë studentëve⁸⁰, të gjithë të diplomuar në Universitetin Amerikan të Bullgarisë, nga ana e Komisioneve për Njohjen e Diplomave, është përdorur e njëjta bazë ligjore: neni 37 i ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr. 41, datë 08.12.2009, “Për procedurat dhe kriteret e njohjes së diplomave dhe çertifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë”, i ndryshuar.

80 1. I.S, 2. J.GJ, 3. E.M, 4. G.B, 5. F.B.

4.4. I.S është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se sa dy personat sipërcituar, në të njëjtën situatë, gjë që në interpretim të nenit 3, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, e vë ankuesen në pozitë të diskriminimit të drejtëpërdrejtë nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë të I.S nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

5.2. Ministria e Arsimit dhe Sportit, (Komisioni për Njohjen e Diplomave), si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, ndaj I.S, rekomandohet të shqyrtojë rishtaz vendimin lidhur me njohjen e diplomës së ankueses.

5.3. MAS të realizojë verifikimin e praktikave qartazi.

5.4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Ministria e Arsimit dhe Sportit, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI TË DREJTPËRDREJTË

Ankesa e P.B. kundër punëdhënësit Albpetrol sh.a., Patos, me objekt pretendimi për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore dhe bindjeve politike

Vendim Nr. 92 / 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me Nr. 67 rregj., datë 22.07.2014, të P.B. kundër punëdhënësit Albpetrol sh.a., Patos, me objekt pretendimi për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore dhe bindjeve politike (anëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë). P.B. pretendon se i është zgjidhur kontrata e punës në mënyrë të menjëhershme për shkak të bindjeve të tij politike dhe gjendjes shëndetësore, pasi nga data 16.12.2013 deri më datë 26.12.2013, ai ka qenë i paafte për punë, vërtetuar kjo nëpërmjet raporteve mjekësore.

1.2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Administratorit të Albpetrol sh.a., Patos, Fier, ku i kërkoi informacion mbi çështjen e parashtruar nga P.B. Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Albpetrol sh.a., informoi Komisionerin se: *“Aktualisht ndaj punonjësit P.B., Shoqëria Albpetrol sh.a., Patos, ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi rezulton se kemi diferenca negative në bilancin e naftës në 902 ton në stacionin e Zharrëzës, përgjegjës i të cilit është P.B. Dëmi i shkaktuar shoqërisë në këtë rast llogaritet në vlerën 28.000.000 lekë. Këtë fakt P.B. e ka pranuar edhe vetë në shkresën bashkëngjitur këtij informacioni, në të cilën ai pranon se ka lejuar futjen e autobotëve me sasi uji. Për këtë arsye nga ana e QASHNG Patos është dhënë masa disiplinore “Zgjidhje e Kontratës së Punës” në mënyrë të menjëhershme për P.B. Zgjidhja e marrëdhënieve të punës është marrë me vendimin nr. 130, datë 27.02.2014, ku është vendosur që P.B. t’i zgjidhet në mënyrë të menjëhershme kontrata e punës”.*

1.3. Komisioneri zhvilloi seancë dëgjimore me datë 21.10.2014. Në seancë dëgjimore u paraqit vetëm pala ankuese dhe për këtë arsye u zhvillua në mungesë të Shoqërisë Albpetrol sh.a. Gjatë seancës dëgjimore, P.B. sqaroi procedurat e hyrje daljeve të naftës në stacionin e Zharrëz. Ai theksoi se matjet nga inxhinierët nuk kanë përlllogaritur firot që ka nafta për shkak të kushteve natyrore dhe teknike në të cilat ndodheshin rezervuarët dhe nuk kanë marrë parasysh përlllogaritjet bazuar në VKM-në Nr. 612, datë 05.09.2012 dhe VKM-në Nr. 128, datë 20.02.2013, me qëllim që ai të dilte me humbje.

1.4. Lidhur me trajtimin me VKM-në Nr. 106, datë 01.02.2012, P.B. deklaroi se ka kërkuar që më datë 01.11.2013 të trajtohet me VKM, por nga Albpetrol sh.a. i është shtyrë trajtimi në dhjetor 2013, deri në momentin që është larguar përfundimisht nga puna. Për këtë janë bërë edhe shënimet përkatëse në librezën e punës ku është bërë shënimi dy herë, që P.B. “del pa punë si pasojë e ristrukturimit me VKM Nr. 106, datë 01.02.2012” dhe janë fshirë. Gjithashtu, shtoi se nga 649 ish punonjës të Albpetrol sh.a., vetëm ai nuk është trajtuar me VKM.

1.5. Ankuesi, në përfundim të seancës dëgjimore shtoi se Shoqëria Albpetrol sh.a., më datë 23 Dhjetor 2013, e ka shkarkuar nga pozicioni i Përgjegjës të Stacionit të Zharrëz, në një kohë që ka qenë me raport paaftësie, vërtetuar nga raporti i lëshuar nga mjeku. Edhe pse ka qenë në këto kushte, më datë 18

Dhjetor 2013, nga përfaqësues të shoqërisë është bërë kontrolli i sasisë së naftës që ndodhej në Stacionin e Zharrëz, pa qenë prezent P.B. Më datë 23 Dhjetor 2013, edhe pse P.B. nuk kishte dorëzuar punën, në vend të tij ishte punësuar një person tjetër, vërtetuar kjo nga procesverbali i mbajtur prej tij.⁸¹

1.6. Në vazhdim, Shoqëria Albpetrol sh.a. informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi se: *“Kontrata Individuale e Punës me P.B. është zgjidhur më datë 27.02.2014, me vendim nr. 130, të Administratorit të Albpetrol sh.a., në respektim të procedurave të parashikuara në Kodin e Punës për shkaqet që i janë bërë të ditura P.B. Shkaqet e zgjidhjes së Kontratës Individuale të Punës me P.B. janë diferencat negative në masën 902 tonë naftë, në bilancin e naftës në Stacionin e Zharrëzës të qendrës QASHNG Patos, përgjegjës i të cilit për periudhën përkatëse ka qenë P.B. Përsa i përket, pretendimit të P.B. për zgjidhje të Kontratës Individuale të Punës për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, ju sqarojmë se ndërprerja e marrëdhënieve financiare dhe të punës me P.B., është kryer më datë 27.02.2014, me vendim nr. 130, të Administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a., z. E.P. dhe për periudhën në fjalë, P.B. nuk ka paraqitur asnjë raport mjekësor pranë qendrës përkatëse të punës dhe është paguar me ditë të plota pune deri më 27.02.2014, siç verifikohet edhe nga listë-pagesa për muajin përkatës”.* Gjithashtu, Shoqëria Albpetrol sh.a. informoi se nuk rezultonte të kishte asnjë dokument me atë të së cilit P.B. të ketë dorëzuar punën.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. P.B ka qenë punonjës i Albpetrol sh.a., që prej datës 20.07.2006. Fillimisht ka punuar në Qendrën e Prodhimit të Naftës dhe Gazit Patos, e më pas është transferuar në Stacionin në Zharrëz, ku ka punuar deri më datë 23.12.2013. Nga kjo datë, ka kaluar në dispozicion të qendrës, deri kur, me vendim Nr. 130, datë 27.02.2014 të Administratorit të Albpetrol sh.a., i është komunikuar zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës, për shkak të diferencave negative të konstatuara në Stacionin e Zharrëz, ku P.B. ka qenë Përgjegjës.

2.2. P.B. ka filluar punë pranë Shoqërisë Albpetrol sh.a. Patos, më datë 20 Korrik 2006, duke punuar në detyra të ndryshme deri më datë 27 Shkurt 2014, datë në të cilën është larguar nga puna. Referuar librezës së punës P.B. rezulton të ketë qenë punonjës i Shoqërisë Albpetrol sh.a., prej 10 vitesh pa ndërprerje. Nga data 23 Maj 2013, deri në datën e zgjidhjes së kontratës së punës, P.B. ka punuar në detyrën e Përgjegjës të Stacionit të Zharrëzës. Më datë 01.08.2013, për shkak të ristrukturimit të Shoqërisë Albpetrol sh.a., ndërmjet punonjësve të shoqërisë, si dhe me P.B. është lidhur një kontratë individuale pune, me afat 2-vjeçar.

2.3. Me miratimin e VKM-së nr. 106, datë 01.02.2012, P.B. fillimisht është përfshirë në listën e personave që do të trajtoheshin me përfitimet që parashikonte ky akt nënligjor, por më pas ai është hequr nga kjo listë nga ana e punëdhënësit Albpetrol sh.a. Në datë 23 Dhjetor 2013, P.B. ka kaluar në dispozicion të qendrave. Me urdhrin nr. 3759 prot., datë 04.11.2013, të Administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a., Patos, është ngritur një grup pune për saktësimin sasiar të naftës bruto në stacionet e QASHNG Patos, për periudhën 11 mujore të vitit 2013. Pas verifikimeve, grupi i punës nxori një diferencë prej 902 ton e naftës bruto, në stacionin ku ishte përgjegjës P.B. Në takimin mes palëve për vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës, P.B i janë parashtruar arsyet e zgjidhjes së Kontratës Individuale të Punës, të cilat lidheshin me diferencat e konstatuara në sasinë e naftës, në qendrën ku ishte përgjegjës. P.B. ka kundërshtuar këto pretendime dhe ka kërkuar ballafaqim. Si rezultat, me vendim nr. 130, datë 27.02.2014, P.B. i është zgjidhur kontrata e punës me efekt të menjëhershëm.

81 Të gjitha këto pretendime janë të pasqyruara në procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 21.10.2014.

2.4. Lidhur me pretendimin për zgjidhje të pajustificuar të kontratës individuale të punës, P.B. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Apelit Vlorë, të cilat kanë pranuar padinë e ngritur nga ankuesi dhe nëpërmjet vendimeve⁸² përkatëse, janë shprehur se: *“Duke qenë se nëpërmjet palëve ka ekzistuar një kontratë pune me afat të pacaktuar, siç u analizua më sipër dhe marrëdhëniet e punës, referuar librezës së punës së paditësit, kanë zgjatur mbi pesë vjet, atëherë afati i njoftimit, bazuar në nenin 143 të Kodit të Punës, duhet të ishte tre muaj. Jo vetëm që nuk u provua respektimi i këtij afati por një fakt i tillë u pohua nga pala e paditur dhe njëkohësisht del edhe vendimi nr. 130, datë 27.02.2014, në bazë të të cilit paditësit i zgjidhej në mënyrë të menjëhershme kontrata e punës. Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim kemi të bëjmë me një zgjidhje të pajustificuar të kontratës së punës nga ana e palës së paditur”*. Gjykata arsyeton se: *“Nga tërësia e këtyre provave të sipërcituara gjykata arrin në përfundimin se nuk del në pah ndonjë përgjegjësi e paditësit P.B. si përgjegjës i stacionit të Zharrëz në lidhje me mungesat e konstatuara në naftën bruto. Gjykata i çmon si të pabazuara pretendimet e palës së paditur përse i përket përgjegjësisë së paditësit edhe për këto shkaqe: Së pari, pala e paditur nuk specifikoi se cilat ishin detyrat konkrete të paditësit si përgjegjës sektori, në cilat akte bazoheshin ato (si p.sh. rregullore të brendshme, kontratë pune) si dhe ku konsistonte shkella konkrete e paditësit, si rrjedhojë e së cilës kishin rezultuar diferenca negative të naftës bruto. Së dyti, nga kallëzimi penal i paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 14.01.2014, rezulton se vepra e cila dyshohet të jetë kryer në rastin konkret “është vjedhja duke shpërdoruar detyrën”. Nga ana tjetër, emri i paditësit nuk figuron në këtë kallëzim dhe as nga materialet bashkëlidhur kallëzimit nuk atashohet në këtë vepër penale... Së treti, ashtu siç prapësoi edhe paditësi, verifikimi në lidhje me sasinë e naftës bruto ishte bërë për për një periudhë 11 muajore gjatë vitit 2013, ndërkohë që ai detyrën e përgjegjësit të stacionit të Zharrëzit e kishte marrë në datën 23 Maj 2013. Në këto rrethana, edhe në rast se do kishte rezultuar përgjegjësi për përgjegjësin e stacionit, nuk specifikohet se cili prej tyre kishte vepruar në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe cila ishte përgjegjësia konkrete e secilit përgjegjës. Së katërti, edhe nëse do të merrej e provuar fakti se paditësi mbante përgjegjësi për diferencat e konstatuara, vetë Drejtoria e QASHNG Patos, në përfundimet e relacionit ka sugjeruar që paditësi të lirohet nga detyra dhe të vihet në dispozicion. Një rekomandim i tillë është ndjekur dhe duke filluar nga data 23 Dhjetor 2013, paditësi ka kaluar në dispozicion. Pra për të njëjtën shkellje, nuk mund të jepen dy herë masa nga ana e punëdhënësit”*.

2.5. Mbështetur në dokumentacionin dhe faktet e administruara, vërehet se:

- **Së pari**, P.B. është larguar nga puna pa shkaqe të justifikuara nga ana e punëdhënësit.
- **Së dyti**, edhe pse Shoqëria Albpetrol sh.a., ka nënshkruar disa herë përfshirjen e ankuesit në listën e punonjësve që do të trajtoheshin me përfitimet që parashikonte VKM nr. 106, datë 01.02.2012, nuk ka lejuar të përfitojë këtë të drejtë.
- **Së treti**, P.B. i është ngarkuar një përgjegjësi për një periudhë kohe, ku një pjesë të së cilës nuk ka qenë në atë pozicion pune, si dhe për një përgjegjësi e cila specifikohet konkretisht se ku qëndron ajo.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Diskriminimi për shkak të gjendjes shëndetësore dhe bindjeve politike janë shkaqe të mbrojtura nga ligji 10221/2010, neni 1 dhe neni 3/1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet se: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit*

⁸² Vendimi Nr. 62-2014-3787 (1211), datë 27.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Fier.
Vendimi Nr. 272, datë 05.03.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

3.2. Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

3.3. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3, pika 3, parashikon se: “*Diskriminimi i drejtpërdrejtë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”

3.4. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashtrohet: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.*”

3.5. Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa (c), parashikon se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*”

4. OPINION

4.1. Lidhja e Kontratave Individuale të Punës me afat të përcaktuar me P.B. si një punonjës që ka 10 vite punë pranë kësaj shoqërie, bie ndesh me rregullin e përgjithshëm të parashikuar në Kodin e Punës dhe është një formë presioni mbi punonjësin. Neni 140, pika 2, e këtij kodi parashikon se: “*Si rregull, kontrata e punës lidhet për një periudhë të pacaktuar. Lidhja e kontratës së punës për një periudhë të caktuar duhet të justifikohet me arsye objektive, që lidhen me natyrën e përkohshme të detyrës, në të cilën punëmarrësi do të punësohet*”. Në këtë rast, **nuk shihet e arsyeshme që një shoqëri me vazhdimësi në aktivitetin e saj prej kaq shumë vitesh, dhe me një natyrë pune jo të përkohshme, siç është Shoqëria Albpetrol sh.a., Patos, duhet të nënshkruajë kontrata me afat të përcaktuar me punonjës që kanë vjetërsi mbi 10 (dhjetë) vite pune pranë saj.**

4.2. Punonjësit e larguar si pasojë e ristrukturimit të shoqërisë, në Janar të 2014 janë trajtuar me VKM-në, ndërsa P.B. rezulton që të ketë kërkuar të trajtohet me përfitimet që parashikonte VKM-ja nr. 106, datë 01.02.2012, por nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., është hequr nga kjo listë dhe ka kaluar në dispozicion deri në momentin që është larguar përfundimisht nga puna. Kjo vërtetohet nga dokumentacioni i dorëzuar, por do të theksonim shkresën Nr. 4882 prot., datë 11.12.2013, të AlbPetrol sh.a. drejtuar Zyrës Rajonale të Punësimit Fier, në të cilën dërgohet lista emërore e punonjësve të Albpetrol sh.a., që dalin të papunë në zbatim të VKM Nr. 106, ku rezulton që P.B. mban numrin rendor 487.

Pavarësisht faktit që P.B. nuk është trajtuar asnjëherë nga përfitimet që parashikonte VKM Nr. 106, datë

01.02.2012 në pikën 1⁸³ të saj, rezulton që ai të ketë aplikuar dhe t'i jetë miratuar e drejta për të përfituar.

4.3. P.B. ka paraqitur si provë procesverbalin e “Bilancit Operativ të Naftës për muajin Dhjetor”, në të cilin evidentohet se është nënshkruar nga A.M., në cilësinë e Përgjegjës të Stacionit të Zharrëzës dhe në të cilin ka bërë shënimin “E kam marrë detyrën më datë 23.12.2013”. Pikërisht të njëjtën ditë kur për P.B. ka dalë njoftimi nga ana e Drejtorit të Qendrës, për kalimin në dispozicion të qendrës, z. A.M. ka marrë detyrën e Përgjegjës të Stacionit të Zharrëzës.

4.4. Nga shqyrtimi i fakteve dhe provave, rezulton që grupi i punës, që kontrollon Stacionin e Zharrëzës, në të cilin ishte përgjegjës P.B., në përfundim të kontrollit të bërë, më datë 18.12.2013, ka hartuar “Relacionin mbi bilancin e naftës bruto për periudhën 11 muajore 2013”, në të cilin ka konstatuar një diferencë të naftës bruto dhe si rezultat ka dalë në përfundimin që P.B. të lirohet nga detyra dhe të kalojë në dispozicion. P.B. është emëruar në detyrën e Përgjegjës, më 23 Maj 2013, në Stacionin e Zharrëzës dhe verifikimi i sasisë së naftës bruto nga grupi i punës për periudhën Janar-Nëntor 2013, nuk ngarkon me përgjegjësi vetëm P.B. Bilanci i konstatuar nga grupi i punës ka përfshirë edhe periudhën që ai nuk ka qenë në këtë detyrë. Gjithashtu, diferenca e naftës së konstatuar i është ngarkuar P.B. dhe përgjegjësi tjetër të Stacionit të Zharrëzës, pa specifikuar përgjegjësinë e secilit, gjë që nuk ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë P.B.

4.5. Rezulton që P.B. është anëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë (PD), që prej datës 15.03.1991. Pas zgjedhjeve të 23 Qershorit 2013 dhe ardhjes në pushtet të koalicionit të majtë qeverisës, u vunë re lëvizje të drejtuesëve të institucioneve. Ndër ta ishte edhe largimi i administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a., z. F.M. dhe zëvendësimi i tij nga E.P., në Shtator 2013. Pak kohë pas emërimit të E.P., në këtë pozicion, në muajin Tetor 2013 e në vazhdim, për P.B., është vënë re një situatë e tensionuar në marrëdhëniet e punës.

4.6. Nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., nuk është marrë asnjë masë për ballafaqimin e kërkuar nga P.B., si dhe gjatë takimit të datës 24.02.2014, në të cilin i janë parashtruar arsyet e zgjidhjes së Kontratës Individuale të Punës. Pra, rezulton që P.B., i është mohuar e drejta e justifikimit të përgjegjësisë së ngarkuar nga ana e grupit të punës së ngritur në bazë të urdhërit nr. 3759 prot., datë 04.11.2013 të administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a.

Nga ana e tjetër, P.B. ka paraqitur fakte dhe prova, mbi të cilat mbështeten pretendimet për diskriminim dhe shkakun e pretenduar, që fakton se largimi nga ana e punëdhënësit nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, pasi të gjitha provat e administruara (vendimet e gjykatave, procesverbale etj.) hedhin poshtë pretendimet e ngritura nga Shoqëria Albpetrol sh.a.

4.7. Përsa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka bindjen se **mospërfshirja në listën e punonjësve që do të trajtoheshin me përfitimet që parashikonte VKM nr. 106, datë 01.02.2012 dhe ngarkimi i një përgjegjësie e cila nuk argumentohet, është bërë në mënyrë të qëllimshme dhe tendencioze me synimin përfundimtar të largimit të ankuesit nga puna.**

4.8. Komisioneri gjykon se, **paligjshmëria e veprimeve apo mos veprimeve nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., në dëm të ankuesit, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, duke e larguar nga puna pa shkaqe të arsyeshme dhe duke e vënë në pozita diskriminuese për shkak të bindjeve politike të tij.**

4.9. P.B. pretendon se i është zgjidhur kontrata e punës në mënyrë të menjëhershme për shkak të gjendjes shëndetësore, pasi nga data 16.12.2013 deri më datë 26.12.2013, ai ka qenë i paafte për punë. Referuar

83 Punonjësit e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos, që dalin të papunë si pasojë e ristrukturimit, gjatë periudhës nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi deri në çastin e privatizimit të shoqërisë, përveç trajtimeve që parashikohen nga Kodi i Punës, përfitojnë, për një periudhë njëvjeçare, pagesë sipas pagës bruto të vitit të fundit të punës. Në përfundim të kësaj periudhe punonjësit kanë të drejtë të aplikojnë për të ardhurën nga papunësia.

listë-pagesave për periudhën nëntor 2013-shkurt 2014, rezulton që P.B. të jetë paguar me ditë të plota pune deri më 27.02.2014. Ky fakt hedh poshtë pretendimet e ankuesit se për këtë periudhë kohe ai nuk është paraqitur në punë për shkak të paaftësisë së përkohshme.

5. VENDIMI

5.1. Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi ***konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë*** të ankuesit, P.B., për shkak të bindjeve politike, nga punëdhënësi Albpetrol sh.a., Patos.

5.2. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit, P.B. për shkak të gjendjes shëndetësore, nga punëdhënësi Albpetrol sh.a., Patos.

5.3. Detyrimin e Shoqërisë Albpetrol sh.a., Patos, të kthejë në mënyrë të menjëhershme në pozicionin e mëparshëm të punës P.B.

5.4. Detyrimin e Shoqërisë Albpetrol sh.a., Patos, të informojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve Komisionerin lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 33, pika 11 e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

5.5. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikime të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FORMËN E DISKRIMINIMIT TË TËRTHORTË

“Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”, informon Komisionerin, se nga verifikimet e bëra prej tyre në terren, janë evidentuar disa probleme dhe vonesa në procesin e shpërndarjes së teksteve falas për komunitetin rom dhe egjiptian⁸⁴.

V E N D I M Nr. 159/2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”, informon Komisionerin, se nga verifikimet e bëra prej tyre në terren, janë evidentuar disa probleme dhe vonesa në procesin e shpërndarjes së teksteve falas për komunitetin rom dhe egjiptian⁸⁵.

1.2. Problematik u paraqit dhe fakti që fëmijët rom për të tërhequr këto libra duhet të paraqesin certifikatën familjare dhe personale, që në shumtën e rasteve nuk e kanë (mospagim i taksave në bashki), për rrjedhojë ata nuk mund të tërheqin dot librat. Në shkollën e Zhupanit janë rreth 70 fëmijë rom që duan të shkojnë në ciklet e ndryshme të shkollës, por deri më tani vetëm një pjesë e vogël e tyre ka marrë libra.

1.3. Nga Komisioneri u kërkua të sqaroheshin arsyet e mosigurimit në kohë të teksteve falas, për fëmijët e komunitetit rom, egjiptian dhe atyre me probleme social-ekonomike, informacion mbi procedurën e ndjekur për shpërndarjen e teksteve falas, mbi numrin e fëmijëve të pa pajisur ende me tekste shkollore... etj.

1.4. Me shkresën nr.829/1 prot, datë 01.10.2015 u njoftua dhe ju kërkua informacion Drejtorisë Arsimore Rajonale Fier, duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, si dhe duke i kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga Shoqata “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Me anë të shkresës me nr.1550 Prot., datë 07.10.2015, Sh.A, Drejtor i Drejtorisë Arsimore Rajonale Fier⁸⁶, bën me dije se:

- “... mospajisja pjesërisht, në kohë me tekste shkollore e nxënësve në shkollën e Zhupanit, duke përfshirë dhe nxënësit romë, ka ardhur pasi distributori nuk kishte gjendje librash.
- Nuk ka patur për asnjë arsye problematika në shpërndarjen e librave falas për fëmijët romë.

84 Urdhër nr.147, datë 25.09.2015 “Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio” të çështjes së shpërndarjes së librave falas për vitin shkollor 2015-2016, për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, në shkollat 9-vjeçare në rrethin e Fierit.

85 Urdhër nr.147, datë 25.09.2015 “Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio” të çështjes së shpërndarjes së librave falas për vitin shkollor 2015-2016, për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, në shkollat 9-vjeçare në rrethin e Fierit.

86 Në vijim Drejtorisë Arsimore Rajonale Fier, do t'i referohemi me shkurtesën DAR Fier.

- Janë pajisur me tekste falas 77 fëmijë romë, pa patur asnjë pengesë burokratike për ta, falë marrëveshjes së DAR me distributorët, praktikë kjo e ndjekur që me daljen e udhëzimit për tekstet falas për këtë kategori.
- Nuk ka asnjë nxënës rom të pa pajisur me tekste falas.
- Pajisja e nxënësve me tekstet që mungonin ka përfunduar për të gjithë nxënësit që më datë 30.09.2015”

2.2. Komisioneri u informua nga DAR Fier, se të gjithë fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, të cilët frekuentojnë arsimin 9-vjeçar, në rrethin e Fierit, janë pajisur me tekste shkollore falas dhe se një vonesë e tillë ka ardhur si pasojë e dërgimit të tyre me vonesë nga shtëpitë botuese.

2.3. Nga korrespondenca⁸⁷ e mbajtur mes Komisionerit dhe përfaqësueses së kësaj shoqate, E.T, si dhe ekspertës së Observatorit në Fier, rezulton që nga verifikimet e tyre në terren, si dhe nga takimet me kryetarët e komunitetit rom dhe prindër të komunitetit egjiptian, të gjithë fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, tashmë janë të pajisur me tekste falas.

2.4. Kështu, për Komunën Qendër, u janë shpërndarë tekste shkollore falas, 77 nxënësve. Në komunën Levan janë pajisur me tekste 143 nxënës rom. Në Bashkinë Roskovec po ashtu, nuk ka nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian të pa pajisur me tekste shkollore falas. Nga puna e koordinatorëve në terren konfirmohet se viti shkollor vijon normalisht.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, **racën**, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Diskriminimi për shkak të racës përbën shkak të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, i cili parashikon se: “...“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

3.3. Në bazë të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti.

3.4. VKM-ja nr.107, datë 10.02.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, në pikën 6.4 të tij përcakton se: “...për tekstet shkollore të nxënësve të pakicave kombëtare, nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes do të mbulohet në masën 100 për qind nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.

3.5. VKM-ja nr.707, datë 26.08.2015⁸⁸, në pikën 6.10 të tij përcakton se: “Për tekstet shkollore të fëmijëve

⁸⁷ Komisioneri ka mbajtur korrespondencë në vijimsi me përfaqësues të Shoqatës “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve në adresat: e.kica@observator.org.al, director@observator.org.al, fier@observator.org.al.

⁸⁸ “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.107, datë 10.02.2010, të Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.

egjiptianë nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100 për qind nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës egjiptianë duhet të dorëzojnë në njësitë arsimore vendore, DAR/ZA përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit”.

3.6. Neni 18, i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “Detyrat e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrit të Arsimit dhe Sportit”, në pikën 2, germa c) parashikon se:

“2. Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Sportit, ndër të tjera, marrin secili masa për: ...c) arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuar, si dhe të personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji.”

3.7. Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”..

3.8. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3, pika 3, parashikon se: “ “ Diskriminimi i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.”.

4. OPINION

4.1. Nisur nga dinamika e ngjarjeve, si dhe nga informacionet e marra nga DAR Fier, përfaqësues të Shoqatës “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve” dhe prindër të komuniteti rom e egjiptian, rezultoi që kjo situatë pas ndërhyrjes së Komisionerit është zgjidhur, pasi procesi mësimor vijon të zhvillohet normalisht dhe nxënësit janë pajisur me tekste shkollore falas. Situata e mos pajisjes në kohë me tekste shkollore për nxënësit e arsimit parauniversitar, në rrethin e Fierit, kryesisht për kategorinë e nxënësve rom dhe egjiptianë, ka ardhur si rezultat i dërgimit të tyre me vonesë nga shtëpitë botuese.

4.2. Në këtë kuadër, Komisioneri, konstaton se ***kjo kategori përfituesish të teksteve shkollore falas, për shkak të vonesave të shkaktuara nga shtëpitë botuese përkatëse, janë vënë në pozita jo të favorshme krahasuar me kategorinë e nxënësve që i kanë blerë tesktet shkollore, duke iu mohuar atyre mundësinë për të filluar një vit shkollor normal, pa hasur në vonesa burokratike.***

4.3. Duke marrë shkas nga zhvillimet e deritanishme lidhur me këtë proces, por dhe nga eksperiencia e vitit të kaluar, ***rekomandojmë ndjekjen dhe monitorimin me prioritet të gjithë procesit për pajisjen me tekste shkollore falas, për kategoritë e fëmijëve romë dhe egjiptianë, për të parandaluar në këtë mënyrë krijimin e situatave diskriminuese për këto kategori nxënësish, të cilët do të gjendeshin në pamundësi për t’u pajisur me tekstet shkollore, si dhe për të mundësuar një ecuri normale të procesit mësimor, pa vonesa të tilla.***

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë, të kategorisë së nxënësve romë dhe egjiptianë, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar dhe që përfitojnë të pajisen me tekste shkollore falas, për shkak të dërgimit me vonesë të tyre pranë shkollave të arsimit 9-vjeçar, të rrethit të Fierit.

5.2. Ndërprerjen e procedurës hetimore, për shkak se pas ndërhyrjes së Komisionerit, situata është zgjidhur në favor të kategorisë së nxënësve romë dhe egjiptianë.

5.3. DAR Fier dhe Drejtoritë e shkollave të arsimit 9-vjeçar të rrethit të Fierit, në bashkëpunim me shtëpitë botuese përkatëse, të marrin masa që për vitin e ardhshëm akademik, pajisja me tekste falas për kategorinë e nxënësve romë dhe egjiptianë, të bëhet në kohë, duke shmangur çdo vonesë të mundshme që ndikon në fillimin dhe ecurinë normale të procesit mësimor.

ÇËSHTJE E DISKRIMINIMIT NË FORMËN E DISKRIMINIMIT TË TËRTHORTË

Çështje e nisur kryesisht nga KMD pas marrjes së informacionit nga gazeta "Tirana Observer", në artikullin me titull: "*Farmacistët kundër urdhrin të ri për daljen në pension.*"

V E N D I M N r . 1 5 , D a t ë 1 2 / 2 0 1 5

1. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1.1.** Nisur nga informacioni i marrë nga gazeta "Tirana Observer", në artikullin me titull: "*Farmacistët kundër urdhrin të ri për daljen në pension: Është diskriminues*" të datës 17.06.2015, bazuar në nenin 32/1/c të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ku sanksionohet se Komisioneri ka kompetencë: "*Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji*", dhe nenit 46 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: "*Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara*", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Me Urdhrin Nr. 120, datë 22.07.2015, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes në lidhje me efektet diskriminuese të ndryshimeve në nenin 19 të statutit të Urdhrin të Farmacistëve të Shqipërisë nga ana e Këshillit Kombëtar të Urdhrin të Farmacistëve.
- 1.2.** Ndërkohë, në rrugë elektronike pranë Komisionerit janë paraqitur dy ankesa të tjera nga një grup farmacistësh pensionistë të qytetit të Pogradecit dhe një grup farmacistësh pensionistë, anëtarë të Urdhrin të Farmacistëve të Shqipërisë, të cilët pasi u informuan për ndjekjen kryesisht të çështjes nga ana e Komisionerit, kërkuan tërheqjen nga ankesa.
- 1.3.** Me shkresën Nr. 703, datë 29.07.2015 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, në lidhje me çështjen, duke i kërkuar që të paraqesin parashtrime me shkrim mbi pretendimet e grupit të farmacistëve në moshë pensioni të punësuar si drejtues teknik.
- 1.4.** Me shkresën Nr. 593, datë 31.07.2015 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrin të Farmacistëve të Shqipërisë (UFSH), informon se për shkak se Presidentja e UFSH-së është me leje vjetore parashtrimet në lidhje me kërkesën e bërë do të paraqiten në fillim të muajit Shtator.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

- 2.1.** Në artikullin e publikuar nga gazeta "Tirana Observer" në datë 17.06.2015, me titull: "*Farmacistët kundër urdhrin të ri për daljen në pension: Është diskriminues*" përcillet shqetësimi i ngritur nga farmacistët lidhur me ndryshimet e kryera në Statutin e Urdhrin, ku një ndër pikat që lidhet me të drejtën e ushtrimit të profesionit të drejtuesit teknik, diskriminon ata që mbushin moshën e pensionit dhe që nuk janë të vetëpunësuar, ndërsa ata drejtues teknikë në moshë pensioni që kanë bizneset e tyre lejohen të ushtrojnë profesionin e drejtuesit teknik.

2.2. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, mban qëndrimin si më poshtë: “Për të përmbushur misionin e UFSH-së, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve që është organi më i lartë vendimmarrës i tij vendosi të miratojë disa ndryshime në nenin 19 të Statutit, ndër të cilat dhe kriterin që një farmacist që të ushtrojë profesionin si drejtues teknik duhet të mos ketë mbushur moshën e pensionit, përjashtuar rastet e të vetëpunësuarve. Drejtuesi teknik i vetëpunësuar ka kuptimin që ai zotëron një biznes me formë juridike të përcaktuar si person fizik e cila përcakton që ky person sjell të ardhura për veten e tij. Farmacistët që kanë mbushur moshën e pensionit dhe janë të vetëpunësuar do iu jepet një farë kohe për vetë faktin se mbi ta përveç barrës si drejtues teknik i rëndon dhe barra e subjektit si biznes dhe Këshilli Kombëtar i UFSH-së nuk mund të marrë një vendim që mund të cenojë interesat ekonomike të subjekteve farmaceutike dhe mund të çojë në falimentimin e biznesit. Në farmacitë ku drejtues teknik i vetëpunësuar është pensionist është më e vështirë gjetja e një drejtuesi tjetër teknik, pasi përgjithësisht në farmacitë ku pronari është farmacist kanë të punësuar vetëm një person tjetër kurse farmacitë ku pronar nuk është farmacisti kanë të punësuar më shumë se dy farmacistë dhe nuk mund të jetë e vështirë gjetja e një drejtuesi teknik tjetër pasi mund të zëvendësohet me një nga farmacistët e tjerë që përmbush kriteret. Ndërsa për farmacistin që ka mbushur moshën e pensionit, por nuk është i vetëpunësuar nuk cenohen interesat e tij ekonomike për vetë faktin se atij nuk i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit si farmacist, por thjesht nuk mund të jetë më drejtues teknik. Arsyet që sollën në marrjen e këtij vendimi dhe që prek në mënyrë të menjëhershme pensionistët që nuk janë të vetëpunësuar u bënë për të garantuar cilësinë e shërbimit, për të mbrojtur konsumatorët nga keq ushtrimet profesionale, për të mbrojtur farmacistët e ndërgjegjshëm, por mbi të gjitha për të përmbushur misionin që UFSH-ja ka. Këshilli Kombëtar i UFSH e ka shtruar si diskutim dhe në një moment të mëvonshëm, por jo të largët do të shqyrtojë kërkesën për një trajtim të barabartë për të gjithë pensionistët qofshin ata të vetëpunësuar apo jo. Për sa më sipër UFSH ju bën me dije se ky vendim i Këshillit Kombëtar për farmacistët që kanë mbushur moshën e pensionit dhe janë të vetëpunësuar do të jetë i përkohshëm pasi UFSH nuk e ka aspak si qëllim të vetin të nxjerrë dhe për më tepër të zbatojë vendime me efekt diskriminues”.

3. BAZA LIGJORE

- 3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë⁸⁹, ose me çdo shkak tjetër”.
- 3.2. Diskriminimi për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë është shkak, i cili gëzon mbrojtje nga ligji dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit dhe Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.
- 3.3. Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për profesion mbrohet në mënyrë të posaçme në Kreun II të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ndërkohë që neni 16 i ligjit përcakton se: “Dispozitat e kreut II të këtij ligji zbatohen në lidhje me kushtet për pranimin në profesion dhe marrjen e lejeve të ushtrimit të profesionit, sidomos në rastet kur personat janë të vetëpunësuar.”

89 Grupi i farmacistëve në moshë pensioni dhe që janë të punësuar si drejtues teknikë.

- 3.4. Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.
- 3.5. Kriteret dhe detyrat që duhet të plotësojë drejtuesi teknik i tregtuesit farmaceutik me shumicë përcaktohen sipas ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në RSH” në nenin 29 të të cilit përcaktohet se: “1. Drejtuesi teknik i tregtuesit farmaceutik me shumicë është çdo shtetas i RSH ose i huaj, që plotëson kërkesat e mëposhtme: a) zotëron diplomë universitare të Fakultetit të Farmacisë....., b) ka një përvojë pune prej dy vjetësh në shërbimin farmaceutik, c) është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve. 2. Drejtuesi teknik i tregtuesit farmaceutik është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë teknike dhe profesionale që zhvillon tregtuesi me shumicë. 3. Tregtuesi me shumicë ushtron veprimtarinë vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar”.
- 3.6. Gjithashtu, në nenin 40 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “1. Drejtues teknik i farmacisë është çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë ose i huaj, që plotëson kërkesat e mëposhtme: a) zotëron diplomë universitare të Fakultetit të Farmacisë..... b) ka një përvojë pune prej tre vjetësh në farmaci, c) është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve, ç) drejtuesi teknik i farmacisë e ushtron këtë rol vetëm për një farmaci. 2. Farmacia lejohet ta ushtrojë veprimtarinë vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar. 3. Drejtuesi teknik i farmacisë është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë teknike dhe profesionale që zhvillohet në farmaci.”
- 3.7. Në nenin 5 të ligjit Nr.10171, datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: “1. Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë janë profesioni i: a) mjekut; b) stomatologut; c) farmacistit,”, ndërsa në nenin 6 të këtij ligji përcaktohet se: “1. Të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar e ka çdo person, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj ose në ligje të tjera, të veçanta. 2. Profesioni ushtrohet si person fizik ose juridik, me cilësinë e të vetëpunësuarit ose të të punësuarit, sipas kërkesave të përcaktuara nga UP-ja përkatëse.”
- 3.8. Në nenin 16, të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve, përcaktohet se: “Farmacistët në pension që nuk ushtrojnë profesionin, njihen si anëtarë të Urdhrit pa qenë të detyruar të paguajnë Kuotizacionin e Anëtarësisë. Kur ata punësohen ose vetëpunësohen detyrohen të paguajnë edhe kuotizacionin e Urdhrit. Farmacistët që nuk ushtrojnë profesionin, sepse vuajnë nga një sëmundje invalidizuese, që nuk pajtohet me kushtet që kërkon ushtrimi i profesionit dhe/ose e bën ushtrimin e profesionit të rrezikshëm për popullatën, mbeten anëtarë të Urdhrit si pensionistët.”
- 3.9. Neni 19, i Statutit të Urdhrit të Farmacistëve (pa ndryshimet që hyjnë në fuqi në datën 01.07.2015), përcakton:
- “Leja e Ushtrimit të Profesionit është individuale dhe jepet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit. Me Leje Ushtrimi Profesionit pajiset çdo farmacist i anëtarësuar në Urdhër dhe çdo ndihmës farmacist i regjistruar në Regjistrin e Veçantë të ndihmës farmacistëve. Leja e Ushtrimit të Profesionit bëhet e pavlefshme kur farmacistit apo ndihmës farmacistit i është ndërprerë anëtarësimi apo regjistrimi. Për të marrë Lejen e Ushtrimit të Profesionit çdo farmacist duhet të paraqesë pranë Zyrës Qendrore të Urdhrit, Çertifikatën e Anëtarësimit dhe një fotografi, kurse çdo ndihmës farmacist Çertifikatën e Regjistrimit dhe një fotografi. Modelet e Lejeve përcaktohen dhe miratohen me vendim nga Këshilli Kombëtar”

3.10. Në ndryshimet që i janë bërë nenit 19 të Statutit të Urdhrit të Farmacistit në mbledhjen e datës 29.05.2015 ndër të tjera është miratuar ndryshimi dhe është shtuar paragrafi:

“Çdo anëtar i Urdhrit të Farmacistëve mund të aplikojë për të qenë drejtues teknik nëse plotëson parakushtet e vendosura në Ligjin “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik” si dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

- *Të jetë anëtar aktiv vetëm i Urdhrit të Farmacistëve.*
- *Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore sipas parashikimeve të nenit 18 pika d) dhe e) të ligjit 9150 “Për Urdhrin e Farmacistëve” brenda një periudhë 3 vjeçare.*
- *Të mos vuajë nga probleme shëndetësore që e bëjnë të pa mundur ushtrimin e profesionit.*
- *Të punojë me kohë të plotë vetëm në farmacinë për të cilën aplikon si drejtues teknik.*
- **Të mos ketë mbushur moshën për pension, përjashtuar rastet e të vetëpunësuarve.**
- *Të plotësojë dispozitat e Kodit të Punës për sa i përket prezencës së tij në subjektin farmaceutik.*
- *Nuk është duke ushtruar një detyrë tjetër publike e cila përbën konflikt interesi sipas ligjit “Për parandalimin e konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”.*
- *Në Rastet e dy punësimit, për drejtuesin teknik, dy punësimi do të lejohet vetëm brenda qytetit.*

4. OPINION

4.1. Në analizë të legjislacionit të mësipërm nuk rezulton që me ligjet e mësipërme të jetë vendosur një kufizim i tillë, që është vendosur me ndryshimet që i janë bërë Statutit të Urdhrit të Farmacistëve në mbledhjen e datës 29.05.2015. **Pra, duket që kufizimi i vendosur nga Statuti është në tejkalim të legjislacionit, që rregullon ushtrimin e profesionit të farmacistëve.**

4.2. Funksionet që kryen drejtuesi teknik janë të lidhura ngushtësisht me aftësitë profesionale të tyre dhe nuk ndikohen aspak nga statusi “i punësuar” apo “vetëpunësuar”. Ndryshimi i mësipërm në nenin 19 të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve vendos kufizim në të drejtën e grupit të farmacistëve në moshë pensioni që janë të punësuar, duke i përjashtuar nga e drejta për të qenë drejtues teknik i tregtuesit farmaceutik me shumicë apo të një farmacie. **Pra, grupi i farmacistëve që janë në moshë pensioni dhe që janë të “punësuar” trajtohen në mënyrë më pak të favorshme, (duke u përjashtuar nga e drejta për të qenë drejtues teknik), se sa grupi i farmacistëve në moshë pensioni, por që janë të vetëpunësuar, të cilëve ju njihet e drejta për të qenë drejtues teknik.**

4.3. Në shkresën nr. 618, datë 02.09.2015 të dërguar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve ka pranuar trajtimin e pabarabartë të farmacistëve, drejtues teknike në moshë pensioni të cilët nuk janë të vetëpunësuar, por justifikon kriterin e vendosur si të përkohshëm, pasi deklaroi se Këshilli Kombëtar nuk mund të çenojë interesat ekonomikë të subjekteve farmaceutike⁹⁰.

4.4. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve në komunikimin me zyrën e Komisionerit nuk ka arritur të parashtojë shpjegime të arsyeshme në lidhje me domosdoshmërinë e vendosjes së kriterit për trajtimin e pabarabartë të farmacistëve drejtues teknike në moshë pensioni.

⁹⁰ Drejtues teknik në moshë pensioni të vetëpunësuar në bizneset e tyre.

- 4.5. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3, pika 3, parashikon se: “*Diskriminimi i tërthortë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, **kriter** apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.
- 4.6. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kriteri i vendosur nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve në mbledhjen e datës 29.05.2015, i cili përjashton farmacistët në moshë pensioni, të cilët nuk janë të vetëpunësuar, për të ushtruar profesionin si drejtues teknikë përbën diskriminim të tërthortë.

5. VENDIMI

- 5.1. **Konstatimi i diskriminimit të tërthortë** të farmacistëve drejtues teknikë në moshë pensioni, që nuk janë të vetëpunësuar nga vendimi i marrë nga Këshilli Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë në mbledhjen e datës 29.05.2015.
- 5.2. Në referim të pikës 1, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve, rekomandohet që të konstatojë pavlefshmërinë e pjesshme të vendimit të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve, për sa referohet në këtë vendim.
- 5.3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
- 5.4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FORMËN E VIKTIMIZIMIT

Ankesa e V.M, kundër Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Bindjes Politike”.

V E N D I M Nr. 36 / 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. V.M shpjegon se: “Ka qenë e punësuar pranë DSHP Mat që nga muaji Nëntor 2012, me detyrë specialiste finance. Me shkresën nr. 167, datë 20.05.2014 është urdhëruar nga ish Drejtori B.D. për largimin e menjëhershëm politikisht nga puna. V.M. shpjegon se prej gjashtë muajsh ndodhej përballë presionit të titullarit, i cili pa asnjë referencë ligjore, por për motive të pastra politike ka bërë largimin e saj nga puna. Mbështetur në vendimin nr. 140, datë 22.09.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në shkresës nr. 460, datë 04.11.2014 të Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, V.M. është rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, specialiste finance. V.M. sqaron se është paraqitur në punë më datë 12.11.2014 dhe nuk ka marrë në dorëzim detyrën e saj nga ana e punonjësit B.D. Gjithashtu, ankuesja pretendon se nga ana e drejtuesit të institucionit, nuk janë firmosur shkresat e hartuara prej saj, lidhur me pagën neto të kërkuar nga punonjësit. Me shkresën nr. 493 prot., datë 25.11.2014, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, ka njoftuar V.M., për fillimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të justifikuara. Arsyeja e e njoftuar për lagimin nga puna, është dëmi ekonomik i shkaktuar institucionit për sistemin e pagave, konstatuar nga Auditimi i ushtruar nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë. Referuar Raportit të Auditit, V.M. sqaron se ndaj saj nuk është rekomanduar asnjë masë disiplinore, por shlyerja e dëmit ekonomik që ka sjellë ndaj DSHP Mat”.

1.2. Më datën 03.12.2014, me shkresën nr. 1019/1 prot., është bërë njoftimi dhe kërkesa për informacion për Drejtorinë e Shëndetit Publik Mat në lidhje me ankesën për pretendim për diskriminim të V.M.

1.3. Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, me gjithë afatin kohor që kishte në dispozicion, nuk përmbushi kërkesat ligjore për dërgimin e informacionit të plotë të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke dërguar vetëm procedurën e largimit nga puna të V.M.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. V.M është punësuar pranë subjektit, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, me shkresën Vendim-Emërimi, nr. 2, datë 14.11.2012 në detyrën e Shefit të Financës për një periudhë 3-mujore. Me shkresën, Vendim-Emërimi, nr. 1, datë 15.01.2013, V.M është emëruar në një afat të pacaktuar..

2.2 Në asnjë nga rekomandimet e lëna nga ana e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, nuk ishte përcaktuar asnjë detyrim për largimin e punonjësve, të cilët janë gjetur në shkelje.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Bindja politike, është shkak për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me bindjen politike.

3.3. Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

3.4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon në nenin 18/2 se: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, **bindjet politike**, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3.5. Për më tepër ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ndalon diskriminimin e personave në lidhje me të drejtën e tyre për punësim. Kështu në nenin 12, pika 1, përcaktohet se ndalohej diskriminimi për shkak të bindjes politike dhe që ka lidhje me: c) “*trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*”.

4. OPINIONI

4.1. Nga dokumentacioni i dhënë nga ana e ankueses, rezulton se ajo është e vetmja punonjëse e larguar, për shkak të shkeljeve të konstatuara, ndërsa 4 (katër) punonjësit⁹¹ e tjerë vijnë ende të punojnë pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkoi informacion lidhur me veprimet e ndërmarra nga Drejtoria e Shëndetit Publik Mat për punonjësit të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi nga Auditi, por nga ana e këtij institucioni nuk u dërgua asnjë informacion mbi këtë fakt.

4.2. Njohja me veprimtarinë politike të subjektit ankues vërtetohet me anë të dokumenteve të paraqitura nga V.M.

4.3. Punëdhënësi, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat nuk ka sjellë asnjë fakt që të hedhë poshtë pretendimet e subjektit ankues dhe të vërtetojë se trajtimi ndryshe i saj ka ardhur për shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkak të bindjes politike të V.M. Përkundrazi me shkresën nr. 167, datë 20.05.2014, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat urdhëron: “**Largimin e menjëhershëm të V. M politikisht nga Drejtoria e Shëndetit Publik Mat. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë**”.

91 z. Z.D., aktualisht Shef i Epidemiologjisë, pranë DSHP Mat, ndërsa M.L., F.K., z. S.K., në të njëjtin pozicion pune që kanë qënë më parë.

4.4. V.M kishte bërë më parë një ankesë tek KMD, i cili kishte dhënë një vendim diskriminimi kundër Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat. Ligji 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka parashikuar në nenin 3, pika 8 të tij, se: *“trajtimi i disfavorshëm apo pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë është “Viktimizim”.*

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të V.M, nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, për shkak të bindjes politike.

5.2. Në referim të pikës 1, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e V.M në vendin e mëparshëm të punës.

5.3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Drejtori i Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

5.4. Kujtojmë se bazuar në nenin 35 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” çdo person mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e tij por kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e institucionit.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËRMES UDHËZIMIT PËR TË DISKRIMINUAR

Ankesa e paraqitur nga T.B, kundër Zyrës Arsimore Kavajë⁹², Drejtores së Shkollës së Mesme të Bashkuar “11 Shkurti”, Synej, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të bindjeve politike⁹³.

V E N D I M Nr. 168 / 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. T.B shpjegon se: “Ai është me profesion mësues, me një vjetërsi pune prej 24 vitesh. Ai jep lëndën e fizikës, mban titullin “Mësues i Fizikës për shkollat e mesme”, si dhe “Mësues Specialist”. Nga data 15.09.1991 deri më datë 31.10.2000, ka ushtruar profesionin e mësuesit të fizikës në Shkollën e Mesme “Aleksandër Moisiu”, Kavajë. Më pas është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Sporteve në Bashkinë e Kavajës, deri më datë 15.07.2011. T.B është rikthyer në profesionin e mësuesit, duke u emëruar si Drejtor i Shkollës 9-vjeçare Beden, më datë 09.05.2012. Më datë 21.10.2013 është emëruar “Kryemësues” në të njëjtën shkollë. Më datë 02.06.2014 është emëruar mësues në Shkollën e Mesme të Bashkuar “11 Shkurti”, Synej dhe është paguar rregullisht deri më datë 30.09.2014. Nga muaji Tetor 2014 deri në Mars 2015 nuk është paguar nga institucioni, fakt ky i vërtetuar nga transaksionet bankare dhe regjistrat e shkollës. Më datë 01.04.2015 është emëruar si mësues me ngarkesë jo të plotë mësimore, për lëndën e Informatikës, deri në përfundim të vitit shkollor 2014-2015. Subjekti ankues pretendon se diskriminohet për shkak të bindjeve politike, pasi ai është përfaqësues i Partisë Demokratike⁹⁴, si dhe ka qenë drejtues politik në administratën e Bashkisë së Kavajës. Ai kërkon nga Komisioneri, ndalimin e diskriminimit në vendin e punës, respektimin e të drejtave të saj dhe detyrimin e Institucionit (ZA Kavajë) për ndërmarrjen e veprimeve rregulluese për të drejtat e shkelura”.

1.2. Me datë 22.04.2015 u njoftua dhe ju kërkua informacion Zyrës Arsimore Kavajë, Shkollës së Mesme të Bashkuar “11 Shkurti”, si dhe Bordit të kësaj shkolle, duke i vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe duke u kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga T.B. Me shkresën me nr.117, datë 28.04.2015, Drejtoresha e Shkollës së Mesme të Bashkuar “11 Shkurti”, Synej, L.Ç⁹⁵, referuar ankesës së T.B, bën me dije se: “Pretendimet e ankuesit se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike janë të pabazuara, pasi unë personalisht nuk jam anëtare e asnjë partie politike”.

1.3. Me datë 29.05.2015⁹⁶, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim në ambientet e Shkollës së mesme të bashkuar “11 Shkurti”, Synej.

92 Në vijim Zyrës Arsimore Kavajë do t'i referohemi me shkurtesën ZA Kavajë.

93 Referuar shkresës me nr.12 prot., datë 31.03.2015 të PD, dega Kavajë.

94 Referuar Vërtetimit me nr.12 prot., datë 31.03.2015, të PD-së Kavajë.

95 Po kështu, në të njëjtën linjë është edhe mendimi i Bordit të shkollës.

96 Në zbatim të Urdhërit nr.90, datë 27.05.2015, të Komisionerit.

1.4. Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore publike me datë 09.07.2015⁹⁷.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me L.Ç, me pozicion Drejtore e Shkollës. Në rend kronologjik të ngjarjeve, L.Ç thekson se: “...T.B me vendimin nr.8, datë 02.06.2014, është emëruar si mësues zëvendësues, në vend të mësuesit F. Xh., deri në përfundim të procedurave të konkurimit. Ndërkohë, T.Xh., i cili mbante dhe pozicionin e nëndrejtorit në këtë shkollë, i ishte zgjidhur kontrata e punës, nga ana e ZA Kavajë,⁹⁸ me datë 22.05.2014.

2.2. Me shkresën me nr.126 prot., datë 04.07.2014, ZA Kavajë i drejtohet Shkollës së mesme të bashkuar “11 Shkurti” Synej, në të cilën bën rikthimin në punë të T.Xh. Rikthimi në punë bazohej në shkresën me nr.1/481/2 prot., datë 04.07.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në të cilën citohet se pas rivlerësimit të masës disiplinore të dhënë ndaj T.Xh., rekomandohej që atij t’i ndryshohej masa në “Paralajmërim për pushim nga puna”.

2.3. E ndodhur në kushtet kur më duhej të zbatohet Urdhërin e titullares së ZA Kavajë, për rikthimin në vendin e punës së T.Xh, ndërkohë që në vend të tij ishte emëruar z.T.B. dhe vendi ishte i zënë, në tagrin e Drejtores së Shkollës së Mesme të Bashkuar “11 Shkurti” i jam drejtuar ZA Kavajë, duke i kërkuar që më parë të bëhej transferimi i T.B, i cili aktualisht mbulonte vendin e punës të T.Xh. T.B i është bërë pagesa për muajt Korrik-Shtator, pasi i takonte leja vjetore. Lidhur me mospagesat e muajve Tetor-Mars, ai nuk është paguar pasi nuk mund të paguaja dy mësues për të njëjtin vend pune.”

2.4. Me datë 01.04.2015 nga ana e L.Ç i është kërkuar ZA Kavajë që të miratojë emërimin e T.B., si mësues me ngarkesë jo të plotë mësimore, për lëndën e Informatikës, deri në përfundim të vitit shkollor 2014-2015⁹⁹.

2.5. Me Urdhërin nr.79, datë 01.04.2015¹⁰⁰, ZA Kavajë miraton vendimin nr.14, datë 01.04.2015 të Drejtorisë së Shkollës së Mesme të Bashkuar “11 Shkurti”, Synej për emërimin e T.B., si mësues për lëndën e Informatikës, me ngarkesë jo të plotë mësimore, me emërim të përkohshëm deri në përfundim të vitit shkollor 2014-2015.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Neni 3, pika 6 e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon se: “Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim apo kërkesë, bazuar në një marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një apo më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1, të këtij ligji”.

97 Referuar shkresës me nr. 659 Prot., datë 06.07.2015, të Komisionerit.

98 Referuar shkresës me nr.25 prot., datë 22.05.2014, vendim nr.16, datë 22.05.2014.

99 Referuar vendimit nr.14, datë 01.04.2015, të Shkollës së mesme të bashkuar “11 Shkurti”, me nr.101 prot., datë 01.04.2014.

100 Referuar shkresës me nr. 163/1 Prot., datë 01.04.2015, të ZA Kavajë.

3.3. Ligji 10 221/2010 parashikon në nenin 7/1 se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

3.4. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 12, pika 1, të tij parashikon ndalimin e diskriminimit të personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. “Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.

4. OPINION

4.1. Për të vërtetuar se ndaj ankuesit ka një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtores së Shkollës, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹⁰¹ dhe trajtimin të pafavorshëm të ankuesit. Por, sikundër rezulton edhe nga proces-verbalet e mbajtura nga inspektorët e KMD-së, vetë ankuesi është shprehur se drejtoresha e shkollës nuk e ka diskriminuar për shkak të bindjeve të tij politike, por ajo ka shkelur ligjin për emërimin e mësuesve, duke zbatuar urdhërin e ZA Kavajë.

4.2. Në fakt, këtu kemi udhëzim të Drejtores së Shkollës nga Drejtorja e ZA-së Kavajë, për të diskriminuar ankuesin për shkak të bindjeve të tij politike. Neni 3, pika 6 e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon se: “Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim apo kërkesë, bazuar në një marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një apo më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1, të këtij ligji”.

4.3. Nisur nga përmbajtja e shkresës me nr.126 prot., datë 04.07.2014 të ZA Kavajë, drejtuar Drejtorisë së Shkollës, e cila urdhëron rikthimin në punë të z.Xh, duke pasur dijeni që në vend të tij ishte i emëruar T.B., **Komisioneri gjykon se, nga ana e ZA Kavajë kemi shkelje të këtij neni, pasi del qartazi se duke shfrytëzuar hierarkinë ndaj Drejtores së Shkollës, ka urdhëruar për diskriminimin e ankuesit.** Kështu, Drejtorja e Shkollës e ka diskriminuar ankuesin, përmes zbatimit të urdhërit të ZA-së.

4.4. Nga administrimi i provave dhe fakteve të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit dhe hetimit të ankesës, rezulton që, përveç paligjshmërisë së veprimeve nga ana e ZA Kavajë në drejtim të ankuesit, ka dhe një tendencë të qëllimshme për ta ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë. Ankuesi sjell si provë të bindjeve të tij të djathta, një dokument anëtarësimi në PD, ku ka mbajtur dhe pozicione drejtuese të PD-së Kavajë, po kështu dhe prova për angazhimet e tij nëpër aktivitete me natyrë politike, çka vërteton dhe tendencën e ZA Kavajë në veprimet e ndërmarra ndaj T.B.

4.5. Komisioneri konstaton se kemi shkelje, në lidhje me trajtimin e z.T.B. si punëmarrës në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tij gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës nga ana e ZA Kavajë.

4.6. ZA Kavajë në shkelje të ligjit dhe jashtë kompetencave që i përcakton ai apo aktet e nxjerra në zbatim të tij, ka marrë vendime në dëm të ankuesit, duke e diskriminuar atë, për shkak të bindjeve të tij politike.

101 Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit të T.B, për shkak të bindjeve të tij politike, nga ana e ZA Kavajë, përmes udhëzimit të Drejtores së Shkollës së Mesme të Bashkuar “11 Shkurti”, Synej, Kavajë, për të diskriminuar ankuesin.

5.2. Konstatimin e diskriminimit të T.B, nga ana e Drejtores së Shkollës së Mesme të Bashkuar “11 Shkurti”, Synej, përmes zbatimit të urdhërit të ZA Kavajë.

5.3. Në referim të pikës 1, të këtij vendimi, ZA Kavajë dhe Drejtorja e Shkollës së Mesme të Bashkuar “11 Shkurti”, Synej, të marrin masa për emërimin e T.B si mësues definitiv, në përputhje me arsimin përkatës, në profilin Fizikë - Matematikë.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FUSHËN E ARSIMIT

Ankesë e A. P kundër M. P, Drejtor pranë Shkollës së Bashkuar Vau i Dejës, ku pretendohet për diskriminim të djalit të saj M.P., për shkak të aftësisë së kufizuar¹⁰².

V E N D I M N r. 1/ 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. A.P shpjegon se: “M.P., ndjek klasën e tretë pranë Shkollës së Bashkuar Vau i Dejës, por prej 2 javësh nuk ka frekuentuar më mësimin. Nëna e tij, (A.P), e cila është mësuese pranë kësaj shkolle, ka theksuar faktin se shkak për këtë mosfrekuentim, është kërkesa e drejtorit të shkollës për ta larguar djalin e saj nga shkolla, pasi ai përbën problem për fëmijët e tjerë, për shkak se vuan nga autizmi. Ndër të tjera, ankuesja A.P., nëna e M.P., kërkon ndërhyrjen e Komisionerit me qëllim që djalit të saj t’i sigurohet një mësues ndihmës, në bazë të nenit 65, pika 3, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë që ai të fillojë të frekuentojë shkollën”.

1.2. Referuar Urdhërit nr. 942/1, datë 03.11.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, më datën 06.11.2014 ekipi i inspektimit të KMD-së, kreu inspektim pranë Shkollës së Mesme në Vaun e Dejës, Shkodër. Ata u takuan me z. M.P., Drejtor pranë Shkollës së Bashkuar Vau i Dejës dhe znj. K.S., mësuese e nxënësit M.P., të cilët dhanë sqarimet përkatëse lidhur me çështjen e parashtruar në ankesën e znj. A.P.

1.3. Me shkresën nr. 979, datë 12.11.2014, Komisioneri i kërkoi informacion DAR Shkodër, lidhur me masat që kishte marrë për zgjidhjen e çështjes së nxënësit M.P.

1.4. Me datën 19.11.2014, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore, ku palët u ftuan për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre. Përveç palëve të përfshira në këtë proces, në këtë seancë dëgjimore u kërkua edhe prania e përfaqësuesve të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, të cilët e kishin ndihmuar Komisionerin me informacionin e nevojshëm, lidhur me çështjen e M.P., si dhe prania e përfaqësuesve të DAR Shkodër, të cilët nuk u paraqitën.

1.5. Me shkresën nr. 120, dat 20.11.2014, Drejtori i Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër, e njoftoi Komisionerin mbi faktin e krijimit të komisionit të institucionit arsimor të zakonshëm, duke bërë me dije edhe mbi përbërjen e tij.

102 M.P. vuan nga autizmi. Inicialet janë të njëjta me ato të Drejtorit të Shkollës

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. M.P. ndjek klasën e tretë pranë Shkollës së Bashkuar Vau i Dejës dhe sipas sqarimeve të dhëna nga Drejtori iu shkollës, kishte patur disa ankesa nga prindërit e fëmijëve që mësonin në të njëjtën klasë me të. Drejtori i shkollës kishte dërguar dy shkresa pranë DAR Shkodër, ku kërkonte që të siguronin një mësues ndihmës për M.P., por DAR Shkodër nuk i kishte dërguar asnjë përgjigje zyrtare. Drejtori i Shkollës së Bashkuar Vau i Dejës informoi se nga DAR Shkodër u është dërguar një e-mail, në datën 13.10.2014, ku kërkohej numri, mosha, lloji i aftësisë mjeko-ligjore për nxënësit e shkollës. Drejtuesi i shkollës u ka dërguar informacionin përkatës, lidhur me nxënësit me aftësi të kufizuara të Shkollës së Bashkuar Vau i Dejës.

2.2. Sipas sqarimeve të dhëna nga znj. K.S. mësuese e M.P.-së që prej klasës së parë, theksoi se asnjëherë nuk kishte ndjekur ndonjë program të specializuar mësimor për fëmijë me aftësi të kufizuara si rasti i nxënësit M.P., por kishte përdorur programin e zakonshëm që zbatohet për nxënësit e tjerë. Ajo theksoi faktin se M.P. asnjëherë nuk kishte patur përparim të njëjtë në mësim, sikurse nxënësit e tjerë të klasës, por këtë vit shkollor që kishte filluar të ndiqte klasën e tretë, në ndryshim me dy vitet paraardhës, kishte bërë regres për sa i përket përparimit të tij të zakonshëm në mësim. Ai shfaqte problematika të tilla si: klithmat gjatë orës së mësimi, goditja e bankës me duar, tërheqja e vëmendjes së nxënësve të tjerë, si dhe nuk komunikonte me të tjerët as më fjalë dhe as nëpërmjet syve. Ndër të tjera, ajo shtoi se sjellja dhe ecuria në mësimet e M.P.-së kishte qënë më e mirë, vitin e kaluar kur ai ndiqte klasën e dytë, pasi gjatë orëve të mësimi ai asistohet dhe rrinte në të njëjtën bankë me psikologun e shkollës. Tashmë, kjo e fundit kishte marrë lejen e barrë lindjes dhe ishte zëvendësuar nga një psikolog tjetër. Sipas saj, prindërit ankues nuk kanë kërkuar asnjëherë largimin e tij nga shkolla, por vetëm caktimin e një mësuesi ndihmës për të gjatë orëve të mësimi.

2.3. Me shkresën nr. 120, dat 20.11.2014, Drejtori i Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër, e njoftoi Komisionerin mbi faktin e krijimit të komisionit të institucionit arsimor të zakonshëm, duke bërë me dije edhe mbi përbërjen e tij.

2.4. Nga hetimet e kryera, rezultoi se pranë Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës, Shkodër nuk ishte ngritur një komision, si detyrim ligjor i njësisë arsimore vendore apo DAR-it, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore shqiptare. Ky legjislacion u ngarkon detyra të rëndësishme njësive arsimore vendore (DAR/ZA) dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara.

3.2. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëjloj si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t'i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme. Nën këtë frymë konsiston edhe përmbajtja e nenit 63, pika 2 e ligjit nr. Nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, ku parashikohet: *“Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme.*

Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore”.

3.3. Gjithashtu, referuar parashikimit të nenit 65, pika 3, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen edhe mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit, kjo për t’u siguruar një kujdes akoma edhe më të veçantë, si dhe për të ndihmuar në mbarëvajtjen e tyre në shkollë.

3.4. Neni 65, pika 2, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” parashikon: *“Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënës të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës”.* Pra ngritja e një komisioni të tillë është detyrim konkret për drejtuesit e institucioneve arsimore të zakonshme.

3.5. Urdhëri nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar” është një akt nënligjor që merr përsipër të parashikojë më hollësisht procedurat dhe të përcaktojë detyrat konkrete që u ngarkohen njësive arsimore vendore dhe institucioneve arsimore, lidhur me trajtimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.

3.6. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

3.7. Neni 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet se: *“Masa e përkohshme, e veçantë që synon përsheptimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”.*

4. OPINION

4.1. Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore shqiptare. Ky legjislacion u ngarkon detyra të rëndësishme njësive arsimore vendore (DAR/ZA) dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëllë si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t’i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme.

4.2. Për të përcaktuar saktësisht, nëse një fëmijë me aftësi të kufizuara, duhet të ndjekë një institucion arsimor të specializuar apo një shkollë të zakonshme të arsimit bazë, neni 64, pika 3 i ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”¹⁰³, përcakton si detyrim ligjor të njësive

¹⁰³ Neni 64, pika 3, i ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” parashikon: *“Njësia arsimore vendore krijon një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të*

arsimore vendore apo DAR-it, të krijojë një komision të përbërë nga: mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.

4.3. Nga hetimet e kryera, rezultoi se pranë Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës, Shkodër nuk ishte ngritur një komision i tillë, as nga drejtori aktual, z. M.P, i cili e mban këtë pozicion prej pak kohësh dhe as nga drejtuesi paraardhës i këtij institucioni arsimor. Gjatë shqyrtimit të çështjes u konstatua, se një gjë e tillë kishte ndodhur për shkak të mosnjohjes së legjislacionit përkatës në fushën e arsimit. Komisioni, i cili duhej ngritur pranë Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës, Shkodër, sikurse parashikohet në pikën 2, të këtij neni, duhet ta kryente punën e tij, bazuar në vlerësimin e komisionit pranë DAR Shkodër, i cili gjithashtu nuk ishte krijuar ende.

4.4. Nga parashikimet e detajuara të nenit 93, të Urdhërit nr. 343, datë 19.08.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave, DAR Shkodër ka patur detyrime tepër të rëndësishme, lidhur me asistencën dhe kujdesin ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara, që mësojnë në institucionet arsimore të qytetit të Shkodrës. Nga trajtimi i rastit të nxënësit autik M.P, rezulton se deri në momentin e paraqitjes së ankesës së nënës së tij pranë Komisionerit, ky institucion nuk ka ndërmarrë asnjë hap për zbatimin e parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura. Në të njëjtën kohë, është për t'u mbajtur qëndrim edhe lidhur me mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga ana e Komisionerit dhe mosparaqitjes së përfaqësuesve të tyre në seancën dëgjimore të kryer nga KMD, fakt që rëndon pozitën e DAR Shkodër kundrejt rastit konkret të M.P-së, por edhe përkundrejt nxënësve të tjerë me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër apo edhe më gjerë.

4.5. Së dyti, në nenin 96, pika 2, gërma b) të Urdhrit "Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar", parashikohet si detyrë e drejtuesit të institucionit arsimor të zakonshëm të nxisë vullnetarizmin në lehtësimin dhe përmirësimin e jetës së nxënësve me AK në mjediset e institucionit arsimor. Në interpretim të këtij neni, ka qenë detyrë e z. P të ndërhyjë në situatën konkrete të krijuar nga ankesat e prindërve të nxënësve, që ishin në një klasë me M.P, dhe jo e nënës së këtij nxënësi. Drejtori i institucionit arsimor, edhe kur s'ka asistencë nga DAR, duhet të marrë përsipër detyrimet e tij ligjore, duke zgjidhur situata të tilla.

4.6. Në nenin 19, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" ¹⁰⁴ parashikohen hollësisht detyrat e drejtuesit të institucionit arsimor. Nga trajtimi i rastit të nxënësit autik M.P, rezulton se deri në momentin e paraqitjes së ankesës së nënës së tij pranë Komisionerit, ky institucion nuk ka ndërmarrë asnjë hap për zbatimin e parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura. Në të njëjtën kohë, është për t'u mbajtur qëndrim edhe lidhur me mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga ana e Komisionerit dhe mosparaqitjes së përfaqësuesve të tyre në seancën dëgjimore të kryer nga KMD, fakt që rëndon pozitën e DAR Shkodër kundrejt rastit konkret të Mateo Prendit, por

kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar".

104 Neni 19, shprehimisht thotë: «Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Masat që merren, ndër të tjera, janë:

- a) rritja e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda institucionit, ndër të tjera duke afishuar ligjin në një vend të dukshëm;
- b) lufta kundër modeleve të sjelljes diskriminuese që përbëjnë ose nxisin diskriminim brenda institucionit;
- c) të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dëgjimit;
- d) trajtimi efektiv i ankesave për diskriminim në institucion, duke shqyrtuar çdo ankim brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij;
- e) vendosja e masave disiplinore ndaj çdo personi që verifikohet të ketë kryer një veprim diskriminues kur një gjë e tillë është e përshtatshme, proporcionale dhe në përputhje me kompetencat e drejtorit".

edhe përkundrejt nxënësve të tjerë me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër apo edhe më gjerë.

4.7. Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Këto masa duheshin marrë menjëherë për t'i ardhur në ndihmë nxënësit M.P.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të nxënësit M.P., nga ana e DAR Shkodër dhe Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër.

5.2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, Komisioneri kërkon marrjen e masave të menjëherëshme nga ana e DAR Shkodër, për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit përkatës, në ndihmë të nxënësit M. P, si dhe të të gjithë nxënësve me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër.

5.3. Marrjen e masave të menjëherëshme për bashkëpunim, ndërmjet DAR Shkodër dhe Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës, Shkodër, lidhur me funksionimin e Komisioneve përkatëse të ngritura pranë secilit institucion.

5.4. Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, Komisioneri kërkon marrjen e masave të menjëherëshme nga ana e DAR Shkodër, për caktimin e një mësuesi ndihmës, nxënësit M. P, si dhe dhënien e vlerësimit përkatës Komisionit të ngritur pranë Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër, për përgatitjen e programit edukativ individual për këtë nxënë.

5.5. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme nga ana e drejtuesit të Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër, për njohjen e të gjithë mësuesve dhe nxënësve të kësaj shkolle, me Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe një kopje e këtij ligjit të afishohet në ambientet e brendshme të shkollës.

5.6. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, DAR Shkodër dhe Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

5.7. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FUSHËN E ARSIMIT

“Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”, informon Komisionerin, se nga verifikimet e bëra prej tyre në terren, janë evidentuar disa probleme dhe vonesa në procesin e shpërndarjes së teksteve falas për komunitetin rom dhe egjiptian në Gjirokastrë.

V E N D I M Nr. 160 /2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në nenin 32, pika 1, germa c), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe bazuar në Urdhërin nr.146, datë 25.09.2015 ¹⁰⁵, filloi procedurën e shqyrtimit kryesisht të çështjes.

1.2. “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”, informon Komisionerin, se nga verifikimet e bëra prej tyre në terren, janë evidentuar disa probleme dhe vonesa në procesin e shpërndarjes së teksteve falas për komunitetin rom dhe egjiptian. Në këto kushte, procesi i shpërndarjes së teksteve ka patur probleme në të gjitha shkollat e rrethit të Gjirokastrës, ku ndjekin procesin mësimor fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, pasi deri në fillim të muajt Tetor 2015 ata nuk ishin të pajisur me tekste shkollore.

1.3. Me shkresën nr.828/1 prot, datë 01.10.2015 u njoftua dhe ju kërkua informacion Drejtorisë Arsimore Rajonale, Gjirokastrë, duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, si dhe duke i kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga Shoqata “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”.

1.4. Komisioneri u kërkua të sqaroheshin arsyet e mos sigurimit në kohë të teksteve falas, për fëmijët e komunitetit rom, egjiptian dhe atyre me probleme social-ekonomike, informacion mbi procedurën e ndjekur për shpërndarjen e teksteve falas, mbi numrin e fëmijëve të pa pajisur ende me tekste shkollore.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Me anë të shkresës me nr.3143 Prot., datë 05.10.2015, znj.L.R, Drejtore e Drejtorisë Arsimore Rajonale Gjirakastër¹⁰⁶, bën me dije se:

“...1. Në lidhje me mosigurimin në kohë të teksteve, këto vonesa kanë ardhur si pasojë e dërgimit me vonesë nga shtëpitë botuese si dhe për arsye të rregjistrimit me vonesë të këtyre nxënësve. Fëmijët të cilët duhet të pajisen me tekste falas për rrethin tonë janë rreth 62 fëmijë të komunitetit rom dhe 126 fëmijë të komunitetit egjiptian. Fëmijë të cilët nuk janë pajisur me tekste falas nuk ka, përveç rasteve kur kanë munguar një apo dy tekste për të gjithë klasën.

Procedura e ndjekur për shpërndarjen e teksteve falas është kryer në mbështetje të VKM-së nr.707, datë 26.08.2015, pika 6.10 dhe VKM-së nr.107, datë 10.02.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, pika 6.4”.

¹⁰⁵ Urdhër nr.146, datë 25.09.2015 “Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio” të çështjes së shpërndarjes së librave falas për vitin shollor 2015-2016, për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, në shkollat 9-vjeçare në rrethin e Gjirokastrës.

¹⁰⁶ Në vijim Drejtorisë Arsimore Rajonale Gjirokastrë, do t'i referohemi me shkurtesën DAR Gjirokastrë.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, **racën, ngjyrën, etninë**, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Diskriminimi për shkak të racës, ngjyrës, etnisë përbën shkak të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, i cili parashikon se: “...“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

3.3. Në bazë të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti.

3.4. VKM-ja nr.107, datë 10.02.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, në pikën 6.4 të tij përcakton se: “...për tekstet shkollore të nxënësve të pakicave kombëtare, nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes do të mbulohet në masën 100 për qind nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

3.5. VKM-ja nr.707, datë 26.08.2015¹⁰⁷, në pikën 6.10 të tij përcakton se: “Për tekstet shkollore të fëmijëve egjiptianë nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100 për qind nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës egjiptianë duhet të dorëzojnë në njësitë arsimore vendore, DAR/ZA përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit”.

3.6. Në këtë kuadër, neni 18, i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “Detyrat e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrit të Arsimit dhe Sportit” , në pikën 2, germa c) parashikon se:

“2. Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Sportit, ndër të tjera, marrin secili masa për: ...c) arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuar, si dhe të personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji.”

3.7. Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

3.8. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3, pika 3, parashikon se: “ “ Diskriminimi i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi,

107 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.107, datë 10.02.2010, të Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.

ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.”.

4. OPINION

4.1. Nga korrespondenca¹⁰⁸ e mbajtur mes Komisionerit dhe përfaqësueses së Observatorit znj.E.T, si dhe ekspertës së Observatorit në Gjirokastrë, rezulton që nga verifikimet e tyre në terren, si dhe nga takimet me kryetarin e komunitetit rom dhe prindër të komunitetit egjiptian, të gjithë fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, tashmë janë të pajisur me tekste falas. Nga puna e tyre në terren konfirmohet se viti shkollor vijon normalisht.

4.2. Ekziston një legjislacion dhe akte nënligjore, politika dhe strategji, ku parashikohen detyrime për të gjithë institucionet e përfshira në procesin e arsimimit. Pra, sikundër rezulton, është mirëpërcatuar që kjo kategori nxënësish duhet pajisur me tekste shkollore falas. Nxënësit që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, kanë qenë dhe janë në fokus të vëmendjes së Komisionerit.

4.3. Nisur nga dinamika e ngjarjeve, si dhe nga informacionet e marra nga DAR Gjirokastrë, përfaqësues të “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”, dhe prindër të komuniteti rom e egjiptian, rezultoi që kjo situatë pas ndërhyrjes së Komisionerit është zgjidhur, pasi procesi mësimor vijon të zhvillohet normalisht dhe nxënësit janë pajisur me tekste shkollore falas. Situata e mos pajisjes në kohë me tekste shkollore për nxënësit e arsimit parauniversitar, në rrethin e Gjirokastrës, kryesisht për kategorinë e nxënësve rom dhe egjiptianë, ka ardhur si rezultat i dërgimit të tyre me vonesë nga shtëpitë botuese.

4.4. Komisioneri, konstaton se kjo kategori përfituesish të teksteve shkollore falas, për shkak të vonesave të shkaktuara nga shtëpitë botuese përkatëse, janë vënë në pozita jo të favorshme krahasuar me kategorinë e nxënësve që i kanë blerë testet shkollore, duke iu mohuar atyre mundësinë për të filluar një vit shkollor normal, pa hasur në vonesa burokratike.

4.5. Duke marrë shkas nga zhvillimet e deritanishme lidhur me këtë proces, por dhe nga eksperiencia e vitit të kaluar, rekomandojmë ndjekjen dhe monitorimin me prioritet të gjithë procesit për pajisjen me tekste shkollore falas, për kategoritë e fëmijëve romë dhe egjiptianë, për të parandaluar në këtë mënyrë krijimin e situatave diskriminuese për këto kategori nxënësish, të cilët do të gjendeshin në pamundësi për t’u pajisur me testet shkollore, si dhe për të mundësuar një ecuri normale të procesit mësimor, pa vonesa të tilla.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë, të kategorisë së nxënësve romë dhe egjiptianë, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar dhe që përfitojnë të pajisen me tekste shkollore falas, për shkak të dërgimit me vonesë të tyre pranë shkollave të arsimit 9-vjeçar, të rrethit të Gjirokastrës.

5.2. Ndërprerjen e procedurës hetimore, për shkak se pas ndërhyrjes së Komisionerit, situata është zgjidhur në favor të kategorisë së nxënësve romë dhe egjiptianë.

5.3. DAR Gjirokastrë dhe Drejtoritë e shkollave të arsimit 9-vjeçar të rrethit të Gjirokastrës, në bashkëpunim me shtëpitë botuese përkatëse, të marrin masa që për vitin e ardhshëm akademik, pajisja me tekste falas për kategorinë e nxënësve romë dhe egjiptianë, të bëhet në kohë, duke shmangur çdo vonesë të mundshme që ndikon në fillimin dhe ecurinë normale të procesit mësimor.

¹⁰⁸ Komisioneri ka mbajtur korrespondencë në vijimsi me përfaqësues të Shoqatës “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve në adresat: e.kica@observator.org.al, director@observator.org.al, gjirokastra@observator.org.al.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FUSHËN E PUNËSIMIT, NË ARSIMIN E LARTË UNIVERSITAR

Ankesë e z. V.M dhe z. A.H, kundër Universitetit Bujqësor të Tiranës, ku pretendohet për diskriminim.

V E N D I M NR.130/ 2014

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Ankuesit V.M. dhe A.H., pedagogë në Universitetin Bujqësor të Tiranës shpjegojnë se: “Nëpërmjet Vendimit nr. 4, datë 29.01.2014, të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, janë pezulluar për një vit nga pjesëmarrja në Komisionet e Provimeve në lëndët e tyre, në të gjitha nivelet e studimeve dhe për të dy drejtimet e studimeve (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme). Shkak për marrjen e tij janë bërë kryesisht ankesat e studentëve për një periudhë kohe të gjatë, ndërkohë që ankuesit theksojnë se për ta nuk janë depozituar ankesa të tilla në Departamentin përkatës, si dhe të gjitha arsyet e përmendura në vendim janë të pabazuara. Sipas tyre, masa e marrë nga Këshilli i Fakultetit është e padrejtë, pasi një masë e tillë nuk parashikohet, as në Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës, as në Rregulloren e UBT-së apo Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Pyjore. Ankuesit theksojnë faktin se kanë dorëzuar ankesë zyrtare në Rektorat, në datën 31.01.2014, por nuk kanë marrë ende një përgjigje. Ata pretendojnë se kanë zbatuar me përpikmëri aktet ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura dhe për ta nuk ka patur ankesa nga studentët. Bashkëlidhur ankesës, ndër të tjera¹⁰⁹, pedagogët dorëzuan pranë KMD-së edhe një deklaratë të z. E.T, me detyrë Përgjegjës i Departamentit të Pyjeve, ku ky i fundit deklaroi se nga periudha shkurt 2008 e deri në datën 10.02.2014, nuk ka patur ankesa nga ndonjë student për rikorrigjim të provimeve në lëndët që zhvillon Prof. Dr. V.M”.

1.2. Komisioneri iu drejtua z.V.T., Dekan dhe Kryetar i Këshillit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, të Universitetit Bujqësor të Tiranës, me shkresën nr. 301/1, datë 18.03.2014, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen në fjalë.

1.3. Me shkresën nr. 43, datë 26.03.2014¹¹⁰, z. V.T në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me ankesën e dy pedagogëve.

1.4. Në zbatim të Urdhërit Nr. 55, datë 08.04.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u realizua inspektimi pranë Fakultetit të Shkencave Pyjore pranë UBT-së.

1.5. Për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së dy pedagogëve të Fakultetit të Shkencave Pyjore pranë UBT-së, Komisioneri vendosi të realizojë një seancë dëgjimore, ku palët ishin të ftuara të merrnin pjesë, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre. Seanca dëgjimore,

¹⁰⁹ Bashkëlidhur ankesës, dy pedagogët kanë dorëzuar një sërë aktesh, të tilla si kopje të Vendimit nr. 4, datë 29.01.2014, të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, Deklaratë e Z. E.T., Përgjegjës i Departamentit të Pyjeve, ankesa drejtuar Rektorit të UBT-së, Z. F.H., Urdhëri nr. 1, datë 18.02.2014, i Dekanit të Fakultetit të Shkencave Pyjore pranë UBT-së etj.

¹¹⁰ Shkresa në fjalë është protokolluar pranë KMD-së me nr. 301/2, datë 26.03.2014.

që ishte vendosur të kryhej në datën 30.04.2014, nuk u realizua si pasojë e angazhimeve të punës së Dekanit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, prandaj ajo u shty për në datën 14.05.2014. Në këtë seancë, morën pjesë në debat (jo në cilësinë e palëve) z. L.P., Zv/Dekani i Fakultetit të Shkencave Pyjore dhe z. E.T., Përgjegjës i Departamentit të Pyjeve, të cilët mbështetën tezën e Dekanit të Fakultetit.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Nëpërmjet Vendimit nr. 4, datë 29.01.2014 të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, pedagogët V.M. dhe A.H. janë pezulluar për një vit, nga pjesëmarrja në Komisionet e Provimeve në lëndët e tyre, në të gjitha nivelet e studimeve dhe për të dy drejtimet e studimeve (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme). Vendimi i marrë nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Pyjore, ishte një vendim kolegjial, ku nga 14 anëtarë të pranishëm në mbledhje, 10 prej tyre votuan pro vendimit, 2 anëtarë dolën kundër vendimit dhe dy të tjerë abstenuan. Objekti i vendimit ishte parandalimi i konfliktit të ashpër ndërmjet pedagogëve V.M dhe A.H, me studentët e fakultetit, të cilët janë ankuar për vlerësimet në provime të këtyre pedagogëve, si dhe kalueshmëria e ulët e studentëve në provime. Pedagogë janë lejuar vetëm të vazhdojnë procesin mësimor sipas orarit dhe në fund të tij do t'i dorëzojnë komisionit përkatës të lëndës, regjistrin mbi pjesëmarrjen e studentëve, ndërsa vendimi për futjen ose jo të tyre në provim, do të merret nga komisioni përkatës, pasi të kryejë verifikimin e regjistrit.

2.2. Në shkresën nr. 287, datë 12.03.2014 të Rektorit të Universitetit, z. F.H, përcaktohet se masa disiplinore e dhënë nga Këshilli i Fakultetit duhet të zgjasë deri në fund të vitit akademik 2013-2014 dhe për sezonin e vjeshtës e në vazhdim, pedagogët duhet të përfshiheshin në komisionet e provimit.

2.3. Gjatë procesit të hetimit, nga biseda e zhvilluar me zv/dekanët e këtij fakultetit: z. V.T, z. L.P., z. H.Th., dhe me z. E.T., Përgjegjës i Departamentit të Pyjeve, rezultoi se ankesat e studentëve përgjithësisht nuk kishin qenë zyrtare, pra ankesat nuk ishin paraqitur me shkrim, por me gojë dhe të padokumentuara zyrtarisht pranë Fakultetit. Nga inspektimi i kryer nga inspektorët e KMD, rezulton se masa disiplinore e marrë nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Pyjore ndaj pedagogëve A. H dhe V. M, është mbështetur në fakte që nuk dokumentohen. Ankesat e studentëve nuk janë zyrtare dhe të dokumentuara¹¹¹, fakt që pranohet edhe nga drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Pyjore, pranë UBT-së. Si të tilla, ato nuk mund të përbëjnë provë konkrete kundër pedagogëve A.H. dhe V.M.

2.4. Pedagogët V. M dhe A. H janë pezulluar për një vit, nga pjesëmarrja në Komisionet e Provimeve në lëndët e tyre, në të gjitha nivelet e studimeve dhe për të dy drejtimet e studimeve (me kohë të plotë dhe

111 Përveç ankesave të XH.M., D.V. dhe G.B. Ankesa e këtij të fundit nuk është marrë parasysh nga Përgjegjësi i Departamentit të Pyjeve, për shkak se ankesa ishte bërë jashtë afateve kohore të parashkuara në Rregulloren e Fakultetit. Bashkëlidhur shkresës nr. 43, datë 26.03.2014, të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, drejtuar KMD-së, ishin dërguar edhe këto kopje ankesash :

-Fotokopje e ankesës të studentëve të viteve III, IV & V të Fakultetit të Inxhinierisë Pyjore, kundër pedagogut A.H. Në bazë të analizimit të anës formale që iu krye kësaj ankese u konstatua se mungonin identitetet (emer, mbiemër) dhe nënshkrimet e ankuesve apo përfaqësuesve të tyre, ankesa ishte e pa protokolluar dhe nuk kishte datë. Në mungesë të këtyre elementeve, kjo ankesë u konsiderua e pavlefshme si provë kundër profesor A.H.

-Fotokopje e ankesës të dy studentëve të MSc, të vitit akademik 2012-2013, ku nuk evidentohet data e dërgimit të ankesës. Gjithashtu, rezulton se ankesës i mungon numri dhe data e protokollimit.

-Fotokopje e ankesës së një grupi studentësh të vitit akademik 2003 e në vazhdim, drejtuar Rektorit të UBT-së, z. F.H të cilët ankohen ndaj profesor A.H. lidhur për vlerësimin e tyre në provimin e lëndës Teknologji e Shfrytëzimit Pyjor. Kjo ankesë është e protokolluar nga Rektori dhe mban nr. 1454, datë 01.10.2012, por në fund të saj mungojnë identitetet (emer, mbiemër) dhe nënshkrimet e ankuesve apo përfaqësuesve të tyre.

-Fotokopje e ankesës së një grupi studentësh të vitit akademik 2003 e në vazhdim, kundër pedagogut A.H drejtuar z. H.TH., Dekan i Fakultetit të Pyjeve. U konstatua se ankesës i mungon numri dhe data e protokollit, ndërkohë që evidentohen emrat e ankuesve (A.B, O.L, N.B, E.P dhe N.GJ) dhe nënshkrimet e tyre, në fund të saj.

me kohë të pjesëshme), nëpërmjet Vendimit nr. 4, datë 29.01.2014, të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, për disa shkaqe të cilat janë cituar në këtë vendim, ndërkohë që atyre nuk iu është dhënë e drejta për t'u dëgjuar dhe për të parashtruar observacionet e tyre, lidhur me shkaqet e pezullimit të tyre.

2.5. Masa disiplinore e marrë nga Këshilli i Profesorëve ndaj pedagogëve V. M dhe A. H, duke i pezulluar për një vit, nga pjesëmarrja në Komisionet e Provimeve në lëndët e tyre, nuk parashikohet si masë disiplinore për stafin mësimor nga Rregullorja e Studimeve Universitare.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Ligji 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", neni 3/1 parashikon: *"Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

3.2. Në nenin 7, pika 1, e ligjit nr.10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", parashikohet: *"Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim".*

3.3. Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *"Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, Komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër".*

3.4. Neni 12/1, i ligjit 10 221/2010 parashikon: *"Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:*

- a) shpalljen e vendeve të lira të punës;*
- b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;*
- c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;*
- ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi".*

3.5. Lidhur me detyrimet e punëvënësit, ligjvënësi është shprehur qartë në nenin 13/1 të ligjit 10 221/2010: *"Punëdhënësi është i detyruar: a) të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloji diskriminimi; b) të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dijenisë; c) t'u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre. 2. Punëdhënësi detyrohet të rrisë ndërgjegjësimin për këtë ligj edhe duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tij me mjetet e veta ose me ndihmën e subjekteve të specializuara".*

3.6. Ligji 10 221/2010 ka parashikuar në nenin 15, të drejtat e punëmarrësit, shprehimisht: *"Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në*

gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit. 2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës. 3. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit. 4. Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t'u mbrojtur nga diskriminimi. Punëmarrësi kthen pagën e marrë, sipas këtij neni, në rast se diskriminimi i pretenduar nuk rezulton i vërtetuar me vendim të formës së prerë”.

3.7. Ligj Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

3.8. Neni 90, gërma j) e Rregullores së Studimeve Universitare të Universitetit Bujqësor të Tiranës, parashikon: “Detyrat e stafit akademik dhe atij ndihmësmësimor janë: j) Të respektojnë gjatë gjithë veprimtarisë së tyre parimet e etikës qytetare, duke shfaqur një figurë morale të papajtueshme me veset e këqija. Figura e pedagogut duhet të shërbejë për studentët si shembull i ndershmërisë, larpamjes etj. Pedagogu mban përgjegjësi për shkeljen e rregullave të shkollës. Shkelje të rregullave të shkollës konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e pedagogut që çenojnë personalitetin e studentëve apo të punonjësve të tjerë të Universitetit, normat etiko-morale të mjedist universitar apo shoqërisë. Ndaj pedagogut që kryen veprime të tilla do të merren këto masa disiplinore: Vërejtje me shkrim; Paralajmërim për pushim nga puna; Përfundim nga puna”.

3.9. Neni 50, pika b) dhe c) e Rregullores së sipërpërmendur, shprehimisht thotë: “b. Komisioni i provimit të një discipline përbëhet nga jo më pak se dy vetë, nga të cilët njëri duhet të jetë pedagogu i disiplinës. c). Nëse titullari i disiplinës apo anëtar i tjetër për arsye madhore nuk mund të marrin pjesë në provim, përgjegjësi i departamentit cakton me shkrim pedagogun që do t'i zëvendësojë”.

4. OPINION

4.1. Masa disiplinore e marrë nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Pyjore ndaj pedagogëve A.H. dhe V.M. është mbështetur në fakte që nuk dokumentohen. Ankesat e studentëve nuk janë zyrtare dhe të dokumentuara, fakt që pranohet edhe nga drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Pyjore, pranë UBT-së. Si të tilla, ato nuk mund të përbëjnë provë konkrete kundër pedagogëve.

4.2. Drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Pyjore kanë përmendur dhe theksuar faktin e qindra ankesave gojore të studentëve, për sa i përket vlerësimit të pedagogëve, por nga sa u konstatua gjatë inspektimit, për verifikimin e këtyre ankesave nuk janë ngritur grupe rivlerësimi, përveç rasteve të paraqitura nga vetë pedagogët, ku vlerësimi i kryer nga grupi i rivlerësimit është pothuajse i njëjtë me atë të pedagogëve.

4.3. Fakt tjetër i përdorur kundër dy pedagogëve, në Vendimin nr. 4, datë 29.01.2014 të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Pyjore është edhe kalueshmëria e ulët e studentëve në lëndët e tyre, ndërkohë që nuk rezulton të jetë parashikuar në asnjë akt ligjor apo nënligjor, mbi bazën e të cilëve funksionon Fakulteti i Shkencave Pyjore, pranë UBT-së, ku kriteri i kalueshmërisë së studentëve të përdoret si kriter penalizues ndaj pedagogut. Kështu, rezulton se masa disiplinore e marrë nga Këshilli i këtij Fakulteti është mbështetur në një kriter të paparashikuar në akte ligjore apo nënligjore.

4.4. Masa disiplinore e marrë nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Pyjore ndaj pedagogëve A.H. dhe V.M. është diskriminuese, pasi bën dallim ndërmjet anëtarëve të komisioneve të provimit. Referuar neni 50, gërma b), të Rregullores së Studimeve Universitare, të UBT-së, komisionet e provimit përbëhen nga jo më pak se dy anëtarë, njëri prej të cilëve është pedagogu i lëndës. Masa për të pezulluar për një vit, nga

pjesëmarrja në Komisionet e Provimeve në lëndët e tyre, është marrë vetëm për dy pedagogët ankues dhe jo për pedagogët e tjerë, që kanë qenë anëtarë në këto komisione provimi, kanë dhënë vlerësimin e tyre për studentët dhe mbajnë përgjegjësinë e tyre në këtë proces.

4.5. Pedagogëve iu është mohuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për të parashtruar observacionet e tyre, lidhur me masën e marrë ndaj tyre.

4.6. Mbështetur në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", rezulton se ndaj pedagogëve V.M. dhe A.H. janë ndërmarrë veprime, që kanë krijuar baza për mohimin e barazisë së tyre, si dhe janë ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë, kur ata janë ndodhur në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit të pedagogëve V. M dhe A. H, nga ana e Këshillit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, nëpërmjet Vendimit nr. 4, datë 29.01.2014.

5.2. Referuar pikës 1, të këtij Vendimi dhe duke patur parasysh faktin, që në momentin e marrjes së Vendimit të KMD-së, efektet e Vendimit nr. 4, datë 29.01.2014, të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Pyjore kanë përfunduar, kërkojmë të merren masa për afishimin e Vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga dita e marrjes dijeni për të, deri në datën 20 nëntor 2014, në ambientet e Fakultetit të Shkencave Pyjore, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës.

5.3. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme nga ana e Këshillit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, pranë UBT-së, që veprime të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen.

5.4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Fakulteti i Shkencave Pyjore, pranë UBT-së, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

5.5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FUSHËN E PUNËSIMIT

Ankesa e N.H, e cila pretendon se është diskriminuar për shkak të “bindjeve politike”, nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Berat (DRSKSH).

V E N D I M Nr. 119/ 2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. N.H shpjegon se: “Ka punuar në DRFSKSH-në Berat, prej 15 vitesh, në pozicione të ndryshme pune. Marrëdhëniet e punës në këtë institucion, kanë nisur në vitin 1999 dhe kanë vazhduar pa ndërprerje, deri më datë 31.01.2014. Nga viti 1999 deri në vitin 2002, ka punuar si ekonomiste pranë DRSKSH-së Berat. Më pas, në vitet 2002-2006, ka ushtruar detyrën e Shefes së Sektorit të Statistikës në këtë institucion. Në vitin 2006, është emëruar në detyrën Zv/Drejtores së DRSKSH-së Berat, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 23.10.2013. Me anë të urdhërit nr. 189, datë 23.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH-së, është liruar nga detyra e Zv/Drejtorit dhe është emëruar si specialiste ekonomiste në Sektorin Spitalor në DRSKSH-në, Berat. Ajo ka mbajtur këtë detyrë deri më datë 31.01.2014, kur me anë të urdhërit nr. 1, datë 31.01.2014 të Drejtorit të këtij institucioni K.M., i është zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontrata e punës dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare. N.H në ankesën e saj pretendon se, për shkak të qënies pjesë e listës emërore të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike, për Qarkun e Beratit, në zgjedhjet e kaluara, është pushuar nga puna që mbante në DRSKSH-në Berat”.

1.2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me datë 17.04.2014, z.K.M, Drejtor i DRSKSH Berat, ku i kërkohej informacion mbi çështjen e parashtruar nga N.H.

1.3. Me datë 28.05.2014 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor Berat.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Më datë 23.10.2013 Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH me urdhërin nr. 189 të po kësaj date, ka vendosur kalimin e N.H.-së nga pozicioni i punës së zv/Drejtores së DRSKSH-së Berat, në specialist ekonomiste në Sektorin Spitalor në po këtë drejtori. Me zbatimin e këtij urdhëri është ngarkuar Drejtoria e Burimeve Njerëzore e FSDKSH-Tiranë dhe DRSKSH-së Berat. Duke u bazuar në urdhërin e sipërpërmendur të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH-së, Drejtori i DRSKSH-së Berat, I.D. me vendim nr. 129/1 prot., datë 25.10.2013 ka vendosur emërimin e N.H.-së specialiste ekonomiste në Sektorin Spitalor të DRSKSH-së Berat”.

2.2. Lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së N.H.-së, DRSKSH Berat, sqaroi se: “Më datë 24.01.2014, jemi njohur me urdhërin nr. 53, datë 22.01.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH-së,

ku në pikën 1 të tij thuhej: “Në strukturën e DRFSDKSH-së Berat, Sektori Spitalor të pakësohet me një specialist ekonomist”. Sektori Spitalor deri më datën 24.01.2014, kur është protokolluar në DRSKSH-së Berat urdhëri i Drejtorit të FSDKSH, përbëhej nga: K.T. (Përgjegjëse e Sektorit Spitalor. Me profesion ekonomiste); N.H (specialiste ekonomiste), si dhe pozicioni specialist mjek. Në cilësinë e Drejtorit të DRSKSH-së Berat, në bazë të ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, vendosa: *Zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës me punëmarrësen N.H, me detyrë ekonomiste e Sektorit Spitalor të DRSKSH-së Berat*. Më datë 28.01.2014 me shkresën nr. 59/2 prot., kam urdhëruar fillimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës në respektim të nenit 141 të Kodit të Punës. Me shkresën nr. 59/3 prot., datë 28.01.2014, N.H është njoftuar të paraqitet në datën 31.01.2014, ora 12:00, për tu informuar në lidhje me arsyet e zgjidhjes së kontratës së punës me punëdhënësin, kjo bazuar në nenin 144 të Kodit të Punës.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Diskriminimi për shkak të bindjeve politike është shkak i mbrojtur nga neni 1 dhe neni 3/1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet se: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

3.2. Në Kapitullin II të Rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës për Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, në të cilin përshkruhen kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencia e punës, parashikohet se Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Spitalor, duhet të plotësojë disa kritere.

3.3. Neni 141 i Kodit të Punës duhet të interpretohet në lidhje me nenin 146 të këtij Kodi. Sipas nenit 141: *“Kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra pale dhe ka përfunduar afati i njoftimit”*. Neni 146 pika 1/c, parashikon se: 1) ***Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur: c. bëhet për motive të pandashme nga personaliteti i punëmarrësit, por që nuk kanë lidhje legjitime me raportet e punës.*** Konsiderohen si motive të tilla raca, ngjyra, seksi, mosha, gjendja civile, detyrimet familjare, shtatzënia, besimi fetar, **bindjet politike**, kombësia, gjendja shoqërore”.

3.4. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3, pika 2, parashikon se: *“Diskriminimi i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”*.

3.5. Në nenin 3, pika 3, ligji përcakton se: *“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.*

3.6. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashtrohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash,*

ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

3.7. Mbrojtja nga diskriminimi në punësim trajtohet në një kapitull të veçantë të ligjit dhe pikërisht në kapitullin e dytë. Në nenin 12, pika 1, germa “c”, parashikohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: (c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*

3.8. Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

4. OPINION

4.1. Në analizë të fakteve dhe provave të administruara, konstatohet se ndryshimi i strukturës së DRSKSH-së Berat, në të dy rastet kur në të janë bërë shkurtime përkatëse, ndryshimet kanë prekur vetëm pozicionet e punës që ka mbajtur ankuesja. Gjithashtu referuar provave¹¹² të vëna në dispozicion nga ana e FSDKSH-së, konstatohet se shkurtime të pozicionit të punës së Zv/Drejtorit të Drejtorive Rajonale ka patur vetëm DRSKSH Berat dhe asnjë drejtori tjetër e rretheve. Ndërsa për pozicionet specialistë vihet re se ka patur edhe në drejtoritë rajonale të tjera por pa përcaktuar pozicionet specifike të cilat do të shkurtoheshin.

4.2. DRSKSH Berat edhe pse kishte si alternativë zgjedhje, në respektim të strukturës të emërojë N.H. në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimit Spitalor, duke qënë se plotësonte të gjitha kriteret e kërkuara në Rregulloren “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës për Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, emëroi K.T., e cila nuk plotësonte kriteret për të mbajtur këtë pozicion pune.

4.3. Referuar dokumentacionit të depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminim dhe në Vendimin nr. 340, datë 11.05.2013, i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Demokratike për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013”, rezulton që ankuesja ka qënë pjesë e listës emërore të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike, për Qarkun e Beratit. Në këto kushte, ankuesja në mbështetje të pretendimit të saj për diskriminim për shkak të bindjes politike, ka sjellë fakte dhe prova për të vërtetuar provuar bindjet politike.

4.4 Bazuar në këto rrethana, krijohet bindja e plotë se nuk ekziston një shkak tjetër për largimin e ankuses nga puna, konstatohet diskriminim i tërthortë për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga FSDKSH-së dhe DRSKSH-së Berat, për shkak të bindjes politike të tij.

4.5 Përsa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka bindjen se veprimet e ndërmarra nga ana e FSDKSH-së dhe DRSKSH-së Berat, janë bërë në mënyrë të qëllimshme dhe tendencioze me synimin përfundimtar të largimit të ankuesit nga puna.

¹¹² Urdhër nr. 190, datë 23.10.2013 i FSDKSH, Urdhëri nr. 53, datë 22.01.2014

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të ankueses N.H., për shkak të bindjeve politike, nga punëdhënësi Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor Berat.

5.2. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë, të N.H, për shkak të bindjeve politike, nga punëdhënësi Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

5.3. Detyrimin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor Berat, të kthejë në një mënyrë të menjëhershme në pozicionin e mëparshëm të punës N.H.

5.4. Detyrimin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor Berat, të informojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve Komisionerin lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 33, pika 11 e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

ÇËSHITJE DISKRIMINIMI NË FUSHËN E PUNËSIMIT

Ankesa e paraqitur nga V.K., me objekt pretendimin diskriminimi “për shkak të bindjeve politike”, nga ana e subjektit OSHEE sh.a

VENDIM Nr. 54/2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga V.K., me objekt pretendimin për diskriminim “për shkak të bindjeve politike”, nga ana e subjektit OSHEE sh.a.¹¹³. Ankuesi V.K., nga muaji Maj 2006 deri në muajin Maj 2010 ka punuar në pozicionin e punës Shef i Zyrës Juridike, pranë Drejtorisë Zonale Burrel (Cez). Nga muaji Maj 2010 e në vijim ka punuar si Specialist pranë Drejtorisë Ligjore Cez Shpërndarje Tiranë, sot emërtuar si OSHEE sh.a. Me datë 05.11.2014, është bërë njoftimi për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme nga ana e OSHEE sh.a. Ankuesi nuk ka marrë dijeni për këtë fakt, deri më datë 20.11.2014, kur i është bërë njoftim verbal nga Shefi i Shërbimeve, se ka vendim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe i është kërkuar të largohej nga vendi i punës pa iu dhënë ende komunikimi i vendimit për largim nga puna. Vendimi i largimit të V.K daton në 20.11.2014, ndërkohë që ai ka qenë me Raport-mjekësor. Nga ana e Drejtorisë Ligjore i është kërkuar me e-maili, dorëzimi i dosjeve që ai kishte në proces.

1.2. Me shkresën Nr. 1015/1 prot, datë 09.12.2014 u njoftua dhe ju kërkuar informacion subjektit OSHEE sh.a., duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe duke i kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga ankuesi. Duke mos patur një përgjigje zyrtare në afatet e përcaktuara nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me datë 29.01.2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim në ambjentet e OSHEE sh.a. Tiranë. Inspektorët e KMD-së u takuan me Drejtorin e Departamentit të Burimeve Njerëzore, pranë OSHEE sh.a, Tiranë dhe Specialisten e kësaj Drejtorie. Ata theksuan faktin se V.K. është larguar nga puna me motivacionin “mosprezencë e pajustificuar në punë, për më shumë se 3 (tre) ditë dhe pa vënë në dijeni eprorët e tij”. Përfaqësuesit e OSHEE sh.a. kërkuar kohë për të verifikuar dokumentacionin që kishte dorëzuar ankuesi pranë KMD.

1.3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, me datë 26.02.2015, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore, në të cilën u paraqitën të gjitha palët. Gjatë seancës, V.K. theksoi se, është larguar nga puna për shkak se është anëtar i PD-së, jo për mosprezencë në punë. Ai ka depozituar dokumente që vërtetojnë se për ditët e pretenduara mosprezencë në punë, ka përfaqësuar OSHEE në seanca gjyqësore. Ai pretendon se në vend të tij është emëruar një person që nuk përmbush kriteret. Përfaqësuesja e OSHEE sh.a, shprehet se ankuesi është larguar për mosprezencë në vendin e punës për tre ditë rresht, verifikuar nga Listë prezencë e muajit Tetor 2014. Lidhur me faktin e verifikimit të procesverbaleve për pjesëmarrje të tij në seanca gjyqësore në datat e cituara, kërkoi një afat kohor për të kthyer një përgjigje shkresore.

¹¹³ Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a Tiranë.

1.4. Nga aktet shkresore të vëna në dispozicion nga ana e OSHEE sh.a, gjatë inspektimit, rezulton se procedura e ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës është si poshtëcituat:

- a) Me shkresën me nr. 2095 prot., datë 16.10.2014, të Drejtorisë Rajonale Burrel, është bërë propozimi për largimin nga puna të V.K. Motivacioni i cituar në shkresë është: “Për thyerje të disiplinës në punë, mosparaqitje në vendin e punës pa shkaqe të arsyeshme dhe pa vënë në dijeni eprorin e drejtpërdrejtë gjatë muajit Tetor 2014 dhe konkretisht në datat 3,6,7 dhe 8, çka evidentohet me Listëprezencën e Drejtorisë Rajonale...”
- b) Me shkresën me nr. 2724/2 prot., datë 21.10.2014, Drejtoria Rajonale Burrel është autorizuar nga Administratori i OSHEE sh.a, të ndjekë procedurat ligjore për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës, për V.K.
- c) Me shkresën me nr. 2724/3 prot., datë 21.10.2014, Administratori i OSHEE sh.a autorizon E.O, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në OSHEE sh.a të njoftojë punëmarrësin V.K me detyrë Specialist pranë Drejtorisë Rajonale Burrel/Dega e Shërbimeve Mbështetëse, për fillimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.
- d) Me shkresën me nr. 2724/4 prot., datë 05.11.2014 V.K. i është komunikuar njoftimi për zgjidhje të marrëdhënieve të punës, në mënyrë të menjëhershme. Bashkëngjitur është edhe Listëprezenca e muajit Tetor 2014 për V.K, e cila për datat e cituara ka shënimin M.¹¹⁴ Subjekti ankues ka depozituar pranë Komisionerit Raportet Mjekësore¹¹⁵ të cilat faktojnë pretendimin se procedura për largimin nga puna është bërë në kundërshtim me zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për shkak të gjendjes shëndetësore.

1.5. Ankuesi ngre pretendimin se nga ana e punëdhënësit nuk i janë rimbursuar shpenzimet vetjake për ditët kur ai ka përdorur automjetin personal për të lëvizur kur është dërguar me shërbim jashtë vendit të punës, për të përfaqësuar Institucionin në çështjet gjyqësore në gjykatat e rretheve: Kukës, Dibër, Kurbin, Lezhë, Shkodër e Tiranë, ndërkohë që punonjësve të tjerë u janë paguar Urdhër-shërbimet dhe orët jashtë orarit. Po ashtu, atij i është mohuar nga ana e punëdhënësit e drejta për të marrë pushimet vjetore të vitit 2014, ndërkohë që punonjësve të tjerë u është dhënë kjo leje. Edhe njoftimi për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, është bërë në periudhën që ankuesi ka qenë me Raport mjekësor, pra në kohë të papërshtatshme për punëmarrësin.

1.6. Ankuesi kërkon nga ana e Komisionerit që në zbatim të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të rekomandojë rikthimin në punë pranë OSHEE sh.a Tiranë, si masë rregulluese për diskriminimin e bërë ndaj tij.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. V.K. ka qenë punonjës pranë OSHEE sh.a për më shumë se 8 (tetë) vite, nga viti 2006 deri më datë 20.11.2014.¹¹⁶ Sikundër vërtetohet nga shkresa me nr. 2724/4 prot., datë 05.11.2014, V.K i është komunikuar njoftimi për zgjidhje të marrëdhënieve të punës, në mënyrë të menjëhershme në periudhën kur ai ishte me Raport Mjekësor. (Referuar verifikimit të raporteve mjekësore të ankuesit, të cilat fillojnë me datë 22.10.2014 – 05.11.2014).

¹¹⁴ Në Listëprezencën e muajit Tetor 2014, Kodi M respektivisht i korrespondon mungesës në punë.

¹¹⁵ a) Raport Mjekësor nr. Regj.680, nga data 22.10 deri më datë 05.11.2014. (katërmëdhjetë ditë).

b) Raport Mjekësor nr. Regj 204, me datë 05.11.2014 deri më datë 20.11.2014 (pesëmbëdhjetë ditë).

c) Raport Mjekësor me nr. Regj 211, me datë 20.11.2014 deri më datë 28.11.2014 (tetë ditë).

¹¹⁶ Me shkresën me nr. 2724/6 prot., datë 20.11.2014 OSHEE sha. Ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me V.K.

2.2. Motivi zyrtar i largimit nga puna ka qenë mosprezenca në punë.

2.3. Lidhur me datat e pretenduara për mosprezencë të ankuesit në punë si dhe referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, rezulton: kopje e vendimit nr. 916, datë 17.04.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër, të tërhequr nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me datë 03.10.2014, e firmosur dhe vulosur nga kancelari i kësaj gjykate. Po kështu, ka qenë prezent në një mbledhje me administratën në Burrel, pasi është kthyer nga Kukësi, brenda po kësaj dite. Referuar procesverbalit të mbledhjes; - kopje e procesverbalit të datës 06.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, ku V.K. ka qenë përfaqësues i OSHEE sh.a; - kopje e vendimit nr. 3148, datë 18.09.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, të tërhequr nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me datë 07.10.2014, nga ana e V.K. si përfaqësues i OSHEE sh.a, e firmosur dhe vulosur nga kancelari i kësaj gjykate; - kopje e vendimit nr. 2813, datë 25.06.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, të tërhequr nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me datë 08.10.2014, nga ana e V.K. si përfaqësues i OSHEE sh.a, e firmosur dhe vulosur nga kancelari i kësaj gjykate.

Nga ana tjetër, OSHEE sh.a, ka marrë dijeni për paraqitjen e këtyre dokumenteve nga ana e subjektit ankues¹¹⁷ dhe ka kërkuar që t'i lihej një kopje e këtyre dokumenteve si dhe një afat i arsyeshëm kohor, për të bërë verifikimet e nevojshme pranë Gjykatave respektive, lidhur me vërtetësinë e tyre.

2.4. Ankuesi shprehet se nuk i është lejuar të bëjë dorëzimin e dosjeve që kishte në proces dhe bazës materiale dhe as është ngritur një komision për marrjen e tyre në dorëzim. Megjithatë ka kërkuar t'i vihet në dispozicion një kopje e praktikës së ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës, nuk i është dhënë asnjë shkresë. V.K. citon se nga ana e titullarit është dhënë udhëzim për diskriminimin e tij, pasi që në muajin Tetor 2013, me ardhjen e Administratorit të ri, ai është transferuar nga Drejtoria Ligjore Tiranë, në Drejtorinë Rajonale Burrel, pa shkresë, por vetëm gojarisht. Që nga periudha që është transferuar në Burrel, ai pretendon se është ushtruar presion në mënyrë të vazhdueshme nga ana e titullarit të Drejtorisë Rajonale Burrel që të jepte dorëheqjen nga puna. Ai mendon se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me punonjësit e tjerë, pasi atij i janë hequr dosjet dhe shfuqizuar autorizime të përfaqësimit të tij në çështjet gjyqësore për Rajonin e Veriut, duke ua kaluar personave të tjerë që nuk janë të kualifikuar për këto përfaqësime. E gjitha kjo, shprehet ankuesi, ka ardhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai është anëtar i PD-së. V.K., citon se: “Punëdhënësi ka bërë dallime, kufizime dhe përjashtime, që për mua kanë të bëjnë me trajtimin e pabarabartë të punonjësve në vendin e punës, ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit dhe mjedisin e punës, procedimin disiplinor dhe me zgjidhjen e kontratës së punës”.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Në nenin 7 të ligjit nr. 10 221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

117 Referuar procesverbalit të mbajtur nga inspektorët e KMD-së në ambjentet e OSHEE sh.a, Tiranë me datë 29.01.2014.

3.3. Në nenin 12, pika 1, germa b) parashikon: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

3.4. Neni 3, pika 1 i po këtij ligji, shpreh se: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

4. OPINIONI

4.1. Referuar Manualit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në pikën 12.4 “Monitorimi i mungesave”, germa c) dhe e) të tij përcaktohet se: “c)...çdo mungesë në punë duhet të justifikohet me shkrim ose me gojë tek drejtuesi përkatës brenda 24 (njëzetekatër) orëve, në të kundërt mungesa do të konsiderohet e pajustificueshme, dhe ndaj punonjësit do të merret masë disiplinore deri edhe “Largim nga puna”, duke e konsideruar si shkelje të rëndë të disiplinës në punë”, “e)...**Çdo drejtues, kur pas verifikimit konstaton se mungesat janë të pajustificuara**, krahas njoftimit për ndalesat përkatëse në pagë, është i detyruar të paraqesë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore propozimin e tij për masën disiplinore “Largim nga puna” që do të merret ndaj punonjësit, i cili mungon 3(tre) ditë rresht pa arsye”. Rezulton se kjo masë disiplinore ndaj V.K., nuk i është komunikuar atij si punëmarrës, në mënyrë që ai të kishte mundësi për ta kundërshtuar atë, por është vijuar më tej duke marrë vendimin për zgjidhjen e kontratës bazuar në këtë masë disiplinore të dhënë ndaj tij.

4.2. Manuali i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në pikën 12.4 “Monitorimi i mungesave”, germa d) të tij përcakton se: “Në fund të çdo muaji, për të gjitha mungesat, pavarësisht nga arsyeja dhe kohëzgjatja e tyre, Drejtori i Departamentit/ Drejtorisë/ Drejtorisë Rajonale/ Drejtorisë së Tensionit të Lartë bën justifikimet e nevojshme dhe evidencën përkatëse së bashku me raportet mjekësore, ia paraqet punonjësit të Burimeve Njerëzore, përgjegjës për pagat, për llogaritjen e ndalesave të nevojshme në pagën e punonjësit”. Rezulton se Listëprezenca e bërë me datë 16.10.2014, është në kundërshtim me Manualin e miratuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Pra, propozimi nga ana e drejtorit duhet të ishte bërë në muajin Nëntor kur dërgohet listëprezenca për muajin Tetor dhe jo më datë 16.10.2014. Për më tepër, nuk ka asnjë procesverbal ku të jetë konstatuar se për datat respektive: 03,06,07,08, Tetor të ketë patur kontroll të ushtruar për verifikimin e prezencës në punë të V.K. Profili i tij i punës si jurist kërkon që ai të jetë edhe jashtë zyre, pasi përfaqëson Institucionin nëpër procese të ndryshme gjyqësore dhe kjo lëvizje bëhet sipas Planit të lëvizjes, dërguar në Drejtorinë Ligjore dhe tërheqjen e akteve, vendimeve, sipas urdhërave të dhëna nga kjo Drejtori.

Ankuesi për shkak se me datë 17.10.2014 do përfaqësonte OSHEE sh.a në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës (vërtetuar nga procesverbali i depozituar në dosjen personale të ankuesit pranë KMD-së), më datë 16.10.2014 ka qenë në zyrën e Shefit të Shërbimeve për t’i kërkuar ti vihet në dispozicion automjeti i punës dhe nuk është vënë në dijeni nga ky i fundit lidhur me faktin e konstatimit të 3 (tre) mungesave rresht pa arsye, megjithëse po atë ditë ishte bërë edhe propozimi për largimin e tij nga puna.

4.3. Komisioneri, konstaton si të pavërtetë motivacionin e cituar në shkresën e largimit nga

puna, për mosprezencë në vendin e punës për më shumë se 3 (tre) ditë rresht. Kjo vërtetohet nga dokumentacioni i dorëzuar nga ankuesi. Përfaqësuesit e OSHEE nuk sollën argumente apo dokumentacion që të hidhnin poshtë pretendimet e ankuesit, gjë që krijon bindjen se nga ana e OSHEE sh.a nuk ka argumente për të kundërshtuar këto pretendime.

4.4. Lidhur me pretendimin për mospagesën e shërbimeve, nga ana e OSHEE sh.a: Nga verifikimi i bërë dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, rezulton se V.K i është kthyer përgjigje me anë të e-mailit, lidhur me faktin se përse nuk janë paguar këto shërbime. Sikundër bëhet me dije nga shkresa, arsyeja e mospagesës së shërbimeve për V.K gjatë vitit 2014, vjen si arsye e dokumentacionit jo të saktë. Pika 13.2.1, germa g) e Manualit të Burimeve Njerëzore, citon se: “...Kur mjetet e kompanisë nuk janë funksionale do të përdoren mjetet private, vetëm me autorizim të lëshuar nga Drejtori Rajonal/Tensionit të lartë, me dijeni dhe konfirmim të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe miratim të Departamentit të Administrimit të Përgjithshëm”. Referuar kësaj pike, asnjë shërbim i kryer me makinë private nuk paguhet, përveç rasteve kur është miratuar nga Administratori. V.K shërbimet i ka kryer me makinë private dhe pa autorizimin e Administratorit për të përdorur mjetin e tij privat. Nga shkresa, bëhet me dije se, shërbimet paguhën nëse ato verifikohen me GPS apo kanë bashkëngjitur bileta të vlefshme të transportit publik që verifikojnë të dhënat tek urdhër-shërbimi dhe km e bëra. Ankuesi nuk solli dokumentacion që të provojë se ka patur një autorizim nga Administratori për përdorim të mjetit privat, dhe që të mos jetë paguar nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse pranë OSHEE sh.a. apo që të vërtetojë pretendimin që personave të tjerë që kanë përdorur mjetet private, pa autorizimin përkatës, t’i jenë paguar shërbimet e punës.

4.5. Sa i takon pretendimit të ankuesit se i është mohuar e drejta e lejes së zakonshme, rezulton se për muajin Gusht 2014, V.K. i është dhënë leje e zakonshme, 14 ditë, vërtetuar nga kopja e Fletëpagesës së tij për muajin Gusht 2014. Ditët e mbetura të këtij viti, i ka marrë në formën e shpërblimit, në muajin Nëntor që është larguar, vërtetuar nga kopja e Listë- pagesës së këtij muaji.

4.6. Sa i takon praktikës së ndjekur nga ana e OSHEE sh.a për rekrutimin e punonjësit të ri, për pozicionin e punës që mbante V.K.: Ankuesi pretendon se personi që e ka zëvendësuar atë, nuk plotëson kriteret e kërkuara për pozicionin e punës si Jurist pranë Drejtorisë Rajonale Burrel/Dega e Shërbimeve Mbështetëse. ***Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës, Komisioneri, konstaton se:***

- A) V.K. ka një eksperiencë punë rreth 9 vjeçare pranë OSHEE sh.a dhe ka kualifikimin e kërkuar për pozicionin e punës që mbante pranë këtij Institucioni ¹¹⁸. Po ashtu, nga ana e punëdhënësit nuk ka asnjë vlerësim negativ për performancën e subjektit ankues. Referuar kopjes së Formularit për Performancën e Punonjësve, vënë në dispozicion nga ana e OSHEE sh.a. V.K ka marrë vlerësimet: Mirë dhe Shumë mirë.
- B) Nga ana tjetër, nga verifikimi i procedurës së rekrutimit të E.A, konstatohet se ai:
 - a) Ka marrë diplomën “Bachelor në Drejtësi”, me dt.20.09.2012, nga Fakulteti i Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës.
 - b) Vërtetohet se ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve, “Master i Shkencave Penale” në sistemin me kohë të plotë, dhe është diplomuar më datë 22.07.2014. ¹¹⁹
 - c) Me shkresën datë 27.12.2014, E. A ka filluar marrëdhëniet e punës me OSHEE sh.a, në pozicionin e juristit, pranë Drejtorisë Rajonale Burrel/Dega e Shërbimeve Mbështetëse.

118 Referuar dokumenteve të depozituara në Dosjen personale të ankuesit pranë KMD-së

119 Vërtetim i datës 17.09.2014 i Fakultetit të Drejtësisë, Universitetit të Tiranës.

Një ndër kriteret e kërkuara për pozicionin e punës si Specialist Jurist në Drejtorinë Rajonale, është që kandidati për këtë vend pune të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet.¹²⁰ Nisur nga viti i diplomimit të E.A. dhe deklarimi i eksperiencës profesionale¹²¹, rezulton që në momentin e lidhjes së marrëdhënieve të punës mes tij dhe OSHEE sh.a ai nuk plotëson kriterin e eksperiencës në punë (mbi 3 vjet). Pra, është larguar nga puna personi që plotësonte kriteret e kërkuara dhe është emëruar ***një tjetër pa kriteret përkatëse.***

4.7. Komisioneri gjykon se ankuesi ka dhënë argumente të mjaftueshme ku mbështet pretendimet e tij, pra shkak për të gjitha pasojat e ardhura nga këto shkelje janë bërë bindjet politike të V.K. Për të vërtetuar bindjet e djathta politike, ankuesi ka depozituar: -kopje të Librezës së Anëtarësisë në PD, lëshuar më datë 20.06.2002; - kopje të Listës së anëtarëve të PD-së, dega Mat, Seksioni Suç, të Q.V 1027, firmosur nga kryetari i PD-së, dega Mat. V.K. mban numrin rendor 23 në këtë listë. Punëdhënësi nuk ka sjellë asnjë fakt që të hedhë poshtë pretendimet e ankuesit lidhur me faktimin e prezencës së tij në punë për ditët e pretenduara nga OSHEE sh.a dhe të vërtetoje se trajtimi ndryshe i tij ka ardhur për shkaqe të arsyeshme.

1. OSHEE sh.a ka sjellë si arsye të largimit, mosprezencën në punë, për më shumë se 3 ditë, ndërkohë që V.K. ka depozituar procesverbale që vërtetojnë pjesëmarrjen e tij në gjykatë, për datat respektive.
2. OSHEE sh.a nuk ka sjellë asnjë argument përse është larguar V.K., duke u zëvendësuar me një person që nuk plotëson kriteret e shpallura (mbi eksperiencën në punë) dhe nuk ka kualifikimet e personit që është larguar nga puna.

4.8. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues për mosvënie në dispozicion të procedurës së ndjekur nga ana e OSHEE sh.a për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, nga verifikimet e bëra dhe dokumentacioni që posedon Komisioneri, rezulton që:

- Nga ana e Shërbimit Postar Tiranë është regjistruar shkresa me nr. 2724/4, datë 05.11.2014 e OSHEE sh.a, (Njoftimi për zgjidhje të marrëdhënieve të punës, në mënyrë të menjëhershme), e cila i është dorëzuar znj. B.F.¹²² më datë 14.11.2014, në adresën: fshati Kurdari, Burrel.
- E njëjta procedurë është përsëritur edhe për shkresën me nr. 2724/6, datë 20.11.2014 të OSHEE sh.a (Njoftim për zgjidhjen përfundimtare të marrëdhënieve të punës), e cila është dorëzuar me datë 24.11.2014, po të njëjtit person, në të njëjtën adresë.
- Kjo është adresa e shënuar në Kontratën Individuale të V.K.¹²³ megjithëse ai pretendon se ka ndërruar adresë dhe OSHEE sh.a ka dijeni nga verifikimi që i ka bërë Kontratës së furnizimit me energji elektrike, në banesën që ai jeton aktualisht.
- Ankuesit i është komunikuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës, me datë 20.11.2014, me anë të një e-maili nga ana e Shërbimit të Shërbimit, por nuk i janë komunikuar as njoftimi, as zgjidhja e kontratës.

¹²⁰ Referuar Formularit të aplikimit për pozicionin e punës si Jurist, shpallur nga OSHEE sh.a, një kopje e të cilit është e plotësuar nga z. E.A. dhe ndodhet në dosjen personale të tij, në D.B.NJ pranë OSHEE sh.a.

¹²¹ Referuar Formularit "Aplikim për vend të lirë pune" të plotësuar nga z. Abazi.

¹²² Znj. B.F. është kunata e V.K. dhe ajo ka firmosur që ka marrë në dorëzim letrën.

¹²³ E verifikuar në Kontratën Individuale të nënshkruar më datë datës 26.11.2009.

5. VENDIMI

5.1. Në bazë të nenit 32, germa “c”, si dhe nenit 33, pikat 10, 11 dhe 12, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi ***konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë*** për shkak të bindjeve politike, në fushën e punësimit të V.K, nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Tiranë.

5.2. Në referim të pikës 1, OSHEE sh.a., si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, ndaj V.K., të bëjë rikthimin e tij në vendin e punës.

5.3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, OSHEE sh.a të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.

5.4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FUSHËN E TË MIRAVE DHE SHËRBIMEVE

Çështje ex-officio, iniciuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi bazën e publikimeve të bëra në media që kanë të bëjnë me denoncimin e kryer nga T.J., lidhur me dhunën e ushtruar mbi vajzën e tij me aftësi të kufizuara, 17-vjeçare, Xh. J., ndërkohë që është përcjellë nga Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës, drejt Shkollës Speciale të Fëmijëve, Durrës.

VENDIM Nr. 8 / 2014

1. PROÇEDURA E NDJEKUR

1.1. Mbështetur në publikimet e bëra në median e shkruar¹²⁴, që kanë të bëjnë me denoncimin e kryer nga T.J., lidhur me dhunën e ushtruar mbi vajzën e tij me aftësi të kufizuara, 17 vjeçare, Xh.J., ndërkohë që është përcjellë nga Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës, drejt Shkollës Speciale të Fëmijëve, Durrës, referuar shkresës nr. 511/1, datë 16.10.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe në zbatim të Urdhërit nr. 92, datë 29.10.2013 *“Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio” të çështjes së nxënësës së Shkollës Speciale të Fëmijëve, Durrës”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka iniciuar hetimin e çështjes së Xh.J. dhe në datën 16.10.2013, ka kryer inspektim pranë Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës.

1.2. Në takimin e realizuar me Drejtoreshën dhe Përgjegjësen e Sektorit të Shërbimit Social të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës, Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkoi informacion të hollësishëm, jo vetëm mbi incidentin e ndodhur ndaj vajzës 17 vjeçare, me aftësi të kufizuara, Xh.J., mbi të cilën është ushtruar dhunë fizike, por edhe lidhur me mënyrën e trajtimit të fëmijëve të tjerë në këtë Qendër, mbi stafin, i cili kujdeset për fëmijët e strehuar në të, bashkëpunimin me Shkollën Speciale etj.

2. FAKTET E KONSTATUARA

2.1. Xh.J., vajza e dhunuar, banonte në Qendër prej 2 muaj e gjysëm, por qëndrimi i saj kishte qenë me shpëputje. Sipas Drejtoreshës, Xh.J. ishte fëmijë e qetë dhe aspak problematike. Sipas saj, një mbrëmje para ditës, kur u konstatuan shenjat e dhunës mbi të miturën, kjo e fundit nuk ishte ndier mirë (kishte patur kollë) dhe ishte njoftuar mjeku për ta vizituar. Të nesërmen, rreth orën 8:20-8:25, vajza ishte shoqëruar nga financierja dhe shoferi i Qendrës me furgon drejt Shkollës Speciale të Fëmijëve.

2.2. Rreth orës 10:00, përgjegjësjë e sektorit të shërbimit social ishte njoftuar, se Xh. ishte rrëzuar nga shkallët në shkollë. Vajza kishte patur të çara në kokë dhe gërvishtje në trup. Për këtë arsye, Xh. ishte dërguar menjëherë nga Shkolla Speciale në spital. Më pas, në Qendër ishin paraqitur të afërmit e vajzës, të cilët kishin qenë tepër të shqetësuar. Aktualisht, vajza banon në shtëpinë e hallës së saj.

¹²⁴ Gazeta Shqip e datës 13 tetor 2013, si dhe nga gazeta të tjera.

2.3. Drejtoresha e Qendrës informon se Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës funksionon sipas Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Qendrave të Zhvillimit. Pyetjes së Komisioneres, nëse rregullorja e sipërpërmendur ka parashikuar, se cilët persona duhet të kryejnë shoqërimin e fëmijëve në shkollë, Drejtoresha e Qendrës i përgjigjet se zakonisht fëmijët shoqërohen nga një pjesëtar i stafit, por rregullorja nuk përcakton saktësisht se detyra e kujt punonjësi duhet të jetë shoqërimi i fëmijëve në shkollë. Zakonisht, fëmijët i shoqëron në shkollë psikologjia dhe mjeku fizioterapist. Ajo pohon faktin se nuk është parashikuar asnjë praktikë e caktuar lidhur me dorëzimin e fëmijëve në shkollë.

2.4. Sipas informacionit të marrë nga Znj. R.N., Drejtoreshë pranë Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës, QZHR është një institucion i përkujdesjes sociale për personat me aftësi të kufizuara. Qendra ka statusin e një institucioni shtetëror dhe është në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. QZHR realizon programe rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara sipas parametrave të tyre psiko-fizikë, duke i ndihmuar ata në integrimin e tyre në jetën shoqërore.

Stafi i kësaj Qendre përbëhet nga 27 punonjës : Drejtori i Qendrës, 1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social, 1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Administratës, 1 (një) Ortofonist, 1 (një) Fizioterapist, 4 (katër) Edukatore, 11 (njëmbëdhjetë) Kujdestarë, 1 (një) Pjatararës, 1 (një) Guzhinier, 1 (një) Punonjës Mirëmbajtjeje dhe 4 (katër) Pastruese. Pranë Qendrës, ushtron funksionet edhe Këshilli Administrativ i saj, i cili përbëhet nga : Drejtori, financieri, punonjësi social, mjeku, prindër dhe donatorë.

Në këtë qendër, aktualisht, strehohen 37 persona. 20 fëmijë që i përkasin moshës 5-14 vjeç dhe janë të sistemuar në një godinë të veçantë, ndërsa pjesa tjetër e personave (17 persona) që banojnë në Qendër, janë të moshës 15-27 vjeç dhe janë sistemuar në godinën tjetër të QZHR. 10 (dhjetë) fëmijë frekuentojnë shkollën, kur janë në gjendje të mire shëndetësore. Shpërndarja e tyre në shkolla, kryhet me furgon, çdo ditë rreth orës 8:00 - 8:20 të mëngjesit.

2.5. Pra, në stafin e kësaj qendre nuk bën pjesë asnjë mjek, thekson R.N. Në rast nevojë, fëmijët vizitohen nga mjeku i familjes dhe diagnozat përkatëse shënohen në kartelën e fëmijës në ambulancën e lagjes dhe tek fletorja e shënimeve të QZHR. Ajo shton se fëmijët e strehuar në Qendër janë me prapambetje mendore, por fizikisht janë të parrezikshëm për të abuzuar seksualisht me njëri-tjetrin. Për ekzaminimin dhe vlerësimin e sjelljes së fëmijëve në Qendër është krijuar grupi multidisiplinor, në përbërje të së cilit është: psikologjia, fizioterapisti, edukatori etj. Ndërkohë, psikologjia e Qendrës bën më dije, se Xh. është diagnostikuar si fëmijë me prapambetje mendore, por jo autike.

2.6. Bashkëpunimi i kësaj qendre me Shkollën Speciale të Fëmijëve ka qenë i mirë. Bashkëpunimi konsiston kryesisht në informacionin që Shkolla i jep Qendrës, lidhur me sjelljen e secilit nxënës në ambientet e shkollës, si dhe gjatë procesit të mësimdhënies. Komunikimi Qendër-Shkollë është i drejtpërdrejtë, asnjëherë nuk ka qenë zyrtar dhe informacionet nuk jepen me shkrim. Në Bordin e Prindërve pranë Shkollës Speciale nuk bën pjesë asnjë përfaqësues i Qendrës së Zhvillimit Rezidencial.¹²⁵

2.7. Znj. R.N. informon gjithashtu edhe mbi aktivitetet e fëmijëve sipas grupmoshave pas orës 16:00, ku dy kujdestarë të Qendrës luajnë rolin kryesor në mbarëvajtjen e këtyre aktiviteteve.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Neni 3, pika 3, neni 7, pika 1, neni 20, pikat 1 dhe 2, germa c), neni 32, pika 1, germa c), pikat 2 e 3 të këtij neni, si dhe neni 33, pikat 10, 11 e 13, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

¹²⁵ Sipas drejtueses së qendrës.

4. OPINIONI

4.1. Përveç aspekteve pozitive të kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuara që banojnë pranë kësaj Qendre, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi edhe disa probleme. Në këtë kontekst, vlen të theksojmë faktin se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është ndalur vetëm në shqyrtimin e atyre çështjeve, të cilat mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, bëjnë pjesë në kompetencat e tij.

4.2. QZHR Durrës funksionon në bazë të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Qendrave të Zhvillimit, rregullore kjo, e cila përcakton rregulla të përgjithshme mbi bazën e së cilave duhet të funksionojnë në përgjithësi të gjitha Qendrat e Zhvillimit në varësi të Shërbimit Social Shtetëror.

4.3. Duke gjykuar se kjo rregullore është hartuar për t’u zbatuar nga shume institucione, nuk ka të specifikuar dhe të parashikuara me hollësi disa praktika rutinë të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Durrës, të cilat pavarësisht faktit se i cilësuam si “rutinë”, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në jetën, shëndetin dhe mbarëvajtjen e fëmijëve që strehohen në qendër. Të tillë konsiderojmë edhe praktikën e shpërndarjes apo përcjelljes së fëmijëve në shkollë, e cila duhet të jetë saktësisht e parashikuar në një akt të brendshëm të kësaj qendre. Në këtë praktikë ditore duhet të përcaktohen saktësisht punonjësit¹²⁶ që duhet të kenë si detyrë shoqërimin e fëmijëve nga Qendra në Shkollë dhe anasjelltas, oraret e sakta të shpërndarjes së fëmijëve, mënyra se si do të dorëzohen këta fëmijë në shkollë (me procesverbal apo ndonjë mënyrë tjetër), si dhe duhet përcaktuar saktësisht edhe punonjësi i Shkollës, i cili duhet t’i marrë në dorëzim këta fëmijë. Mosparashikimi i një praktike të tillë, në një akt të brendshëm të kësaj Qendre, ka sjellë si pasojë mos identifikimin e personave përgjegjës për ngjarjen e ndodhur ndaj Xh.J.

4.4. Mosparashikimi i një pozicioni “mjek” në strukturën e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Durrës shkakton vonesa në ofrimin e shërbimit mjekësor ndaj fëmijëve të strehuar në të. Aktualisht, për ankesat shëndetësore të këtyre fëmijëve njoftohen mjekët e familjes dhe diagnozat e fëmijëve shënohen në kartelat përkatëse në ambulancat e lagjeve, ndërkohë që gjykojmë se prania e vazhdueshme e një mjeku pranë Qendrës është më se e nevojshme për këta fëmijë me aftësi të kufizuara.

4.5. Sikurse është përmendur edhe më sipër, fakt tjetër i konstatuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është edhe mungesa e korrespondencës dhe bashkëpunimit zyrtar ndërmjet Qendrës së Zhvillimit Rezidencial dhe Shkollës Speciale të Fëmijëve, Durrës. Gjykojmë që, për efekt të mbarëvajtjes së aktivitetit të të dy institucioneve, ky bashkëpunim duhet të zyrtarizohet.

4.6. Me rëndësi për t’u përmendur është edhe fakti, se asnjë përfaqësues i Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, nuk bën pjesë në Bordin e Prindërve pranë Shkollës Speciale. Në këtë kontekst, gjykojmë që fëmijët, të cilët banojnë pranë kësaj Qendre duhet të kenë një përfaqësues, që mbron interesat e tyre në këtë bord.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimi i diskriminimit të tërthortë, për shkak të aftësive të kufizuara, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga Qendra së Zhvillimit Rezidencial, Durrës, të fëmijëve të strehuar pranë saj.

5.2. Referuar pikës 1, të këtij vendimi, rekomandojmë :

¹²⁶ Akti në fjalë, (që mund të jetë një rregullore apo urdhër i brendshëm i Drejtoreshës së QZHR), duhet të përcaktojë gjithashtu edhe personat që duhet të zëvendësojnë punonjësit përgjegjës për shoqërimin e fëmijëve, kur këta punonjës mungojnë për arsye të ndryshme, mënyrën se si këta punonjës duhet të njoftojnë eprorin, në rast mungese etj.

- a- marrjen e masave të menjëhershme nga Qendra e Zhvillimit Rezidencial, Durrës në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, për të hartuar një akt të brendshëm të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Durrës, ku të parashikohen me hollësi rregulla të specifikuar, lidhur me shoqërimin e fëmijëve jashtë ambienteve të Qendrës, sidomos lidhur me përcjelljen e tyre në shkollë;
- b- marrjen e masave të menjëhershme nga Qendra e Zhvillimit Rezidencial, Durrës në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, për t'iu siguruar fëmijëve që banojnë në këtë Qendër, trajtim të përshtatshëm mjekësor dhe përkujdesje permanente mjekësore me kohë të plotë, nga ana e personave përgjegjës të ngarkuar për të kryer këtë detyrë.

5.3. Rekomandohet që, bashkëpunimi dhe korrespondenca, ndërmjet Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Durrës dhe Shkollës Speciale të Fëmijëve, Durrës, të zyrtarizohen. Çdo akt apo informacion, që këto dy institucione i drejtojnë njëri-tjetrit, të ketë formën dhe efektet e shkresës zyrtare.

5.4. Rekomandohet që, në Bordin e Prindërve të Shkollës Speciale së Fëmijëve Durrës të bëjë pjesë 1 (një) përfaqësues i Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, i cili të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e fëmijëve që banojnë në këtë Qendër.

5.5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Qendra e Zhvillimit Rezidencial, Durrës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

5.6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FUSHËN E TË MIRAVE DHE SHËRBIMEVE

Ankesa e O.S., në të cilën pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim OSHEE).

V E N D I M Nr. 108/2015

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. O.S. shpjegon se: “Ai i përket komunitetit Rom/Egjiptian. Familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike në masën 4300 lekë në muaj dhe bashkëshortja për shkak të një sëmundje të rëndë është e paaftë për punë. Ankuesi dhe pjestarët e tjerë të familjes janë të rregjistruar në Zyrën Rajonale të Punësimit Elbasan, si punëkërkues të papunë, por ende nuk janë punësuar. Ndërmjet tij dhe OSHEE-së është lidhur kontrata me nr. 17305, për furnizimin me energji elektrike. Duke qënë se ankuesi është debitor në vlerën 406.368 lekë, ndaj OSHEE-së, më datë 04.08.2014, një grup pune i Drejtorisë Rajonale të OSHEE-së Elbasan, kanë ndërprerë energjinë në banesën e tij. Për shkak të pamundësive financiare, ai prej shumë kohësh nuk ka paguar energjinë elektrike. Në vijim O.S. sqaron se energjia elektrike në banesën e tij mund t'i rilidhet vetëm pasi ai të ketë shlyer detyrimin prej 406.368 lekë, që ka ndaj OSHEE-së, gjë që për të është e pamundur. Më datë 01.12.2014, Këshilli Mbikqyrës i OSHEE-së ka miratuar një lehtësi për personat që kanë detyrime të prapambetura, duke i ofruar zbritje në masën 80 % të kamat vonesës për ata që do të paguajnë të gjithë shumën e detyrimit brenda datës 28.02.2015. Ankuesi referuar këtij vendimi sqaron se nuk është në gjendje të përfitojë nga këto lehtësira për shkak të pamundësisë ekonomike, pasi gjatë këtij afati 3-mujor ai mund të siguroj deri në 12900 lekë të ardhura, të cilat edhe nëse i kursen plotësisht, nuk mundet të paguajë të gjithë detyrimin që ka ndaj OSHEE-së. Ankuesi sqaron se me veprimet e saj OSHEE ka trajtuar në mënyrë të diferencuar klientët debitor, duke mos krijuar lehtësi të barabarta për familjet në gjendje të vështirë ekonomike, si dhe për të përfituar nga falja e 80 % të kamat vonesës”.

1.2. Më datën 14.01.2015 është bërë njoftimi dhe kërkesa për informacion për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në lidhje me ankesën për pretendim për diskriminim të O.S.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Familja e ankuesit trajtohet me ndihmë ekonomike në masën 4300 lekë në muaj dhe bashkëshortja për shkak të një sëmundje të rëndë është e paaftë për punë. Ankuesi dhe pjestarët e tjerë të familjes janë të rregjistruar në Zyrën Rajonale të Punësimit Elbasan si punëkërkues të papunë. Duke qënë se ankuesi është debitor ndaj OSHEE-së, më datë 04.08.2014, nga ana Shoqërisë OSHEE është bërë ndërprerja e energjisë elektrike në banesën e tij. Pasi O.S. ka nënshkruar akt marrëveshjen me Shoqërinë OSHEE, për

të shlyer detyrimin e prapambetur në shumën prej 1000 lekë në muaj, është rilidhur energjia elektrike në banesën e tij.

2.2. Me anë të shkresës me nr. 768/1 Prot., datë 13.02.2015, OSHEE, bën me dije se: “Më datë 26.11.2014, Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë “OSHEE” sh.a., ka miratuar Vendimin nr. 7 “Mbi miratimin e skemës për pagesën me këste të detyrimit të energjisë elektrike nga debitorët familjarë”. Nëpërmjet këtij vendimi OSHEE sh.a., ka vendosur miratimin e kushteve lehtësuese ndaj klientëve familjarë të cilët paguajnë detyrimet e prapambetura të energjisë elektrike, përfshirë edhe familjet e kategorizuara në skemën e ndihmës ekonomike”. Shoqëria OSHEE, bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, vuri në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi informacion lidhur me ecurinë e pagesës nga O.S. dhe informacionin lidhur me marrëveshjen për pagesën me këste, 1000 lekë në muaj të detyrimeve të prapambetura.

3. BAZA LIGJORE

3.1. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

3.2. Gjendja ekonomike, është shkak për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me gjendjen ekonomike.

3.3. Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

3.4. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3, pika 3, parashikon se: “Diskriminimi i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.

3.5. Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashtrohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

4. OPINION

4.1. Lidhur me përfitimin nga kushtet lehtësuese që do të zbatohen ndaj konsumatorëve familjarë të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike konstatojmë se: Këshilli Mbikqyrës i OSHEE-së, duke shqyrtuar me kujdes propozimin e Shoqërisë OSHEE sh.a., lidhur me kushtet lehtësuese që do të zbatohen ndaj konsumatorëve familjarë, të cilët ekzekutojnë detyrimet e prapambetura nga vitet e kaluara dhe duke marrë në konsideratë nivelin e të ardhurave mesatare të familjeve shqiptare dhe gjendjen e tyre sociale, ka marrë Vendimin nr. 7, datë 26.11.2014, në përmbajtje të të cilit parashikohet se: *“Përjashtimisht, për familjet e kategorizuara në sistemin e ndihmës ekonomike, vlera e këstit mujor për ekzekutimin e detyrimit të prapambetur, negociohet rast pas rasti nga shoqëria por në çdo rast, nuk mund të jetë më e vogël se 1000 lekë në muaj.”*

4.2. Në këto kushte konsumatorët familjarë dhe familjet me ndihmë ekonomike, përfitojnë nga lehtësirat e krijuara në vendimin e Këshillit Mbikqyrës të OSHEE-së, pasi këtyre familjeve i krijohet mundësia të kryejnë detyrimet e prapambetura duke negociuar me shoqërinë OSHEE, dhe vendosur një afat të shlyerjes së debisë, si dhe një vlerë sipas mundësisë ekonomike të familjeve, si dhe atyre që trajtohen me ndihmë ekonomike.

4.3. Pra, O.S, bazuar në statusin e përfituesit të ndihmës ekonomike, i janë krijuar lehtësira për ekzekutimin e detyrimit të prapambetur, si dhe referuar informacionit të administruar ai ka negociuar me Shoqërinë OSHEE sh.a., ka lidhur aktmarrëveshje dhe aktualisht ka përfituar nga lehtësirat e krijuara.

4.4. Mbështetur në informacionin e sipërcituar, vërehet se nga ana e Shoqërisë OSHEE sh.a, janë marrë masa që familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike t'i krijohet lehtësi për shlyerjen e debisë sipas mundësive ekonomike të tyre, si dhe afati për nënshkrimin e aktmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve familjarë dhe shoqërisë është shtyrë deri në fund të muajit Mars 2015. Në këtë rast konstatohet se familja e O.S. është trajtuar ndryshe në kushte të ndryshme dhe vlerësohet se nuk kemi të bëjmë me një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues.

4.5. *Referuar Vendimit nr. 7, datë 26.11.2014, të Këshillit Mbikqyrës të OSHEE-së, Komisioneri vëren se të gjithë konsumatorët familjarë dhe që bëjnë pjesë në kategorinë e famijeve që trajtohen me ndihmë ekonomike e kanë të pamundur të përfitojnë nga falja e 80 % e kamat vonesës.*

4.6. Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i fakteve, *Komisioneri gjykon se vendimi i marrë nga ana e Këshillit Mbikqyrës të OSHEE-së, i paanshëm në dukje, ka sjellë vendosjen në kushte të disfavorshme të O.S si përfitues i ndihmës ekonomike, në raport me konsumatorët familjarë të cilët kanë mundësi ekonomike për të shlyer të gjithë detyrimin e debisë që i detyrohen OSHEE-së dhe për të përfituar nga falja e 80 % të kamat vonesës.* Në këto kushte, O.S. dhe kategoria e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë duke u vënë në pozita diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike të tyre.

5. VENDIMI

5.1. Konstatimin e diskriminimit për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Shoqërisë OSHEE sh.a, të O.S dhe familjeve që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, për të përfituar nga falja e 80 % e kamat vonesës.

5.2. Detyrimin e Shoqërisë OSHEE sh.a., për të ndaluar në mënyrë të menjëhershme sjelljet dhe veprimet diskriminuese ndaj konsumatorëve familjarë të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike.

5.3. Detyrimin e Shoqërisë OSHEE sh.a., të parashikojë në mënyrë të menjëhershme kushtet lehtësuese për të përfituar nga falja e 80 % e kamat vonesës, për konsumatorët familjarët që trajtohen me ndihmë ekonomike.

5.4. Detyrimin e Shoqërisë OSHEE sh.a., të informojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve Komisionerin lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 33, pika 11 e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

5.5. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikime të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

ÇËSHITJE DISKRIMINIMI NË FUSHËN E TË MIRAVE DHE SHËRBIMEVE

Ankesa e paraqitur nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë kundër Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas, me pretendimin e diskriminimit për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*.

VENDIM Nr. 181 / 2014

1. PROCEDURA E NDJEKUR

1.1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën me Nr. Regj. 62, datë 03.07.2014, të paraqitur nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë, kundër Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas, me pretendimin e diskriminimit për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*. Përfaqësuesi i Shoqatës së Invalidëve të Punës të Shqipërisë, z. A.O shpreh se me datë 01.07.2014, një numri të madh invalidësh i është mohuar e drejta për të udhëtuar falas në urbanët e linjave qytetase të Tiranës. Ndaj tyre është ushtruar dhunë psikologjike dhe fizike në disa raste, nga ana e faturinove, duke i zbritur me forcë nga urbanët, duke i diskriminuar haptazi. E gjithë kjo në kundërshtim të zbatimit të nenit 11, të Ligjit “Për Statusin e Invalidit të Punës”, i cili shpreh se: *“Udhëtimi i invalidëve në mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas”*. Ai kërkon nga ana e Komisionerit që në zbatim të legjislacionit në fuqi, në lidhje me të drejtat e invalidëve të punës, të jenë të mbrojtur nga diskriminimi si dhe të merren të gjitha masat që kjo kategori personash të udhëtojnë falas, me mjetet e transportit urban.

1.2. Komisioneri mori në shqyrtim çështjen, duke ndërmarrë të gjithë procedurat e parashikuara nga Ligji Nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*. Me shkresë zyrtare, Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, bën me dije qëndrimin e saj lidhur me ankesën në fjalë, si më poshtë:

- Duke filluar nga data 23 Maj 2014, ka hyrë në fuqi ligji nr. 37/2014, datë 10.04.2014, “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, i cili shfuqizon aktet apo dispozitat kontraktuale që bien ndesh me të. Në zbatim të nenit 3, kategoria e qytetarëve që përfitojnë udhëtim falas, deri në nxjerrjen e VKM-së që do përcaktojë masat, kriteret dhe procedurat për kompensimin e tarifës së transportit nuk do të mund të udhëtojnë më vetëm me paraqitjen e dokumentit statutor. Për këtë arsye, pas kërkesës së operatorëve privatë, në zbatim të ligjit të sipërcituar, Shoqata ka nxjerrë njoftimet për udhëtarët të cilat ishin vendosur nëpër autobusë e linjave.
- Pas takimeve të bëra me përfaqësues të Bashkisë së Tiranës dhe me Ministrin e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me datë 25 Qershor 2014, këto njoftime janë hequr nga ana e Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas. Përveç këtij veprimi, gjatë muajve Qershor dhe Korrik 2014, këto kategori personash kanë udhëtuar falas.
- Po ashtu, si Shoqatë nuk kanë dijeni që ndaj kësaj kategorie personash të jetë ushtruar forcë, dhunë psikologjike sikundër pretendon z. A.O.

1.3. Me datë 03.10.2014, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore mes palëve. Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas nuk u paraqit në seancën dëgjimore, duke bërë me dije se nuk ka parashtrime të reja për të bërë. Ndërkohë përfaqësuesi i ankuesit solli prova të reja në mbështetje të pretendimit të tij.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

2.1. Shërbimi i transportit qytetas të udhëtarëve në vendin tonë, që prej 12 vitesh ushtrohet kryesisht nga subjekte private, të licensuara nga bashkitë përkatëse, mbi bazën e kontratave të lidhura mes tyre. Veprimet e operatorëve privatë gjatë ofrimit të shërbimit të transportit urban janë vendimmarrje individuale të secilit prej tyre në kuadër të përmbushjes së kërkesave ligjore të njohura në kontratat respektive të nënshkruara me bashkinë.

2.2. Operatorët privatë gjatë kësaj periudhe, për shërbimin e kryer pa pagesë, për kategoritë e personave që sipas ligjit përfitojnë udhëtimin falas, ku bën pjesë edhe kategoria e invalidëve të punës, nuk kanë marrë asnjë lloj kompensimi nga shteti.

2.3. Nga pala që ka bërë ankesën, pranë Komisionerit u paraqit z. A.O, në tagrin e përfaqësuesit të Shoqatës së Invalidëve të Punës të Shqipërisë. Ai paraqiti si provë të pretendimeve të tij për diskriminimin e kësaj kategorie personash rreth 20 (njëzet) deklarata, ku citohej se ishin zbritur me forcë nga autobusët e linjave (cituar specifikisht në deklaratat përkatëse, sipas itinerarit të tyre të lëvizjes) apo u është ndaluar të udhëtojnë pa bileta (bashkëngjitur deklaratave të tyre janë edhe kopje të biletave). Por, pavarësisht kësaj situate, z. A.O shprehet se ky moment konsiderohet i tejkaluar dhe i zgjidhur që në momentin e daljes së shkresë me nr. 3129 Prot., datë 28.05.2014 të Ministrit të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, mbi zbatimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e invalidëve të punës për udhëtimin falas me mjetet e komunikacionit qytetas privat

3. BAZA LIGJORE

3.1. Shqipëria me datë 15.11.2012, miratoi ligjin nr. 108/2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”. Një ndër parimet themelore të saj është edhe parimi i mosdiskriminimit. Konventa ka për qëllim në vetvehte që të nxisë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

3.2. E drejta e invalidëve të punës, si njëra prej kategorive që përfitojnë shërbimin pa pagesë në mjetet e komunikacionit qytetas privat, është e përcaktuar edhe në dokumentacionin licencues dhe certifikues të shoqërive të transportit. Në pikën 6, të Dispozitave të përgjithshme të kësaj licëse, specifikohet se: “Mbajtësi i licencës mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr. 7889/1994, nr. 7663/1993, nr.8626/200, në të cilat përcaktohet: “Invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik, të cilët nga organizatat përkatëse janë pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë falas”

3.3. Në nenin 20, pikën 1, germa a), pikën 2, germa f) si dhe pikën 3 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikohet specifikisht: “Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht: f) lehtësi për transport ose udhëtim; 3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të

mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet”.

3.4. Në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 4, pika 1 e kësaj Konvente përcakton se: *“Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminimin e ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar”.*

3.5. Në nenin 9, pika 2, germa b) të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara¹²⁷ përcaktohet se: *“Shtetet Palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura për: të siguruar se subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun të marrin parasysh të gjitha aspektet e arritshmërisë dhe shfrytëzimit nga personat me aftësi të kufizuar”.*

3.6. Në pikën 1, të nenit 11 të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar, citohet se: *“Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas”.*

4. OPINIONI

4.1. Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerëson se ***lidhur me pretendimin e z. A.O se (për periudhën e cituar në ankesë), kategoria e personave të pajisur me dëshmi invaliditeti apo vërtetim të KMCAP-së që shpreh qartaz aftësinë e kufizuar të tyre, është ndjerë e diskriminuar, duke u përjashtuar nga e drejta e tyre për të përfituar shërbimin falas për të udhëtuar me autobusët e linjave qytetëse të Tiranës.***

4.2. Mbështetur në provat e mëposhtme, Komisioneri e konsideron të vërtetë këtë fakt:

- Referuar vënies së Njoftimit për mosnjohje të librezave apo dëshmime të invaliditetit, nga
- Ana e shoqërive të transportit të linjave qytetëse të: Tiranës, Elbasanit, Shkodrës etj.
- Po kështu referuar dëshmime të paraqitura me deklarata dhe bileta të paguara të kësaj kategorie personash (me statusin e invalidit) përfitues të këtij shërbimi.¹²⁸

4.3. Sa i takon ligjit nr. 37/2014, datë 10.04.2014, “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, përveçse nuk shfuqizon asnjë nga dispozitat ligjore të mëparshme mbi të drejtën e invalidëve të punës për transport falas, mbetet i pazbatueshëm përderisa ende nuk janë miratuar aktet nënligjore. Kjo hedh poshtë edhe pretendimin e Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas, të cituar në shkresën me nr. 320 Prot., datë 11.09.2014, me anë të së cilës pretendojnë se duke filluar nga data 23 Maj 2014, ka hyrë në fuqi ligji nr. 37/2014 e për këtë arsye, pas kërkesës së operatorëve privatë, në zbatim të ligjit të sipërcituar, Shoqata ka nxjerrë njoftimet për udhëtarët, të cilat ishin vendosur nëpër autobusë e linjave.

4.4. Po kështu, neni 3 i këtij ligji përcakton shprehimisht se: “Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohen nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masat, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave”. Referuar interpretimit të këtij neni, pretendimi i Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas se kategorisë së personave me statusin e invalidit nuk i është ofruar shërbimi urban me arsyetimin se operatorët privatë gjatë kësaj periudhe, për

¹²⁷ Heqja e barrierave.

¹²⁸ Kopje të këtyre deklaratave shoqëruar me biletat e autobusëve të paguara, të kategorisë së personave me statusin e invalidit, janë të depozituara në dosjen e sipërcituar.

shërbimin e kryer pa pagesë, për kategoritë e personave që sipas ligjit përfitojnë udhëtimin falas, nuk kanë marrë asnjë lloj kompensimi nga shteti, nuk është i bazuar në ligj. Kur ligji kërkon akte nënligjore specifike për një nen të caktuar, ai është i pazbatueshëm deri në momentin kur të kenë dalë këto akte.

4.5. Sipas Udhëzimit nr. 20, datë 10.10.2007, të Ministrit të Transportit “Për modelet e liçensave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, mbajtësi i liçensës së transportit rrugor mban përgjegjësi për zbatimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e udhëtimit qytetës falas, rrethqytetës dhe ndërqytetës me 50% të vlerës së biletës, për invalidët e punës”.

4.6. Pavarësisht kësaj situate, çështja për të cilën filloi ankesa e ardhur pranë KMD-së nga z. A.O, konsiderohet se është zgjidhur në favor të kësaj kategorie personash. Kjo referuar:

1. Deklarimeve të vetë z. A.O gjatë seancës dëgjimore.¹²⁹
2. Shkresës të Ministrit të Ministrisë Së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,¹³⁰ në të cilën citohet se kjo Ministri do të vijojë monitorimin e kësaj çështjeje në vazhdimësi dhe do të procedojë me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion në rast se do të konstatohen shkelje të legjislacionit në fuqi, lidhur me respektimin e të drejtave të kësaj kategorie personash.
3. Shkresës së Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas, me anë të së cilës bëjnë me dije se pas takimeve të bëra me përfaqësues të Bashkisë së Tiranës dhe me Ministrin e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me datë 25 Qershor 2014, këto njoftime janë hequr nga ana e Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas. Përveç këtij veprimi, gjatë muajve Qershor dhe Korrik 2014, këto kategori personash kanë udhëtuar falas.

4.7. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka bërë herë pas here rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nxjerrjen e akteve nënligjore, lidhur me këtë kategori personash. Ky fakt evidentohet edhe në Raportin Vjetor 2013, të Komisionerit, më specifikisht në Seancën Publike në Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23.10.2013, për masat e marra për strehimin e familjeve romë dhe për pagesat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Duke qenë se romët edhe personat me aftësi të kufizuara janë dy nga kategoritë me të cilët KMD zhvillon pjesën më të madhe të punës, Komisionerja theksoi problematikat e këtyre grupeve vulnerabël si dhe rekomandimet e nxjerra për përmirësimin e situatës së tyre.

5. VENDIMI

5.1. Në bazë të nenit 20, pika 1, gërma a), pika 2, gërma f), pika 3, nenit 32, gërma c), si dhe nenit 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi **konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar**, ndaj kategorisë së personave më dëshmi invaliditeti-pune, nga ana e operatorëve privat të shërbimit të transportit qytetas të Tiranës.

5.2. Pushimin e çështjes për shkak se situata është zgjidhur në favor të kësaj kategorie, në emër të të cilëve, z. A.O ka paraqitur edhe ankesën pranë Komisionerit dhe konsiderohet se është arritur qëllimi.

5.3. Rekomandimin e Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas, për të patur në vëmendje zbatimin me korrektësi të gjithë kuadrit ligjor të sipërcituar në vendim, që në të ardhmen të mos ketë sërish përsëritje të situatave të ngjashme, në dëm të kësaj kategorie personash.

129 Deklarimet e z. A.O. i referohen Proces-verbalit të datës 02.10.2014.

130 Shkresës me nr. 3129 Prot., datë 28.05.2014 të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

PËRMBLEDHJA E LËNDËS

Çështje të diskriminimit për shkak të gjinisë	1
Çështje të diskriminimit për shkak të gjinisë, shtatëzanisë dhe gjendjes shëndetësore	4
Çështje të diskriminimit për shkak të “bindjeve politike”	7
Çështje të diskriminimit për shkak të bindjeve politike	11
Çështje të diskriminimit për shkak të bindjeve politike	14
Çështje diskriminimi në fushën e arsimit për shkak të bindjeve fetare	18
Çështje diskriminimi për shkak të gjendjes ekonomike	25
Çështje diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor	29
Çështje të diskriminimit për shkak të racës dhe etnisë	35
Çështje të diskriminimit në punë për shkak të racës	39
Çështje të diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar dhe bindjeve politike	42
Çështje të diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar	45
Çështje të diskriminimit për shkak të vendbanimit	48
Çështje të diskriminimit për shkak të mëmësisë dhe gjinisë	52
Çështje diskriminimi për shkak të gjendjes shëndetësore dhe përkatësisë në një grupim sindikal	55
Çështje të diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore	61
Çështje të diskriminimit për shkak të moshës	65
Çështje diskriminimi për shkak të gjendjes arsimore	69
Çështje diskriminimi për shkak të gjendjes arsimore	74
Çështje të diskriminimit për shkak të lidhjes familjare	81
Çështje diskriminimi në formën e diskriminimit të drejtpërdrejtë	85
Çështje të diskriminimit në formën e “diskriminimit të drejtpërdrejtë”	88
Çështje diskriminimi të drejtpërdrejtë	91
Çështje të diskriminimit në formën e diskriminimit të tërthortë	97
Çështje e diskriminimit në formën e diskriminimit të tërthortë	101
Çështje të diskriminimit në formën e viktimizimit	106
Çështje të diskriminimit përmes udhëzimit për të diskriminuar	109
Çështje diskriminimi në fushën e arsimit	113
Cështje te diskriminimit ne fushen e arsimit. Të diskriminimit në fushën e arsimit	118
Çështje të diskriminimit në fushën e punësimit, në arsimin e lartë universitar	121
Çështje të diskriminimit në fushën e punësimit	126

Çështje diskriminimi në fushën e punësimit	130
Çështje diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve	137
Çështje diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve	141
Çështje diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve	145

